GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Materiale mësimore për vitin e parë

Arsimi i gjimnazit

Përmbajtja

Fusha programore: *GJUHË DHE KOMUNIKIM*

RRETH GJUHËS SHQIPE

Shkenca e gjuhës

Gjuha shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane

Zhvillimit historik i gjuhës letrare shqipe

GJUHËSI

Degët kryesore të gjuhësisë

Fonetikë dhe fonologji

Theksi

Drejtshkrim dhe drejtshqiptim

Shenja të pikësimit

Fjalët e shkurtuara dhe shkurtesat

TË DËGJUARIT, TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT

Të dëgjuarit për të kuptuar

Të lexuarit për të kuptuar

Të shkruarit e teksteve për komunikim zyrtar dhe jozyrtar

Fusha programore: *LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA*

TEORIA E LETËRSISË

Arti dhe llojet e tij

Shkenca e letërsisë

Ndarja e letërsisë

Lirika

Figurat stilistike

Epika

Llojet epike në vargje

Llojet epike në prozë

Llojet epiko-lirike

Fusha programore: *NJOHURI MEDIATIKE*

Fakte dhe opinione

Burime të informacionit

Vërtetim i fakteve

Paragjykimi dhe manipulimi

Dezinformata dhe lajme të rreme

Shkenca e gjuhës

Shkenca e gjuhës (linguistika), është shkenca që merret me studimin e gjuhës njerëzore – si funksionon gjuha, si është ndërtuar, si përdoret dhe si zhvillohet me kalimin e kohës. Ajo nuk merret vetëm me fjalët por edhe me rregullat dhe mënyrën se si njerëzit komunikojnë. Shkenca e gjuhës na shërben për të ruajtur dhe zhvilluar gjuhët, njëkohësisht është edhe e rëndësishme, sepse na ndihmon të kuptojmë si komunikojnë njerëzit.

Gjuha është një sistem që përbëhet nga tinguj, të cilët kur kombinohen në mënyrë të caktuar formojnë fjalë. Fjalët pastaj përdoren për të ndërtuar fjali. Ajo është një dukuri e ndërlikuar, prandaj ekzistojnë një varg disiplinash që e studiojnë atë. Gjuha shërben për të formësuar dhe komunikuar mendimet. Për ta plotësuar këtë rol, ajo ka një sistem shenjash që njerëzit të merren vesh mes tyre. Gjuha është mjeti kryesor i komunikimit mes njerëzve, ajo nuk është vetëm një sistem shenjash, por ura që lidh njerëzit me njëri-tjetrin. Është mjeti më i fuqishëm i njeriut për të ndërtuar botën shoqërore, kulturore she shpirtërore.

Komunikimi është procesi përmes të cilit një person i përcjell një informacion një personi tjetër ose një grupi personash. Komunikimi nis në familje por zhvillohet gjatë edukimit shkollor. Njerëzit komunikojnë ndërmjet tyre në mënyra të ndryshme: duke folur, duke shkruar, me gjeste, mimikë, shenja ose duke i kombinuar të gjitha këto. Komunikimi është një ndër veçoritë më të rëndësishme të njeriut me anë të të cilit shkëmbehen dhe kuptohen informacionet midis njerëzve. Pra, ne çdo ditë marrin dhe japin informacione, të cilat na nevojiten në jetën tonë të përditshme. Disa nga këto informacione i marrim dhe i japim me ndihmën e sinjaleve të thjeshta, siç është për shembull drita e kuqe e semaforit, që do të thotë *"ndal"*, lëvizja e kokës lart-poshtë , që do të thotë *"pohim"*, apo drita rrotulluese e ndihmës së shpejtë, që do të thotë "hapni rrugën" ose që na bën të kuptojmë se bëhet fjalë për një rast urgjent. Por, mbi të gjitha duhet mbajtur në mend se çdo lloj i komunikimit arrihet vetëm atëherë kur pjesëmarrësit i interpretojnë shenjat në mënyrë të njëjtë. Nëse ky sistem shenjash, me anë të të cilit komunikojmë, shprehet nëpërmjet të folurit, atëherë kjo nënkupton që të dy palët duhet ta njohin atë gjuhë. Gjatë procesit të komunikimit ne zbatojmë një skemë të caktuar, ku kemi gjithmonë një **dërgues** i cili ka një mesazh dhe të cilin duhet ta përçojë te **marrësi**. Por, që mesazhi të përçohet me sukses, duhet të ekzistojë një **kod**, i cili mund të jetë mund të jetë një fjalë e shqiptuar apo e shkruar, një shenjë komunikacioni, një gjest ose ndonjë mënyrë tjetër e të shprehurit. Veç këtyre, duhet doemos të ekzistojë një kanal komunikimi, i cili ndodhet ndërmjet dërguesit të mesazhit dhe marrësit të mesazhit.

Komunikimi verbal është lloj i komunikimit me anë të gjuhës (të folur ose të shkruar), duke përdorur fjalë, fjali dhe rregulla gjuhësore pët të shprehur mendime, ndjenja ose informacion, shembull, një bisedë me shokët, një letër ose një mesazh elektronik, një

ligjëratë apo mësim në klasë.

Komunikimi joverbal është një mënyrë tjetër e të shprehurit të mendimeve, ndjenjave dhe qëndrimeve pa përdorur fjalë. Shoqëron gjithmonë komunikimin verbal, por shpesh mund të ketë edhe më shumë ndikim se fjalët vetë. Format kryesore të komunikimit joverbal janë:

- **Mimika** (shprehjet e fytyrës) – Një buzëqeshje tregon gëzim ose mirësjellje, një vetull e ngritur mund të trgojë habi, kurde një fytyrë e vrejtur shpreh mërzitje apo zemërim etj.
- **Gjestet** (lëvizjet e duarve dhe trupit) – Ngritja e dorës për të marrë fjalën në klasë, tundja e dorës tregon pershëndetje, gishti i vendosur në buzë për heshtje etj.
- **Kontakti me sy** (shikimi) – një shikim i derjtpërdrejtë tregon siguri, vëmendje ose respekt, shmangja e syve mund të nënkuptojë turp ose mungesë interresi etj.
- **Qëndrimi** – Si qëndrojmë ose si ulemi jep një mesazh për gjendjen tonë, një trup i drejtë dhe i hapur trgon vetëbesim, ndërsa një trup i përkulur mund të trgojë pasiguri ose lodhje.
- **Toni i zërit** – edhe kur përdorim fjalë, mënyra si i themi ka peshë të madhe, një ton i lartë mund të tregoj yemërim, ndërsa një ton i qetë shpreh mirëkuptim.
- **Prekja** – një shtrëngim duarsh, një përqafim apo një prekje mbi sup tregojnë respekt, ngrohtësi ose mbështetje emocionale.
- **Shenjat** - janë figura, shkrime apo vizatime që përdoren për të treguar ose për të na kujtuar diçka. Të tilla mund të jenë shenjat e komunikacionit që janë pjesë e rëndësishme e komunikimit joverbal, sepse ato përcjellin rregulla dhe paralajmërime për drejtuesit e mjeteve dhe për këmbësorët, pastaj shenjat e pikësimit, shenjat që përdoren në matematikë etj. Këto shenja kuptohen pa pasur nevojë të flasim.
- **Simbolet** - janë elementë që përfaqësojnë diçka në mënyrë indirekte, nëpërmjet një shoqërimi kulturor. Kuptimi i simbolit nuk është i qartë dhe kërkon njohuri paraprake për interpretimin e tij. Ata mund të jenë gjithashtu imazhe, ngjyra ose forma që përfaqësojnë diçka specifike. Për shembull: zemra e kuqe simbolizon dashurinë, emotikonet gjithashtu, paraqesin simbole të fuqishme sot në epokën digjitale. Dallimi kryesor midis shenjave dhe simboleve është se shenjat përfaqësojnë diçka drejtpërdrejt, ndërsa simbolet e bëjnë këtë në mënyrë indirekte. Me fjalë të tjera, shenjat nuk kërkojnë interpretim, ndërsa simbolet kërkojnë.
- **Sinjalet** - janë shenja të vendosura sipas një marrëveshjeje që japin udhëzime të qarta dhe që interpretohen njësoj nga të gjithë. Ato mund të jenë pamore apo zanore. Për shembull: Llamba e verdhë pulsuese e makinës tregon kthesën e makinës djathas ose majtas, zëri i autoambulancës tregon një rast urgjrgjent, zilja e shkollës tregon fillimin ose mbarimin e orës mësimore etj.

Në bazë të kësaj, kuptojmë se komunikimi joverbal shpreh emocione të sinqerta, që fjalët apo komunikimi verbal mund t'i fshehin. E bën komunikimin më të gjallë dhe më të kuptueshëm dhe mund të plotësojë, forcojë ose kundërshtojë fjalët që themi. Ky komunikim kuptohet shpesh edhe përtej gjuhëve, pra një buzëqeshje ose një gjest kuptohet kudo në botë.

Komunikimi njëkahësh – ndodh atëherë kur dërguesi dhe pranuesi i mesazhit kanë role të veçanta dhe me njëri tjetrin janë të pavarur. Kjo formë karakterizohet nga fakti se nuk ka informata kthyese nga pranuesi te dërguesi i mesazhit. Për shembull, kur dëgjohen lajme në radio ose televizion.

Komunikimi i ndërsjellë - mundëson pranim të informatës kthyese momentale, ofron mundësinë për të vendosur kontakte personale dhe nëpërmjet kësaj, informacione nga shenjat joverbale. Komunikimi ballë për ballë është forma më e pasur e komunikimit. Këtu përfshihen biseda joformale, prezantime gojore, intervista, fjalime dhe video-konferenca. Ky lloj komunikimi mundëson informata kthyese të menjëhershme. Këtu përfshihen bisedat telefonike, letërkëmbimi nëpërmjet internetit, shkrimi i mesazheve përmes telefonit celular, etj. Në këtë lloj komunikimi, folësit duhet të flasin qartë në mënyrë që të kuptojnë mesazhin dhe të kthejnë përgjigje, pasi sinjalet joverbale mungojnë.

Fjalimi - është një formë tjetër e komunikimit me anë të të folurit para publikut, zakonisht me një përmbajtje të përgatitur më parë, për të dhënë një informacion apo për të treguar qëndrime dhe për të bindur dëgjuesin.

Funksionet e gjuhës

Funksionet e gjuhës lidhen me mënyrat se si ajo përdoret në komunikim dhe me rolin që luan në marrëdhënie mes njerëyve. Studiues të ndryshëm i kanë përcaktuat në forma të ndyshme, por më e njohura është ndarja e Roman Jakobson-it. Sipas tij njihen disa funksione krzesore të gjuhës:

Funksioni referencial (informues) - ky funksion përdoret për të na dhënë informacion për diçka që na rrethon, ndodh ose ekyiston. Për shembull: *Shfaqja do të fillojë në orën 12:00.*

Funksioni emotiv (shprehës) - shpreh ndjenjat, emocionet ose gjendjen e folësit. Për shembull: *O sa u gëzova!*

Funksioni konativ (thirrës) - përdoret për të nxitur dëgjuesin të bëjë diçka, për t'i dhënë urdhra, këshilla, kërkesa. Për shembull*: Mbylle derën! Eja këtu! Më jep pak ujë, të lutem!*

Funksioni fatik (kontakti) – shërben për të hapur, mbajtur ose mbyllur komunikimin. Për shembull: *Alo, më dëgjon?*

Funksioni poetik – lidhet me formën e bukur të shprehjes, përdoret në letërsi, në poezi, në këngë.

Fuksioni metagjuhësor – përdoret për të shpjeguar vetë gjuhën, fjalët ose kuptimet. **Metagjuha** është gjuha që përdoret për të shpjeguar gjuhën vetë. Pra, kur ne flasim rreth fjalëve, rreth kuptimeve, rreth rregullave gramatikore apo rreth funksioneve të gjuhës, atëherë ne përdorim matagjuhën.

Diskutim

- Shpjegoni rëndësinë e gjuhës si mjet për komunikim dhe fuqinë e saj mbi mënyrat e tjera të komunikimit!
- Krahasoni dhe interpretoni veçoritë dhe funksionet e gjuhës!
- Jepni dhe ju shembuj të llojeve të ndryshme të komunikimit!
- Demonstroni disa nga llojet e komunikmit!
- Shpjegoni kuptimin e termit metagjuhë!

Gjuha shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane



Gjuhët indoevropiane

Gjuha indoevropiane përfshinë një grup të madh gjuhësh që ndajnë një orgjimë të përbashkët. Ajo shtrihet nga India deri në Evropë, duke përfshirë një gamë të gjërë dialektesh dhe variantesh.

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, ku futen gjuhët indoiranike, greqishtja, gjuhët romane, gjuhët sllave, gjuhët gjermane, etj. Ajo formon një degë të veçantë në këtë familje gjuhësore dhe nuk ka ndonjë lidhje prejardhjeje me asnjerën prej gjuhëve të sotme indoevropiane. Përveç shqipes, greqishtja dhe armenishtja janë gjithashtu gjuhë të veçanta, secila më vete. Ndërsa, nga ana tjetër, flitet për grupe gjuhësh si grupi i gjuhëve sllave (*rusishtja, polonishtja, çekishtja, serbokroatishtja, bullgarishtja etj.),* grupi i gjuhëve romane *(italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, rumanishtja etj.*), grupi i gjuhëve gjermanike *(gjermanishtja, anglishtja, danishtja, norvegjishtja, suedishtja etj.)*e të tjera. Kanë ngjashmëri dhe lidhje të shumta mes tyre, që tregon se këto gjuhë kanë një prejardhje të përbashkët.

Gjuha shqipe daton që nga periudha e vonë antike, duke evuluar përmes ndikimeve të shumta kulturore dhe politike. Karakteri indoevropian i shqipes, përkatësia e saj në familjen gjuhësore indoevropiane, u arrit të përcaktohej e të vërtetohej që nga mesi i shekullit XIX, në sajë të studimeve të gjuhësisë historike krahasuese. Ishte sidomos merita e njerit prej themeluesve kryesorë të këtij drejtimi gjuhësor, dijetarit të njohur gjerman Franz Bopp, që vërtetoi me metoda shkencore përkatësinë e gjuhës shqipe në familjen gjuhësore indoevropiane. Franz Bopp i kushtoi këtij problemi një vepër të veçantë me titull *""Mbi shqipen në lidhjet e saj farefisnore"*, botuar në vitin 1854. Në ndarjen e gjuhëve indoevropiane në dy grupe: në gjuhë lindore ose satem dhe në gjuhë perëndimore ose kontum, shqipja shkon me gjuhët lindore (satem), bashkë me gjuhët indoiranike, gjuhët balto-sllave dhe me armenishten.

Veçoritë e gjuhës standarde shqipe:

- Një ndër veçoritë e gjuhës shqipe është alfabeti latin me 36 shkronja.
- Është gjuhë sintetike (shumë kuptime që shprehen me mbaresa fjalësh)
- Ka një sistem të pasur foljor me shumë kohë dhe mënyra.
- Ka rasat gramatikore të emrit dhe mbiemrit (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore)
- Ka një fjalor të pasur, me fjalë autoktone dhe huazime nga gjuhë të ndyshme (latinishtja, greqishtja, turqishja, sllavishtja, sllavishtja, italishtja)

Dallimet e shqipes me gjuhët e tjera indoevropiane:

- Shqipja është gjuhë orgjinale, me degë më vete, ndryshe nga gjuhët romane, gjermanike apo sllve.
- Morfologjia: ka ruajtur rasat, ndryshe nga anglishtja dhe gjuhët e tjera moderne që i kan; humbur.
- Fonetikë e veçantë: ka tinguj unikë (ë, y, q, gj, rr, ll).
- Fjalori: ka shtresë të lashtë autoktone që nuk gjendet në gjuhë të tjera.

Diskutim

- Shpjegoni prejardhjen e gjuhës shqipe si degë e veçantë në familjen e gjuhëve indoevropiane.
- Shpjegoni dhe identifikoni veçoritë e gjuhës standarde shqipe, si dhe afërsitë dhe dallimet e saj me gjuhët e tjera indoevropiane.

Zhvillimi historik i gjuhës letrare shqipe

Periudha parahistorike: Kjo periudhë fillon me shfaqjen e njeriut dhe zgjat deri në shpikjen e shkrimit. Për shkak të mungesës së burimeve të shkruara, njohuritë tona për parahistorinë mbështeten kryesisht në gjetjet arkeologjike, si mbetjet e objekteve, mjeteve, dhe strukturave. Të vetmet shenja nga gjetjet arkeologjike gjenden në muret e shpellave të banuara nga njerëzit parahistorikë. Ato ishin shkrime ideografike, pra figura të thjeshta e të zakonshme të skenave të gjuetisë apo të riteve të magjisë. Këto figura quhen ideograma. Parahistoria ndahet më tej në paleolitik (epoka e vjetër e gurit), neolitik (epoka e re e gurit), dhe epokën e bronzit dhe hekurit.

Periudha historike: Historia e njerëzimit fillon atëherë, kur ajo fillon të shkruhet, d.m.th. kur fillon rregjistrimi i shkruar, pra kur fillojnë dokumentet e shkruara, të quajtura shkrimet e para. Gjuha shqipe edhe pse është një nga gjuhët e lashta të Ballkanit, me shkrim është e dokumentuar mjaft vonë, në shekullin XV.



"Formula e pagëzimit" (1462) - është dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe. Është një fjali e shkurtër: *"Unë të pagëzoj në emër të Atit, e të Birit e të Shpirtit Shenjt". ("Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit")* e shkruar nga Kryepeshkopi i Durrësit Pal Engjëlli, bashkëpunëtor i ngushtë i Skënderbeut.

I zbuluar në vitin 1915 nga Nikolla Jorga në Arkivin e Vatikanit, është dëshmia më e vjetër e ruajtur në gjuhën shqipe. Për shkak të jetesës së vështirë në zonat malore dhe mungesës së klerikëve, kjo formulë u hartua që prindërit të pagëzonin vetë fëmijët. Është shkruar në gegërisht, me alfabetin latin. Ky dokument shënon jo vetëm fillimin e periudhës së shqipes së shkruar, por edhe përdorimin e parë të shqipes në ritualet fetare.

"Fjalorthi i Arnold von Harfit" (1497) - i hartuar nga një udhëtar gjerman që vizitoi brigjet shqiptare në vitin 1497. Ai përfshiu 26 fjalë, 8 shprehje, si dhe numrat nga një deri në dhjetë, 100 dhe 1000 – të gjitha të përkthyera në gjermanisht. Kjo dëshmi tregon përdorimin e gjuhës shqipe të folur në jetën e përditshme.

Më saktësisht, bëhet fjalë për një ditar udhëtimi, ku autori kishte përpiluar një fjalor të vogël që ne e quajmë *Fjalorth shqip-gjermanisht*, me fjalë dhe shprehje që i kishte mbledhur gjatë qëndrimit në trojet shqiptare dhe t'i mbajtur mend më mirë, pranë fjalës shqipe shënoi edhe atë gjermane. Edhe ky dokument ka rëndësi të veçantë për gjuhësinë sepse vërteton veçoritë e dialektit të veriut.


Pri s(h)in Matthèe / ungjil, anagolosme - + Evangjil s(h)inti: e prempte e madhe.
I me nesër që ès(h) er(r), që ès(h)të me è prëmte, u mbilodhi e prifterì edhè Farisei, e thenë Pilatoi: / Zot, e kuituam se aì u plan edhè kur qe ngjal(l) / e the se pre tre dit pirèremi. Urdhurò / as(h)tu, ngjèel(l)si Zot, t'u mbil(l)etë var(r)i mos po kę e vini nate, e avtù mathitè e vjedhin; / atà pra thon lausi se u ngre së vdèkur e is(h)të'i ma keqi së prapa <s>e keqi së para. / Pra tha Pilati: Keni kustodhì, prin t'e mbil(l)ë / var(r)ën e, si e pat, sfragjisne me gurin me t' / gjithë kustodhie. + S(h)um vjet, Zoti nun.

Transkriptimi në shqip i Perikopes së shekullit XIII – XIV

"Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve" (shek. XIV) -një tjetër dokument nga dëshmitë më të hershme të shkrimit të gjuhës shqipe, që daton rreth shekullit XIV-XV, i gjetur në një dorëshkrim në gjuhën greke, në Bibliotekën Ambroziane të Milanos.

Fjala *"perikope"* do të thotë një pjesë e shkëputur nga një tekst më i madh, në këtë rast një fragment i Ungjillit të Shën Mateut. Ky shkrim ka rëndesi të veçantë, pasi vërteton se gjuha shqipe në shekullin e XIV, shkruhej në dy dialektet kryesore dhe me dy alfabete, latin dhe grek, më saktë, dëshmohet se kultura arbërore dhe jeta shpirtërore konfensionale e popullit tonë, ishte nën ndikimin e kultures latine-katolike dhe asaj bizantine-ortodokse.

Periudha e re- (nga shkrimet e para deri në ditët e sotme**):** Rruga dhe fati i zanafillës dhe i zhvillimit të gjuhës shqipe në përgjithësi, si dhe i gjuhës letrare në veçanti, ndonëse shekuj me radhë nën zgjedhën e robërive të njëpasnjëshme, ka pasur një ecuri të veçantë. Populli ynë gjatë shekujve ka ruajtur individualitetin dhe identitetin e tij kombëtar me anë të asaj që ka krijuar vepra të ndryshme. Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe ka kaluar në periudha të ndryshme, duke pasur një ndikim të theksuar në historinë tone, që njihet më së miri si **Periudha parakombëtare** dhe **Periudha kombëtare** (nga viti 1860 e gjer më sot).

- **Periudha parakombëtare** (shek. XV, XVI-1860) - Kjo periudhë përbën në vetvete etapën e formimit të gjuhës shqipe si gjuhë e përgjithshme e popullit ose si gjuhë e kombit shqiptar. Ajo shkruhej në vepra kryesisht me karakter fetar të cilat përbëjnë edhe momunentet e para gjuhësore të shqipes së shkruar. Kjo periudhë fillon me **Mesharin e Gjon Buzukut** (1555) si vepër e parë e plotë e shkruar në gjuhën shqipe dhe me **Lekë Matrëngë** me veprën *"E mbsueme e krishterë"* (1592), e më vonë me veprat e tyre vijojnë **Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdadni, Jul Variboba etj.**

Kjo periudhë quhet parakombëtare sepse gjuha shqipe ende nuk kishte marrë rolin e gjuhës së unitetit kombëtar, por përgatiti terrenin për periudhën kombëtare, kur gjuha u bë mjet i lëvizjes politike dhe kulturore.

- **Periudha kombëtare** (nga 1860 e gjer më sot) – Kjo periudhë përfshinë zanafillën e Rilindjes Kombëtare dhe përpjekjet që rilindësit dhanë për pasurimin e gjuhës shqipe si dhe pastrimin e saj nga huazimet e tepërta. Hapi i parë i kalimit nga Periudha parakombëtar në Periudhën kombëtare mund të merret *"Evetari"* i **Naum Veqilharxhit,** që është abetarja e parë e gjuhës shqipe**,** botuar për herë të parë në vitin 1844. Ky dokument është konsideruar si manifesti i parë i lëvizjes sonë kombëtare,

Kjo periudhë mund të ndahet në tri etapa, edhe atë:

I. **prej 1860 gjer në shaplljen e Pavarësisë- (1860-1912);**
II. **prej 1912 gjer në çlirimin e vendit (1912-1944);**
III. **prej çlirimit (1944) gjer më sot.**

Etapa e parë e gjuhës letrare kombëtare karakterizohët me qëllime përparimtare të Rilindjes Kombëtare, me përpjekje që të krijohët një gjuhë e njësuar, kështu që shkrimet shqipe t'i shërbenin kombit. Pas shumë përpjekjesh, u përcaktua edhe alfabeti unik i gjuhës shqipep në Kongresin historik të Manastirit **(Kongresi i Alfabetit-1908).** Brenda kësaj kohe, gjthashtu, u hartuan edhe disa gramatika të gjuhës shqipe përpos disa te huajave, edhe nga autorët shqiptarë, si: **Dhimitër Kamarda** (në italishte), **Kostandin Kristoforidhi** (në greqishte), **Sami Frashëri** (në gjuhën shqipe), **Pashko Vasa** (në frengjishte) etj. **Kostandin Kristoforidhi**, në atë kohë, hartoi edhe "*Fjalorin shqip-greqisht"* që u botua më 1904 dhe bashkë me veprën "*Fjalori i ri i shqipes"* nga Shoqëria ***"Bashkimi"*** e botuar më 1908, u bënë mbështetje e fortë për zhvillimin e mëtejmë të gjuhës letrare shqipe.

Etapa e dytë. Në këtë etapë gjuha jonë letrare zë të zhvillohët e të pasurohet tani brenda shtetit të pavarur shqiptar (1912-1939). Ajo tashmë zë të bëhet armë e forcimit dhe zhvillimit të shtetit shqiptar, bën një hap të madh përpara, donëse me shumë peripeci e pengesa, meqë shteti ishte në duart e fedoborgjezëve. Forcat përparimtare intelektuale bënë përpjekje e punë të mëdha në këtë drejtim: Formuan *Komisinë Letrare të Shkodrës* (1916), mbajtën *Kongresin e arsimtarëve të Lushnjës* (1920). Në këtë menyrë përpjekje gjithnjë e më të mëdha për zgjedhjen e çështjës së gjuhës letrare - për lëvrimin, pasurimin dhe njësimin e saj. Procesin e formimit, të njësimit, të shqipes letrare e pengoi edhe pushtimi i okupatorëve italianë e gjermanë.

Etapa e tretë dhe përfundimtare e njësimit të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj zë fill me çlirimin nga regjimet antipopullore e posaçërisht nga okupimi italiano-gjerman, atëherë kur populli punonjës e mori pushtetin dhe mjetet e prodhimit në duart e veta

Me gjithë kushtet e vështira e të pasluftës, fillojnë të krijohen kushte të reja, të lira, pa pengesa, për njësimin e gjuhës letrare dhe të drejtshkrimit të saj. Revolucioni popullor, sistemi socialist, me pëermbysjen e së vjetrës antikombëtare, dhe me ndryshimin rrënjësor të mardhënieve ekonomike-shoqërore, hapin shtigje e perspektiva të reja në të gjitha fushat e jetës. Në të gjithë vendin hapen edhe institute, shkolla të larta pedagogjike, univerzitet, e në fund edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve. Veprimataria botuese dita-ditës merr hov të madh ku botohen libra të ndryshëm.

Kjo dinamikë e madhe e zhvillimit të popullit tonë në të gjitha sferat e jetës bëri që procesi i i bashkëveprimit të të dy varianteve letrare, të të dy dialekteve, të shpejtohet, për të cilën gjë mbahen konferenca e konsullta gjuhëtarësh, letrarësh e dashamirësh të gjuhës së shkruar shqipe për afrimin dhe për njësimin e gjuhës e të drejtshkrimit. Të gjitha këto arritje të mëdha më në fund u kurorëzuan me vendimet e **Kongresit të Drejtëshkrimit**, të mbajtur në Tiranë 1972. Drejtshkrimi i njësuar i sanksionoi trajtat normative dhe e ngriti gjuhën shqipe në nivelin e gjuhëve të tjera të zhvilluara letrare. Kështu edhe shqiptarët u bëne me një gjuhë dhe drejtshkrim të njësuar letrar siç vepruan shumë më herët edhe popujt e tjerë të kulturuar. Gjuha letrare shqipe, të cilën ndryshe e quajmë edhe standarde, është gjuhë e normuar, e organizuar në nivelin më të lartë e me mundësi jashtëzakonisht të mëdha të përgjithësimit gjuhësor, Ajo s'ka variante dhe nuk njeh kufij dialektorë apo të folmesh.

Diskutim

- Dalloni periudhën parahistorike!
- Krahasoni veçoritë e përgjithshme të dëshmive të periudhës parahistorike dhe të shkrimeve të para të periudhës historike të gjuhës shqipe!
- Njihni etapat e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në periudhën e re!

Degët kryesore të gjuhësisë

Meqë gjuha është mjet kryesor për komunikim midis njerëzve dhe për zhvillimin e të gjitha shkencave e të mbarë shoqërisë, ajo ka filluar të studiohet qysh në kohët më të lashta të historisë së njeriut. Shkenca që merret me studimin e gjithanshëm të gjuhës quhet *gjuhësi* ose *linguistikë* (nga *lingua = gjuhë*) që do të thotë *shkencë mbi gjuhën.* Kjo shkencë i studion veçoritë e përgjithshme të të gjitha gjuhëve: lindjen dhe zhvillimin e tyre, ndryshimet që ndodhin etj. Degët kryesore të gjuhësisë janë: *fonetika, leksikologjia* dhe *gramatika.*

Fonetika është degë e gjuhësisë që studion tungujt e gjuhës, mënyrën e formimit të tyre, veçoritë akustike e fiziologjike, llojet e tingujve, ndryshimet që pësojnë tingujt në pozicione të ndryshme, theksin, intonacionin, rrokjen etj. Me fonetikën është i lidhur ngushtë edhe drejtshqiptimi ose ortoepia.

Leksikologjia po ashtu është degë e gjuhësisë, e cila merret me studimin e fjalëve të një gjuhe. Fjala *leksikologji* vjen nga greqishtja dhe përbëhet nga fjalët *leksis = fjalë* dhe *logos = dituri,* që do të thotë shkencë mbi fjalët. Pra si degë gjuhësore leksikologjia studion thesarin e fjalorit të një gjuhe, kuptimin e fjalëve, shprehjet frazeologjike **etj.**

Gramatika është dega më e rëndësishme e gjuhësisë, sepse ajo studion strukturën e gjuhës e kjo është ana më themelore e gjuhës. Fjala gramatikë vjen nga greqishtja *gramatechne* që do të thotë *art i të shkruarit,* por sot me këtë fjalë kuptojmë shkencën që merret me studimin e rregullave të ndryshme të fjalëve dhe të **bashkimit** të tyre në togfjalësh e në fjali. Gramatika ndahet në dy pjesë: në ***morfologji*** dhe ***sintaksë.***

Morfologjia është pjesa e gramatikës që studion format e ndryshme të fjalëve, kuptimin e këtyre formave, klasifikimin e fjalëve në pjesë ligjërate, si dhe formimin e fjalëve. Ajo analizon morfemat, njësitë më të vogla të kuptimit që formojnë fjalët dhe mënyrës se si ato lidhen me njëra tjetrën.



Sintaksa është pjesë e gramatikës që merret me studimin e rregullave të bashkimit të fjalëve në grupe fjalëshe (togfjalësh) e në fjali dhe të fjalive në periudhë (fjali të përbërë), si dhe rolin që luajnë ato.



Diskutim

- Shpjegoni rolin e gjuhësisë si shkencë që merret me studimin e gjithanshëm të gjuhës!
- Dalloni degët kryesore të gjuhësisë dhe shpjegoni rolin e tyre!

Fonetikë dhe fonologji

Tingujt janë mjeti themelor përmes të cilit realizohet gjuha. Çdo fjalë që shqiptojmë është e përbëre nga tinguj të ndryshëm, të cilët kanë vlerë si në aspektin fizik, ashtu edhe në rrafshin gjuhësor. Për këtë arsye, studimi i tingujve bëhet nga dy disiplina të veçanta, por të lidhura ngushtë: **fonetika** dhe **fonologjia.**

Fonetika (nga fjala greke *phone = tingull/zë)* është shkenca që merret me studimin e tingujve të të folurit si dukuri materiale. Ajo e shqyrton tingullin nga tri këndvështrime:

- **Fonetika artikulative** – studion mënyrën se si tingujt prodhohen me anë të të folurit (gjuhë, buzë, qiellzë, akorde zanore etj.)
- **Fonetika akustike** – shqyrton tingujt si valë zanore, duke parë gjatësinë, forcën dhe timbrin e tyre.
- **Fonetika perceptive** – analizon se si tingujt perceptohen nga veshi i njeriut dhe përpunohen nga truri.

Njësia themelore e fonetikës është **tingulli.**
Shembull: Nëse marrim tingullin *p,* fonetika na tregon se ky tingull prodhohet duke bashkuar buzët dhe duke lëshuar ajrin pa dridhje të akordeve zanore.

Fonologjia (nga fjala greke *phone = tingull/zë* dhe *logos = shkencë/studim,* pra, studimi i tingullit) është shkenca që studion tingujt nga këndvështrimi gjuhësor. Ajo merret me funksionin e tyre në gjuhë, pra si përdoren tingujt për të dalluar kuptimin e fjalëve. Njësia themelore e fonologjisë është **fonema**, që është njësia më e vogël e gjuhës, e cila nuk mund të ndahet më tej në njësi më të vogla lineareqë ndjekin njëra tjetrën në rrjedhën e të folurit. Fonema nuk është thjesht një tingull i caktuar, por një njësi dalluese kuptimore. Ndryshimi i vetëm një foneme në një fjalë sjell ndryshimin e kuptimit të saj.

Ortoepia dhe **ortografia** janë dy norma të gjuhës standarde, të lidhura ngushtë me fonetikën, njëra për shqiptimin dhe tjetra për shkrimin.

Ortoepia (drejtshqiptimi) – vjen nga fjala greke *orthos* (i drejtë) dhe *epos* (fjalë apo të folur). Është sistem i rregullave që përcakton shqiptimin e drejtë të fjalëve në gjuhën standarde. Ortoepia është e domosdoshme sepse jo gjithmonë fjalët shqiptohen ashtu si shkruhen, shpeshherë edhe dialektet mund të ndryshojnë shqiptimin, por gjuha standarde kërkon një normë të unifikuar.

Ortografia (drejtshkrimi) – vjen nga greqishtja e lashtë *orthos* (i drejtë) dhe *grapho* (shkruaj). Është gjithashtu, sistemi i rregullave që përcakton mënyrën e të shkruarit të gjuhës standarde (me shkronja, me shenja pikësimi, përdorim të drejtë të shkronjave të mëdha, etj.).

Diskutim

- Shpjegoni funksionin dhe rëndësinë e fonetikës dhe fonologjisë si degë të gjuhësië!
- Shpjegoni origjinën dhe kuptimin e fjalëve: *fonemë, grafemë, fonetikë, fonologji, ortografi* (drejtshkrimi), *ortoepi* (drejtshqiptimi).

Organet e të folurit dhe funksioni i tyre



Të folurit është aftësi e lindur e njeriut. Është një proces artikulativ, që shprehet nëpërmjet lëvizjeve përkatëse të gjuhës, buzëve, tejzave të zërit si dhe organeve të tjera, në koordinim me të gjitha organeve e të folurit nga sistemi nervor. Të folurit është një proces fiziologjik, që vë në veprim organet e shtytjes së ajrit (mushkëritë), organet dridhëse (tejzat e zërit), zgavrat rezonatore (laringu, goja dhe hunda) dhe sistemin nervor, që udhëheq dhe harmonizon lëvizjet e organeve të përmendura.

Aparati i të folurit ndahet në tri grupe:

- **Aparati i frymëmarrjes** (pjesa e poshtme) – trakea, bronket, mushkëritë dhe diafragma. Këto dërgojnë rrymë ajri për formimin e tingujve.

- **Aparati i fonacionit** (pjesa e mesme) – laringu me tejzat e zërit, për zëshmimin e valës së ajrit që depërton.
- **Aparati artikulativ** (pjesa e sipërme) – zgavra e hundës dhe zgavra e gojës, ku bëjnë pjesë edhe gjuha, qiellza, njerithi, dhëmbët dhe buzët, që bëjnë përpunimin përfundimtar të tingujve: zanoreve dhe bashkëtongëlloreve.

Diskutim

- Njehni dhe dalloni organet e të folurit dhe funksionin e tyre gjatë nyjëtimit të tingujve.

Klasifikimi i tingujve të gjuhës shqipe

Tingujt e ligjërimit të, ndahen në dy grupe të mëdha, në zanore dhe në bashkëtingëllore. Zanore të gjuhës shqipe janë 7: *a, e, ë, i, o, u, y,* ndërsa bashkëtingëllore janë 29: *b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, y, zh.*

Kur flasim për tingujt apo për fonemat e shqipes, kemi parasysh gjithnjë ato të gjuhës standarde shqipe.

Zanoret dhe bashkëtingëlloret dallohen mes tyre nga tipare nyjëtimore, akustike dhe funksionale.

Klasifikimi i zanoreve

Zanoret janë tinguj të zëshëm, për nyjëtimin e të cilëve toni latingal kalon nëpër faring dhe gojë pa hasur në ndonjë pengesë. Klasifikimi i zanoreve bazohet sipas pozitës së ngritjes së gjuhës (*të përparme, të mesme, të prapme),* sipas shkallës të ngritjes së gjuhës (*të hapura, gjysmë të hapura, të mbyllura)* dhe sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së buzëve (*të buzorëzuara, të pabuzorëzuara*).



Sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së buzëve në nyjëtimin e zanoreve, ato mund të jenë **të buzorëzuara** dhe **të pabuzorëzuara.**

Në nyjëtimim e zanoreve të buzorëzuara **o, u, y**, buzët zgjaten dhe rrumbullakohen. Ndërsa te zanoret e pabuzorëzuara **a, e, ë, i**, gjatë nyjëtimit buzët nuk marrin pjesë.

Pra:

- zanorja ***i*** është e mbyllur, e rradhës së përparme, e pabuzorëzuar;
- zanorja ***y*** është e mbyllur, e rradhës së përparme, e buzorëzuar;
- zanorja ***u*** është e mbyllur, e rradhës së prapme, e buzorëzuar;
- zanorja ***e*** është e gjysmë e hapur, e rradhës së përparme, e pabuzorëzuar;
- zanorja ***ë*** është e gjysmë e hapur, e rradhës së mesme, e pabuzorëzuar;
- zanorja ***o*** është e gjysmë e hapur, e rradhës së prapme, e buzorëzuar;
- zanorja ***a*** është e hapur, e rradhës së mesme, e pabuzorëzuar;

Togjet (grupet) e zanoreve dhe diftongjet

Në gjuhën shqipe ndodh që të shqiptohen njëra pas tjetrës dy a më shumë zanore, si për shembull: *ftua, muaj, përrua, thua, bluaj, quaj, ruaj, mësuam, dëgjues, mësues, i gëzueshëm, arsye, dyer, krye, kryesor, lyej, pyes, i shkëlqyeshëm, diell, qiell, miell* etj. Nëse dy zanore të afërta shqiptohen veçmas, duke formuar secila rrokje më vete, atëherë kemi **tog** apo **grup zanoresh.** Pra, secila nga zanoret ruan pavarësinë e vet dhe formon rrokje më vete, që do të thotë, se asnjëra nuk bëhet gjysmëzanore. Këto zanore formojnë togje zanoresh. Te togjet e zanoreve theksi bie zakonisht në zanoren e parë.
Ndryshe ndodh në rastet si: *opium, akuarium, materie, pejsazh*, ku dy zanoret formojnë një rrokje të vetme. Ato fonetikisht formojnë një diftong. Në diftong, zanorja e dytë humb aftësinë e formimit të rrokjes, pra, ato reduktohen në gjysmëzanore.

Përdorimi i drejtë i togjeve të zanoreve – Në shqiptimin e disa grupeve të zanoreve, vihet re luhatje të ndryshme, nën ndikimin e shqiptimeve dialektore e të traditës së shqiptimit të varianteve letrare të mëparshme: *ftua-ftu, muaj-muj, ruaj-ruj, mësues-mësus, pyes-pys, diell-dill, miell-mill* etj. Por, gjuha shqipe ka ngritur në normë shkrimin dhe shqiptimin e plotë të togjeve të zanoreve, pra duke i ruajtur elementet përbërëse të grupeve, pa i cunguar ato.

Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i dy zanoreve të njejta – kur gjatë formimit të fjalëve takohen dy zanore të njejta, ato shkruhen e shqiptohen të pandryshuara, p.sh: *joorgjinal, kryeengjëll, i paarmatosur, i paaftë, joobjektiv, mikroorganizëm* etj. Gjithashtu, edhe fjalët me prejardhje të huaj, që shkruhen me *-oo*, si: *alkool, zoologjik, koordinatë, kooperativë* etj., shqiptohen të pandryshuara.

Diskutim

- Shtjelloni dallimin midis tingullit dhe fonemës!
- Klasifikoni zanoret sipas vendit të ngritjes së gjuhës, sipas shkallës së ngritjes së gjuhës dhe sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së buzëve!
- Dalloni shqiptimin e grupit (togut) zanor nga diftongu dhe shkruani drejt ato!

Klasifikimi i bashkëtingëlloreve

Bashkëtingëlloret, ndryshe nga zanoret, formohen nga pengimi i rrymës së ajrit në një pikë të kanalit të zërit, ato janë zhurma dhe në gjuhën shqipe nuk kanë aftësi rrokjeformuese. Klasifikimi i bashkëtingëlloreve rëndom bëhet duke pasur parasysh: vendin e formimit të pengesës, mënyrën e formimit dhe punën e tejzave të zërit.

Bashkëtingëlloret klasifikohen sipas këtyre parimeve:

I. **Sipas vendit të formimit:**
- **buzore:** *p, b, m, f, v.*
- **dhëmbore:** *t, d, th, dh, ll.*
- **alveolare:** *c, x, n, s, z, l, r, rr.*
- **paraqiellzore:** *ç, xh, sh, zh.*
- **qiellzore:** *q, gj, j, nj, j.*
- **prapaqiellzore:** *k, g, h.*

II. **Sipas mënyrës së formimit:**
- **mbylltore:** *p, t, b, d, c, x, c, xh, q, gj, g, h.*
- **shtegore:** *f, v, dh, th, s, sh, z, zh, j, h.*
- **hundore:** *m, n, nj.*
- **anësore:** *l, ll.*
- **dridhëse:** *r, rr.*

III. **Sipas pjesëmarrjes së zërit apo të zhurmës:**
- **të tigullta** (sonante): *m, n, nj, j, l, ll, r, rr.*
- **të zhurmëta,** të cilat më tej ndahen në:

të zëshme	*b*	*d*	*dh*	*g*	*gj*	*v*	*x*	*xh*	*z*	*zh*	
të pazëshme (të shurdhëta)	*p*	*t*	*th*	*k*	*q*	*f*	*c*	*ç*	*s*	*sh*	*h*

Në formë tabelare, klasifikimi i bashkëtingëlloreve do të dukej kështu:

		Buzore	Dhëmbore	Alveolare	Paraqiellzore	Qiellzore	Prapaqiellzore
Mbylltore	e zëshme	*b*	*d*	*x*	*xh*	*gj*	*g*
	e pazëshme	*p*	*t*	*c*	*ç*	*q*	*k*
Shtegore	e zëshme	*v*	*dh*	*z*	*zh*	*j*	
	e pazëshme	*f*	*th*	*s*	*sh*		*h*
Hundore	tingëllore (sonante)	*m*		*n*		*nj*	
Anësore	tingëllore (sonante)		*ll*	*l*			
Dridhëse	tingëllore (sonante)			*r, rr*			

Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve

Bashkëtingëlloret: ***q, ç*** dhe ***gj, xh*** - Bashkëtingëlloret ***q*** dhe **gj** në disa të folme popullore shqiptohen si ***ç*** dhe ***xh***. Prandaj, si kur flasim, ashtu edhe kur shkruajmë, shpeshherë në vend të ***q*** -së përdorim ***ç*** -në, ndërsa në vend të ***gj*** -së përdorim ***xh*** -në. Për shembull.: *qafë – çaf; qen – çen; qilim – çilim; qershi - çershi, qiell; çift – qift; qymyr - çymyr, qyqe – çyçe - çiçe; gjak – xhak; i gjallë - i xhall; gjarpër – xharpën; gjashtë – xhasht; gjeth – xheth; gjysh – xhysh- xhish* etj. Por sipas rregullave të drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit të gjuhës shqipe, këto fjalë duhet të përdoren ashtu si duhet.

Bashkëtingëlloret: ***h, nj, f,*** dhe ***v*** - Nën ndikimin dialektor, këto bashkëtingëllore ndonjëherë nuk shqiptohen e nuk i shkruhen siç duhet. Në disa të folme të shqipes ***h***-ja nuk shqiptohet fare ose dëgjohet shumë dobët. Duhet të nyjëtohen e të shkruhen me ***h*** fjalët: *ha, hap, hartë, harroj, hënë, hudhër, i hollë, hundë, hallë; aheng, lahem, ah, krah, fsheh, shoh* etj. Shpeshherë në vend të ***h***-së gabimisht përdoret ***f***. Kështu fjalët *njoh, shoh, i ftohtë, i nxehtë, i mprehtë* etj. nyjëtojhen e shkruhen në formë të gabuar, si: *njof, shof, i ftoftë, i nxeftë, i mpreftë.*

Edhe tingulli ***nj*** në disa të folme dialektore nuk përdoret kudo njësoj. Ai shumë herë zëvendësohet me ***j*** -në ose ***n*** -në, si p.sh.: *e zonja - e zoja; ftonj – ftoj; thonj – thoj; një – ni; njëzet – nizet* etj.

Në përdorimin e bashkëtingëllores ***v*** ka më pak shmangie. Atë zakonisht e përdorim drejt, si: *vazo, vezë, vesh, i vogël, shkrova, mësova, punova* etj., por ka raste kur gabim përdoren format e fjalëve: *thivi, kavi, shivi, shkovi, msovi, punovi* etj., përderisa forma normative janë: *thiu kau, shiu, shkoi, mësoi, punoi.*

Bashkëtingëlloret: ***r*** dhe ***rr*** - Në disa të folme, bashkëtingëllorja ***rr*** zbutet në ***r***. Mirëpo, në gjuhën standarde shqipe këto dy bashkëtingëllore dallohe, sepse janë fonema të veçanta dhe shkruhen me shkronja të posaçme. Ka disa çifte fjalësh që dallohen edhe për nga kuptimi nëse kanë ***r*** ose ***rr***, të tilla si: *arë - arrë, rasë - rrasë, deri - derri, rimë - rrimë – rrymë* etj.

Bashkëtingëlloret: ***r*** dhe ***rr*** - Në disa të folme, bashkëtingëllorja ***rr*** zbutet në ***r***. Mirëpo, në gjuhën standarde shqipe këto dy bashkëtingëllore dallohen, sepse janë fonema të veçanta dhe shkruhen me shkronja të posaçme. Ka disa çifte fjalësh që dallohen edhe për nga kuptimi nëse kanë ***r*** ose ***rr***, të tilla si: *arë - arrë, rasë - rrasë, deri - derri, rimë - rrimë – rrymë* etj.

Në gjuhën letrare shqipe bashkëtingëllorja ***rr*** shqiptohet dhe shkruhet në fillim, në mes dhe në fund të fjalës:

a) **në fillim të fjalës,** si: *rreze, rrezik, rreth, rregull, rrafsh, rrënjë, rri, rrit, rrotë, rrotull, rrugë, rrymë etj.*

b) **në mes të fjalës:** *arrë, arrij, përrua, përrallë, burrë, furrë, qerre, karrige, harroj, ngatërroj, kurrë.*

c) **në fund të fjalës:** *marr, oborr, ëndërr, terr, tmerr, kokërr, sherr, varr; korr, etj.*

Togjet (grupet) e bashkëtingëlloreve

Kur dy bashkëtingëllore përdoren njëra pranë tjetrës, formojnë **grupe** apo **togje bashkëtingëlloresh**. Përdorimi i drejtë i tyre në gjuhën standarde shqipe del i vështirësuar, për arsye se në disa të folme (dialekte), për shqiptim më të lehtë, ato zëvendësohen me bashkëtingëllore të rëndomta, ose ndonjëra nga to shkrihet në një tingull të vetëm. Por një nga normat e gjuhën standarde shqipe është që togjet e bashkëtingëlloreve të ruhen të plota, si në nyjëtim ashtu edhe në shkrim, në të gjitha pozitat, si në fillim, si në mes ashtu edhe në fund të fjalës. Të tilla janë togjet e bashkëtingëlloreve: ***mb, mp, nd, ng, ngj, pl, pj, pr, fl, fsh, bl, br, vj, shk*** etj.

Për shembull:

mb – *mbaj, mbaroj, mbesë, mbush, mburem, mbyt; përmbi, ëmbëlsi, këmbë, ombrellë; krimb, gjemb, plumb, shkëmb, dhëmb, rimëkëmb* etj.

mp – *mpakem, mpihem, mpreh, mpiksur; amper, ampulë, epirik, imperializëm, import, impresionist, simpati, simpozium, simptomë, dëmprurës, temperament, tempull, pamposhtur* etj.

nd – *ndaj, nderoj, ndjek, ndërtoj, ndërmarrje, ndodhem, ndriçim; këndej, andej, mundoj, sundim, këndoj, prandaj, lundroj; mend, kuvend, përmend* etj.

ng – *ngadalë, ngacmim, ngarkesë, ngut, ngujim; mëngë, këngë, kungull, shtëllungë, trangull, tingull, mangësi; trung, cung, deng, peng,* etj.

ngj – *ngjyros, ngjaj, ngjall, ngjalë, ngjyrë; thëngjill, bashkëngjitur, tungjatjeta, engjëll; qengj, ungj* etj.

pl - *plep, pluhur, pleqëri, pleh, planet, plage, plumb, plesht, plis, plogështi, plejadë; aeroplan, besëplotë, buzëplasur, implementim, replikë,* etj.

pj – *pjatë, pjek, pjellor; epje, bukëpjekës, përpjekje, mirupjekshim* etj.

pr – *pra, prag, predikim, predhë, praktikoj, prush, prishur; aprovim, epror, sprapsem, sprovë, mpreh, riprodhim, riprovim, sprapsem, sprovë, shpresë* etj.

fl – *flagrancë, flamur, fluturoj, flakë, flokë, flijim, fletore, flas, flamë, flaut, fletë, flotë, flori* etj.

fsh – *fshat, fsheh, fshesë, fshikë; përfshij, mirupafshim; punofsh, mësofsh, afsh* etj.

bl – *blegërimë, blegtor, bli, blic, bluaj, blej, bluzë, bletë; obligim, tabletë, tablo, mbledh, problem, përbluaj, përmbledh, republikë* etj.

br – *braktis, breshkë, bredh, brez, bri, bricjap, brigje, bregdet, brazdë, brenda, brumbull, brumë; abrash, embrion, ibrik, algjebrik, barabrinjës* etj.

vj – *vit, vjetore, vjeshtë, vjershë, vjelje, vjetër, vjollcë; parvjet, përvjetor, havjar, dhjetëvjeçar* etj.

shk – *shkabë, shkak, shkel, shkëlqim, shkuar, shkurre, shkurorëzim, shkoj, shkop, shkollë, shkallë, shkatërroj, shkëputje, shkretëtirë, shkumës, shkrihet; bashkë, bashkuar, ashkë, pashkelur, mashkullor; dushk, mushk, krushk* etj.

Diskutim

- Klasifikoni bashkëtingëlloret sipas mënyrës së formimit, sipas vendit të formimit dhe sipas pjesëmarjes së zërit!
- Zbatoni drejshkrimin dhe drejtshqiptimin e bashëtingëlloreve dhe grupeve (togjeve) të bashkëtingëlloreve!

Ndryshimet fonetike

Studimi i ndërrimeve morfologjike të fonemave në fushën e eptimit (ndryshim që pësojnë fjalët në trajtën e tyre gramatikore, kur hyjnë në lidhje me fjalë të tjera në fjali). Përbën problem qendror të morfologjisë së shqipes. Veç funksioneve të rëndësishme gramatikore, ato kanë një denduri pak a shumë më të madhe, në dallim nga ndërrimet e fjalëformimit, që përgjithësisht kanë një shtrirje më të kufizuar.

Gjatë lakimit, zgjedhimit dhe gjatë fjalëformimit e njejta morfemë mund të paraqitet me dallime në përbërjen fonematike të saj, si për shembull: *dash-desh, del-dal-dilni, plak-pleq, lepur, lepuj, vep;r-vepra, bluaj-blova, zë-zini, mbjell-mbillni, rreth-rrathë, derë-dyer, tingull-tingëlloj* etj.

Dukuritë e ndërrimit morfologjik të fonemave dallohen nga ndryshimet kombinatore të tingujve. Zgjidhja e varianteve të tingujve lidhet me kushtëzimin fonetik të tyre (*sot-sod, ekzistoj-egzistoj, s'bën-z'bën* etj.), ndërsa ndërrimet e fonemave në gjendjen e sotme nuk kanë lidhje me rrethimin fonetik, por janë të kushtëzuara morfologjikisht (*dal-del-dola-dilni, zë-zura-zini, rreth-rrathë, plak-pleq* etj.).

Gjatë evolucionit historic të gjuhës shqipe janë zhvilluar disa procese fonologjike me vlerë morfologjike, të cilat zakonisht quhen dukuri morfologjike. Të tilla janë: *qiellzorizmi, metafonina, apofonina, asimilimi, disimilimi, metateza, rotacizmi, elizioni, rënia dhe shtimi i tingujve* etj.

Qiellzorëzimi i fonemave - Qiellzorëzimi ose palatalizimi (lat. palatum-qiellzë) është dukuri morfologjikee ndërrimit të një foneme joqiellzore në një fonemë qiellzore. Në gjuhën shqipe më shpesh qiellzorëzohen bashkëtingëlloret ***k*** në ***q***, ***g*** në ***gj***, ***l***, ***ll*** dhe ***r*** në ***j***.

- Qiellzorëzimi i ***k*** në ***g*** – p.sh.: *ka-qe, mik-miq, peshk-peshq, krushk-krushq, fik, fiq, bllok-blloqe, qark-qarqe, rrezik-rreziqe, park-parqe* etj.
- Qiellzorëzimi i ***g*** në ***g*** j – p.sh.: *zog-zogj, breg-brigje, shteg-shtigje, varg-vargje, lug-lugje, trung-trungje, i lig-të ligj, djeg-dogja* etj.
- Qiellzorëzimi i ***ll*** në ***j*** – p.sh.: *buall-buaj, grumbull-grumbuj, kungull-kunguj, portokall-portokaj, yll-yje* etj.
- Qiellzorëzimi i ***l*** dhe ***r*** në ***j*** – p.sh.: *muskul-muskuj, kal;-kuaj, lepur-lepuj, flamur-flamuj, bir-bij, fle-fjeta* etj.

Qiellzorëzimi i zanoreve - Nën ndikimin e bashkëtingëlloreve në zanore, disa zanore me kalimin e kohës kanë marrë nyjëtim më të përparmë, saqë tani më janë shndërruar në zanore të përparme. Dukuria e kthimt të cilësdo zanore në ndonjë zanore tjetër më të përparme dhe më të mbyllur (zakonisht në *i* ose *y*) quhet qiellzorëzim i zanoreve. P.sh.*: jemi-jini, keni-kini, merr-mirrni, dredh-dridhni, fle-flini-flija-flihet, te numërori të tre-të trija* etj. Qiellzorëzimi i zanoreve ndodh edhe në disa të folme si: *qëlloj-qilloj, gjëmoj-gjimoj, gjendem-gjindem*, si dhe në fjalët: *grurë-grytë, ushqim-yshqim* etj.

Metafonia – rrjedh nga greqishtja (*meta–parashtesë* dhe *pfonia–tingull)*, që kuptojmë se metafonia është ndërrim apo transformim i tingullit. Pra, ky rregull ka të bëjë me ndërrimin e tingujve. Metafonia në gjuhën shqipe njihet si ndërrimi i zanores ***a*** në ***e*** dhe zanoes ***e*** në ***i***. Është dukuri që gjen përdorim tek emrat dhe te foljet, p.sh.:
- **ndërrimi i zanores *a* në *e***: *natë-net, dash-desh, cjap-cjep, ka-qe, asht–eshtra, kunat-kunetër, kulaç-kuleçë, lak-leqe, plak-pleq ; trokas-troket, bërtas-bërtet, thërras-thërret, pëlcas–pëlcet*;
- **ndërrimi i zanores *e* në *i***: *shteg-shtigje, breg–brigje; ndez-ndiz-ndizni, pres-prit-prisni, del-dil - dilni* etj.

Apofonina - sikurse edhe metafonia, ka të bëjë me ndryshimin e tingujve. Apofonia ka të bëjë me ndryshimin e zanores së rrënjës - temës së fjalës, përkatësisht ka të bëjë me ndërrimin e zanores ***e*** në ***o***, zanores ***a*** në ***o***, por edhe ***je*** në ***o***. Apofonia gjen përdorim më të madh te foljet, sidomos te disa folje në kohën e kryer të thjeshtë, p.sh.:
- **ndërrimi i zanores *e* në *o***: *bredh-brodha, dredh-drodha, hedh-hodha, djeg- dogja, heq-hoqa* etj.
- **ndërrimi i zanores *a* në *o*:** dal–dola, marr-mora;
- **ndërrimi i *je* në *o*:** vjel - vola, nxjerr - nxora, mbjell - mbolla, tjerr - tora, ndjek - ndoqa, sjell - solla etj.

Këto folje, në trajtat e pashtjelluara (pjesore, përcjellore, paskajore dhe mohore), nuk e marrin ndajshesën -***ur***, por marrin -***ë,*** si: *dal-dola-dalë* (dhe jo *dalur*), *marr-mora-marrë* (dhe jo *marrur), mbjell-mbolla, mbjellë* (dhe jo *mbjellur); duke dalë, duke marrë, duke mbjellë* (jo *duke dalur, duke marrur, duke mbjellur), për të dalë, për të marrë, për të mbjellë* (jo *për të dalur, për të marrur, për të mbjellur), pa dalë, pa marrë, pa mbjellë* (jo *pa dalur, pa marrur, pa mbjellur).*

Asimilimi (përngjashmimi) – është bashkëpërshtatje e tingujve zanorë ose bashkëtingëllorë, gjatë të cilit njëri tingull merr tiparet e tingullit tjetër ose të dy shkrihen në një tingull të vetëm. Për shembull: *nga-ka, ngat-gat, ngutu-gutu, tambël-tamël, tjetër-qetër, ndaje-daje, mjegull-mjegël, vjehërr-vehërr, djalë-gjalë, plak-qak, oxhak-axhak* etj.

Disimilimi (shpërngjashmimi) - është dukuri e kundërt **e** asimilimit. Kemi disimilim atëherë kur dy tinguj të njejtë ose të ngjashëm bëhen të ndryshëm ose më shumë të dallueshëm. Ja disa fjalë ku vepron kjo dukuri fonetike: *motor-matorr, tamam-taman-tamëm, oborr-aborr, sheqer-shiqer, xhamadan-xhemadan, lodroj-ladroj, flutur-flutër* etj.

Metateza – është ndërrimi i vendeve të fonemave kur janë dhe nuk janë afër njëra tjetrës-tjetrës, por janë Brenda një fjale. Për shembull: *përtoj-pritoj, hua-uha, lëshoj-shloj, shpëtoj-pshtoj, leblebi-elbebi, llagap-gallap, kthej-thkej* etj.

Rotacizmi – është kalimi i ***n***-ës në të folmen toske, kur është në pozicion ndërmjet dy zanoreve, në ***r,*** si p.sh.: *venë-verë, peni-peri, druni-druri, syni-syri, vuna-vura, zani-zëri, emën-emër, dimën-dimër, kunorë-kurorë, i varfën-i varfër, dhelpën-dhelpër, drapën-drapër, ardhun-ardhur, hapun-hapur* etj. por në shqipen standard ka edhe fjalë mjaft të hershme, në të cilën ***n***-ja nuk është rotacizuar, si: *hënë, nënë, unazë, punë, anë, e shtunë, unë, zënë, thënë, qenë, vënë* etj.

Elizioni – është zhdukja e zanores fundore të pa theksuar të një fjale para një zanoreje tjetër të fjalës që vjen pas. Për shembull*: në agim-, më u afrua-m'u afrua, të ia japë-t'ia japë, të i them-t'i them, të u thuash-t'u thuash.* Në të folur, elizion kemi edhe në rastet: *n'agim, n'gjum, n'ujë, t'egra, t'bukura* etj. Por duhet shkruar: *në arë, në gjum, në ujë, të erga, të bukura* etj.

Rënia e tingujve – është kur bie një tingull ose grup tingujsh, në fillim të fjalës **(aferezë),** në mes të fjalës **(sinkopë)** ose në fund të fjalës **(apokopë)**. Për shembull: *vështirë-shtirë, shtëllungë-shllungë, tashti-shti, Ibrahim-Brahim; Edita- Dita, shqiptar-shiptar, mëndafsh-mënash, laheni-lahi, shtëpi-shpi; shoqëri- shoqni, miqësi-miqsi; erdhi-erdh, pati-pat, fjeti-fjet, kujt-kuj, gjysmë-gjys, kisht-kish, ishte-ish* etj. **Shtimi tingujve** – kjo dukuri fonetike vjen si rrjedhim i ndërveprimitnë nyjëtimin e tingujve fqinjë, sidomos në ligjërime nëndialektore. Edhe shtimi i tingujve mund të bëhet në fillim të fjalës **(protezë),** në mes të fjalës **(epentezë)** ose në fund të fjalës **(epitezë).** Për shembull: *bletë-mbletë, gjetkë-ngjetkë, këthehet-nkëthehet, e ëma-e jëma, i ati-i jati; yemra-yembra, qepalla-qerpalla, paloj-paltoj, veton-vekton, lakuriq-laskuriq, misri-mistri; tym-tymb, e majtë-e majshtë, dajë-dajxhë, është-është, andej-andeza* etj.

Duhet pasur parasyshë se disa nga tingujt e shtuar, gjatë zhvillimit historik të gjuhës shqipe, tani janë mishëruar aq shumë me tingujt etimologjik saqë janë bërë pjesë e domosdoshme

përbërëse e disa fjalëve, që kanë jo vetëm shtrirje dialektore, por janë ngritur në forma normative në shqipen standarde. Këta tinguj vendosen për të zhdukur **hiatin** d.m.th. për të mënjanuar shqiptimin e dy zanoreve të njëpasnjëshme për të cilat goja hapet dy herë. Të tillë janë tingujt: ***j, h, v.*** Për shembull:

- **j** – shtohet tek emrat e gjinisë femërore që në trajtën e pashquar mbarojnë me ***a, e*** ose **o**, p.sh.: *kala-kalaja, bela-belaja, ide-ideja, dele-delja, nuse-nusja, byro-byroja, fjongo-fjongoja* etj. Por jo edhe tek emrat e gjinisë femërore që në trajtën e pashquar mbarojnë me **i**, ato duhet të shkruhen: *liri-liria, shtëpi-shtëpia, rini-rinia* etj.
- **h** – u shtohet disa fojleve që dalin me temë në zanore, në diatezën pësore e vetvetore në kohën e tashme, të tilla si: *afroj-afrohem-afrohesh, laj-lahem-lahesh, bëj-bëhem-bëhesh, mësoj-mësohem-mësohesh, largoj-largohem-largohesh* etj. -
- **v** – u shtohet foljeve në të kryerën e thjeshtë që mbarojnë me zanore, si p.sh: *afroj- afrova-afrove, laj-lava-lave, mësoj-mësohem-mësohesh, largoj-largohem-largohesh* etj.

Vështirësia që krijohet në procesin e ligjërimit nga bashkimi i dy ose tri bashkëtingëlloreve, gjithashtu mund të shmanget me ndërhyrjen e një tingulli zanor, si në rastet: *lot-lotët, dit-ditët, vjet-vjetët, bujq-bujqit, krushq-krushqit, nxënës-nxënësit, i bukur-të bukurit, i egër-të ergrit* etj.

Diskutim

- Përcaktoni variantet e tingullit brenda një fjale a disa fjalësh të ndryshme!
- Shpjegoni shkaqet pse një tingull artikulohet në mënyra të ndryshme dhe jepni shembuj përkatës!
- Identifikoni dhe shpjegoni ndryshimet fonetike të tingujve dhe jepni shembuj për to!
- Respektoni rregullat për zbatimin e ndryshimeve fonetike të tingujve gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim!

Theksi

Theksi është shqiptimi ose rëndësia që i jepet një rrokjeje në një fjalë ose në një fjali të caktuar. Ky theks zakonisht shkaktohet nga veti të tilla si ngritja e zërit, artikulimi i plotë i zanores dhe ndryshimet në ton në krahasim me rrokjet e tjera. Rrokja që dallohet nga rrokjet e tjera përmes shqiptimit më të fortë, quhet **rrokje e theksuar**, ndërsa të tjerat quhen **rrokje të patheksuara**.

Theksi në gjuhën shqipe dallohet vetëm nëpërmjet të folurit dhe bartëse e theksit janë vetëm zanoret ku në një fjalë kemi vetëm një zanore të theksuar. Në përdorimin e zakonshëm të gjuhës së shkruar, shenja e theksit nuk përdoret. Ajo vendoset vetëm në fjalorë ose materiale shkencore për të treguar shqiptimin e saktë të fjalëve. Theksi shënohet me një vijë të shkurtër (') mbi zanoren e rrokjes së theksuar. Duke pasur parasyshë se mund të theksohet vetëm një rrokje në një fjalë dhe këtë rrokje e karakterizon më tepër fuqia, do të thotë është **theks dinamik** dhe se rrokja e theksuar shqiptohet me fuqi shumë më të madhe se rrokjet e patheksuara. P.sh.: *gëzím, këmíshë, kalá, rrëké, punój* etj.

Në gjuhën shqipe theksi nuk bie vetëm mbi një rrokje të caktuar. Ai mund të bjerë në rrokje të ndryshme:

- Në **fjalët njërrokëshe** theksi bie mbi zanoren e vetme: *mík, qén, lís, fúnd, shtég, trím etj,.*
- Në **fjalët shumërrokëshe** theksi bie:
  a) në rrokjen e parafundit: *lúle, déle, bésë, aníje, mótër, shkóllë, alfabét* etj. dhe quhet **theks parafundor** (paroksiton);
  b) në rrokjen e fundit: *folé, qytét, qirí, lirí, babá, puním, shtëpí, shikój, mendój* etj., dhe ky quhet **theks fundor** (oksiton);
  c) në rrokjen e tretë dhe të katërt nga fundi: *flútura, plúhuri, fshéhurazi, kúmbulla, shpírtëror, thémelor, gúximshëm* etj., dhe quhet **theks tejfundor** (proparoksiton).

Kur theksi bie mbi një rrokje të caktuar dhe nuk lëviz brenda fjalës kur ajo ndryshon format gramatikore, bëhet **theks i qëndrueshëm (i palëvizshëm)**. P.sh*: mál, máli, i málit, i máleve, prej málit; aníje, aníja, e aníjes, e aníjeve, aníjen, prej aníjes, láj, láva, lája, kam lárë; púnoj, púnova, púnojmë, kam púnuar* etj. Ndërsa, kur theksi kalon nga rrënja e fjalës te disa prapashtesa, si: *qytét – qytetár, lúftë - luftëtár, spórt – sportíst, shkóllë – shkollór, mál – malór* etj. atëherë kemi **theks të lirë (të lëvizshëm)**.

Theksi i fjalës në gjuhën shqipe është një element shumë i rëndesishëm, sepse na ndihmon që gjatë artikulimit t'i dallojmë fjalët që kanë formë të njejtë por kuptime të ndryshme nga njëra-tjetra, si p.sh: *bári -barí* ; *fotografí – fotográfi; kúrse – kursé; gjéni – gjení etj.*

Diskutim

- Shpjegoni karakteristikat e theksit në gjuhën standarde shqipe!
- Shqiptoni saktë fjalën duke theksuar më tepër rrokjen e theksuar kur lexoni dhe kur flisni!
- Shpjegoni theksin dinamik, theksin e lëvizshëm dhe të pa lëvizshëm!
- Identifikoni theksin fundor, parafundor dhe tejfundor!
- Shënoni saktë me shenjë theksi (`) fjalët njërrokëshe, dyrrokëshe, trerrokeshe dhe shumërrokeshe!

Theksi në fjalët e huazuara

Fjalët e huazuara janë përshtatur me natyrën e theksit të shqipes dhe ato përgjithësisht shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor. P.sh. te sllavizmat dialektorë, theksi nga rrokja e tretë, në gjuhën shqipe është zhvendosur në rrokjen e dytë, si: sllavisht *névolja* - shqip *nevójë*, sllavisht *lópata* - shqip *lopátë* etj. Ndërsa te orientalizmat në përgjithësi, (turqizmat) ruhet theksimi fundor (si në gjuhën e burimit). P.sh belá, kalá, e xhumá, dynjá, hatá, xhamí, bojaxhí, teneqexhí etj.

Fjalët klitike

Fjalët kuptimplota siç janë: emrat, mbiemrat, foljet me kuptim të plotë dhe ndajfoljet formojnë fjalë fonetike më vete, ndërsa fjalët shërbyese: nyjat, parafjalët, pjesëzat nuk mund të qëndrojnë të vetme, por bashkohen me një fjalë kuptimplote e cila është boshti i shqiptimit. Në fjalinë: *Bashkë do të shkojmë në shkollë,* fjalët shërbyese ***do, të, në*** nuk mbajnë theks më vete por lidhen me fjalët që kanë afër. Këto fjalë të patheksuara quhen **fjalë klitike**. Pra, **fjalët klitike** janë fjalë të shkurta, pa theks të vetin, që nuk përdoren dot më vete por mbështeten fonetikisht te një fjalë tjetër në fjali.

Sipas pozicionit ndaj fjalës kuptimplote ato ndahen në: **fjalë proklitike** dhe **fjalë enklitike.** Kur fjalët klitiket ndodhen para fjalës kuptimplote, quhen **proklitike** dhe shkruhen veçmas. P.sh.: *E lexova librin: **Më** tha **se po** vjen; **Më** tregoi **të** vërteten* etj. Ndërsa kur fjalët klitiket ndodhen pas fjalës kuptimplote, quhen **enklitike** dhe zakonisht bashkohen në një fjalë të vetme. P.sh.: *Jep**ma** librin*! *Thu**aje** të vërtetën! Sill**ua** dhuratat! Trego**ja** lajmin!* etj.

Theksi i fjalisë

Siç e theksojmë një rrokje të fjalës, ashtu mund ta theksojmë, apo ta dallojmë si më të rëndësishme për nga kuptimi edhe një fjalë në fjali. **Theksi i fjalisë** është theksimi i një fjale brenda fjalisë, me qëllim që të vihet në dukje pjesa më e rëndësishme e mesazhit që duam të përçojmë. Ai realizohet përmes rritjes së forcës së zërit dhe ndryshimit të melodisë (intonacionit). Përveç theksit të fjalisë, kemi edhe **theksin logjik.** Këtë theks e përdorim kur duam të kur duam të vëmë në dukje një nga fjalët e fjalisë. P.sh:

Nxënësit *shkuan në shëtitje me mësuesit.*
Nxënësit ***shkuan*** *në shëtitje me mësuesit.*
Nxënësit shkuan ***në shëtitje*** *me mësuesit.*
Nxënësit shkuan në shëtitje ***me mësuesit.***

Theksi i logjik nuk i jep fjalisë kuptim të ri, por nuanca të ndryshme kuptimore që shërbejnë për të theksuar informacionin kryesorë.

Diskutim

- Identifikoni dhe vini në dukje theksin në fjalët e përbëra dhe në fjalët e huazuara!
- Dalloni fjalët klitike dhe ndani ato sipas pozicionit (proklitike, enklitike)!
- Sqaroni dallimin e theksit të fjalës nga theksi i fjalisë!
- Identifikoni dhe shqiptoni saktë fjalinë duke theksuar më tepër fjalën e theksuar!

Drejtshkrim dhe drejtshqiptim

Shqipja standarde është ura që lidh të gjithë shqiptarët nga të gjitha trevat, pavarësisht dallimeve dialektore. Është një gjuhë e gjallë, që përshtatet me kohën, por që duhet të ruajë rregullat dhe strukturën e saj themelore. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurojmë një komunikim të qartë, të pasur dhe të qëndrueshëm ndërbrezor.

Rregullat e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit janë thelbësore për përdorimin e saktë të gjuhës shqipe. Këto rregulla ndihmojnë në evitimin e gabimeve dhe përmisimin e komunikimit si në të folur ashtu edhe në të shkruar. Gjuha e shkruar ka normat drejtshkrimore, që rregullojnë mënyrën e njëjtë të të shkruarit për të gjithë, ndërsa gjuha e folur ka normat e drejtshqiptimit, që synojnë të njësojnë shqiptimin e gjuhës standarde.

Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar.

Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i zanoreve

Zanorja E

a) Shkruhen me **e** (dhe jo me **ë**) fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndiqet nga një bashkëtingëllore hundore *(**m, n, nj**).* Me **e** shkruhen gjithashtu fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit, p.sh:

- *(më) dhemb*, (jo më dhëmb), *dhembje* (jo dhëmbje), *femër* (jo fëmër), *gjemb* (jo gjëmb) *shemb* (jo shëmb), *shembull* (jo shëmbull), *shtrembëroj* (jo shtrëmbëroj), *tremb* (jo trëmb), *i shtrembër* (jo i shtrëmbër) etj;
- *argjend* (jo argjënd), *brenda* (jo brënda), *çmend* (jo çmënd), *gjendje* (jo gjëndje), *kuvend* (jo kuvënd), *mendje* (jo mëndje), *përmend* (jo përmënd), *qendër (jo qëndër), qenësi, qengj, vend (jo vend), zëvendësoj (jo zëvëndësoj)* etj;
- *e enjte (*jo e ënjte), *gështenjë* (jo gështënjë), *ndenja,* (jo ndënja), *shenjë* (jo shënja), *e shenjtë* (jo e shënjtë),*i, vrenjtur* (jo i vrënjtur) *etj.*

b) Tek emrat femërorë të cilët në trajtën e pashquar të njëjsit kanë -**e** fundore të patheksuar, vetëm në rasën emëroren të shquar bie zanorja-**e** dhe zëvendësohet me -**ja**, ndërsa në rasat e tjera ajo shkruhet, p.sh:

- *artiste - artistja, artisteje; fitore - fitorja, fitoreje; lule - lulja, luleje; mësuese - mësuesja, mësueseje; nxënëse - nxënësja, nxënëseje; perde - perdja, perdeje; qytetare - qytetarja, qytetareje; -shishja, shisheje etj.;*
- *anije - anija, anijeje; ardhje - ardhja, ardhjeje; çështje -çështja, çështjeje; familje - familja, familjeje; korrje - korrja, korrjeje; nisje - nisja, nisjeje; pyetje - pyetja, pyetjeje; rrokje - rrokja, rrokjeje etj.*

Zanorja Ë

a) Shkruhen dhe shqiptohen me **ë** të theksuar të gjitha fjalët që në gegërisht dalin me **a** të theksuar të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore. P.sh:

- *bëj,* (baj) *çështje* (çashtje), *dëm* (dam), *dhëmb* (dhamb), *dhëmballë* (dhamballë), *dhëndër* (dhandër), *kam dhënë* (kam dhanë), *e ëma* (e ama), *e ëmbël (*e ambël), *ëndërr* (andërr), *gjëmë* (gjamë), *hënë* (hanë), *këmbë* (kambë), *i këndshëm* (i kandshëm), *këngë* (kangë), *lëng* (lang), *mbrëmje (*mbramje), *mëngë* (mangë), *nëntor (*nantor), *kam ngrënë (*kam ngranë), *shkëmb* (shkamb), *kam thënë (*kam thanë), *thëllëzë (*thëllanzë), *kam zënë (*kam zanë) etj.

b) Shkruhen dhe shqiptohen me **ë** edhe të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra që dalin prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit, si:

- *gojëdhënë* (gojdhanë), *parathënie* (parathanie), *shtatzënë* (shtatzanë), *nxënës* (nxanës), *frëngjisht* (frangjisht) etj.

c) Shkruhen me **ë** fjalët që kanë **ë** në rrokjen e parë dhe fjalët që janë të prejardhura prej tyre, si:
- *argëtim* (dhe jo argtim), *fëlliq* (jo flliq), *bërryl* (jo bryl), *gërryej* (jo grryej), *këlysh* (jo klysh), *këpucë* (jo kpucë), *këmishë* (jo kmishë), *kënaq* (jo knaq), *këput* (jo kput), *të këqij* (të kqij), *të mëdhenj* (jo të mdhenj), *dëlir* (jo dlir), *kësaj* (jo ksaj), *mësyj* (jo msyj) etj.

ç) Shkruhen me **ë** fjalët e formuara nga një temë më **-ë** që ndiqen nga një prapashtesë apo nga një temë që nis me bashkëtingëllore, si:

- *punëtor* (jo puntor), *anëtar* (jo antar), *atëror* (jo atror), *bardhësi* (jo bardhsi), *botëror* (jo botror), *copëtoj* (jo coptoj), *drejtësi* (jo drejtsi), *atëherë* (jo atherë), *bashkëpunoj* (jo bashkpunoj), *i jashtëzakonshëm* (jo i jashtzakonshëm), *mirëdita* (jo mirdita) etj.

d) Shkruhen me **ë** fjalët e prejardhura nga tema që mbarojnë me bashkëtingëllore, ku zanorja **ë** është si zanore mbështetëse, si:

- *armiqësi* (jo armiqsi), *besnikëri* (jo besnikri), *bujarësi* (jo bujarsi), *djallëzi* (jo djallzi), *kombësi* (jo kombsi), *kombëtar* (jo kombtar), *lajmëroj* (jo lajmroj), *mjekësi* (jo mjeksi) etj.

dh) **Shkruhen me ë fundore:** fjalët me theks në rrokjen e parafundit, duke u ruajtur ajo edhe në trajtat e tyre ku s'është më fundore, si:

- emrat femërorë si *bukë (jo buk), fjalë (jo fjal), punë (jo pun), zhurmë (jo zhurm)* etj.;
- disa emra mashkullorë që përdoren edhe si asnjanës: *atë* (jo at), *burrë* (jo burr), *djalë* (jo djal), *gjumë* (jo gjum), *kalë* (jo kal), *lumë* (jo lum), *brumë* (jo brum*) djathë* (jo djath*), drithë* (jo drith), *dhjamë* (jo dhjam), *gjalpë* (jo gjalp), *mjaltë* (jo mjat), *ujë* (jo uj) etj.;
- mbiemrat: *i/e butë (jo but), i/e ftohtë (jo ftoht), i/e gjatë (jo gjat), i/e lehtë (jo leht), i/e mirë (jo mir), i/e ngrohtë (jo ngroht) etj.;*
- mbiemrat e formuar me anën e prapashtesës **-të** nga emra njërrokësh ose me theks në rrokjen fundore: *i/e artë* (jo art), *i/e drunjtë* (jo drunjt), *i/e leshtë* (jo lesht), *i/e pambuktë* (jo *pambukt), i/e zjarrtë* (jo zjarrt), *i/e mpitë* (jo mpit), *i/e ndytë* (jo ndyjt), *i/e thatë* (jo that) *etj.;*

- trajtat e shumësit të emrave dhe të mbiemrave mashkullorë si: *një afrikan – disa afrikan**ë**, një amerikan - disa amerikan**ë**, një arab - disa arab**ë**, një shqiptar – disa shqiptar**ë**, një docent - disa docent**ë**, një fishek - disa fishek**ë**, një gram - disa gram**ë**, një hektar - disa hektar**ë**, një kilogram - disa kilogram**ë**, një kuintal - disa kuintal**ë**, një laborant - disa laborant**ë**, një lejlek - disa lejlek**ë**, një maturant - disa maturant**ë**, një mekanik - disa mekanik**ë**, një punëtor - disa punëtor**ë**, një shkrimtar - disa shkrimtar**ë**, një traktorist - disa traktorist**ë**, një ushtar - disa ushtar**ë**, një vesh – dy vesh**ë*** etj.;
- emrat femërorë që mbarojnë me **-më** (të parmë a të prejardhur) si: *astmë* (jo astëm), *basmë* (jo basëm), *dasmë* (jo dasëm), *diafragmë* (jo diafragëm), *dogmë* (jo dogëm), *gjysmë* (jo gjysëm), *kazmë* (jo kazëm), *krismë* (jo krisëm), *nismë* (jo nisëm), *sintagmë,* (jo sintagëm) etj.;
- përmemrat pronorë: *ynë* (jo yn), *tanë* (jo tan), *tonë* (jo ton), *sonë* (jo son), *të mitë* (jo të mit), *të tutë* (jo të tut), *të tijtë* (jo të tijt), *të sajtë* (jo të sajt) etj.;
- numërorët themelorë dhe numërorët rreshtorë si: *pesë* (jo pes), *gjashtë* (jo gjasht), *tetë* (jo tet), *dhjetë* (jo dhjet), *dymbëdhjetë* (jo dymbëdhjet), *pesëdhjetë* (jo pesmbëdhjet); *i/e dytë* (jo dyt), *i/e*

Nuk shkruhen me ë:

a) fjalët fjalët e prejardhura që formohen prej temash me një bashkëtingëllore me anë të prapashtesave **-tar(e), -tor(e), -ti, -toj,** si: *amtar* (jo amëtar), *besnik* (jo besënik), *fillestar* (jo fillesëtar), *tradhtar (jo tradhëtar), lojtar* (jo lojëtar), *arsimtar* (jo arsimëtar), *shqiptar* (jo shqipëtar); *fajtor* (jo fajëtor), *leshtor, tregti* (jo tregëti); *caktoj (jo cakëtoj) , dëmtoj* (jo dëmëtoj), *robëtohem (*rob*), shkaktoj* (jo shkakëtoj), *shqiptoj* (jo shqipëtoj), *shtegtoj* (jo shtegëtoj) etj;

b) emrat që mbarojnë me ***-ël, -ër, -ërr,*** kur nga tratjta e pashquar kalojnë në trajtën e shquar si: *thnegël-thnegla* (jo thnegëla), *pupël-pupla* (jo pupëla), *dhelpër-dhelpra* (jo dhelpëra), *gënjeshtër-gënjeshtra* (jo gënjeshtëra), *motër-motra* (jo motëra), *numër-numri* (jo numëri), *kodër-kodra (jo kodëra), kokërr-kokrra* (jo kokërra), *vjehërr-vjehrra* (jo vjehërra), *endërr-ëndrra (jo ëndërra)* etj.;

c) përemrat, ndajfoljet dhe lidhëzat e përngjitura që kanë si pjesë të parë fjalët **gjithë** ose **kurrë**, si: *gjithçka* (jo gjithëçka), *gjithçmos* (jo gjithëçmos), *gjithfarë* (jo gjithëfarë), *gjithherë* (jo gjithëherë), *gjithkush* (jo gjithëkush*), gjithmonë* (jo gjithëmonë), *gjithsej* (jo gjiësej), *gjithsecili* (jo gjithësecili); *kurrfarë* (jo kurrëfarë), *kurrgjë* (jo kurrëgjë), kurrsesi *(jo kurrësesi)* etj.

d) fjalët e përbëra, ku tema e dytë fillon me zanore, si: *bashkautor* (jo bashkëautor), bashkudhëtar (jo bashkëudhëtar), gojëmbël (jo gojëëmbël), kokulur (jo kokëulur), i shumanshëm, (jo shumëanshëm) etj.

Por fjalët te të cilat **ë**-ja fundore te tema e parë është e theksuar, shkruhen me **ë**, si: i njëanshëm (jo i njanshëm), zëëmbël (jo zëmbël) etj.

Nuk shkruhen me ë fundore:

a) emrat dhe mbiemrat më **-ël, -ër, -ërr, -ëz, -ull, -ur**, të cilët në emëroren e pashquar të njëjësit nuk e kanë theksin në rrokjen e fundit, si: *bukël* (jo bukëlë), *gogël* (jo gogëlë), *pupël (jo pupëlë), thnegël (jo thnegëlë), i/e ëmbël* (jo ëmbëlë), *i/e vogël* (jo vogëlë); *dhelpër* (jo dhelpërë), *gënjeshtër* (jo gënjeshtërë), *motër* (jo motërë), *numër* (jo numërë), *i/e ashpër* (jo ashpërë), *i/e shurdhër* (jo shurdhërë), *i/e verbër* (jo verbërë) ; *kokërr* (jo kokërrë), *puçërr* (jo puçërrë), *vjehërr (jo vjehërrë); dhëmbëz* (jo dhëmbëzë), *fshikëz* (jo fshikëzë*), gishtëz* (jo gishtëzë), *lidhëz* (jo lidhëzë), *mollëz* (jo mollëzë*); kumbull* (jo kumbullë), *nofull* (jo nofullë), *rregull* (jo rregullë), *tingull* (jo tingullë), *tjegull* (jo tjegullë), *vetull* (jo vetullë); *flutur* (jo fluturë), *hekur* (jo hekurë) *i/e bukur (jo bukurë), i/e lumtur (jo lumturë)* etj.;

b) emrat dhe mbiemrat që në shumësin e pashquar dalin më bashkëtingëlloret **-gj, -q, -j, -nj, gj,** si: *zogj* (jo zogjë), *të ligj* (jo të ligjë), *fiq* (jo fiqë), *miq* (jo miqë), *pleq* (jo pleqë), *bujq* (bujqë), *krushq* (jo krushqë), *peshq (jo peshqë), tirq* (jo tiqë), *ujq* (jo ujqë);; *bij* (jo bijë), *ftonj* (jo ftonjë), *heronj* (jo heronjë), *thonj* (jo thonjë); *murgj* (jo murgjë) etj.:

c) përemrat dëftorë: *i/e atij (jo atijë), i/e këtij (jo këtijë), i/e asaj (jo asajë), i/e kësaj (jo kësajë),* si edhe përemrat pronorë *i/e tij (jo tijë), i/e saj (jo sajë)* etj.

Në çiftet e fjalëve më poshtë mbiemrat shkruhen me **-ë,** ndërsa ndajfoljet pa **-ë:**

- *i/e drejtë* (mbiemër) – *drejt* (ndjfolje), *i/e fortë* (mbiemër) – *fort* (ndajfolje), *i/e kotë* (mbiemër) – *kot* (ndajfolje), *i/e* lartë (mbiemër) – *lart* (ndajfolje), *i/e mbrapshtë* (mbiemër) – *mbrapsht* (ndajfolje), *i/e plotë* (mbiemër) – *plot* (ndajfolje), *i/e* shpejtë (mbiemër) – *shpejt* (ndajfolje), *i/e thjeshtë* (mbiemër) – *thjesht* (ndajfolje), *i/e vërtetë* (mbiemër) – *vërtet* (ndajfolje) etj.

Drejtshqiptimi i zanores Ë

Shkronja **ë** në fund të fjalës shqiptohet vetëm kur është e theksuar. P.sh.:
Theksohet: *nënë, plakë, ai/ajo të shikojë, fëmijë, bukë* etj.;
Nuk theksohet: *këmbë, kënaqësi, drejtësi, gojë, dritë* etj.;
Kur ë-ja gjendet në një rrokje të theksuar, ajo shqiptohet qartë dhe kjo quhet pozicion i fortë fonetik, si te fjala *nënë, plakë* etj. Por kur është e patheksuar dhe ndodhet në fund të fjalës, në një pozicion të dobët fonetik, ajo zakonisht nuk shqiptohet, edhe pse shkruhet, si te fjala *këngë, gojë* etj.

Zanorja U

Shkruhen me **-u** dhe jo me **-ë,** në të gjitha rasat emrat dhe mbiemrat më ***-ull, -ur,*** si edhe fjalët e formuara prej tyre, si: *akulli* (jo akëlli), *kukull* (jo kukëll), *kumbull* (jo kumbëll), *mjegull (jo mjegëll), i/e mjegullt (jo mjegëllt); nofull (jo nofëll), petull (petëll), rrotull (jo rrotëll), sqetull (jo sqetëll), shembull (jo shembëll), shembullor (jo shembëllor), i/e pashembullt (pashembëllt); shpatull (jo shpatëll), tingull (jo tingëll), vetull (jo vetëll), mashkull (jo mashkëll); flutur (jo flutër), hekur (jo hekër), lepur (jo lepër), i/e bukur (jo bukër), i/e lumtur (jo lumtër)* etj.

Zanoret I dhe Y

Shkruhen me -**i** dhe jo me -**y** fjalët: *ai* (jo ay), *bilbil* (jo bylbyl), *fishek* (jo fyshek), *frikë* (jo frykë), *gjilpërë* (jo gjylpërë), *hipi* (jo hypi), *hipje* (jo hypje), *krimb* (jo krymb), *krip* (jo kryp), *qilim* (jo qylim), *qime* (jo qyme), *rrip* (jo rryp), *sirtar* (jo syrtar), *shpir*t (jo shyrt), *shqip* (shqyp), *shqiptar* (jo shqyptar) etj.

Por shkruhen -**y** dhe jo me -***i*** fjalët: *dy* (jo di), *bylyzyk* (jo bilizik), *dysheme* (jo disheme), *gjym* (jo gjim), *i/e gjymtë* (jo gjimtë), *gjysmë* (jo gjismë), *gjysma*k (jo gjismak), *lyp* (jo lip), *lypës* (jo lipës), *tym* (jo tim), *vyshket* (jo vishket), zymbyl (jo zimbil), ylber (jo ilber) etj.

Zanoret U dhe Y

Shkruhen me -**u** dhe jo me -**y** fjalët:

Bufe (jo byfe), *bulmet* (jo bylmet), *burokrat* (jo byrokrat), *duel* (jo dyel), *duzinë* (jo dyzinë), *fruta* (jo fyta), *frutore* (jo frytore), *i/e grunjtë* (jo grynjtë), *gjurmë* (jo gjyrmë), *gjurmoj* (gjyrmoj), *kurbet* (jo kyrbet), *parashutë* (jo parashytë), *qurrash* (jo qyrash), *sfungjer* (jo sfyngjer), *temperaturë* (jo temperatyrë), *tunel* (jo tynel), *turk* (jo tyrk), *turqisht* (jo tyrqisht) etj.

Grupet e zanoreve dhe diftongjet

Grupet e zanoreve dhe diftonjgjet shkruhen dhe shqiptohen të plota në fjalët, si:

- IE: *e diel* (jo e dill), *diell* (jo dill), *diellor* (jo dillor), *miell* (jo mill), *qiell* (jo qill), *qiellor* (jo qillor), *bie* (jo bi), shpie (jo shpij), *ziej* (jo zij), *përziej* (jo përzi), *ndiej* (jo ndij), etj.;
- JE: *mjel, vjel, mbështjell, mbjell, përcjell, pjell, sjell, shtjell, vjell, nxjerr, tjerr, çjerr, mjelëse, pjellor, sjellje, ujësjellës, tjerrje* etj. *djegës, bukëpjekës* etj.;
- YE: *arsye* (jo arsie), *i arsyeshëm* (jo i arsishëm), *dyer* (jo dir*), fyerje* (jo firje), *fyell* (jo fill), *kryesi* (jo kriesi), *kryesor* (jo kriesor), *kryekëput* (jo kriekput), *lyerje,* (jo lirje), *përlyej* (jo përlij), *ngjyerje* (jo ngjirje*), i pëlqyeshëm* (jo i pëlqishëm), *përkthyes* (jo përkthis), *pyes* (jo pies), *pyetje* (jo pitje), *i shkëlqyeshëm* (jo i shkëlqishëm), *thyej* (jo thij*), thyesë* (jo thies), *i pathyeshëm* (jo i pathishëm) etj.;
- UA: *buallicë* (jo bollicë), *dragua* (jo drago), *dua* (jo du), *ftua* (jo ftu), *grua* (jo gru), *hua (*jo uha), *i/e huaj* (jo huj*), muaj* (jo muj*), i përmuajshëm* (jo i përmujshëm*), përrua* (jo prru), *thua* (jo thu), *bluaj (jo bluj), quaj (jo quj), shkruaj (jo shkruj)* etj.;
- UE: *botues* (jo botus), *dëgjues* (jo dëgjus), *edukuese* (jo edukuse), *gatuese* (jo gatuse), *mësuese* (jo mësuse), *ndërtues* (jo ndërtus), *parashikues* (jo parashikus), *pastrues* (jo pasrtus), *i afrueshëm* (jo i afrushëm*), i dëgjueshëm (jo i dëgjushëm), i gëzueshëm (jo i gëzushëm), i paharrueshëm (jo i paharrushëm), i shoqërueshëm (jo i shoqërushëm), i vazhdueshëm (jo i vazhdushëm)* etj.

Takimi i dy zanoreve të njëjta

Kur në formim fjalësh takohen dy zanore të njëjta, ato shkruhen që të dyja. Për shembull:

i paaftë, i paafrueshëm, i paanshëm, paanësi, i paapelueshëm, i paarmatosur, i paarrirë, kryeengjëll, autoofiçinë, joobjektiv, joorganik, jooksidues, joorigjinal, mikroorganizëm etj.

Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i bashkëtingëlloreve

Bashkëtingëlloret e zëshme ***b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh*** shkruhen si të tilla, ashtu siç shqiptohen;

- shkruhen dhe shqiptohen me **b** dhe jo me **p** fjalët*: elb* (jo elp), *gjembi (jo* gjempi*), korb* (jo korp), *rob* (jo rop), *këmbë* (jo këmpë), *plumb* (jo plump), *shkëmb (jo shkëmp), humbni* (jo humpni) etj.;
- shkruhen dhe shqiptohen me **d** dhe jo me **t** fjalët*: invalid* (jo invalit*), fund* (jo funt*), kënd* (jo kënt*), hibrid* (jo hibrit), *mund* (jo munt), *standard* (jo standart), *shkund* (jo shkunt), *vend* (jo vent), *kuvend* (jo kuvent), *vendtakim* (jo venttakim), *përmend* (jo përment) etj.;
- shkruhen dhe shqiptohen me **dh** dhe jo me **th** fjalët: *bredh* (jo breth*), dredh* (jo dreth*), gardh* (jo garth*), lidh* (jo lith*), livadh* (jo livath*), ndodh* (jo ndoth*), ndrydh (*ndryth*), zbardh* (jo zbarth) etj.;
- shkruhen dhe shqiptohen me **g** dhe jo me **k** fjalët: *breg* (jo brek), *burg* (jo burk), *djeg* (jo djek), *larg* (jo lark), *lëng* (lënk), *i lig* (jo i lik), *prag* (jo prak), *shtegu* (jo shteku), *vargu (jo* varku*), zogu* (jo zoku);
- shkruhen dhe shqiptohen me **gj** dhe jo me **q** fjalët: *ligji (jo* liqi*), digje* (jo diqe), *u përgjigj* (jo u përqjiq*), qengji* (jo qeqji*), tungjatjeta* (jo tunqatjeta), *engjëll (jo* enqëll) *etj.;*
- shkruhen dhe shqiptohen me **v** dhe jo me **f** fjalët: *hov* (jo hof), *hovshëm* (jo hofshëm), *urov* (jo urof*), novelë* (jo nofelë), kova (jo kofa), *sovran* (jo sofran) etj.;
- shkruhen dhe shqiptohen me **x** dhe jo me **c** fjalët: *xixa* (jo cixa), *xixëllimë* (jo cixëllimë), *xehe* (jo cehe), *xehetor* (jo cehetor) etj.;
- shkruhen dhe shqiptohen me **xh** dhe jo me **ç** fjalët: *xhaketë* (jo çaketë), *borxh* (jo borç*), tunxh* (jo tunç*), xhuxh* (jo xhuç); *bixhoz* (biçoz*)* etj,;
- shkruhen dhe shqiptohen me **z** dhe jo me **s** fjalët: *brez* (jo bres), *çamçakëz* (jo çamçakës), *dorëz* (jo dorës*), filiz* (jo filis*), gaz* (jo gas), *ndez* (jo ndes*), njerëz* (jo njerës*), oriz* (jo oris*), pullaz* (jo pullas*), rrogoz* (jo rrogos) etj.;
- shkruhen dhe shqiptohen me **zh** dhe jo me **sh** fjalët: *garazh* (jo garash), *shantazh* (jo shantash) *zheg (jo sheg), azhurim* (jo ashurim), *bagazh* (jo bagash), *bizhuteri* (jo bishuteri) etj.;

Fjalët me **sh, zh,** dhe **ç** nistore shkruhen kështu:

- me **sh,** kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët (**f, k, p, q, t, th** etj.): *shfajësoj, shfaq, shfaqje, shfaros, shfryj, shfrytëzoj; shkarkoj, shkatërroj, i/e shkëlqyer, shkëmbej, shkrep; shpalos, shpallje, shpërblim, shpërdorim, shpërndaj, shpjegoj, shpikje, shpoj, shporr ; shqep, shqetësoj, (i, e) shquar; shtjelloj, shtrydh; shthur, shthurje* etj.*;*
- me **zh,** kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme **(b, d, g, gj, v):** zhbëj, zhbllokoj; zhdoganoj, zhdredh, (i, e) zhdrejtë, zhduk; zhgënjej, zhgënjim, zhgërryej; zhgjakësohem, zhgjandërr; zhvat, zhvendos, zhvesh, zhvilloj, zhvillim, zhvleftësim etj.

- me **ç**, kur kjo ndiqet nga një zanore ose nga një bashkëtingëllore e tingullit (**l, ll, r, rr, m, n, nj, j**): *çarmtatos, çarmatim; çorganizoj, çorganizim, çorientoj, çorientim; çliroj, çlirimtar, çlodhem; çregjistroj, çregjistrim; çrregulloj, çrregullim, i,/e çrregullt, çrrënjosje; çmallem, çmend, çmendinë, i/e çmendur, çmësohem, çmos; çnderoj, çngjyros; çnjerëzor; çjerr* etj.

Fjalët me **s** dhe **z** nistore, të ndjekur nga një bashkëtingëllore shkruhen kështu:

- me **s,** kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëlloret e shurdhët **(f, k, p, q)** ose e tingullt (**m, n, l**): *sferë, sfidë, sfilit, sfungjer, sfurk; skaj, skajshëm, skedë, skelet, skicë, skalit, skeç, skuq, skuadër, skulptor; spamgo, spanjoll, spikat, spec, special, specialist, specikik, spontan, sport, spërkat, spërderdh; sqarim, sqep, sqepar, sqimtar, squfur* etj.*; smag, smalt, smaltoj, smat, smatos, smerald, smeril, , smilar, smilat, smilatës, smirë, smirëzi, smiroj; snajper, snob, snobizëm, slogan* etj.*;*
- me **z**, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme*: zbardh, zbaticë, zbath, zbavit, zbërthej, zbokth, zbraz, zbres, zbritje, zbukuroj, zbut; zdrukth; zgavër, zgërbonjë, zgërdhihem, zgrip; zgjat, zgjedh, zvarit, zverdhem, zvogëloj* etj.
- Në pajtim me shqiptimin më të përhapur, me **z** shkruhen edhe foljet zmadhoj, zmbraps, si edhe fjalët e formuara prej tyre.

Shkruhen dhe shqiptohen me **j dhe** jo me **i** fjalët:

- emrat ku **j**-ja ndërzanore i përket temës, si edhe fjalët e formuara prej tyre: *anija* (jo ania), *batanije (jo batanie), dije* (jo die), *dijetar* (jo dietar), *vetëdije* (jo vetëdie) *fije* (jo fie), hije (jo hie), shija (jo shia)*, bijat (jo biat), fëmija* (jo fëmia), *nyjëzim* (jo nyiëzim), *pajis* (jo pais), *pajisje* (jo paisje)*, shkëndija* (jo shkëndia), *ujis (jo uis), ujitje* (jo uitje)**,** *vija* (jo via), *vijoj,* (jo vioj), *vijim* (jo viim), *çaji* (jo çai), *faji (*jo fai), *kallaji (*jo kallai), *lloji* (jo lloi), *llojit* (jo lloit), *maji* (jo mai), *majit (jo mait), skaji (jo skai), vaji (jo vai),* etj.
- përemrat: *i/e tij* (jo i/e ti), *i tiji* (jo i tij) e *tija* (jo e tia), *të tijtë* (jo të titë), *të tijat* (jo të tiat), i/e atij (jo i/e ati), i/e këtij (jo i/e këti).

Nuk shkruhen dhe nuk shqiptohen me **j** fjalët:

- *bukuri - bukurie - bukuria* (jo bukurij -bukurije - bukurija), *cilësi – cilësia - cilësie (jo cilësij – cilësija - cilësije), dashuri – dashuria - dashurie (jo dashurij – dashurija -dashurije); dituri – dituria - diturie (jo diturij – diturija – diturije), liri – liria – lirie (jo lirij – lirija – lirije) ministri – ministria – ministrie (ministrij – ministrija – ministrije), parti – partia – partie (jo partij – partija – partije), rini – rinia – rinie (jo rinij – rinija – rinije), shtëpi – shtëpia – shtëpie (jo shtëpij– shtëpija – shtëpije), ushtri – ushtria -ushtrie (jo ushtri j– ushtrija -ushtrije), veti - vetia – vetie (jo veti j- vetija – vetije)* etj.

Bashkëtingëllorja **h,** shkruhet dhe shqiptohet si në fillim, në mes, ashtu edhe në fund të fjalës:

- **në fillim të fjalës:** *habit* (jo abit), *hamshor* (jo amshor), *hap* (jo ap), *harabel* (jo arabel), *hardhucë* (jo ardhucë), *hartë* (jo artë), *harroj* (jo arroj), *haber* (jo aber), *hajdut* (jo ajdut), *hajmali* (jo ajmali), *hallë* (jo allë), *hashash* (jo ashash), *hallvë* (jo allvë), *hambar* (jo ambar), *hedh (jo hedh), hero (jo ero), hesht (jo esht), hendek (jo endek), hënë, (jo ënë), hidhur (jo idhur), hije* (jo ije), *hiç* (jo iç), *hile* (jo ile), *hinkë* (jo inkë), *hipi* (jo ipi), *hoje* (jo oje), *i hollë* (jo i iollë), *hop* (jo op), *hordhi* (jo ordhi), *hurmë* (jo urmë), *hua* (jo uha), *hudhër* (jo udhër), *hundë* (jo undë), *hurdhë* (jo urdhë), *hyj* (jo yj), *hyzmet* (jo yzmet) etj.;
- **në mes të fjalës:** *lahem* (jo laem), *kthehem* (jo ktheem), *kthehu* (jo ktheu), *bëhem, bëhesh* (jo bëesh), *bëhu* (jo bëu), *fshihem* (jo fshiem), *fshihu* (jo fshiu), *tregohu* (jo tregou), *mësohem* (jo mësoem), *shtyhem* (jo shtyem), *përzihem* (jo përziem), *ndihesh (jo ndiesh), i lehtë (jo i letë), vjehrra (jo vjerra).*
- **në fund të fjalës:** *fsheh* (jo fshe), *leh* (jo le), *mpreh* (jo mpref), *ndih* (jo ndi), *ngreh* (jo nge), *nxeh* (jo nxef), *njoh* (jo njof), *rrah* (jo rraf), *shkreh* (jo shkref), *shoh* (jo shof) etj.

Bashkëtingëllorja **rr,** shkruhet dhe shqiptohet si në fillim, në mes, ashtu edhe në fund të fjalës:

- **në fillim të fjalës:** *rrafsh* (jo rafsh), *rrahësi* (jo rahësi), *rradake (jo radake), rraketake* (jo raketake), *rrapëllimë (jo rapëllimë), rrebesh* (jo rebesh), *rreckë* (jo reckë), *rregull* (jo regull), *rrenë* (jo renë), *rreng* (jo reng), *rrepë* (jo repë), *rresht* (jo resht), *rreth* (jo reth), *rreze* (jo reze), *rrezik* (jo rezik), *rrëfim (jo rëfim), rrëke* (jo rëke), *rrëmujë* (jo rëmujë), *rrënjë* (jo rënjë), *rrëqebull* (jo rëqebull), *rrëshirë* (jo rëshirë), *rrëzë* (jo rëzë), *rrip* (jo rip), *rriqër (jo riqër), rrjetë* (jo rjetë), *rrobë (jo robë), rrogë* (jo rogë), *rrush (jo rush), rruzull* (jo ruzull), *rrymë* (jo rymë); *i/e rrallë (jo* rallë), *i/e rremë* (jo remë) , *i/e rreptë* (jo reptë); *rrah* (jo rah), *rrej* (jo rej), *rrekem* (jo rekem), *rrëfej* (jo rëfej), *rrëmbej* (jo rëmbej), *rrënoj* (jo rënoj), *rrëqethem* (jo rëqethem), *rrëshqas* (jo rëshqas), *rrëzoj* (jo rëzoj), *rri* (jo ri), *rrjedh* (jo rjedh), *rrjep* (jo rjep), rroj (jo roj), *rroftë* (jo roftë), *rrokullis* (jo rokullis), *rrobaqepës (jo robaqepës), rrudh (jo rudh), rrallë* (jo rallë), *rreth e rrotull* (jo reth e rotull), *rrotull, rrumbull* (jo rumbull) etj.
- **në mes të fjalës:** *arrë* (jo arë) *barrë* (jo bare), *bërryl* (jo beryl), *birrë* (jo birë), *burrë* (jo burë), *ferrë* (jo ferë), *furrë* (jo furë), *furrik* (jo furik), *karrige* (jo karige), *kërrabë* (jo kërabë), *korrik* (jo korik), *kurriz* (jo kuriz), *mëshqerrë* (jo mëshqerë), *manaferrë* (jo manaferë), *marrëveshje* (jo marëveshje), *mburrem* (jo mburem), *murriz* (jo muriz), *ndërmarrje* (jo ndërmarje), *përrallë* (jo përallë), *përrua* (jo përua), *qerre* (jo qere), *sorrë* (jo sorë), *sharrë* (jo sharë), shkurre (jo shkure), *shndërroj, (jo shëndroj), thërrime* (jo thërime), *zorrë* (jo zorë); *i/e pjerrët* (jo pjerët); *arrij* (jo arij) *arratisem* (jo aratisem), *dërrmoj* (jo dërmoj), *gërryej* (jo gëryej), *harroj* (jo haroj), *sipërmarrje* (jo sipërmarje), *kërrus* (jo kërus), *ndërroj* (jo ndëroj), *ngatërroj* (jo ngatëroj), *ngurroj* (jo nguroj), *shkarravit* (jo shkaravit), *shkatërroj* (jo shkatëroj), *sharroj* (jo sharoj), *turrem* (jo turem), *thërras* (thëras), *thërrmoj* (jo thërmoj), *urrej* (jo urej); *varreza (jo vareya), vocërrak (jo vocrak), kurrë* (jo kurë), *kurrsesi* (jo kursesi); *urra!* (jo ura!);
- **në fund të fjalës:** *derr* (jo der), *dokërr* (jo dokër), *ëndërr* (jo ëndër), *gabzherr* (jo gabzher), *horr* (jo hor), *kokërr* (jo kokër), *kotorr* (jo kotor), *oborr* (jo obor), *qorr* (jo qor), *sherr* (jo sher), *terr* (jo ter), *tmerr* (jo tmer), *varr* (jo var), *zjarr* (jo zjar), *zhavorr* (jo zhavor), *çjerr* (jo çjer), *korr* (jo kor), *marr* (jo mar), *nxjerr* (jo nxjer), *tjerr* (jo tjer), *mburrem* (jo mburem), *i/e) errët* (jo erët), etj.;

Shkruhen me **nj** e jo me **j fjalët:**

- *banjë* (jo bajë), *brinjë* (jo brijë), *gështenjë* (jo gështejë), *mushkonjë* (jo mushojë), *rrëfenjë* (jo rrëfejë), *rrënjë* (jo rrëjë), *shkronjë* (jo shkrojë), *shushunjë* (jo shushujë), *thinja* (jo thija), *ulkonjë* (jo ujkojë), *zonjë (jo zojë); i/e florinjtë* (jo florijtë), *i/e drunjtë* (jo drujtë), *i/e grunjtë* (jo grujtë), *i/e shenjtë* (jo shejtë), *i/e shtrenjtë (jo shtrjtë); arinj* (jo arij), *barinj* (jo barij), *kallinj* (jo kallij), *kushërinj* (jo kushërij), *minj* (jo mij), *mullinj* (jo mullij), *turinj* (jo turij), *ullinj* (jo ullij), *të rinj* (jo të rij), *budallenj* (jo budallej), *maskarenj (jo* maskarej), *heronj* (jo heroj), *drunj* (jo druj), *(*hu), *kërcunj (*kërcu), *ftonj* (jo ftoj), *përrenj* (jo përrej), *thonj* (thoj), *gjarpinj (gjarpërij), lumenj* (jo lumej), *priftërinj* (jo priftërij), *shkëmbinj* (jo shkëmbij) etj.

Takimi i dy bashkëtingëlloreve të njejta gjatë formimit të fjalëve a trajtave, ato shkuhen të dyja:

- *kënddrejtë* (jo këndrejt), *nënndarje* (jo nëndarje), *kundërrevolucionar* (jo kundërevulucionar), *kundërreformë* (jo kundëreformë), *mossulmim* (jo mosulm), *zëvendëssekretar* (jo zëvendësekretar); *i kujdesshëm* (jo i kujdeshëm), *passhkrim* (jo pashkrim), *i pjesshëm* (jo i pjeshëm), *leshhollë* (jo leshollë), *shpeshherë* (jo shpsherë), *mishshitës* (jo mishitës), *veshshkurtër* (jo veshkurtër) etj.

Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i fjalëve me prejardhje të huaj

Fjalët me prejardhje të huaj që kryesisht i takojnë terminologjisë teknike-shkencore, shkruhen sipas rregullave të mëposhtme të gjuhës shqipe:

Shkruhen me *d, t* dhe jo me *dh, th* fjalët ndërkombëtare me burim nga greqishtja e vjetër si:

- *dekagram, dekametër, demokraci, diplomë, hidrogjen, ortopedi, pedagog, antipati, antologji, aritmetikë, etnografi, liturgji, maratonë, telepati, terapi, termik etj.*

Shkruhen me *d, t* edhe emrat e përveçëm grekë e romakë, si:

- *Adanis, Afërdita, Dedali, Delfi, Demokriti, Demosteni, Driadat, Fedra, Iliada, Pindari, Leonida, Etiopia, Itaka, Maratona, Metodi, Prometeu, Skitia, , Tezeu, Trakia, Zakinti etj.*

Bëjnë përjashtim nga ky rregull fjalët dhe emrat e përveçëm të përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me ***th, dh*** dhe jo me **t, d**, si:

- *dhaskal, dhespot, idhull, themel, Dhimitër, Dhimosten, Athina, Kleanth, Thanas, Themistokli, Theodhor* etj.

Shkruhen me *l* dhe jo me *ll* fjalët e huaja me burim nga greqishtja e vjetër ose latinishtja, si:

- *alfa, algoritëm, ambulancë, analogji, antologji, atlas, balonë, balsam, bilanc, biolog, dialog, diplomaci, filologji, ideologji, kolos, lustër, tablo, zoologji* etj.

Shkruhen me *l* edhe emrat e përveçëm grekë e romakë, si:

- *Apoloni, Atlantida, Atlantik, Babilonia, Lukiani, Pelagonia, Peloponezi, Penelopa, Platoni, Salusti, Shila* etj.

Përjashtim nga ky rregull janë fjalët dhe emrat e përveçëm të përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me ***ll,*** si:

- *apostull, ballkanik, ballkon, bllok, busull, çokollatë, dishepull, idhull, gorillë, galloshe, kabllo, kapitull, konsull, orakull, llogari, protokoll, sallë, vullkan* etj.

Fjalët me burim nga latinishtja dhe greqishtja të cilat në gjuhën shqipe kanë një *c* të ndjekur nga zanorja *e* ose *i* shkruhen me *c*:

- acetik, acetilen, celebrim, celulë, centimetër, central, cerebral, certifikatë, kancelar, koncert, koncesion, proces, agjenci, agjitacion, ciklamin, cinik, citat, deficit, konciz, recension etj.

Po ashtu, edhe emrat e përveçëm të kësaj kategorie shkruhen me **c**:

- *Barcelonë, Cezari, Cincinati, Horaci, Lukreci, Marciali, Mecena, Sicilia* etj.

Përjashtim nga ky rregull janë fjalët e përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me **ç**, si:

- *biçikleta, çiklist, çiklizëm, çimento, motoçikletë* etj.

Fjalët me burim nga anglishtja shkruhen me *l* dhe *ll*, si:

gol, golf, kloun, klub; basketboll, futboll, hendboll, penallti, volejboll etj.

Fjalët me burim nga gjuhët sllave shkruhen me *l* dhe *ll*, si:

- *bolshevik, kolkoz, polak, polka; bjellorus, sllav, sllovak, slloven, Bjellorusi, jugosllav* etj.

Diskutim

- Shkruani duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit sipas ndryshimeve fonetike të tingujve dhe diskutoni për ato!
- Shkruani dhe shqiptoni drejt fjalët me prejardhje të huaj dhe diskutoni për ato!

Përdorimi i drejtë i shkronjave të mëdha

Në gjuhën shqipe, shkronja e madhe përdoret për të dalluar emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm. Ajo përdoret gjithashtu në fillim të çdo teksti, paragrafi dhe fjalie.

1. Shkruhen me shkronjën e parë të madhe **emrat dhe mbiemrat e personave, epitetet ose ofiqet** (nofkat) që janë pjesë përbërëse e tyre si edhe pseudonimet:
   - *Dedë Gjo Luli, Gjergj Elez Alia, Gjergj Kastrioti, Gjon Buzuku, Ismail Qemali, Naim Frashëri, Pjetër Budi,* etj.; *Aleksandër Dyma **Biri**, Gavril Dara i **Riu**, Leka i **Madh**; Asdreni, Çajupi, Migjeni* etj.
   - Nyjat dhe pjesëzat e mbiemrave të huaj shkruhen me shkronjë të vogël, vetëm kur jepet i plotë emri dhe mbiemri i personit, por shkruhen me shkronjë të madhe, kur përdoret vetëm mbiemri dhe kur nyja ose pjesëza është element i domosdoshëm i tij, si: Leonardo da Vinci, por *Da Vinci*; Lope de Vega, por *De Vega*, Sharl dë Koster, por *Dë Koster*; Vincent van Gog, por *Van Gog* etj.
   - Me shkronjë të madhe shkruhen edhe pjesët *O, Mak, San, Sen* të mbiemrave të huaj të personave, si: *O Brien, O Konor, O Kejsi; Mak-Dovel, San-Martin, Sen-Simon* etj.

2. Shkruhen me shkronjë të madhe **emrat e kontinenteve, të shteteve, të deteve, të liqeneve, të lumenjve, të maleve, të fushave etj.** P.sh.:

   - *Evropa, Amerika Veriore, Amerika Latine, Azia, Afrika* etj.;
   - *Republika e Maqedonisë së Veriut, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Franca, Italia, Turqia, Belgjika* etj.;
   - *deti Adriatik, deti Jon, deti Mesdhe; lieqni i Shkodrës, liqeni i Ohrit, liqeni i Prespës; liqeni i Ujmanit* etj.;
   - lumenjtë: *Vardar, Drin, Vjosa, Buna, Shkumbin, Danub, Misisipi, Nil, Amazon.* Por: *lumi Vardar, lumi Drin, lumi Shkumbin, lumi Danub, lumi Missispi, lumi Nil* etj.:
   - malet: *Sharr, Tomor, Korab, Bjeshkët e Nemuna, Kilimanxharo, Himalaje.* Por: *mali Sharr, mali, mali Tomor.;*
   - *fusha e Pollogut, fusha e Myzeqesë, fusha e Maliqit etj.*

3. Shkruhen me shkronjë të madhe **emërtimet zyrtare të institucioneve të shtetit dhe organizatave:**
   - *Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Tetovës, Universiteti "Nënë Tereza", Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Fakulteti Ekonomik, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Instituti i Shkencave, Teatri i Operës dhe i Baletit, Biblioteka Kombëtare, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Këshilli Ekzekutiv, Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, Partia Socialiste, Partia Demokratike, Partia Liberale* etj.
   - Kurse shruhen me shkronjë të vogël **emërtimet e funksioneve shtetërore, politike, ushtarake dhe titujt fetarë**, p.sh: ***ministri*** *i Ekonomisë,* ***deputeti*** *i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut,* ***presidenti*** *i Republikës së Shqipërisë,* ***kryetari*** *i Komunës së Strugës,* ***mbretëresha*** *Teuta;* ***perandori*** *Kostandin,* ***sulltan*** *Murati II,* ***ambasadori*** *i Bashkimit Evropian në Maqedoni;* ***princ*** *Karl Topia,* ***dukë*** *Gjin Tanushi,* ***kont*** *Niketë Topia, Ali* ***pashë*** *Tepelena,* ***peshkopi*** *Pal Engjëlli,* ***at*** *Shtjefën Gjeçovi,* ***sheh*** *Mustafa Tetova,* ***imzot*** *Luigj Bumçi etj.*

4. Shkruhen me shkronjë të madhe emërtimet e ngjarjeve dhe të dokumenteve historike:

   - *Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore, Lufta e Ftohtë, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Kuvendi i Lezhës, Kongresi i Manastirit, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, Pakoja e Ahtisarit, Deklarata e Pavarësisë, Monumenti i Shpalljes së Pavarësisë,* etj.

5. **Shkruhen me shkronjë të madhe emrat e shesheve, rrugëve lagjev etj. kur ata janë pjesë e emërtimit të përveçëm përkatës,** si:
   - *Rruga e Barrikadave, Sheshi i Flamurit, Lagjja e Re, Klubi i Manastirit, Sheshi Skënderbeu, Sheshi Nëna Terezë, Çarshia e Vjetër, Sheshi Iliria, Lagjja Dardania*, etj.
   - Por Emrat e përgjithshëm si *rrugë, bulevard, stadium, shesh, lagje, teatër, shkollë, klub* etj., që përcaktohen nga një emërtim i përveçëm në rasën emërore, i vënë ndërmjet thonjëzash, shkruhen me shkronjë të vogël:

- ***rruga*** *"Kongresi i Manastirit",* ***bulevardi*** *"Aradhat Partizane",* **bulevardi** *"Ilirida",* **stadiumi** *"Dinamo",* **sheshi** *"Skënderbej",* **lagjja** *"Drenovec", "***kinema** *"Cine plex",* **shkolla** *"Liria",* **klubi** *"Flamurtari",* **klubi** *"Tomori";*

6. Shkruhen me shkronjë të madhe vetëm **fjala e parë dhe çdo emër i përveçëm brenda tij te titujt e gazetave, të revistave e të librave, të cilët vihen kurdoherë ndërmjet thonjëzash:**

- *"Zëri i popullit", "Jeta e re", "Studime filologjike", "Gjurmime albanologjike", "Revista pedagogjike", Gramatika e gjuhës shqipe", Drejtshkrimi i gjuhës shqipe", "Ata nuk ishin vetëm...", "Bagëti e bujqësia", ""Historia e Skënderbeut", "Historia e letërsisë shqipe", "Komedia hyjnore", "Historia e Skënderbeut", "Kronikë në gur", "Tartufi", "Sikur të isha djalë"Lulet e verës", "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës", "Para agimit", Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë", "Toka jonë"* etj.

7. Shkruhen me shkronjë të madhe **emërtimet e festave:**

- *7 marsi - Dita e Mësuesit, 8 Marsi – Dita e Ndërkombëtare e Gruas, 22 Dhjetori - Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, 28 Nëntori – Dita e Flamurit, 1 Maji – Dita Ndërkombëtare e Punës, Bajrami i Madh, Pashkët, Dita e Verës* etj.

8. Shkruhen me shkronjë të madhe emërtimet e **planetëve, të yjeve, të yjësive e të trupave të tjerë qiellorë:**

- *Arusha e Madhe, Arusha e Vogël, Galaktika, Jupiteri, Kashta e Kumtrit, Dielli, Hëna, Marsi, Neptuni, Saturni, Toka, Urani, Ylli Polar* etj.
- Por emrat *dielli, dheu, hëna, toka* etj. shkruhen me shkronjë të vogël, kur nuk përdoren si terma të astronomisë, p.sh. *perëndimi i* ***diellit****; temperatura në* ***tokë*** *është e ndryshme; një natë pa* ***hënë*** etj.

9. Shkruhen me shkronjë të madhe **emrat e përveçëm të botës mitologjike e fetare,** si edhe ata të figurave e të tregimeve popullore:

- *Adami, Apoloni, Buda, Diana, Eva, Hermesi, Jupiteri, Krishti, Minerva, Muhameti, Polifemi, Zeusi* etj.*; Borëbardha, e Bukura e Dheut, Hirushja, Katallani, E Përhitura, Syqenëza* etj.
- Por shkruhen me shkronjë të vogël emrat e përgjithshëm të sferave të mësipërme si: *ëngjëll, perëndi, perri, shenjt, xhind, zanë* etj.).

10. Shkruhen me shkronjë të madhe emrat e anëve të horizontit dhe mbiemrat e formuar prej tyre (me përjashtim të nyjës), kur përdoren si emërtime njësish territoriale (gjeografike ose historike):

- *Lindja e Largme, Lindja e Mesme, popujt e Lindjes, popujt e Veriut, shtetet e Perëndimit, vallet tona të Jugut, kryengritjet e malësrorëve të Veriut, Amerika e Jugut, Maqedonia Veriperëndimore Italia e Jugut, Poli i Jugut, Irlanda e Veriut, Koreja e Jugut, Poli i Veriut, Shqipëria e Veriut,* Evropa Juglindore, ***Evropa*** **Perëndimore,***Mesdheu* Lindor,etj.*;*

11. Shkruhen me shkronjë të madhe shkurtimet e emrave të shteteve, të institucioneve, të partive, të organizatave, të shoqërive, të institucioneve, të ndërmarrjeve etj., pa vënë pikë as ndërmjet, as pas tyre:

- *SHBA, RMV, BE; MASH, MPB, MPJ, BZhA, QShP, ISh; PDK, BDI, PDSh, ASh; OKB, NATO, SEATO, UNESCO, FIDE, FIFA, SVEA, UEFA; UT, TEC, EVN, AFP, MENA, NP,* etj.

Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes

Fjalët që shkruhen njësh

Shkruhen njësh të gjithë ato fjalë, që nga pikëpamja leksikore përbëjnë një fjalë të vetme, si:

1. **Fjalët me parashtesa:**
   - *antifashist, i derisotshëm, joantagonist, jokalimtare, jozyrtar, kundërsulm, kundërvënie, i mëparshëm, i mëvonshëm, mospërfillje, mossulmim, nëndrejtor, nënndarje, paaftësi, i pabesë, i papërshtatshëm, parregullësi, pasiguri, i pashkollë, i pashpresë, parafytyrim, i parakohshëm, parashkollor, prapaskenë, riatdhesim, sipërmarrje*;

2. **Fjalët e përbëra me kuptim të plotë dhe të qëndrueshëm:**
   - *bashkatdhetar, bashkëjetesë, besëlidhje buzëqeshur, botëkuptim, ditëlindje, disavjeçar, dëmshpërblim, nëndrejtor, mospërfillje, faqebardhë, kundërvënie, faqebardhë, fjalëformim, frymëmarrje, kokëfortë, këmbëngulje, krahëhapur, kryeqytet, letërnjoftim, liridashës, parafytyrim, parashkollor, paraardhës, parathënie, paragjykim, marrëveshje, rrobaqepës, rrugëdalje, sipërmarrje, sypatrembur, syshqiponjë, riatdhesim, rrobaqepës, rrugëdalje, vajguri, vendkalim, vendlindje, vetëshërbim, vetëvendosje, zemërgur, zemërmirë, zëvendësministër* etj.

3. **Fjalët e përbëra me lidhje këpujore ndërmjet tyre:**
   - *ballafaqe, dritëhije, këmbadoras, juglindje, marrëdhënie, shitblerje, shurdhmemec, pulagjel, shitblerje, shurdhmemec, veshmbathje, verilindje, verilindor, veriperëndim, veriperëndimor* etj.

4. **Fjalët e përbëra e të përngjitura, të cilat janë ngulitur prej kohësh si të tilla në gjuhë:**
   - *farefis, fëshfëshe, gjëegjëzë, qoftëlargu, rraketake, shtojzovalle, taketuke, thashetheme, ecejake* etj.

5. **Numërorët e përngjitur:**
   - *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë; tridhjetë, dyzet, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, nëntëdhjetë; njëqind, dyqind, treqind, katërqind; i/e njëmbëdhjetë, i/e dymbëdhjetë, i/e njëzetenjëtë, i/e tridhjetenëntë, i/e pesëdhjetegjashtë, i/e njëqindedytë,* i/e *njëqindmijtë, i/e pesëqindegjatëdhjetekatërt, i/e njëmiliardtë etj.*

6. **Përemrat e pakufishëm:**
   - *asgjë, askush, asnjë, asnjëri, cilido, çdonjëri, diçka, dikush, disa, gjithçka, gjithkush, gjithsecili, kurrfarë, kurrgjë, kushdo, ndokush, ndonjë, secili, secilido, tjetërkush* etj.

7. **Ndajfoljet dhe parafjalët:**

   - *askund, anembanë, asnjëherë, aspak, atëherë, brendapërbrenda, buzagaz, dalngadalë, doemos, domosdo, dosido, drejtpërdrejt, drejtpërsëdrejti, gjithandej, gjithherë, gjithkah, gjithkund, gjithmonë, gjithnjë, gjithsaherë, hëpërhë, kësisoj, kësodore, kurrkund, kryekëput, matanë, mbasandaj, mbasdite, medoemos, menjëherë, ndërkohë, ndërmjet, ndonjëherë, ndopak, ngado, ngaherë, ngandonjëherë, njëherazi, njëherë, njëlloj, njëmend, papritmas, pardje, pareshtur,* pardje, *përpara, përpjetë, përqark, përreth, përsëri, prapëseprapë, përgjithmonë, përherë, përmes, rrallëherë, sakaq, sidokudo, sidoqoftë, shpeshherë, vetvetiu* etj.

8. **Lidhëzat dhe pjesëzat:**

   - *derisa, domethënë, gjersa, gjithsaherë, kurse, megjithatë, megjithëse, meqenëse, meqë, mirëpo, ndërsa, ndonëse, ndoqë, ngaqë, ngase, nëse, përderisa, përveçqë, përveçse, poqë, porsa, porse, porsi, posa, qëkurse, sapo, sesa, siç, sikur, sikurse, teksa, veçse etj;*
   - *kushedi, pikësëpari, pothuaj, pothuajse, seç, thuajse* etj.

9. **Pasthirrmat:**

   - *obobo, ububu, faleminderit, lamtumirë, mirëmëngjes, mirëdita, mirëmbrëma, mirupafshim, tungjatjeta* etj.

Fjalët që shkruhen ndaras

Shkruhen ndaras ato fjalë që janë pjesë e një grupi emëror, e një shprehjeje ose e një emërtimi të përbërë, si:

1. **Togëfjalëshat e tipit emër në rasën emërore + emër në rasën rrjedhore:**
   - *bar ethesh, bar blete, bar miu, bar veshi, lule blete, lule dhensh, lule gjaku, luleshqerrash, vaj peshku, vaj ulliri* etj.

2. **Togëfjalëshat me kuptim mbiemëror të përbërë nga emrat *bojë* ose *ngjyrë* + emër në rasën rrjedhore:**
   - *bojë (ngjyrë) argjendi, bojë (ngjyrë) ari, bojë dheu, bojë hiri, bojë mishi, bojë mjalti, bojë plumbi, bojë qielli, bojë tulle, bojë ulliri,*

3. **Ndajfoljet dhe shprehjet ndajfoljore:**
   - *së afërmi, së bashku, së dyti, së fundi, së jashtmi, së paku, së pari, më së fundi, më së miri; për së afërmi, për së gjalli, për së largu, për së mbari; më dysh, më tresh, më katërsh; për një, për dy, për tre* etj.

4. **Shprehjet ndajfoljore të formuara nga dy fjalë të njëjta ose të ndryshme të lidhura në mes tyre me një parafjalë ose me lidhëzën e:**
   - *këmbë mbi këmbë, ditë me ditë, nata me natë; buzë më buzë, dorë më dorë, gojë më gojë, grykë më grykë, kokë më kokë, krah më krah, majë më majë, sy më sy; dy nga dy, një nga një; punë pa punë; brez pas brezi, herë pas here, kohë pas kohe; aty për aty, ballë për ballë, ditë për ditë, dorë për dorë, fjalë për fjalë, krah për krah, mes për mes, mot për mot, një për një, pikë për pikë, sot për sot, tani për tani; fund e krye, kokë e këmbë, lesh e li; qesh e ngjesh, shkel e shko, mbarë e prap, rreth e (për) qark, rreth e rrotull, veç e veç* etj.

5. **Numërorë themelorë të formuar me pjesëmarrjen e fjalëve mijë, milion, miliard etj., si dhe pjesët përbërëse të një numri themelor, të lidhura me lidhëzën e:**
   - *një mijë, dy mijë, tri mijë, dhjetë mijë, pesëmbëdhjetë mijë, dyzet mijë, dyqind mijë, një milion, dy million, një miliard, dy miliard; njëzet e një, njëzet e shtatë, tridhjetë e dy, dyzet e katër, shtatëdhjetë e tre, njëqind e një, njëqind e trembëdhjetë, treqind e pesëdhjetë e katër, një mijë e nëntqind e shtatëdhjetë e tre, njëzet e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë, një milion e pesëqind mijë e dyqind e dymbëdhjetë* etj.;

6. **Shprehje parafjalore ose lidhëzore:**
   - *aq sa; ashtu si; deri ku, deri kur, deri në, deri te; duke qenë se; edhe pse, edhe sikur; gjer kur, gjer në, gjer te; kaq sa; kështu që; kurdo që; mjaft që; në qoftë se; në mënyrë që, në rast se; ngado që; po që se, po të jetë se; që në, që se, që te; qysh se; sado që; sapo që; si edhe; sido që; tekdo që; vetëm se* etj.

7. **Shprehje pasthirrmore për përshëndetje, urime, falënderime, ngushëllime etj.:**
   - *Mbeçi me shëndet!, Mirë ardhshi!, Mirë ju gjetshim!, Mirë se erdhe!, Mirë se ju gjeta!, Mirë se vjen!, Mirë se na vjen!, Mirë se vini!, Punë të mbarë!, Udha mbarë!, Udhë të mbarë!, Mbarë pastë!, Nga mot gëzuar!, E paçim me jetë!, Për shumë vjet!, Qofshi shëndoshë!, Me shëndet!, Shëndet paç!, Shëndet paçi!; Qofshi vetë! Të rrosh vetë! Vetë shëndoshë! Si urdhëron! Si urdhëroni!* etj.

Fjalët që shkrujhen me vizë në mes

Viza lidhëse përdoret për të bashkuar dy fjalë që kanë kuptim të lidhur. Ajo ndihmon të formojmë fjalë të përbëra, të përsëritura ose që shprehin lidhje mes pjesëve, si:

1. **Fjalë e përftuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajta të ndryshme:**
   - *pika-pika, fije-fije, lloj-lloj, copë-copë, herë-herë, duar-duar, grupe-grupe, lara-lara, ngjyra-ngjyra, fletë-fletë, palë-palë,* etj.

2. **Fjalët e përftuara nga bashkimi i dy antonimeve,** si:
   - *hyrje-dalje, aty-këtu, vajtje-ardhje, pritje-përcjellje* etj.

3. **Fjalët e përftuara nga bashkimi i dy numërorëve themelorë, për të treguar një sasi të përafërt,** si:
   - *dy-tri* (orë), *katër-pesë* (veta), *pesë-gjashtë* (ditë,) *dhjetë-pesëmbëdhjetë* (vjet) etj.

4. **Numërorët rreshtorë kur vetë numri ose një pjesë e tij shkruhet me shifra arabe:**
   - klasa e *1-rë*, viti *i 2-të*, kreu *i 5-të*, e 7-ta, Kongresi *i 3-të*, shekulli i *21-të*, i *50-mijëti, 300-shi, 300 000-shi* ose *300-mijëshi* etj.

5. **Emërtimet e përvjetorëve dhe formimet e ngjashme me to, kur numërori shënohet me shifër:**
   - *100-vjetori i Pavarësisë; shkolla 9-vjeçare; 15-ditëshi i parë i shtatorit; 30-vjetëshi i parë i shekullit XX* etj.

6. **Fjalët onomatopeike të përftuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajtë të ndryshuar, si:**
   - *ciu-ciu, tik-tak, bam-bam, ham-ham, bam-bum, kuak-kuak, llap-llup, fap-fup, paf-puf* etj.

7. **Emërtimet e përbëra të njësive të matjes,** si:
   - *kuaj-fuqi, ton-kilometër, kilovat-orë, orë-normë, vit-dritë* etj.

8. **Emërtimet e tipit:**
   - *hotel-restorant, kafe-restorant, bar-bufe, shtëpi-muze, dyqan-shtëpizë, hotel-pension* etj.

9. **Fjalët mbiemërore që shprehin marrëdhënie plotësuese ose të ndërsjella,** si:
   - *shqiptaro-amerikan, afro-aziatik, austro-hungarez, historiko-gjeografik, politiko-kulturor,* analitiko-sintetik, *trako-ilir* etj.

10. **Emërtimet e përbëra të pikave të horizontit, të formuara prej një fjale të thjeshtë dhe prej një fjale të përbërë,** si:
    - *jug-juglindje, jug-jugperëndim, lindje-verilindje, perëndim-jugperëndim* etj.

11. **Emrat e përbërë të krahinave e të fshatrave:**
    - *Shën-Naum, Kriva-Pallankë, Fushë-Krujë, Fushë-Kosovë, Gazi-Babë, Kopaçin-Doll* etj.

12. **Fjalët që përmbajnë pjesëzën ish- përpara emërtimeve të ndryshme,** si:
    - *ish-ministër, ish-drejtor, ish-nxënës, ish-komandant, ish-ndërtesa e gjimnazit* etj.

13. **Mbaresat tek emërtimet e shkurtuara të institucioneve, të zyrave, të organizatave etj.:**
    - sekretar i *MASH-it* (Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), këshilltare e BZHA-së, (Byrosë së Zhvillimit të Arsimit), korrespondentët e ATSH-së (Agjencisë Telegrafike Shqiptare), nxënësit e ZLM-së (Zef Lush Markut), studentët e UT-së (Universitetit të Tetovës) etj.

Fjalë që nuk shkruhen me vizë lidhëse

Nuk vendoset vizë lidhëse tek:

1. **Emërtimet gjeografike që si pjesë të parë kanë një nyjë të përparme në gjuhët përkatëse**, si:
   - *Los Anxhelos, (jo: Los-Anxhelos), Nju Jork* (jo Nju-Jork), *Buenos Aires* (jo Buenos-Aires), *La Paz* (jo La-Paz), *Le Mans* (jo Le-Mans) *Le Kaj* (jo Le-Kaj) etj.
2. **Emrat e huaj me pjesëza si: *d' da, de, von***, si:
   - *Dora d'Istria* (jo Dora d-Istria), *Leonardo da Vinçi* (jo Leonardo da-Vinçi), *Lope de Vega* (jo Lope de-Vega), *Gi de Mopasan* (jo Gi de-Mopasan), *Sharl de Gol* (jo Sharl de-Gol), *Fridrih von Shiler* (jo Fridrih von-Shiler etj.

Diskutim

- Zbatoni përdorimin e drejtë të shkronjave të mëdha dhe diskutoni për ato!
- Zbatoni dhe shpjegoni rregullat e shkrimit të fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes dhe jepni shembuj fjalësh për ato!

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit mbështetet kryesisht në ndarjen e fjalëve në rrokje, duke marrë parasysh edhe strukturën morfologjike të fjalës, pra të kuptimin dhe ndërtimin e saj. Ajo bëhet sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Le të kujtojmë disa rregulla, kur ndahen dhe kur nuk ndahen fjalët në fund të rreshtit:

1. **Fjalët me më shumë se një rrokje ndahen sipas rrokjeve,** si:
   - *li-bër, dru-ri, më-su-es-ja, bre-dhi, ple-pi, po-pu-lli, shpre-sa, xi,-në-llo-nja* etj.
2. **Nuk ndahen fjalët që kanë vetëm një rrokje, si:**
   - *jam, kam, qen, afsh, ankth, bulkth, çmend, dash, dru, kënd, kopsht, lak, lëng, ngjall, shkrep, shkrumb, tremb, thumb, vrull, zmbraps, lis* etj.
3. **Nuk ndahen shkronjat e një dyshkronjëshi, si: ll, rr, nj, sh, th, dh, xh, zh, gj, p.sh:**
   - *mo-lla* (jo mol-la), *bu-rri* (jo bur-ri), *mash-kull* (jo mas-hkull), *azhu-rim* (jo az-hurim) etj.
4. **Nuk ndahet një shkronjë e vetme në fund ose në fillim të rreshtit**, si:
   - *lu-mi* (jo l-umi ose lum-i), *bu-ka* (jo b-uka ose buk-a), *shko-lla* (jo sh-kolla ose shkoll-a) etj.
5. **Kur dy a më shumë bashkëtingëllore ndodhen midis dy zanoresh, njëra rri me zanoren para, ndërsa tjetra me zanoren të pas:**
   - *qen-dra, lun-dra, pos-ta, për-parim, qën-dis, hën-gra, mëtej-shme* etj.
6. **Kur në një fjalë vijnë dy zanore njëra pas tjetrës ato mund të ndahen në fund të rreshtit,** si:
   - *di-ell, qi-ell, mu-aj, blu-aj, atdhe-ut, vëlla-it, muze-ut, veri-ut, shkru-an, sku-adër* etj
7. **Fjalët e përbëra, të prejardhura dhe të përngjitura ndahen sipas pjesëve që i formojnë,** si:
   - *hekur-udhë, breg-det, këpucë-bërës, ri-shikoj, punë-tor, para-dite, për-vitshëm* etj.
8. **Te fjalët me vizë lidhëse, nëse pjesa e dytë kalon në rreshtin tjetër dh viza përsëritet në fillim të rreshtit:**
   - *pika-/-pika, fije-/-fije, lloj-/-lloj,* vajtje-/-*ardhje, hyrje-/-dalje, lara-lara, palë-/-palë,* etj.
9. **Dy shkronja të njëllojta që takohen në një fjalë, mund të ndahen në fund të rreshtit, si:**
   - *i pa-aftë, i pa-anshëm, i pa-arsyeshëm, ko-operativë, e gjet-të*
10. **Nuk ndahen shkurtimet, si:**
    - *RMV, RSH, FIFA, NATO, OKB, SHBA, MASH-it, BZHA-ja, d.m.th., p.sh, etj, p.e.r.*
11. **Nuk ndahen në fund të rreshtit emërtimet e veçanta të mjeteve teknike, si dhe shkurtimet e njësive të masave:** si:
    - *TU-104, Boing-707, Mig-21; 35 cm, 50 dm, 20 mm, 60 ml, 5 l, 40km, 28 800 km², 90 ha, 3 m³, 200 g, 35 kg, 70 kv, 100%, 30‰* etj.
12. Nuk qëndrojnë të vetme në fund të rreshtit dhe nuk kalojnë të shkëputura në fillim të rreshtit tjetër edhe shenjat e pikësimit, ato duhet të shkruhen bashkë me fjalën që i përkasin.

Drejtshkrimi i datave

Përveç drejtshkrimit të fjalëve të tjera edhe datat shkruhen sipas disa rregullave të veçanta që përcaktojnë mënyrën e shënimit të ditës, muajit dhe vitit, si dhe përdorimin e shenjave të pikësimit dhe të parafjalës ***më,*** sidomos në rastet formale dhe zyrtare.

Ja disa shembuj për drejtshkrimin e datave në gjuhën shqipe:

1. **Kur në datat e plota muaji shkruhet me shifra (arabe ose romake), pas shënimit të datës dhe të muajit vihet një pikë:**

- *10.VI.2025* ose *10.6.2025* (jo 10/6/2025 ose 10-VI-2025) etj.

2. **Kur në datat e plota muaji shkruhet me shkronja, nuk vihet asnjë shenjë midis ditës, muajit dhe vitit,** si:

- *15 janar 2004,* (jo 15.janar.2004) , *4 mars 2020* (jo 4-mars-2020) etj.

3. **Në shkrimin e datave, pas emrit të vendit vihet presje dhe para shifrës që shënon datën, në shkresat zyrtare, vihet parafjala *më,*** p.sh:

- *Shkup,* **më** ***22.II.1986*** (jo Shkup 22,II,1986), *Tetovë,* **më** *5 tetor 1990* (jo Tetovë 5 tetor 1990) etj.

4. Parafjala **më** shkruhet kurdoherë para datave, kur ato përdoren si plotës kohe brenda një fjalie si:

- *Viti i ri shkollor fillon të hënën,* **më** ***1.IX.2023*** *ose* ***më 1.9.2023*** *ose* ***më 1 shtator 2023*** (jo Viti i ri shkollor fillon të hënën, **1.IX.2023** ose **1.9.2023 ose 1 shtator 2023**); *Mbledhja bëhet të premten,* **më** *1 gusht 2026* (jo Mbledhja bëhet të premten 1 gusht 2026) etj.

Diskutim

- Zbatoni rregullat për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit dhe diskutoni së bashku!
- Shkruani drejt datat dhe shpjegoni rregullat e drejtshkrimit të tyre!

Shenja të pikësimit

Kur flasim, shpeshherë e ulim apo e ngremë zërin, u japi fjalëve intonacion pyetës ose thirrmor, shprehim kënaqësi, frikë, inat etj. Të gjitha këto, në të shkrua, shprehen me anë të shenjave të pikësimit. Ata përdoren që të kuptohet përmbajtja e një teksti. Nga mospërdorimi i drejtë i tyre mund të ndryshojë ose të prishet kuptimi i tekstit. Me to sigurohet lexueshmëria dhe qartësia e një teksti.

Pika, **pikëpyetja, pikëçuditësja**, dhe **tri pikat** përdoren në fund të fjalisë për të shënuar pushimin që ndan dy fjali në gjuhën e folur.

- **Pika (.)** shënon intonacionin zbritës që shoqëron zakonisht fundin e fjalisë dëftore:

  Pranvera erdhi vonë sivjet (.)

- **Pikëpyetja (?)** shënon gafikisht intonacionin ngjitës që karakterizon pyetjen gjatë të folurit:

  Nga na vjen o djalë (?)

- **Pikëçuditja (!)** shënon grafikisht intonacionin ngjitës dhe intensitetin e veçantë që karakterizon shprehjen e një emocioni (një e papritur, kundërshtim, zemërim, gëzim):

  Merre lahutën dhe na këndo një këngë trimash (!)

- **Tri pikat (...)** tregojnë që fjalia, për arsye të ndryshme, ndërpritet e nuk jepet e plotë. Përdoret kur folësi nguron ta shfaqë deri në fund mendimin apo nuk e gjen dot fjalën e përshtatshme etj.:

  Me këto veprimet e tua unë (...)

Presja, pikëpresja, dy pika, kllapat përdoren brenda fjalisë.

- **Presja (,)** shënon grafikisht një pushim të shkurtër brenda fjalisë. Ajo shërben për të vënë në dukje një fjalë a një grup fjalësh në rolin e një gjymtyre të veçuar apo të një gjymtyre homogjene si dhe fjalët ose togjet e fjalëve të ndërmjetme:

  Agimi (,) për çudi (,) nuk shkoi larg.

- **Pikëpresja (;)** shënon grafikisht një pushim më të gjatë se presja. Ajo ndan në përgjithësi pjesë të ndryshme të pavarura të një fjalie të përbërë:

  Ata që më donin, erdhën (;) ata që s'më donin, nuk erdhën.

- **Dy pikat (:)** shënojnë një pushim që zgjat pothuajse sa pikëpresja, por ndryshe prej saj dy pikat kanë një vlerë, lajmërojnë një shpjegim, një varg shembujsh etj.

  Disa pemë p.sh (:) portokallat, limonat, mandarinat i pjekin frutat në dimër.

- **Kllapat (())** shënojnë një pushim të shkurtër si presja e shërbejnë për të dalluar, shquar dhe veçuar një grup fjalësh që shprehin një sqarim ose një mendim të ndërshtënë:

  Te fusha e kuqe (quhej kështu, se në mes të saj kishte një shkëmb të kuq), Hanën e priste Agroni.

Shenja të tjera të pikësimit që përdoren rëndom janë edhe **thonjëza, viza, shenja e pjerrët, shenja e theksit, apostrofi, ylli etj.**

- **Viza (–)** përdoret për të ndarë pjesë të fjalisë, për të treguar një ndryshim të papritur ose për të rrethuar fjalët ndërhyrëse Ja përdorimet kryesore:

  a) në dialog (ligjëratë e drejtë):

  (–) Kur do të nisemi?
  (–) Sapo të agojë, – u përgjigj ai.

  b) për flalët dhe fjalitë ndërhyrese:

  Ai vend (–) nëse mund ta quajmë kështu (–) ishte krejtësisht i braktisur

- **Thonjëzat (" ")** janë shenja pikësimi që përdoren kryesisht për të izoluar një pjesë të tekstit nga pjesa tjetër e fjalisë. Ja rastet kryesore kur duhet t'i përdorim:

  a) në ligjëratë të drejtë: për të treguar fjalët e thëna drejtpërdrejt nga dikush:

  (") Zemra e prindit nuk gënjehet aq kollaj ("), – tha plaku.

  b) në citime: kur merret një pjesë teksti nga një libër, dokument apo autor tjetër.

  Siç thotë populli: (") Gjuha kocka s'ka, por kocka thyen (")

  c) në emra të përveçëm institucionesh, titujsh librash, gazetash, emra rrugësh, ndërmarrjesh etj.

  Lexova librin (") Kronikë në gur (") të Ismail Kadaresë.

  ç) në ironia ose në kuptimi të figurshëm: kur një fjalë përdoret me ironi ose jo në kuptimin e saj të parë.

  *Sa i (") **pajisur** (") qenka ky djalë! (në kuptimin që nuk di asgjë).*

- **Shenja e pjerrët e pikësimit (/)** quhet edhe pjerrësia (në gjuhën e përditshme njihet edhe si slash), përdoret kryesisht në këto raste:

  a) për të shënuar variante alternative duke zëvendësuar lidhëzat "ose", "edhe/ose":

  i (/) e dashur, shkolla fillore (/) e mesme.

  b) në adresa dhe data, për të ndarë numrat:

  Rruga "Kongresi i Manastirit", nr. 10 (/) 2).

c) në njësi matëse kur tregon raportin *"për"*

100 (/) h; 21 (/) s

ç) në poezi përdoret për të ndarë vargjet kur ato shkruhen në të njëjtin rresht:

"Pa dëgjo fyellin ç'thotë (/) Tregon mërgimet e shkreta, (/) Qahet nga e zeza botë".

- **Apostrofi (')** përdoret kryesisht për të shënuar rënien e një zanoreje në fund të një fjale ose brenda saj, sikurse:

  a) te trajta e shkurtër e përemrave, kur zanorja **-i** ose **-e** bie para një fjalë që fillon me zanore:

  *m (') atë = më + atë; **t (')** i = të + i; **m (')** u = më + u* etj.

  b) te pjesëza mohuese "mos**",** kur zanorja **-o** bie para një trajte të shkurtër ose fjalë tjetër:

  *mos **m (')** harro.*

  c) në poezi përdoret për të ruajtur ritmin ose rimën duke hequr një zanore (zakonisht **-ë**-në fundore):

  N *(') fusha e n (') male*

- **Ylli (*)** që zyrtarisht njihet si asterisk, përdoret për referencë (shënim) për të lidhur një fjalë ose fjali me një shënim plotësues në fund të faqes (footnote).

Rregulli i artë për përdorimin e hapësirës me shenjat e pikësimit në gjuhën shqipe është: asnjëherë hapësirë para shenjës, por gjithmonë një hapësirë pas saj.

Diskutim

- Shpjegoni funksionin dhe kuptimin e shenjave të pikësimit!
- Zbatoni drejt shenjat e pikësimit në komunikim me shkrim!
- Gjeni dhe korrigjoni gabimet në përdorimin e shenjave të pikësimit në një tekst!

Fjalët e shkurtuara dhe shkurtesat

Fjalët e shkurtuara (akronimet) - janë fjalë të formuara nga shkronjat fillestare ose rrokjet e një emërtimi të gjatë të cilat shqiptohen si fjalë të vetme ose si shkronja individuale. Ato shërbejnë për shkurtimin e kohës në të shkruar dhe të folur, duke qenë të kudondodhura në media, teknologji dhe fusha të ndryshme të dijes. Shembuj:

- ***UNESCO*** – (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization), Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë;
- ***SHBA*** – Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- ***BE*** – Bashkimi Evropian;
- ***NATO*** - (North Atlantic Treaty Organization), Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut;
- ***RMV*** – Republika e Maqedonisë së Veriut;
- ***OKB*** – Organizata e Kombeve të Bashkuara
- ***RSH*** – Republika e Shqipërisë;
- ***ASHSH*** – Akademia e Shkencave të Shqipërisë;
- ***UT*** – Universiteti i Tetovës;
- ***ITSHKSH*** - Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve;
- ***MASH*** – Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- ***SHMQSH*** – Shkolla e Mesme e Qytetit të Shkupit;
- ***SHMK*** – Shkolla e Mesme Komunale;
- ***TVSH*** – Tatimi mbi Vlerën e shtuar;
- ***KQZ*** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- ***USB*** – (Universal Serial Bus), Ndërfaqe Seriale Universale;
- ***PDF*** – (Portable Document Format), Format i Dokumentit të Bartshëm;
- ***GPS*** – (Global Positioning System), Sistemi i Pozicionimit Global

Akronimet shkruhen me shkronja të mëdha, pa vendosur pika ndërmjet shkronjave, si: ***UNESKO*** dhe jo ***U.N.E.S.K.O.***

Shkurtesat janë forma të shkurtuara të fjalëve ose të shprehjeve që përdoren për ta bërë shkrimin dhe komunikimin më të shpejtë, më praktik dhe zakonisht shënohen me pikë në fund. Ato shqiptohen sipas fjalës që përfaqësojnë, jo si fjalë të reja. Shembuj:

- ***z.*** - zotëri;
- ***znj.*** – zonjë
- ***prof.*** – profesor;
- ***dr.*** – doktor;
- ***ing.*** – inxhinier;
- ***parag.*** – paragraf;
- ***kap.*** – kapitull;

- ***shek.*** - shekull
- ***fq.*** – faqe;
- ***nr.*** – numër;
- ***rr.*** – rruga;
- ***lagj.*** lagjja;
- ***fig.*** - figurë;
- ***p.sh.*** – për shembull;
- ***b.f.*** – bie fjala;
- ***etj.*** – e të tjera;
- ***dmth.*** – do me thënë;
- ***flm.*** – faleminderit;
- ***klm.*** – kalofsh mirë;
- ***tung.*** – tungjatjeta;
- ***ps.*** – pas shkrimit

Diskutim

- Dalloni fjalët e shkurtuara nga shkurtesat!
- Jepni shembuj fjalësh të shkurtuara dhe shkurtesa të zakonshme sipas rregullave të ndryshme.
- Hulumtoni se si shkruhen drejt fjalët e shkurtuara dhe shkurtesat në botimin *"Drejtshkrimi i gjuhës shqipe"*!
- Zbatoni drejt shkurtesat dhe fjalët e shkurtuara gjatë të shkruarit!

Të dëgjuarit për të kuptuar

Të dëgjuarit për të kuptuar është një proces aktiv dhe kritik që shkon përtej dëgjimit të thjeshtë, duke kërkuar përqendrim, përpunim të informacionit dhe kuptim të mesazhit thelbësor. Ai përfshin përdorimin e aftësive njohëse të trurit për të interpretuar sinjalet zanore, thelbësore për komunikim efektiv dhe ndërveprim social.

Përqendrimi apo fokusimi i plotë te folësi, pa shpërqendrime, si dhe përpunimi i duhur i informacionit janë thelbësore për të kuptuar si duhet atë që lexon. Është shumë i rendësishëm edhe fakti i kuptimi të kontekstit emocional dhe synimit të folësit e jo vetëm dëgjimi i fjalëve.

Të dëgjuarit efektiv është thelbësor për të mësuar, për të ndërtuar marrëdhënie të shëndosha dhe për të shmangur keqkuptimet.

Interpretimi i teksteve letrare përmes të dëgjuarit është një proces që kërkon të shkohet përtej fjalëve të thjeshta për të zbuluar kuptimin, strukturën, stilin dhe mesazhin e një vepre. Gjatë dëgjimit, duhet të identifikohen përvojat, emocionet dhe mesazhet që autori përpiqet të përcjellë. Motivet e përsëritura shpesh shërbejnë për të përforcuar konceptet kryesore të veprës. Teksti letrar shpesh është "i veshur me imazhin e përfytyrimit", veçanërisht në vepra romantike apo fantastike dhe simbolet shpesh fshehin kuptime më të thella se ajo që thuhet drejtpërdrejt.

Diskutim

- Riprodhoni informacione nga një tekst i dëgjuar!
- Shpjegoni dhe interpretoni të kuptuarit e mesazheve dhe të koncepteve nga një tekst i dëgjuar!
- Zbatoni informacionin e dëgjuar në situata ose në kontekste të tjera!

Të lexuarit për të kuptuar

Leximi është proces aktiv i të kuptuarit të teksteve të ndryshme. **Të lexuarit për të kuptuar** është procesi i nxjerrjes së kuptimit nga një tekst përmes ndërveprimit aktiv midis lexuesit dhe materialit të shkruar. Ky proces shkon përtej identifikimit të thjeshtë të fjalëve, duke përfshirë analizën, interpretimin dhe lidhjen e informacionit të ri me njohuritë paraprake.

Para se të fillojmë leximin, është mirë që të shfletojmë titujt, nëntitujt dhe imazhet për të krijuar një ide të përgjithshme mbi temën. Parashtrimi i pyetjeve vetes gjatë leximit (p.sh., "Pse ndodhi kjo?" ose "Cila është pika kryesore?"), është shumë e rëndësishme për të mbajtur vëmendjen të fokusuar. Gjithashtu duhet bërë lidhja me përvojën pra, krahasimi i informacionit të tekstit me gjërat që i dimë tashmë ose me ndonjë përvojë personale, por nëse nuk gjejmë të tilla, atëherë bëjmë vizualizim, krijojmë imazhe mendore për ngjarjet ose konceptet e përshkruara.

Për ta kuptuar edhe më mirë atë që lexojmë është e nevojshme edhe identifikimi i fakteve të drejtpërdrejta që thuhen në tekst (kush, çfarë, ku, kur), leximi "midis rreshtave" për të kuptuar mesazhet e nënkuptuara ose qëllimin e autorit si dhe kuptimin kritik apo vlerësimin e vërtetësisë, rëndësisë dhe cilësisë së informacionit të dhënë në tekstin që lexojmë.

Të lexuarit për të kuptuar është thelbësor për aftësinë e nxënësve për të marrë njohuri në të gjitha lëndët mësimore. Gjatë viteve të shkollimit, nxënësit duhet të zhvillojnë një kuptim më të thellë të llojeve të ndryshme të teksteve. Kjo është e rëndësishme sepse të kuptuarit e mirë të leximit, jo vetëm që i ndihmon ata të kuptojnë dhe të mësojnë lëndë të reja, por edhe të marrin pjesë në shoqëri dhe të mbështesin vlerat demokratike.

NGROHJA GLOBALE: NJË SFIDË PËR PLANETIN TONË

Ngrohja globale i referohet rritjes graduale të temperaturës mesatare të atmosferës së Tokës dhe oqeaneve, një proces që është përshpejtuar ndjeshëm gjatë shekullit të fundit. Sipas raporteve shkencore të IPCC *(Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike),* ky fenomen shkaktohet kryesisht nga efekti i serës, ku gazet si **dioksidi i karbonit (CO2) dhe metani** bllokojnë nxehtësinë e diellit brenda atmosferës.

Burimet kryesore të këtyre gazeve janë **djegia e lëndëve fosile (qymyri, nafta), shpyllëzimi dhe aktivitetet industriale.** Pasojat janë tashmë të dukshme: shkrirja e akullnajave ka bërë që niveli i detit **të rritet me rreth 17 deri në 58 centimetra (parashikim deri në fund të këtij shekulli),** duke rrezikuar qytetet bregdetare. Në rajonin e Ballkanit, ndryshimet klimatike po shfaqen përmes ekstremeve të motit, si **valët e gjata të të nxehtit dhe përmbytjet e papritura.**

Mbrojtja e mjedisit kërkon veprime urgjente, si **kalimi drejt energjisë së renovueshme** (diellore dhe e erës) **dhe pyllëzimi i zonave të zhveshura**. Çdo individ mund të kontribuojë duke reduktuar mbeturinat, duke kursyer energjinë dhe duke përdorur transportin publik

Identifikimi i detajeve kryesore:

- Shkaktarët kryesorë: _____.
- Burimet e ndotjes: _____.
- Parashikimi për nivelin e detit: _____.
- Efektet në Ballkan: _____.
- Zgjidhjet e mundshme: _____.

Diskutim

- Identifikoni dhe riprodhoni fakte dhe detaje kryesore nga teksti i lexuar dhe diskutoni për ato!

PSE "SPEKTATORI" ËSHTË ÇELËSI I NDRYSHIMIT?

Bulizmi nuk është thjesht një zënkë mes dy personave; ai është një abuzim i përsëritur i pushtetit, ku dikush përdor forcën fizike, fyerjet ose përjashtimin social për të lënduar një tjetër. Një person që përdor bulizmin krijon një mjedis frike dhe pasigurie. Shënjestra e sulmeve të përsëritura si fizike ashtu edhe emocionale është viktima. Ai ndjen izolim, pafuqi dhe rënie të vetëvlerësimit si dhe pasoja afatgjate si ankth, depresion dhe tërheqje nga aktivitetet sociale. Sot, ky fenomen është zhvendosur edhe në botën digjitale (cyberbullying), ku dëmi mund të jetë i vazhdueshëm, 24 orë në ditë.

Në çdo situatë bulizmi ekzistojnë tre aktorë: **agresori, viktima**, **spektatori** dhe **mbrojtësi**. Studimet tregojnë se spektatorët (ata që shohin dhe nuk veprojnë) luajnë rolin vendimtar. Ai vëzhgon ngjarjen, por nuk reagon (nga frika ose indiferenca), por kur spektatorët heshtin, agresori ndihet i fuqizuar. Kur spektatorët ndërhyjnë ose kërkojnë ndihmë, rreth 57% e rasteve të bulizmit ndalojnë brenda 10 sekondave.

Një spektator shumë mirë mund të shndërrohet në një mbrojtës. Një mbrojtës nuk ka nevojë të jetë hero fizik. Ai mund të ndërhyjë në shumë mënyra për të ndihmuar viktimën ose për të ndaluar agresorin, duke ndryshuar ekuilibrin e fuqisë së agresorit dhe kështu mund të ndalojë sulmin. Mbrojtësi përveç që ndihmon viktimën, ai njëkohësisht zhvillon udhëheqësi (leadership), empati dhe integritet moral për veten e tij.

Zgjidhja që ndalon bulizmin nuk qëndron te ndëshkimi i vetëm një personi, por te ndërtimi i një kulture të empatisë. Kjo do të thotë të mbrosh të tjerët edhe kur nuk je ti shënjestra, duke kuptuar se siguria e komunitetit varet nga veprimi i secilit individ.

Përcaktimi i roleve në situatat e bulizmit:

Roli	Karakteristika kryesore	Ndikimi në situatë	Pasoja afatgjatë
Agresori			
Viktima			
Spektatori			
Mbrojtësi			

Diskutim

- Shpjegoni dhe përmblidhni idetë dhe temat kryesore nga ky tekst!
- Zbatoni informacionin ose konceptet nga ky teksti në kontekste ose situata të tjera!

NDËRTESAT MË TË LARTA

"*Ndërtesat më të larta*" është artikull në një revistë norvegjeze i publikuar në vitin 2006.



DETYRË: Interpretoni me kujdes të dhënat në këtë artikull dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim!

1. Në kohën kur është publikuar artikulli, cila ndërtesë sipas Grafik-ut 2 ka qenë ndërtesa më e lartë e përfunduar?

2. Çfarë tipi të dhënash jep Grafik-u 1?

3. Radison SAS Plaza Oslo, është e lartë vetëm 117 metër. Pse është përfshirë në Grafik-un 2?

4. Parmendoni që për njëzet vjet, të dhënat për ndërtesat e larta janë treguar përsëri në një artikull si ky.
   Më poshtë janë dhënë tre karakteristika të artikullit origjinal. A mendoni se do të ndryshojnë ndoshta këto karakteristika për njëzet vjetët e ardhme duke rrethuar "po" ose "jo" në tabelën më poshtë dhe argumentoni për ato!

Karakteristikat e artikullit	A thua vallë do të ndryshojnë këto karakteristika për njëzet vjetët e ardhme?
Qytetet e paraqitura në Grafikun 1	Po / Jo
Titulli në Grafikun 1	Po / Jo
Numri i ndërtesave në grafikun 1	Po / Jo

Diskutim

- Gjeni dhe interpretoni informacionin e kërkuar në një tekst tjetër, duke përfshirë edhe informacionin e dhënë me tabela, me grafikë, me harta, me të dhëna statistikore dhe me diagrame!

Të shkruarit e teksteve për komunikim zyrtar dhe jozyrtar

Të shkruarit është një aftësi themelore për të komunikuar me të tjerët në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme. Përmes shkrimit, mendimet dhe idetë tona bëhen të kuptueshme edhe për ata që nuk janë të pranishëm në momentin e komunikimit. Shkrimi përdoret në situata të ndryshme dhe, sipas rastit, ai mund të jetë:

- **komunikim zyrtar** - kur përdoret për të përcjellë informacion serioz që mbështetet në rregulla strikte, në strukturë të standardizuar dhe në **gjuhë formale;**
- **komunikim jozyrtar** - kur shërben për komunikim të lirshëm që është më fleksibël, më shprehës dhe më i fokusuar te marrëdhënia personale.

Komunikimi zyrtar (formal)

Ky lloj komunikimi përdoret në institucione, në administratë publike dhe në marrëdhënie biznesi. Formatet e komunikimit zyrtar janë: **shkresa (letra) zyrtare, procesverbali, lutja, kërkesa** etj.

- **Shkresa zyrtare** - është mjet komunikimi formal që përdoret për të shkëmbyer informacion midis institucioneve, bizneseve ose individëve në një kuadër profesional. Ajo konsiderohet si një tekst joletrar që ka vlerë dokumentuese. Përdoret gjuha standarde, e qartë, e saktë dhe pa ngarkesa emocionale.

Në strukturën e shkresave zyrtare përfshihen: **emri i institucionit, titulli, data, numri i protokollit, lënda, marrësi, përmbajtja e tekstit** dhe **nënshkrimi**. Shkresat duhet të jenë koncize dhe të dokumentueshme.

- **Procesverbali** është një dokument zyrtar që shërben për të pasqyruar me saktësi rrjedhën e një mbledhjeje, diskutimet e bëra, vendimet e marra ose konstatimin e një fakti të caktuar në terren. Ai konsiderohet si akt administrativ me vlerë ligjore dhe dokumentuese.

  Procesverbali duhet të paraqet saktësi dhe objektivitet, pra duhet të mbajë shënim vetëm atë që është thënë ose parë, pa shtuar mendime personale të mbajtësit të procesverbalit. Struktura e tij është standarde: **hyrja** (emrin e institucionit, datën, orën, vendin e zhvillimit dhe listën e të pranishmëve, **rendi i ditës (**pikat që do të diskutohen gjatë mbledhjes, **zhvillimi (p**ërmbledhje e diskutimeve për çdo pikë të rendit të ditës), **vendimet apo konkluzionet** (detyrat e lëna për secilën pale) dhe **përmbyllja** (ora e përfundimit dhe nënshkrimet e kryesuesit dhe procesmbajtësit

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË TRETË TË PARLAMENTIT TË NXËNËSVE

Shkolla: "7 Marsi"
Data: 5 prill 2025
Ora e fillimit: 12:30
Vendi: Biblioteka e shkollës

TË PRANISHËM:

Kryetari/ja: Blerta Toska
Sekretari/ja: Artan Alijaj
Përfaqësuesit e klasave: I-1, I-2, II-1, II-2, III-1, III-2, IV-1, IV-2
Koordinatori i shkollës (mësimdhënësi): Bujar Toçi

RENDI I DITËS:

1. Organizimi i "Javës së Kulturës dhe Sportit".
2. Propozimi për përmirësimin e kushteve në kabinetin e informatikës.
3. Caktimi i datës për aksionin e radhës të pastrimit të mjedisit.

DISKUTIMET:

- **Për pikën 1:** Kryetari hapi mbledhjen duke propozuar aktivitetet për javën kulturore. Përfaqësuesi i klasës III-2 sugjeroi një turne futbolli ndërsa klasa I-1 propozoi një konkurs poezie, ku do të merrnin pjesë edhe grupi letrar i shkollës.
- **Për pikën 2:** Nxënësit shprehën shqetësimin se disa kompjuterë në kabinetin e informatikës nuk funksionojnë. Përfaqësuesi i klasës II-2 propozoi që t'i dërgohet një kërkesë zyrtare Drejtorisë së Shkollës
- **Për pikën 3:** U diskutua që aksioni i pastrimit të bëhet në fundjavë, por shumica ranë dakord që të bëhet të premten pas mësimit.

VENDIMET E MARRA:

1. **Java e Kulturës** do të mbahet nga data 20 prill deri më 25 prill 2025.
2. .**Sekretari** të hartojë shkresën drejtuar drejtorisë për pajisjet e informatikës deri nesër.
3. **Aksioni i pastrimit** u caktua për të premten e ardhshme në orën 14:00.

Mbledhja u mbyll në orën 14:00

Proçesverbaliste: KRYETARI
Laura Selimi

_____ _____

(nënshkrimi) (nënshkrimi) (vula)

- **Kërkesa** - është një shkresë formale përmes së cilës një individ ose një grup i caktuar i drejtohet një autoriteti më të lartë për të kërkuar zgjidhjen e një problemi, marrjen e një lejeje ose realizimin e ndonjë projekti. Kërkesa zyrtare karakterizohet nga **gjuha e drejtpërdrejtë ku** përdoret gjuha standarde, pa emocione dhe me tone respekti. Qëllimi i kërkesës duhet të specifikohet që në krye të faqes e më pas shpjegohet shkurtimisht pse po bëhet kjo kërkesë dhe cilat janë përfitimet.

DREJTUAR: Drejtorisë së Shkollës "7 Marsi

LËNDA: Kërkesë për riparimin e pajisjeve në kabinetin e informatikës

I nderuar z Drejtor,

Në emër të Parlamentit të Nxënësve, po ju drejtohemi me këtë kërkesë lidhur me gjendjen teknike të kabinetit të informatikës. Gjatë mbledhjes sonë të fundit, u konstatua se pesë njësi kompjuterike janë jashtë funksionit, gjë që vështirëson procesin mësimor për shumë nxënës.
Kërkojmë nga ana Juaj të mundësoni ndërhyrjen e specialistëve për riparimin e këtyre pajisjeve ose zëvendësimin e tyre, me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e rregullt e mësimeve praktike.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme, mbetemi në pritje të një përgjigjeje.

Me respekt,

Kryetarja e Parlamentit të Nxënësve
Blerta Toska

_____

(Nënshkrimi)

Data: 06 prill 2025

Komunikimi jozyrtar (joformal)

Ky lloj komunikimi zhvillohet midis miqve, familjarëve ose kolegëve në rrethana shoqërore. Për dallim nga komunikimi zyrtar, ku detyrimisht përdoret gjuha standarde, këtu mund të përdoret edhe zhargone e dialektete të ndryshme, shkurtimet ose shenjat e pikësimit në mënyrë më ekspresive (p.sh., përdorimi i emojive). Nuk ka një format të paracaktuar; mesazhi mund të jetë i shkurtër dhe spontan. Përdoret me qëllimi të mbajtjes së raporteve sociale dhe të shkëmbimit të informacioneve të përditshme. Formatet e komunikimit jozyrtar janë: **letra jozyrtare (personale), mesazhet elektronike** (e-mailet), **mesazhet në rrjetet sociale** (WhatsApp, Viber) etj.

.

- **Letra personale** - është një lloj komunikimi jozyrtar që shkëmbehet midis njerëzve që kanë një lidhje të afërt, si miqtë, familjarët apo të afërmit. Për dallim nga shkresat zyrtare, këtu fokusi është te shprehja e ndjenjave, mendimeve dhe përvojave vetjake. gjuha është e lirshme, e ngrohtë dhe shpesh përdor shprehje emocionale, dialektore apo shkurtime (zhargon miqësor). Struktura e letrës nuk ka rregulla strikte, por zakonisht përmban vendin dhe datën por më tipike është përshëndetja fillestare (p.sh. "*I dashur...*" apo "*E shtrenjta...*") dhe ajo përmbyllëse ("*Të përqafoj me mall*", "*Me dashuri*").

  Sot, letrat personale në letër janë zëvendësuar kryesisht nga e-mailet personale dhe mesazhet në rrjete sociale, por ato mbeten mjeti më intim i komunikimit të shkruar.

Shkup, 11 Mars 2026

I dashur Drini,

U bë kohë që nuk jemi parë dhe shpresoj që kjo letër të të gjejë mirë me shëndet e me punë. Më ka marrë malli për gjthçka, veçanërisht për bisedat tona të gjata buzë lumit dhe për të qeshurat që nuk mbaronin kurrë.
Po të shkruaj sepse mbrëmë pashë disa fotografi të vjetra të maturës dhe u kujtova për planet që bënim dikur. Këtu te ne gjërat po shkojnë mirë, ndonëse qyteti është bërë shumë i zhurmshëm kohët e fundit. Unë kam filluar një kurs të ri pikture dhe po më pëlqen pa masë – më ndihmon të qetësohem pas një dite të lodhshme në zyrë.
Mezi po pres të vish për vizitë në maj, ashtu siç premtove. Kemi shumë gjëra për të treguar! Mos harro të më shkruash sapo të kesh pak kohë të lirë.

Të përqafoj me mall dhe të uroj gjithë të mirat,

Miku yt,
Arbi

- **Mesazhi elektronik (e-mail)** - përdoret për komunikim me njerëz që njihen mire mes vete, si miqtë, familjarët ose kolegët e afërt. Struktura e e-mail-it është më e lirë dhe më spontane, pa nevojën për një format strikt. Mund të përmbajë shkurtime, zhargon, emotikone dhe një ton bisedor. Mund të përdoret për shembull për ftesa dhe urime të ndryshme shoqërore ose familjare ose thjesht për të mbajtur kontaktet me miqtë.



Mesazhet në rrjete sociale (WhatsApp, Instagram, Viber, etj.) - janë forma më e shpeshtë e **komunikimit jozyrtar** në epokën digjitale. Ato janë mesazhe të shpejta, të shkurtra dhe kryesisht spontane. Karakteristikat kryesore të tyre është se komunikimi ndodh në kohë reale (chat) dhe shpesh përdoren shkurtime (p.sh. "klm" për kalofsh mirë), zhargone, dhe mungon kujdesi për pikësimin apo për gjuhën standarde. Këto mesazhe shoqërohen masivisht me **emoji**, **stickers**, GIF, imazhe ose mesazhe zanore (voice messages). Shpesh kuptimi varet nga bisedat e mëparshme, duke e bërë tekstin më pak formal se një e-mail apo letër. Ndryshe nga e-maili zyrtar që kërkon strukturë (subjekt, hyrje, mbyllje), mesazhi në rrjete sociale mund të jetë vetëm një fjalë ose një ikonë.

Diskutim

- Identifikoni elemente dhe formatet kryesore nga tekstet zyrtare dhe jozyrtare!
- Bëni dallim mes stilit dhe strukturës në komunikimin zyrtar (formal) dhe atë jozyrtar (joformal) gjatë komunikimit me shkrim dhe diskutoni bashkë!
- Përdorni gjuhën formale dhe format e përshtatshme në komunikimin zyrtar, duke respektuar strukturën gjatë shkrimit të tyre!
- Njihni dhe zbatoni gjuhën joformale duke përdorur shprehje bisedash, shkurtesa dhe emotikone (shenja), të përshtatshme për kontekstin dhe audiencën kur shkruani letra personale, e-maile joformale ose mesazhe në rrjetet sociale!

Arti dhe llojet e tij

Arti është një nënndarje e madhe e kulturës, e përbërë nga shumë përpjekje dhe disiplina krijuese. Është një formë shprehjeje e individit dhe ndihmon në reflektimin e emocioneve, ideve dhe përvojave. Historia e artit shtrihet në mijra vjet, duke filluar nga atrefaktet prehistorike deri në lëvizjet bashkëkohore. Ky evolucion ka reflektuar ndryshimet kulturore, sociale dhe teknologjike në histori.

Arti luan një rol të rëndësishëm në shoqëri, për të reflektuar, provokuar mendimin dhe për të nxitur ndryshimin. Ai ndihmon në krijimin e identitetit kulturor dhe social të një kombi. Arti shërben edhe si mjet komunikimi përmes të cilit njerëzit shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre, përfshin emocione dhe ide duke, tejkaluar barrierat e gjuhës dhe kulturës.

Artet ndahen në lloje të ndryshme të cilët më të rëndësishmët janë: arkitektura, skulptura, piktura, muzika, aktrimi, letërsia etj.



Arkitektura është arti i projektimit, i vendosjes dhe i zbukurimit të ndërtesave ose veprave të tjera që kombinohet me funksionalitetin dhe estetikën. Arkitektura pasqyron ndikimin thelbësor të krijimit njerëzor në mjediset e ndërtuara. Ajo formëson hapësirat tona me struktura që përmbushin nevojat tona.

Skulptura është arti i krijimit të statujave, të busteve e të veprave të tjera artistike me vëllim, duke i gdhendur në mermer, në gur, në dru, në metal etj. Ajo shpreh forma dhe figura, duke sjellë kështu një dimension të ri në art. Nëpërmjet skulpturës shpjegohën shumë ngjarje dhe procese sociale.

Piktura ësht arti i paraqitjes së sendeve, të natyrës, të njerëzve dhe të veprave të tyre etj., me anë të vijave e të ngjyrave mbi sipërfaqe zakonisht të sheshta. Është një nga format më të njohura të artit me stile të ndryshme si pikturë në vaj, akuarel, pastel, secila me teknika të veçanta. Nëpërmjet pikturimit shprehen ndjenja të ndryshme si dhe ngjarje historiko – shoqërore.

Muzika si një formë arti, shpreh ndjenjat përmes tingujve dhe ritmeve. Ajo ndihmon në krijimin e atmosferave dhe transmetimin e emocioneve përmes kompozimeve të ndryshme. Muzika shqiptare, duke reflektuar transformimet sociale dhe kulturore ka kaluar përmes periudhash të ndryshme ku muzika popullre ka shërbyer si kanal për ruajtjen dhe zhvillimin e traditës sonë.

Aktrimi është art i shndërrimit të aktorit në një personazh, përmes gjesteve, fjalëve, mimikës dhe ndjenjës, pra është një formë e artit që kombinon aktrimin dhe dranatikën për të treguar ngjarje përmes performancës së gjallë. Aktrimi ka kaluar nga ritualet fetare të lashtësisë, në teatrin klasik, më pas në skenat realiste të shek. XIX dhe sot në kinematografinë e avancuar, duke mbetur gjithmonë një pasqyrë e shpirtit njerëzor.

Letërsia është një nga artet më të lashta dhe më të fuqishme që përdor gjuhën si mjet shprehjeje. Përmes saj krijohen vepra artistike që pasqyrojnë botën e brendshme të njeriut. Letërsia inspiron dhe provokon ndjenja dhe mendime të thella të shfaqura në poezi, në prozë, në dramë, në ese apo në tregime. Letërsia si art është një pasqyrë e shpirtit njerëzor dhe shoqërisë, një mënyrë për të kuptuar botën dhe vetveten, që vazhdon të jetë një nga mjetet më të fuqishme të komunikimit shpitëror, duke tejkaluar kufijtë kombëtarë dhe gjuhësorë.

Diskutim

- Njihni llojet e arteve dhe shpjegoni se si ndryshon letërsia nga artet e tjera!

Shkenca e letërsisë

Gjatë zhvillimit të saj historik letërsinë e kanë përcjellë studime dhe shkrime të shumta e të llojllojshme. Në këto shkrime autorët e ndryshëm janë përpjekur ta definojnë dhe ta caktojnë karakterin (natyrën) e letërsisë, ta shpjegojnë rolin e saj dhe të analizojnë veprat letrare si të tillë. Shkenca që merret me studimin sistematik të letërsisë quhet **shkenca e letërsisë**. Meqë vepra letrare është një krijim specifik, ajo studiohet në forma dhe metoda të ndryshme. Objekt i shkencës së letërsisë, si një shkencë e veçantë, është vepra letrare, historia veçoritë e krijimit dhe vlerat artistike të saj.

Letërsia - si art, është një nga format e shprehjes së ndërgjegjes shoqërore, që e pasqyron jetën nëpërmjet figurave artistike të krijuara me anë të fjalës, duke shprehur qëndrime të caktuara. Ajo ka rëndësi të madhe në gjithë jetën shoqërore, por rëndësi të veçantë i kushtohet në arsim. Së pari, ajo ndihmon në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, kulturës dhe identitetit kombëtar, ku përmes veprave letrare, nxënësit lidhen me historinë, traditat dhe figurat kombëtare. Ndihmon në edukimin moral dhe shoqëror, sepse veprat përcjellin mesazhe etike dhe vlera njerëzore, që bën nxënësit të reflektojnë mbi jetën dhe të kuptojnë marrëdhëniet njerëzore. Zhvillimi gjuhësor është i pashmangshëm, pasi leximi pasuron fjalorin e nxënësve duke zhvilluar kështu edhe aftësinë e të shprehurit, zhvillimin e imagjinatës dhe mendimit kritik përmes analizës, interpretimit dhe krahasimit të veprave letrare.

Shkenca e letërsisë ndahet në tri degë të mëdha që njihen si: **teoria e letërsisë, historia e letërsisë** dhe **kritika letrare.**

Teoria e letërsisë - është degë e shkencës së letërsisë, e cila përmbledh në vete një varg rregullash e përgjithësimesh që i përkasin krijimtarisë letrare si dukuri kulturore, me përkufizimin e konceptit të saj dhe me shpjegimin e metodologjive e të teknikave të leximit, të interpretimit e të analizës së teksteve letrare. **Stilet** dhe **formacionet letrare**, gjithashtu janë objekt studimi të kësaj lënde gjatë analizës së një vepre letrare dhe interpretimit të saj. Nëpërmes të kësaj lënde studiohet **forma** dhe **përmbajtja** e një vepre si **tema**, **ideja, kompozicioni**, **fabula, syzheu, personazhi, tregimtari** etj. Gjithashtu ajo bën klasifikimin e lerërsisë në **gjini** dhe **lloje letrare,** duke i veçuar një nga një **poezinë**, **prozën dhe dramën.**

Historia e letërsisë - është degë e shkencës së letërsisë e cila merret me studimin e letërsisë në rrjedhën e saj historike. Ajo studion letërsinë artistike në zhvillimin e saj të vazhdueshëm, duke filluar nga krijimtaria popullore (para shpikjes së shkrimit) deri te veprat letrare të ditëve tona. Ajo studion zhvillimin historik të letërsisë së një populli ose të një epoke. Në kuadër të saj studiohen shkrimtarët e veçantë dhe veprat e tyre, drejtimet letrare, orientimi i përgjithshëm shpirtëror në periudha të ndryshme. Detyra e historisë së letërsisë është shumë e madhe, sepse ajo e njeh popullin me **kulturën** dhe **zhvillimin** e saj, shpjegon **rrethanat historike, shoqërore, politike** dhe **ekonomike** në të cilat është krijuar letërsia, i shpjegon historikisht dukuritë dhe ndërrimet e **lëvizjeve letrare, drejtimeve** dhe të **shkollave letrare**, duke lujatur rolin e saj edukativ.

Kritika letrare - Është një degë e shkencës së letërsisë e cila merret me vlerësimin dhe gjykimin e vlerave letrare të veprës artistike. Ajo ka funksionin e ndërmjetësuesit mes lexuesit dhe veprës duke shprehurit gjykimin mbi veprën letrare, mbi cilësitë dhe të metat e veprës, krahas me arsyetimin e gjykimeve tona, prandaj, kritika letrare ndikon mbi autorët, mbi lexuesit edhe në formimin e opinioneve. Kritika letrare ka për detyrë ta vlerësojë vlerën e veprës letrare dhe të tregojë se ç'rëndësi ka ndonjë vepër në çastin kur ajo botohet dhe ç'ndikim do të ketë ajo në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë.

Disa lloje të kritikës letrare:

- **kritika stilistike** – si lloj i kritikës letrare është e lidhur ngushtë me stilin dhe stilistikën. Mbështetet në elemente stilistike të veprës letrare duke analizuar mënyrë se si është shkruar një tekst dhe jo vetëm përmbajtjen e tij, analizon zgjedhjen e fjalëve, ndërtimin e fjalive, figurat letrare, ngjyrimin emocional të gjuhës, individualitetin e autorit. Qëllimi i kritikës stilistike është të tregojë veçantinë e shkrimtarit përmes stilit, pra, çfarë e bën stilin e tij unik.
- **kritika estetike** - e studion veprën letrare në aspektin estetik dhe zbaton kriteret estetike në vlerësimin e saj. Kjo kritikë analiyon bukurinë e gjuhës dhe harmoninë e saj, vlerën artistike të figurave letrare dhe përshkrimeve, shijen estetike që vepra përcjell te lexuesi dhe orgjinalitetin e krijimit letrar. Pra, kritika estetike është një kritikë e të bukurës në letërsi. Ajo kërkon të ybulojë dhe të vlerësojë dimensionin artistic që e bën një vepër të ketë fuqi dhe jetëgjatësi letrare.
- **kritika impresioniste** – është lloj i kritikës letrare, e cila si kriter themelor për vlerësim e veprës letrare merr përshtypjen, impresionin të cilin e ngjall vepra. Detyra e kritikës impresioniste është të kumtojë përjetimin e veprës artistike dhe kritiku letrar shpesh duhet të mbështetet në mbresat që ngjall vepra letrare tek ai.
- **kritika biografike** - e shpjegon veprën letrare duke u mbështetur në biografinë e shkrimtarit. Ajo nis nga ideja se për të kuptuar thellë një vepër, duhet njohur edhe jetën personale, përvojat dhe rrethanat e krijuesit. Kritika biografike është kritikë që e sheh letërsinë si pasqyrim të jetës së autorit, duke e ndihmuar lexuesin të kuptojë se prapa çdo vepre fshihet një përvojë njerëzore.
- **kritika filozofike** – analizon veprën letrare duke u mbështetur në konceptet filozofike dhe idetë themelore që shfaqen në vepër, siç janë për shembull, çështja e ekzistencës njerëzore, absurdi, çështjet mbi jetën, vdekjen, lirinë, dashurinë etj. Kritika filozofike studion edhe botëkuptimin filozofik të vetë autorit dhe mëmyrën si shfaqet në veprën e tij, si dhe mesazhin universal që vepra bart për njeriun dhe shoqërinë. Kritika filozofike e sheh letërsinë jo vetëm si art i fjalës, por edhe si një udhëtim të mendimit, që lidhet me filozofinë dhe me kuptimin e jetës.

- **kritika gazetareske** - është formë specifike e kritikës letrare artistike e cila shkruhet nëpër gazetat e ditore dhe në ato periodike letrare e kulturore, qofshin ato edhe në internet. Për nga forma e jashtme kritika gazetareske është pjesë e gazetarisë, respektivisht e gazetarisë letrare, kurse për nga esenca ajo është pjesë e letërsisë. Përcjell krijimtarinë letrare bashkëkohore dhe veprat e sapobotuara. Kritika gazetareske shkruhet për publikun e gjërë lexues/dëgjues, andaj duhet të jetë komunikative. Meqë publikohet në një kënd të caktuar dhe në një kohë të kufizuar mediatike, ajo mund të jetë shumë koncize, duke i potencuar vetëm ato që janë qenësore për një vepër letrare, anët pozitive apo të metat e veprës letrare.

Diskutim

- Përkufizoni nocionin *letërsi* dhe renditni karakteristikat themelore të saj!
- Njihni llojet e kritikës letrare dhe shpjegoni karakteristikat e tyre!

Ndarja e letërsisë

Gjinitë dhe llojet letrare

Me termin lloj letrar (ose "zhanër letrar") përcaktohet një grupim tekstesh, të cilat kanë ngjashmëri mes tyre dhe që analizohen përmes të njëjtave kritere. Përbëjnë një lloj letrar, veprat që kanë temë dhe karakteristika stilistiko- gjuhësore të përbashkëta – në vargje ose në prozë, në gjuhën standarde ose në dialect. Të gjitha veprat letrare të vendeve dhe epokave të ndryshme historike, sipas tipareve të përbashkëta që shfaqin në përmbajtjen dhe formën e tyre artistike, ndahen në tri grupe të mëdha që quhen gjini letrare. Këto janë: **epika, lirika** dhe **dramatika**. Në secilën prej këtyre gjinive janë përpunuar mënyra dhe mjete të veçanta artistike për pasqyrimin e realitetit. Në rrjedhën e kohës letërsia është karakterizuar nga larmia e llojeve letrare, të cilat u janë nënshtruar zhvillimit historik të njerëzimit.

Gjatë zhvillimit të letërsisë në kohë, llojet letrare kanë pësuar ndryshime: disa prej tyre janë zhdukur, të tjera kanë lindur, disa lloje kanë sjellë risi në krahasim me ato tradicionalet. Kështu, në kohën tonë, poezia njehsohet me poezinë moderne, e cila është kryesisht lirike ose epiko-lirike. Proza shfaqet përmes llojeve të epikës në prozë. Drama mund të jetë si në vargje edhe në prozë, por gjithmonë e karakterizuar nga veçori të ndryshme nga llojet e tjera.

Gjinitë letrare kanë edhe nëndarjet e tyre apo llojet. Me fjalën lloj kuptojmë një trajtë të caktuar të një gjinie, p.sh. tregimi, novela, romani janë lloje të gjinisë epike etj. Ndarja e veprave në këto tri gjini bëhet sipas mënyrës së paraqitjes së realitetit, në secilën prej tyre. Pra:

- Karakteristika kryesore e **lirikës** është shprehja e drejtpërdrejtë e botës subjektive të poetit, pasi përcjell te lexuesi gjendje shpirtërore dhe emocione, përmes imazheve poetike. Llojet më të njohura lirike janë:

Elegjia - është një poezi e shkurtër me nota vajtuese, që i këndon pikëllimit për humbjen e njeriut të dashur. Elegjia ka përmbajtje të trishtuar, plot dhimbje shpirtërore. Në poezinë shqipe këtë lloj poezie e kanë lëvruar shumë poetë, si: "*Elegji për Luigj Gurakuqin"* nga Fan Noli, por

Himni - është një këngë e lashtë, që i kushtohej perëndive ose heronjve legjendarë, figura e të cilëve meritonte respekt e lavde. Toni i himnit është madhështor dhe arrihet përmes ritmit solemn të ngadalshëm. Në letërsinë shqiptare janë të njohura: *"Himni i flamurit"* i Asdrenit dhe *"Gurrave të Jordanit"* i Gjergj Fishtës.

Oda - e ka origjinën në vjershat korale të Greqisë së vjetër. Tematika e saj shtrihet më gjerë se ajo e himnit. Shkruhet për nder të dikujt që është mjaft i afërt dhe i dashur me poetin. Është poezi e cila i thurr lavdi një individi apo dhe një ngjarjeje. Në poezinë shqipe janë të njohura odat: *"Nji lule vjeshte"* e Gjegj Fishtës dhe *"Fuqia e Uratës"* nga Vinçens Prenushit.

Ditirambi - është këngë religjioze që këndohej në Greqinë antike nga kori i meshkujve dhe përcillej me flautë. Ditirambi, para se gjithash, i kushtohej Dionisit (hyjnisë të verës dhe gëzimeve jetësore). Sot në ditiramb trajtohen tema të ndryshme, por është i theksuar toni i admirimit dhe i entuziazmit, i lartësimit të gëzimit jetësor, gjithfuqia e natyrës dhe e lumturisë, ku lavdërohen gëzimet e jetës. Këtë formë poetike e kanë lëvruar edhe shkrimtarët shqiptarë, si: Naimi Frashëri te *"Jeta", "Dit'e re"*, Kristo Floqi te *"Pylli i gjelbëruar"*, Migjeni tek "*Ekstaza pranverore", "Sonet pranveruer"*, Çajupi te *"Kopshti i dashurisë"* etj.

Epigrami – burimin e ka në letërsinë e lashtë greke e romake, ku përdorej si mbishkrim për monumente ose varre. Është një poezi e shkurtër lirike që shquhet për thellësinë e mendimit që sjell në pak vargje. Shpesh ka ton satirik, ironik ose moralizues, por mund të jetë edhe thjesht meditues. Edhe në poezinë shqipe epigram përdoret si një goditje e shkurtër poetike, shpesh me humor dhe ironi, për të ncjerrë në pah të vërteta të mëdha me pak vargje.

Epitafi –në Greqinë e lashtë shënonte një fjalim pranë një varri si dhe një mbishkrim varri. Ka karakter lirik dhe përshkruan jetën, virtytet, veprën ose mesazhin e të ndjerit. Epitafi i një gjatësie më të madhe, është zakonisht lavdi për herojtë, për dëshmorët si dhe për merita e të aritura të tjera në jetë. Në kohët moderne epitafi vazhdon të jetë gjini letrare por tanimë, i rimëzuar dhe që shpreh një adhurim për një person apo për veprën e tij.

Idila –është nje lloj vjershe e lashtë lirike. Edhe pse është e përcaktuar si tip, ajo njëkohësisht ka kuptim të zgjeruar. Nga një aspekt me Idil emërtohet çdo vepër letrare me temë nga jeta e qetë dhe e tërhequr në natyrë. Për të tilla mund të merren si ilustrim edhe disa fragmente nga vepra *"Bagëti e Bujqësi"* e Naim Frashërit.

Poezia - është lloj i lirikës, ku bota e brendshme, frymëzimi hyjnor dhe porosia e poetit zakonisht shprehet me vargje. Konsiderohet se poezia është lloji më i vjetër i krijimtarisë letrare, që ndërthur në vete edhe figura stilistike (letrare). Poezia nuk ka të bëjë vetëm me formën e të shkruarit, por edhe me mënyrën e transmetimit të përmbajtjes. Ajo është një nga fushat më të lëvruara të letërsisë shqiptare, duke nisur nga letërsia e vjetër e deri te ajo bashkëkohore.

Vjersha – është krijim poetik i thjeshtë, me vargje të rimuara, që përdoret zakonisht në letërsinë për fëmijë. Ka gjuhë të lehtë, ritëm dhe rimë të qartë. Për dallim nga poezia, që ka qëllim shprehjen e emocioneve, mendimeve dhe pëjetimeve në formë artistike, vjersha ka karakter didaktik ose zbavitës.

- Karakteristikë kryesore e **epikës** është rrëfimi, që bëhet nga vetë autori ose, në momente të caktuara, edhe nga personazh të tjerë. Llojet më të njohura epike janë: **epi, romani, novela, tregimi, skica, përralla, legjenda.**

Në periudhën romantike llojeve epike iu veshën elemente lirike. Nga ndërthurja e elementeve të gjinisë epike me ato lirike u krijuan llojet e ndërmjetme që u quajtën lloje **epiko-lirike**, të tilla si: **poema**, **balada, romanca, fabula** dhe **romani në vargje.**

- Karakteristikë kryesore e **gjinisë dramatike** është veprimi (duke qenë se është e paracaktuar të vihet në skenë), sepse i rindërton ngjarjet nëpërmjet fjalëve, gjesteve dhe lëvizjeve të personazheve që veprojnë në skenë. Llojet më të njohura dramatike janë: **tragjedia, komedia** dhe **drama.**

Diskutim

- Shpjegoni gjinitë dhe llojet letrare dhe përshkruani karakteristikat e tyre!
- Njihni dhe dalloni gjinitë dhe llojet e ndryshme letrare në tekste!
- Identifikoni gjinitë dhe llojet e ndryshme letrare, duke përmendur shembuj për secilën prej tyre!

Mitologjia, miti dhe folklori

Fjala **mitologji** (nga gjuha greke *mythos* -një *tregim* ose *fjalim*) që nënkupton tregimin e miteve apo historive që një kulturë specifike beson dhe përdor të mbinatyrshmen për të interpretuar ngjarje natyrore dhe për të shpjeguar natyrën e universit dhe njerëzimit.

Mitologjia greke dhe ajo romake janë mitologjitë më të hershme të njerzimit dhe dy tradita më të lashta që lidhen ngushtë me njëra-tjetrën.

Mitologjia greke u zhvillia më herët dhe përfshin historitë e perendive perëndive si Zeusi, Hera, Afërdita, Aresi, Athina, Apolloni, Poseidoni etj., si dhe heronjët mitik si Herakliu, Akili, Odiseu etj. Ajo ka thellësi filozofike dhe shpjegon botën, natzrën dhe fatin e njeriut përmes tregimeve alegorike.

Mitologjia romake u ndikua drejpërdrejt nga ajo greke. Prënditë romake shpesh ishin të njejtë por me emra të ndryshëm: Zeusi – Jupiteri, Afërdita – Venera, Aresi – Marsi, Poseidoni – Neptuni etj. Romakët u dhanë miteve kuptim më praktik dhe moral, të lidhur me shtetin, luftën dhe disiplinën. Pra, mitologjia greke është themeli i fantazisë dhe filozofisë, ndërsa mitologjia romake është vazhdimi i saj, i përshtatur për kulturën dhe jetën romake.

Mitologjia shqiptare është një pasuri shumë e vjetër dhe e larmishme, që ruan elemente të besimeve pellazge, ilire dhe ballkanike, të trashëguara brez pas brezi përmes gojëdhënave, këngëve dhe riteve popullore. Ajo është më shumë mitologji gojore, sepse nuk ka tekste të shkruara të lashta, por jeton në traditën e popullit tonë. Mitologjia shqiptare është pasqyrë e botës shpirtërore të popullit tonë, ku shihet frika, shpresa dhe mënyra se si të parët tanë e shpjegonin të panjohurën.

Miti është një zhanër folklorik i përbërë nga tregime që luajnë një rol themelor në një shoqëri, siç janë përrallat themelore ose mitet e origjinës. Meqenëse "miti" përdoret gjerësisht për të nënkuptuar se një histori nuk është objektivisht e vërtetë, identifikimi i një narrative si një mit mund të jetë shumë i diskutueshëm.

Personazhet kryesore në mite janë zakonisht jo-njerëz, si perënditë, gjysmëperënditë dhe figura të tjera të mbinatyrshme. Të tjerët përfshijnë njerëzit, kafshët ose kombinimet në klasifikimin e tyre të mitit. Historitë e njerëzve të zakonshëm, edhe pse shpesh të liderëve të një lloji, zakonisht gjenden në legjenda, në krahasim me mitet. Mitet ndonjëherë dallohen nga legjendat në atë që mitet kanë të bëjnë me perënditë, zakonisht nuk kanë bazë historike dhe vendosen në një botë të së shkuarës së largët, shumë të ndryshme nga ajo e së tashmes.

Miti është tregim i cili përmban simbole të cilat zakonisht kanë shumë kuptime. Miti në kulturat e caktuara zakonisht trajton çështjet që kanë të bëjnë me origjinën e botës apo se si bota dhe krijesat e saj erdhën në ekzistencë. Qeniet mitike aktive zakonisht janë perënditë dhe perëndeshat, heronjtë dhe heroinat, apo kafshët. Shumica e miteve merren se kanë ekzistuar në të kaluarën e pafund, para fillimit të numërimit të kohës. Në përdorimin popullor, miti është bindje apo besim kolektiv që nuk bazohet në fakte. Miti dhe letërsia përbëjnë një dyshe të pandarë, shpeshherë duke e parë në bazë të krijimeve apo versioneve letrare, e madje edhe në bazën e dijeve të tjera, miti konsiderohet nga studiues të ndryshëm si një e dhënë fillestare. Ai ka pasur ndikim të madh edhe në letërsinë shqipe, duke bërë që shumë autorë shqiptarë të shfytëzojnë mite të ndryshme në krijimet e tyre. Këta autorë shfrytëzuan lëndën e marrë nga mitet për t'ia përshtatur një kulture dhe mendësie vendëse. Këto krijime mitologjike dhe folklorike atyre u kanë shërbyer si modele, tema e burim subjektesh e

Mitet më të njohura greke

Krijimi i botës dhe Olimpianët
rrëfimi për Khaosin, Tokën dhe Qiellin dhe lindjen e perëndive të Olimpit të udhëhequra nga Zeusi.

Promoteu dhe zjarri
Titani që vodhi zjarrin nga perënditë për t'ia dhënë njerëzve dhe për këtë shkak u dënua nga Zeusi.

Herakliu (Herkuli)
12 punët e pamundura që duhej të kryente si shagim për fajin e tij. Nëpërmjet këtyre punëve ai do të falej dhe do të arrinte pavdekësinë.

Lufta e Trojës
Kur Paris e rrëmbeu Helenën dhe e çoi në Trojë, Menelau dhe aleatët e tij grekë organizuan një ekspeditë për ta rikthyer atë dhe për të ndëshkuar Trojën, çka solli një luftë të gjatë dhe të përgjakshme që sipas legjendës zgjati për dhjetë vjet.

Perseu dhe Meduza
Medusa, vajzë e bukur e shndërruar në një përbindësh me flokë gjarpërinj, që i kthente në gur ata që e shikonin në sy. Perseus, i udhëhequr nga Athina, arriti t'i presë kokën Meduzës me dinakëri.

Orfeu dhe Euridika
Dashuria e madhe e Orfeut që zbriti në botën e nëndheshme për të shpëtuar të dashurën Euridikën e cila u pickua nga një gjarpër helmues dhe vdiq. Orfeu zemërthyer dhe i shkatërruar nga vdekja e saj vendosi të zbriste në botën e vdekjes për të provuar ta kthente në jetë.

Mitet më të njohura romake

Remi dhe Romuli
Binjakët, që i hodhën në lumin Tiber ku u ushqyen me qumësht nga një ujkonjë derisa u gjetën dhe u shpëtuan nga një bari. Kur u ritën, binjakët shkuan në brigjet e lumit Tiber ku themeluan qytetin e tyre të ri. Romuli vrau Remin dhe e quajti qytetin me emrin e tij, Roma.

Janusi
Perëndia me dy fytyra, që shikon nga e kaluara dhe e ardhmja (simbol i fillimeve dhe i mbarimeve) ishte Portieri i Qiejve. Ai

Enea (Aeneas)
I biri i mbretit Ankiz, dhe i perëndeshës Aferditë. Heroi trojan që, sipas Virgjilit, themeloi gjenezën e popullit romak.

Figurat mitologjike shqiptare

Zanat e malit
Krijesa mitologjike shqiptare me veti tepër origjinale autoktone, simbol i bukurisë dhe i fuqisë. Shpesh shfaqen si mbrojtëse e krshnikëve në beteja, por edhe të repta kur i prishet qetësia dhe ndaj atyre që nuk respektojnë natyrën .

Orët
Shpirtra mbrojtës të njeriut ose familjes. Paraqiten si gjë ja të padukshme, përgjithësisht pa trup dhe pa formë, përvec se kur është e trupëzuar, si një vashë ose gjarpër që ruan një njeri, një shtëpi, një fis etj. Kështu, Besohej se jetonin në male, pyje, kroje, ose pranë njerëzve, u ndihmonin të mirëve dhe i ndëshkonin të këqinjtë.

Kuçedra

Përbindësh mitologjik (shpesh gjarpër shumëkokësh), që shkaktonte yjarre, përmbytje ose fatkeqësi. Heroi (zakonisht një djalë trim) duhej ta vriste për të shpëtuar fshatin.

Shqiponja

Është simboli kombëtrarë i shqiptarëve. Ajo përfaqëson lirinë, fuqinë, krenarinë dhe identitetin kombëtar duke qenë figurë qendrore në mitologjinë shqiptare.

Drangoi

Mban fuqi të mbinatyrshme, veçanërisht në krahë dhe supe. Qëllimi kryesor i drangoit është të luftojë kuçedrën në beteja legjendare. Ai përdor gurë meteorikë, shpata rrufe, grumbuj gurësh për të mposhtur atë dhe për të mbrojtur njerëzimin nga stuhitë, zjarri, përmbytjet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore të shkaktuara nga fuqia shkatërruese e kuçedrës. Stuhitë e forta mendohej të kenë qenë rezultat i betejave të tyre.

E Bukura e Dheut

Figurë e fuqishme femërore e lidhur me dashurinë, bukurinë dhe magjinë. Herojntë shkojnë në botën e saj ,që ruhet nga një kuçedër, dhe po fitoi luftën me kuçedrën, ajo mund të bëhet nusja e tij, po humbi, gllabërohet nga kuçedra.

Gogoli

Në mitologjinë shqiptare përfaqëson një figurë mitike dhe besohej se ishte qenie e cila shfaqej natën në fusha e male. Me pamje të fikshme që është në gjendje të fluturojë, të bejë magji, mallkime etj. besohej se gogolët mund të mposhteshin vetem nga rrezja e diellit e cila u përvelon lëkurën.

Folklori është emri për tërësinë e krijimeve artistike (gojore, muzikore, valle etj.) të një populli. Ai paraqet aspekte të ndryshme të traditës kulturore, në kuptimin e emrave të përbashkët për format tradicionale të letërsisë, muzikës, vallëzimit, dramës dhe krijimtarisë artistike popullore. Rrjedh nga fjala angleze *folk* - popull, dhe *lore* - dije, dituri, Në përdorim popullor, folklori nënkupton aspektet që shfaqen në format e aplikuara në kulturën popullore, dmth. këngët dhe vallëzime të adaptuara skenografikisht, artizanati, tregimet, anekdotat, etj. Një studiues i folklorit quhet *folklorist* ndërsa shkenca që studion nocionin e folklorit quhet *folkloristikë*, dhe daton nga koha e periudhës para romantizmit.

Përderisa te shumë popuj, si grekët e apo romakët, mitet u ruajtën në libra të shkruar, te shqiptarët ato mbijetuan kryesisht përmes folklorit. Kështu, folklori ynë – me këngë, valle, legjenda, përralla e besime popullore, është trashëgimtari më i madh i mitologjisë shqiptare. Folklori shqiptar e ruajti mitin si kujtesë kolektive dhe si pasqyrim i shpirtit të popullit. Pra, mitet dhe folklori janë të lidhura ngushtë si trupi me shpirtin: mitin është themeli i lashtë, ndërsa folklori është shtëpia ku ai jetoi dhe u përcoll brez pas brezi. Nëpërmjet folklorit, mitet dhe lashtësia shqiptare mbetën të gjalla, duke na dhënë këngë e legjenda, por edhe një pasqyrë të shpirtit, besimeve dhe vlerave të popullit tonë.

Diskutim

- Shpjegoni se si mitet dhe përrallat shërbejnë si burime për letërsinë artistike!
- Përshkruani karakteristikat e mitit dhe të letërsisë popullore (folklorit)!

Lirika

Lirika është quajtur kështu nga emri i instrumentit muzikor, lirës, me të cilën grekët e vjetër shoqëronin recitimin e një poezie. Lirika realizohet përmes **gjuhës poetike** si mjet shprehës dhe si mjet krijimi dhe përjetimi të së bukurës pasi përcjell te lexuesi gjendje shpirtërore dhe emocione, përmes imazheve poetike. Poeti e shkruan poezinë lirike nga pozicioni i vetes, nga uni i tij. Ai është brenda veprës poetike, kurse lexuesi futet në këtë pozicion në çastin kur fillon leximin sepse lirika është më shumë se një mënyrë shprhjeje, ajo është psqyrimi i shpirtit njerëzor të interpretuar përmes **përfytyrimit** dhe **emocionalitetit** si elemente të domosdoshme të gjuhës poetike.

Elemente të tjera thelbësor të gjuhës poetike:

- **Ritmi** - është elementi kyç që krijon **muzikalitet** dhe që thekson më tepër emocionet. **Ritmi** është lëvizja e rregullt dhe melodike e vargjeve, që krijohet nga përsëritja e thekseve, rrokjeve, tingujve ose pauyave. Është ajo "rrjedhë" që e bën poezinë të timgëllojë si muzikë kur lexohet me zë.

- **Kuptim konkret dhe figurativ i fjalëve** - Kuptimi konkret i fjalëve në poezi u referohet përkufizimeve të drejtpërdrejta, thelbësore duke ofruar përshkrim real, ndërsa kuptimi figurativ përdor fjalët që kuptojmë me mendje dhe ndjejmë me zemër, duke krijuar kështu imazhe artistike, emocione dhe kuptime të thella (metafora, epitete) që pasurojnë gjuhën.

Për shembull, në vargjet: *"Dielli ngroh çatitë e qytetit,*
Shkrin vesën mbi bar,
*Një **fjalë e mirë ngroh shpirtin,***
shkrin akullin e heshtjes".

Fjala: ***fjalë e mirë ngroh shpirtin*** – është me kuptim figurativ, sepse nuk tregon për një dritë fizike, por tregon shpresë, gëzim, besim.
Fjala: ***shkrin akullin e heshtjes*** – është me kuptim figurativ, sepse realisht, heshtja nuk ka akull, por nënkupton thyerjen e ftohtësisë emocionale.


Muri i mbështetjes

Shtrëngoma dorën kur jam i dehur
Dhe mendoj për Kullën e Babilonisë
Jam i palarë dhe i sinqertë
E ngjitem shkallëve të akullta për në qiell
Ku flenë në një shtrat
Mendjemadhi që gërhet në gjumë
Dhe Ciniku me pagjumësi në sy

E në rënça mos më ngrit
Prej se e mbaj mend
Ky është qëllimi im

Mos më lër që dorë e nëmur përtej mjegullës
Të më gjuajë me mëdyshje si poezinë e dështuar
E cila që mbrëmë fle në shporte
Kur jam i larë esëll dhe gënjeshtar
Kur këmbëzbathur e ndiej vesën e mëngjesit
Prej letrës së zhubravitur bëj vjershë

Edhe Ty e dashur
Në të lënça në rrugën me glasa pëllumbash
Kur jam xheloz dhe me tym në kokë
Kthehu këmbëzbathur
Me vesën e mëngjesit mes gishtërinjve
për të m'i njomur buzët e thara nga dehja
Besomë se do të marr për poezi

- **Vjershërimi** – është mënyra e të shkruarit në vargje dhe se si ndërtohet një poezi sipas rregullave të **vargut, rimës, ritmit** dhe **strofës,** pra është ndërtimi teknik i poezisë.

  Vargu – është elementi bazë i lirikës, si forma më e përhapur poetike, që përbëhet nga fjalë të vendosura në mënyrë të rregullt dhe e formuar nga një numër i caktuar rrokjesh. Sistemi i rregullave që përcakton numrin e rrokjeve dhe vendosjen e thekseve në një një varg poetik është **metrika e vargjeve**. Ajo tregon sa rrokje ka një varg, ku bien thekset dhe nëse vagjet ndjekin një model të rregullt apo jo.

Llojet e vargjeve – mund të ndahen sipas disa kritereve kryesore: **sipas numrit të rrokjeve, sipas strukturës së ndërtimit, sipas rimës** dhe **sipas plotësisë kuptimore.**

- **Sipas numrit të rrokjeve:** dyrrokësh, trerrokësh, katërrrokësh, pesërrokësh, gjashtërrokësh, shtatërrokësh, tetërrokësh, nëntërrokësh, dhjetërrokësh, njëmbëdhjetërrokësh, dymbëdhjetërrokësh;
- **Sipas strukturës së ndërtimit: varg i rregullt** (me numër të njejtë rrokjesh dhe model të qëndrueshëm theksesh) **dhe varg i lirë** (nuk respekton metër të caktuar dhe zakonisht nuk ka rimë të rregullt);
- **Sipas rimës: varg me rimë** (fundet e vargjeve përputhen në tingull) dhe **varg pa rimë** (ka meter të rregullt, por nuk ka rimë);
- **Sipas plotësisë kuptimore: varg i plotë** (ka kuptim të përfunduar) dhe **varg i ndërprerë** (mendimi vazhdon në vargun pasues)

Strofa – përpëhet nga dy e më shumë vargje, që formojnë një njësi të veçantë ritmike me kuptim të përbashkët që tregon një mendim, ndjenjë ose pamje.



Llojet e strofave në poezinë shqipe klasifikohen kryesisht nga numri i vargjeve që përmbajnë, si: **strofa dyvargësh** (distiku), **trevargësh** (tercina), **katërvargësh** (kuartina), si dhe struktura më të gjata si strofa **pesëvargësh, shtatëvargësh, tetëvargësh, dhjetëvargësh. Soneti** (tingëllima), që ka një strukturë specifike me 14 vargje (zakonisht dy katërvargësha dhe dy trevargësha), si dhe strofa me origjinë orientale si **Haiku, Gazeli, Kasideja, Rubaia.**



Përveç këtyre, përdoren edhe vjersha **astrofike** (që nuk ndahen në strofa) ose ndryshe i quajmë **strofa me vargje të lira.**

- **Kompozicioni** - është ndërtimi i brendshëm i një vepre letrare, që përcaktohet nga synimi për të zbuluar më mirë idenë e veprës; mënyra si janë lidhur e si janë vendosur pjesët përbërëse të veprës. Kompozocioni mund të jetë:
  - **Strofik** është mënyra se si ndërtohet një poezi me strofa të rregullta dhe të përsëritura, p.sh: strofat kanë numër të njejtë vargjesh, kanë të njejtën skemë rime dhe kanë zakonisht të njejtën metrikë (rimë);
  - **Heterostrofik** është kur poezia ka strofa të ndryshme nga njëra-tjetra, p.sh: strofat nuk kanë të njejtin numër vargjesh (njëra 3 vargje, tjetra 5, tjetra 4), mund të ndyshojjë skema e rimës dhe e ritmit.

- **Rima** - është përputhja e tingujve në fund të dy a më shumë vargjeve te nje poezie. Llojet më të shpeshta të rimave në poezinë shqipe janë:

  - **rimë e puthitur (AABB),** kur vargu i parë rimon me të dytin dhe i treti me të katërtin:

*Që ditën që vdiqe, që kur s'të kam **parë,*** (A)
*lotët që kam derdhur s'më janë dhe **tharë!*** (A)
*Shumë vjet u bënë, sot u mbushën **dhjetë,*** (B)
*që kur më ke lënë dhe s'të shoh në **jetë!*** (B)

Poezia "Vaje", Çajupi

  - **rimë e kryqëzuar/alternuar ABAB,** kur vargu i parë rimon me të tretin dhe i dyti me të katërtin:

*Këtu s' do të jem, do jem **larguar;*** (A)
*Ne tokë i tretur si të **tjerët,*** (B)
*Në kafenenë e **preferuar*** (A)
*Nuk do me shohin **kamarierët.*** (B)

Poezia "Kur të jesh mërzitur shumë", D. Agolli

  - **rimë e përmbyllur ABBA,** kur vargu i parë rimon me të katërtin dhe i dyti me të tretit:

Manushaqe bukuroshe, (A)
Pse s'ngre kryete përpjetë, (B)
Po rri e mpit' edh' e qetë, (B)
Pse s'zbukuroh e s'shëndoshe? (A)

Poezia "Shkëndijë e diellit ndaj manushaqes", N. Frashëri

  - **monorimë AAAA,** kur të gjitha vargjet rimojnë njësoj:

Keq Harapit Gjergji iu gërmua
Pse, Harap, ti fjalë mua me m'çua?
A di gjânë qi sot i lash 'gujua?
Kohë nuk kâ, jo, aspak me u vonua.

Poezia "Gjergj Elez Alija", Cikli i kreshnikëve

Diskutim

- Identifiko dhe interpreto elementet e gjuhës poetike - emocionalitetin, përfytyrimin, muzikalitetin, ritmin, kuptimin konkret dhe figurativ të fjalëve!
- Shpjegoni nocionet: poezi lirike, gjuhë poetike, vjershërim, strofë dhe rimë!

Llojet lirike sipas formës

Vepra lirike është një gjini letrare ku shkrimtari nuk përshkruan ngjarje, por përqëndrohet te ndjenjat dhe emocionet e veta për një çështje të caktuar. Ai përshkruan atë që ndien nga brenda. Në llojet lirike sipas formës bëjnë pjesë të gjitha llojet e poezisë së lashtë, siç janë:

- **Himni** - është një vjershë që i është kushtuar dikujt apo diçkaje, të cilën njeriu e adhuron dhe e konsideron hyjnore. Në të kaluarën e lashtë mitologjike kjo formë e lirikës ka qenë e shpeshtë. Tradita e kësaj poezie të lashte lirike sot ruhet përmes himneve të shteteve, himneve të kombëtare etj.

- **Oda** - e ka origjinën në vjershat korale të Greqisë së vjetër. Tematika e saj shtrihet më gjerë se ajo e himnit. Shkruhet për nder të dikujt që është mjaft i afërt dhe i dashur me poetin. Është poezi e cila i thurr lavdi një individi apo dhe një ngjarjeje.

- **Idila** - është nje lloj vjershe e lashtë lirike. Nga një aspekt me Idil emërtohet çdo vepër letrare me temë nga jeta e qetë dhe e tërhequr në natyrë. që përshkruan skena të idealizuara, shpesh bukolike (fshatare), duke theksuar jetën e qetë dhe natyrën.

- **Ditirambi** - është këngë religjioze që këndohej në Greqinë antike nga kori i meshkujve dhe përcillej me flautë që kryesisht i kushtohej Dionisit. Më vonë ditirambi merr formën e saj të përpiktë; që do të thotë se udhëhiqej nga një zë dhe përcillej nga kori vetëm gjatë refreneve. Nga ditirambi më vonë zhvillohet tragjedia e në kohët moderne merr kahje të lavdive dhe kënaqsive të tepruara.

- **Elegjia** - është lloj i poezisë lirike me përmbajtje të trishtuar e plot dhembje shpirtërore, në të cilën poeti shpreh ndjenjat e dhembjes, pikëllimit dhe hidhërimit për diçka të humbur, që nuk mund të kthehet më.

- **Epitafi** - është një lloj tjetër i shkurtër i poezisë lirike, që shkruhet si përkujtim për dikë që ka vdekur. Në Greqinë e lashtë shënonte një fjalim pranë një varri si dhe një mbishkrim varri. Në kohët moderne epitafi vazhdon të jetë gjini letrare por tanimë, i rimëzuar dhe që shpreh një adhurim për një person apo për veprën e tij.

- **Epigrami** – është një poezi shumë e shkurtër, zakonisht me ton satirik, thumbues ose filozofik, që përfundon me një mendim të mprehtë.

Llojet lirike sipas motivit

Poezia lirike, qysh në fillet e saj e ka shfaqur qëllimin shprehës përmes motivit (tematikës) së caktuar. Motivi i lirikës është një realitet i veçantë, që lidhet me botën shpirtërore, me subjektiven, ose me gjërat thelbësore të jetës. Llojet lirike sipas motivit (tematikës) klasifikohen bazuar në ndjenjat, nxitjet dhe ngacmimet që frymëzojnë poetin. Llojet kryesore që përdoren më së shpeshti në letërsinë shqipe janë:

- **Lirika e dashurisë (erotike)** – është një nga format më të vjetra dhe më të përhapura të poezisë lirike. Ajo shpreh ndjenjat intime të poetit ndaj një personi të dashur, por edhe përjetime si malli, dhimbja, xhelozia, pritja lumturia apo edhe zhgënjimi.

KËNGË DASHURIE

Dëgjo, vajzë nga gjumi zgjohu,
në se krejt dashuria ty nuk t'u ftoh:
sonte ta them unë një këngë.
që midis zemrës me dhimbje më del,
e në se edhe ti më dashuron,
dëgjo, vajzë, e më kujto.

Sa mirë të desha, sa mirë të dua,
vetëm ti, vashë, më deshe mua,
M'u faneps një ditë ky dhe
plot me gaz e me hare,
se dashuria jote më shtiu një dritë,
që hoqi natën, ngado më priste.
Po në se edhe ti më dashuron,
lule e gëzuar, mos më harro.

S'qe bukuria që më rrëmbeu,
jo begatia që më gënjeu
po jotja zemër mendtë m'i ktheu,
më ngriu gjakun, shpirtin më vodhi.
Tani në se edhe ti më dashuron,
kujtomë një herë e mos më harro.

Zef Serembe

- **Lirika e peisazhit (përshkruese)** – është një lloj lirike ku poeti shpreh ndjenjat dhe gjendjen e tij shpirtërore përmes përshkrimit të natyrës dhe peisazhit. Pra, natyra nuk përshkruhet thjesht për bukurinë e saj, por bëhet pasqyrë e emocioneve të brendshme të poetit. Ajo shpesh ndërthur përshkrimin e detajuar vizual me ndjesi qetësie, nostalgjie apo admirimi për natyrën.



DREMIT LIQERI

Mi zall të pyllit vjeshtarak
Dremit liqeri pa kufi,
Ay ndaj fundesh u përflak
Posi me zjarr e me flori.

Posi me flakë u ndes e kroj,
E vetëtiti plot magji,
E ylli i ditës perëndoj
Në qetësi dhe dashuri

Tashi po shuhet nënë mal
Qytet'i ngrysur në zi.
Po ndizen yjtë dal-nga-dal
Plot bukuri! plot fshehtësi!

Në këtë çast perëndimor,
Ndaj po më dehen sytë e mi,
Kuptoj si shpirtin vjershëtor
M'a frymëzon nja mall i ri.

Lasgush Poradeci

- **Lirika atdhetare (patriotike),** – është lloj i lirikës ku poeti shpreh dashurinë për atdheun, kombin, gjuhën dhe lirinë. Në këtë lirikë ndihen emocione të forta si ndjenja e krenarisë dhe e përkushtimit, sakrifica, dhimbja për robërinë dhe thirrja pëe çlirim.

HYMNI I FLAMURIT

O Flamur gjak, o flamur shkabë,
O vënd e vatr' o nën' e babë,
Lagur me lot, djegur me flagë,
Flamur i kuq, flamur i zi.

Fortesë shkëmbi tmerr tirani,
S'të trëmp Romani, as Venecjani,
As Sërp Dushani, as Turk Sulltani,
Flamur i math për Vegjëli

Flamur që lint Shën Kostandinin,
Pajton Islamn' e Krishtërimin,
Çpall midis feve vllazërimin,
Flamur bujar për Njerëzi.

Me Skënderben' u-lavdërove
Dhe në furtun' i funtmi u-shove,
Me Malon prapë lart vrapove,
Yll i pavdekur për Liri.

Sa shpesh pastaj për-dhe u-shtrive
Me zjarr e zi u-ndeze u-nxive,
Po çdo mizor me shpat' e grive,
O fushë-kuq, o shkabë-zi.

Përpjetë pri-e Shqipërinë,
Përlintj'a shpirtin dhe fuqinë,
Diell për vllanë, yrnek për fqinë
Për botën ëndr' e qjell i ri.

Fan S. Noli

- **Lirika sociale** – është një lloj lirike ku poeti shpeah shqetësimet për problemet shoqërore, padrejtësitë dhe vuajtjet e njerëzve. Në këtë lloj lirike përveç ndjenjave peronale, autori flet edhe për fatin e komunitetit, të shtresave të shtypura ose të varfra, për luftën kundër padrejtësive dhe për një shoqëri më të drejtë. Autori synon që kjo poezi të ndikojë te njerëzit dhe të ngrejë ndërgjegjësimin social.

PO TË VIJË PUSHTUESI

Po të vijë pushtuesi te ju, në qytet,
Ta bëni t'i duket që s'e ka pushtuar vërtet.
Askush ndër ju atij të mos i japë çelës,
Se ai s'vjen si mik, se ai vjen si shkelës.
Mos i nxirrni për të ngrënë dhe sofër mos i shtroni,
Karrige e shtrat për të të shkoni t'i coptoni.
Atë ç'ka s'digjni dot, ta fshihni ku mos duket.
Përmbysni çdo qumësht, groposni çdo krodhë buke.
Ta bëni të klithë: Ndihmë! Ta quani: Barbar!
Ta (Tani- në përkthim) bëni të hajë dhe, të rrojë përmbi zjarr.
Edhe sikur të lutet, as gjellë – as mëshirë.
Që s'ka qytet për të, ta marrë vesh fort mirë.
Ku sheh – të shohë hiç; ku hyn – të gjejë asgjë.
Ta dijë që në qytet bujtinë s'ka për të

Bertolt Brecht

- **Lirika filozofike (reflektive)**– është poezia ku poeti reflekton mbi jetën, vdekjen, kohën, fati, ekzistencën dhe pyetjet univerzale, dhe jo vetëm me dashurinë ose natyrën. Me këtë poezi poeti synon të zgjojë mendimin dhe ndjenjat e lexuesit mbi elzistencën.



SPLEEN

Kur qielli i rëndë e i ulët peshon si një saç
Mbi trurin mërzimadh të mposhtur nga lëngata,
E kur nga kupa e tij e sheshuar e bërë rrafsh
Buron një ditë e zezë më e zymtë se nata;

Kur toka është qeli përplot me lagështirë,
Ku Shpresa, si lakuriq nate,përpëlitet
Duke rrahur muret me krahë krejt të mpirë
E për tavane tërë myk koka i sfilitet;

Kur shiu, duke hedhur litare të stërgjatë,
Hekurat e një burgu të paanë imiton,
E kur një lukuni mermiangash përnatë
End rrjeta të kobshme në palcë të trurit tonë,

Këmbanat delikate befas i kap tmerri
Dhe lëshojnë në qiell një piskamë lemeri
Si shpirtra endacake arratisur nga ferri
Qe ia marrin kujës me kryeneçesi...

Dhe korba pendësterrë, pa tam-tam as muzikë,
Parakalojnë përzishëm në shpirtin gjithë mërzië;
E mundur, Shpresa qan, dhe Ankthi tiranik
Mbi kokën e ulur ngul flamurin e zi.

Sharl Bodler

- **Lirika humoristike** - është lloji i lirikës ku poeti shpreh situata të qeshura, ngjarje komike, satirë ose ironinë për njerëzit dhe për jetën. Qëllimi kryesorë është të argëtojë, por shpesh edhe të kritikojë zakone, padrejtësi ose të metat njerëzore në mënyrë lehtë dhe qesharake.

SYRI, MENDJA, HUNDA

Ish një sy, një sy, për dreq
Qe kish marrë huq të keq:

S'shihtë fare aty pranë
Por matanë, tej matenë

I tha mendja: More sy
Bëj çudi, çudi me ty

Shih më parë ç'ke përqark
Me pastaj bridh tutje, larg

Dritëro Agolli

- **Lirika moderne** - është ajo lloji poezie që u zhvillua në fund të shek.XIX dhe gjatë she.XX, duke sjellë risi në formë, gjuhë dhe përmbajtje krahasuar me poezinë tradicionale. Shpesh përdor vargun e lirë (pa rimë dhe pa metrikë të rregullt) dhe nuk ndjek gjithmonë strukturë klasike strofash. Ritmi krijohet përmes mendimit dhe figurave stilistike. Në lirikën moderne poeti shpreh botën e brendshme, krizën ekzistenciale, vetminë. Zakonisht trajton tema si: lufta, qytetërimi, teknologjia etj.

BESOMË

Në u ftohshin
pështpërimat e fjalëve,
ndonjëherë,
e ritme pulsi mos ndihesh më...
Diku,
diçka do të ketë ndodhur,
dhe nëse nuk duket,
a s´ndihet zë...

E kur lëndinave,
flutura mos duken,
e ngjyra krahësh,
mos vjedhim për tonat netë...
Diku,
diçka do të ketë ndodhur,
ndaj as une s´do jem,
e ti do ndihesh vetë...

Por kur tutje,
në ndonjë qoshëzë,
do shohësh të tharë,
një pikë lot...
Vërtetë,
diçka do të ketë ndodhur...
Besomë ti,
dhe nëse s´të dukem si zot.

Alma Papamihali

- **Subjekti lirik** - është zëri poetik ose "un-i" që shpreh ndjenjat, mendimet, përjetimet e brendshme dhe emocionet në një poezi. Është entiteti që flet në vargje dhe përcjell subjektivitetin e poezisë. Subjekti lirik shpreh qëndrimin e tij ndaj tematikës që shtjellon poezia.

Diskutim

- Dalloni karakteristikat stilistike të veprës lirike sipas motivit dhe përmbajtjes dhe diskutoni për ato!
- Krijoni vepra me strukturë poetike duke zbatuar njohuritë për poezinë lirike!

Figurat stilistike

Figurat stiklistike janë mjete artistike të gjuhës që përdoren për ta bërë shprehjen më të fuqishme, më të bukur dhe më domethënëse. Ato e largojnë fjalën nga kuptimi i saj i zakonshëm ose i drejtpërdrejtë dhe i japin një kuptim të figurshëm, duke krijuar emocion, imagjinatë dhe thellësi mendimi. Në letërsi (sidomos në poezi), figurat stilistike janë thelbësore sepse përmes tyre poeti shpreh botën e brendshme dhe mesazhin në mënyrë më artistike, gjithashtu ato ndihmojnë në interpretim letrar dhe e bëjnë gjuhën më të pasur.

Figurat stilistike ndahen në:

- **Figura të kuptimit (semantike):** *krahasimi, personifikimi, antiteza, kontrasti, hiperbola, litota, grotesku, simboli, paralelizmi figurativ.*

- **Figura të shqiptimit poetik (figurat tingullore dhe të intonacionit):** *pyetja retorike, pasthirma, apostrofa, heshtja (reçitena), përsëritja, epifora, anafora, aliteracioni, asoanca, paranomazia, onomatopeja, optacioni, konsonanca, pauza etj.*

- **Figura të fjalëve dhe të shprehjeve:** *metafora, katakreza, metonimia, sinekdoka, ironia, sarkazma, asteimi, paradoksi, perifraza, epiteti, alegoria, eufemizmi, antonomazia.*

- **Figura të sintaksës poetike**: *inversion, konversioni, gradacioni, elipsi, asidenti, polisidenti* etj.

Figurat stilistike më të përdorura janë:

- **Krahasimi** - është figurë e kuptimit që përshkruan, një sendi, një frymori a një dukurie me anën të krahasimit me një sendi, frymori a dukurie tjetër të ngjajshme, P.sh:

*“**Porsi kanga e zogut t’ tverës.***
qi vallzon n’blerim të prillit;
porsi i ambli fllad i erës,
qi lmon gjit e drandofilit;
porsi vala e bregut t’detit,
porsi gj â ma e rrfès zhgjetare,
porsi ushtima e një tërmeti,
njashtu â gjuha e jon shqyptare.”

“Gjuha jonë”, Gjergj Fishta

- **Personifikimi** - është figurë tjetë e kuptimit në të cilën kafshëve apo sendeve u jepen veti të njerëzve dhe kur gjërave pa shpirtë iu mveshen ndjenja apo kryerje të ndonjë veprimi. P.sh:

*"Fshiu lotet dhe **më tha Tomori:***
O shqipetarët e gjorë,
Ndëgjoni Baba-Tomorë:
Kombi tuaj s'vete mbarë
se besët u kanë ndarë...."

"Baba Tomori", Andon Z. Çajupi

- **Antiteza** – përbëhet nga dy njësi kuptimore, të cilat janë në kundërvënie të vazhdueshme dhe të skajshme. Kjo figurë shpesh realizohet përmes antonimeve. P.sh:

*"... Se të **deshte** dhe **s'të deshnin,***
*Se të **qante** kur të **qeshnin,***
*Se të **veshte** kur të **çveshnin,***
Nëno moj, të ra dëshmor...

"Syrgjin-vdekur", Fan Noli

- **Hiperbola** (zmadhim i tepruar) – është një nga shprehjet figurative që ka të bëjë me zmadhimin e tepërt të forcës, të rëndësisë dhe të përmasave të një fenomeni. Më shpesh e ndeshim në krijimtarinë letrare popullore, kryesisht në këngët kreshnike. P.sh:

. "... Përmbi kryet topuzi i ka fjorue:
***dymbëdhet pash** n'lëndinë u ngul topuzi!*
***dymbëdhet pash** përpjetë si re u çue pluhni!*

"Gjergj Elaz Alia"

- **Litota**– Litota është figurë stilistike e zvogëlimit (e kundërta e hiperbolës), ku një pohim i fortë zëvendësohet me mohimin e së kundërtës së tij, duke u shprehur më butë ose me ironi. Ajo shërben për të ulet intensiteti i një shprehjeje për hir të mirësjelljes ose për të theksuar diçka përmes nënvlerësimit (p.sh., "*nuk është budalla*" në vend të *"është i zgjuar"*).

"...Shpejt vrapova gjer tek lumi,
Mora e solla një pikë ujë
E ia derdha përmbi faqet "

"Kënga e sprasme e Balës", Gavrill Dara i Ri

- **Simboli**– është një tjetër figurë e kuptimit që zëvendëson emrin e një fenomeni, apo të një objekti për të cilin bëhet fjalë në veprën poetike, me një shenjë tjetër që të kujton këtë fenomen jetësor apo objekt. P.sh.: *agimi (mëngjesi)* – simbole të rinisë, të fillimit të jetës. *Nata* – simbol i vdekjes, i fundit të jetës. *Dëbora*, simbol i të ftohtit, i ndjenjës së ftohtë. *Pëllumbi* – simbol i paqes, apo Manushaqa te poezia e Naim Frashërit që simbolizon atdheun:

__Manushaqe__ bukuroshe,
Pse s'ngre kryete përpjetë,
Po rri e mpit' edh' e qetë,
Pse s'zbukuroh e s'shëndoshe?

"Shkëndijë e diellit ndaj manushaqes", Naim Frashëri

- **Pyetja retorike** – është figurë e shqiptimit poetik, pyetje e cila ka të bëjë me të pohuarit në formë pyetëse. Përdoret në veprat artistike dhe në ligjëratat oratorike, jo për të marrë përgjigje, por për t'i dhënë frazës forcë dhe intonacion të ngritur. P.sh.:

"__Pse__ s'vjen o dit'e mirë
__Pse__ vallë nuk vjen?
__Gjer__ kur në errësirë?
Mos Zoti të pëlqen? "

"Përse", Naim Frashëri

- **Pasthirma** – është figurë e shqiptimit poetik, që përdoret në poezi në formën e thirorit sim mjet i ndërhyrjes emocionale të autoritpër të shprehur entuziazëm, ngazëllim, dëshpërim ose revoltë. P.sh:

"__O__, si nuk kam një grusht të fortë
t'i bij mu në zemër malit që s'bëzanë,
ta dij dhe ai se ç'domethanë i dobët –
n'agoni të përdihet si vigan i vramë. "

"Recital i malsorit", Migjeni

- **Heshtja (retiçenca)** – kjo figurë stilistike ka të bëjë me mos thënien e një fjale gjatë ligjërimit poetik, por edhe gjatë ligjërimit në përgjithësi. Ndërkaq, të hequrit e një fjale sinjalizohet përmes intonacionit të posaçëm të zërit, që shpreh diçka të pakryer deri në fund, fjalë që tërheq fuqishëm vëmendjen e lexuesit apo dëgjuesit. P.sh:

"...vetëm njëri sy të mëkish mbetur çel
nuk po mund të besoj Lumi
se ti, se ti..."

"Nuk kam bërë kurgjë për Lumin", Ali Podrimja

- **Epifora** – është përsëritja e fjalëve a shprehjeve në fund të dy ose më shumë vargjeve të njëpasnjëshme për të forcuar idenë dhe për të dhënë më shumë ngarkesë emocionale.

*"Ti ike me erën, **pa fjalë***
*Mbeta në prag të kohës, **pa fjalë***
*Edhe qielli u mbyll mbi mua, **pa fjalë**"*

- **Anafora** – është përsëritje e së njëjtës fjalë apo e disa fjalëve në fillim të disa vargjeve që vijnë njëri pas tjetrit për t'i dhënë forcë shprehjes. P.sh:

"Unë, biri yt, Kosovë t'i njoh dëshirat e heshtura,
***t'i njoh** ëndrrat, erërat e fjetura me shekuj,*
***t'i njoh** vuajtjet, gëzimet, vdekjet,*
***t'i njoh** lindjet e bardha, caqet e tuka të kulluara."*

"Unë, biri yt, Kosovë", Ali Podrimja

- **Aliteracioni** – është figurë stilistike tingëllore që arrihet përmes përsëritjes së të njejtës bashkëtingëllore në fjalë të ndryshme brenda një a më shumë vargjesh, për t'i dhënë gjuhës poetike një fuqi më të madhe shprehëse ose për të prodhuar harmoni imitative.

*"Vijnë **v**ashat **v**alle-**v**alle,*
gush' e gji stolisura
një pëllumb, një sy sorkadhe
seç më vjen më e mbollisura."

"Vallja e luleve", Lasgush Poradeci

- **Asonanca** – është figurë stilistike tingëllore që rrit muzikalitetin e poezisë. Asonanca përsërit zanoret e theksuara me qëllim të krijimi të harmonisë dhe ritmit. P.sh:

*"Fëmij**a** p**a** nanë, si n**a**t**a** p**a** h**a**në"*

"Popullore"

- **Paranomazia** (ose paronimia) - është një figurë stilistike e bazuar në vendosjen afër të dy fjalëve me tinguj shumë të ngjashëm, por me kuptime të ndryshme. Ajo krijon lojë fjalësh duke shfrytëzuar ngjashmërinë zanore ose bashkëtingëllore, pra tingujt e ngjashëm mund te jene te tipit zanor ose bashkëtingëllor, si: *afroj-ofroj* etj. P.sh:

*"Kërkova **paqen, pagën** e shpirtit,*
*Mes **lotit, motit** u mplaka para stinës."*

- **Onomatopeja** - është fjalë tingullimituese ose përshkrim i dukurive a sendeve duke shfrytëzuar imitimin e zhurmave e të zërave të tyre. P.sh:

"O nënë", po nëna nuk është më përqerk
Diku mitralozi troket ***trak-trak."***

"Nëna", Ismail Kadare

- **Metafora** - është një nga figurat kryesore poetike**.** Është fjalë e figurshme që emërton një send a një fenomen me emrin e një sendi a fenomeni tjetër që i ngjan atij. Në bazë të metaforës pra ndodhet një krahasim i nënkuptuar. Për shembull: *Vullnet i hekurt.* Përdorimi i metaforës i thekson tiparet e ngjashmërisë ose, përkundrazi, ndryshimet e sendeve apo të fenomeneve mbi të cilat shkrimtari dëshiron të tërheqë vëmendjen tonë. Me fjalë të tjera, bazë e metaforës është një krahasim i nënkuptuar.

*"**Molla** t'kputkuna nji deget*
***dy qershia** lidhë n'ji rrfanë,*
ku fillojnë kufit e Geget,
rrijnë dy çika me një nanë"

"Andrra e jetës", Ndre Mjeda

- **Metonimia** – është figurë poetike që zëvendëson emrin e një fenomeni apo të një sendi me një emër tjetër, që ka lidhje nga me të nga prania e përbashkët, në kohë, në hapësirë, apo si rrjedhim, si shkak, si: *"Nëna ndezi* ***oxhakun*** *(zjarrin) e vjetër.* Kjo figurë e pasuron poezinë duke krijuar imazhe të fuqishme. P.sh.:

"Të premten e madhe
në fundin e javës
lodhja hyp në katër rrota
e del në shëti." "Automobil", Sabri Hamit

- **Sinekdoka** – është figurë stilistike nga llojet e veçanta të metonimisë. Përdorimi i një fjale për të shfaqur një ide më të gjerë ose më të ngushtë se ideja që duam të tregojmë, pra, kur përdorim njëjësin në vend të shumësit dhe anasjelltas: P.sh.:

"...se ***mileti*** *po gatitet,*
se ***tirani*** *lebetitet,*
se pëlcet, kërcet furtuna,
fryhet vjosa, derdhet buna,
skuqet semani dhe drini,
dridhet ***beu*** *dhe* ***zengjini,..."***

"Anës lumenjve", Fan Noli

- **Ironia** – është një figurë dhe teknikë e rëndësishëme letrare që përfshinë një tallje të hollë dhe të fshehur me intonacion lavdërues, që nënkupton të kundërtën. P.sh.:

"Në vendin tim e në vendin tënd
E shpojnë lakren, i hedhin mënd.

Në vendin tim e në vendin tënd
Ty te kruhet, tjetrit i dhëmb.

Në vendin tim e në vendin tënd
Hënën si petull e pjekin në shkëmb.

Në vendin tim e në vendin tënd
Një i çmendur, një vend e çmënd"

"Në vendin tim e në vendin tënd", Dritëro Agolli

- **Paradoksi** – është një figurë stilistike e kuptimit (figura të fjalëve) që paraqet një fjali ose ide e cila duket qartësisht kontradiktore, absurde apo e pamundur në sipërfaqe, por që në thelb mbart një të vërtetë të thellë, logjikë të fshehur ose kuptim artistik. P.sh.:

"Në mbrëmje bie qetësia mbi qytet
Dritat ndizen ngadalë nëpër rrugë
***Në heshtjen time bërtas** më fortë se kurrë*
Dhe hëna me vëmendje më dëgjon"

- **Epiteti** – është një figurë stilistike që zbukuron dhe thekson një cilësi të emrit përmes një fjalë përshkruese me vlerë artistike. Epiteti pasuron kuptimin e fjalës së cilës i shtohet dhe shpreh qëndrimin emocioan të autorit. P.sh.:

*"Krujë, o qytet **i bekuar,***
prite, prite Skënderbenë!
*Po vjen si pëllumb **i shkruar***
të shpëtojë mëmëdhenë."

"Historia e Skënerbeut", Naim Frashëri

- **Alegoria** – shpreh një ide, mesazh ose koncept abstrakt përmes një tregimi ose figure konkrete me kuptim të fshehtë. Përderisa **simboli** është një figurë e vetme (p.sh. pëllumbi që simbolizon paqen, **alegoria** përdoret edhe për një tekst të tërë ose një rrëfim me kuptim të fshehtë. P.sh.:

"Kalonin në një shteg të ngushtë mali,
gomari para, pas gomarit kali.
Të dy ngarkuar me thasë mirë,
nga vapa të munduar e djersirë.

"Kali dhe gomari", Dritëro Agolli

- **Eufemizmi** –është figurë stilistike që përdor një shprehje më të butë, më të lehtë ose më të pranueshme, për të shmangur një fjalë të ashpër, të drejtpërdrejtë ose të pa këndëshme, p.sh.: *u nda nga jeta*, në vend të fjalës *vdiq.*

"Në mëngjesin e ftohtë,
*Ai **pushoi** në qetësi,*
Dritaret mbeten të mbyllura
Dhe era në vetmi."

- **Gradacioni (shkallëzimi)**– është figurë stilistike ku autori i vendos fjalët sipas një shkallëzimi të përcaktuar ***ngjitës*** apo ***zbritës***, duke filluar prej fjalës më të fortë drejt fjalës më të butë dhe anasjelltas duke shkuar gradualisht nga fjala e butë drejt fjalës së fortë. Pra, **gradacion ngjitës** dhe **gradacion zbritës**. Psh.:

"Thuaja kangës, rini, pash syt' e tu!
Të rroki, të puthi kanga, të nxisi me dashnu!"

"Kanga e rinis", Migjeni

"Valim-i anijes q`u sos.
Valim-i anijes se lete
Qetohet, ndalohet, mbaron"

"Gjeniu i anijes", Lasgush Poradeci

- **Elipsa** - është figura stilistike qe krijohet, kur heqim nga tërësia e tekstit ndonjë fjalë a pjesë, e cila nënkuptohet, pa prishur kuptimin, me qëllim që t'i japim shprehjes më shumë gjallëri, hijeshi apo shpejtësi. Psh.:

"Maletë me gurë,
fushat me bar shumë,
aratë me grurë,
më tutje një lumë."

"Fshati im", Çajupi

- **Asindeti** - është një element letrar, ku me qëllim nuk përdoren lidhëza dhe zëvendësohen me presje në fjali për t'i dhënë gjallëri e intonacion të shpejtë. Në aspektin gramatikor, asidenti është dukuri e renditjes dhe vargëzimeve, pra listave të gjymtyrëve të cilat ndahen me presje dhe pa lidhëza. Psh.:

*"**Nëna, motra, nusja dalin,***
Ngrehin krahët të të ndalin."

"Rrent, or Marathonomak", Fan Noli

- **Polisindeti** - është e kundërta e asidentiti, ku përdoren të gjitha lidhëzat (zakonisht bashkërenditëse si: *dhe, e, as, apo*) për të lidhur gjymtyrët, që renditen njëra pas tjetrës në fjali duke ngadalësuar ritmin dhe duke theksuar çdo element. Psh.:

*"**Dhe** më le mua e plakën kërcure*
__Dhe__ më le arën mbjedhë pesë vjet
__Dhe__ më le selishten mbuluar me hithra e shkurre ..."

"Krevati i perandorit", Dritëro Agolli

Diskutim

- Njihni dhe interpretoni figurat stilistike dhe funksionin e tyre në vargje!
- Dalloni figura stilistike në raport me stilin, gjuhën dhe kohën në të cilën është krijuar vepra dhe diskutoni për ato!

Epika

Epika është lloj letrar nga më të lashtët. Rrënjet i ka në këngët e hershme heroike që lindin pas luftrave që bënin popujt ndër vete. Epika është gjinia më e vjetër letrare që shumë herët i ka zhvilluar tiparet e saj. Ajo pothuajse në të gjitha letërsitë është shumë e afërt me mitin.

Epika është lloj letrar ku jeta pasqyrohet nëpërmjet rrëfimit për ngjarje dhe njerëz që kanë marrë pjesë në to, për sjellje dhe emocione të tyre në rrethana të ndryshme.

Në gjininë epike futen ato vepra, në të cilat autori rrëfen ngjarje (vetë ose nëpërmjet personazheve). Këto vepra mund të jenë të shkruara: **në vargje** (epi, poema, cikle këngësh, epope që e marrin temën nga ngjarje historike etj.) dhe **në prozë.** Romani, novela, tregimi janë lloje të mëvonshme të prozës, të cilat e kanë zanafillën në veprat epike. Në gjininë epike dallohen dhe llojet **epiko-lirike**, ku autori përveç se rrëfen ngjarjet, shpreh edhe ndjenjat dhe mendimet e tij. Të tilla mund të jenë: poemat, baladat (që e marrin temën nga jeta morale dhe shoqërore), fabulat (që nëpërmjet figurave të kafshëve trajtojnë marrëdhënie njerëzore).

Në veprat epike, **tema** (çfarë trajtohet), pasqyron ngjarje të rëndësishme historike apo shoqërore, që përcaktojnë fatin e një populli, si luftërat, lëvizjet historike, apo periudha tranzicioni. **Motivi** (çfarë përsëritet) është elementi specifik që zhvillon temën, pra, njësi më të vogla tematike që e pasurojnë veprën, si: motivi i besës, motivi i dasmës, lufta kundër pushtuesit, vajtimi për trimin, ose ndërhyrja e forcave mbinatyrore etj. Ndërsa **ideja** (pse shkruhet) përcjell mesazhin thelbësor që autori synon të përcjellë mbi fatin e një populli, moralin apo vlerat njerëzore, shpesh të shprehura përmes një heroi epik dhe veprimeve të tij.

Një ndër elementet kryesore të epikës është edhe **kompozicioni** i veprës letrare. Është mënyra se si autori i organizon dhe i vendos elementet e veprës (ngjarjet, personazhet, përshkrimet) për të krijuar një tërësi artistike. Nëse **subjekti** është "çfarë" ndodh, **kompozicioni** është "si" është ndërtuar vepra. Ai karakterizohet nga një rrëfim kronologjik, shtrirje e gjerë kohore, përshkrime të detajuara duke ndërthurur narracionin me përshkrimin e ngjarjeve nëpërmjet **hyrjes**, **zhvillimit të konfliktit**, **pikës kulminante** dhe **zgjidhjes** (përfundimit).

Elementet tjetër kyç në epikë është **rrëfimi (narracioni)** në veprën lertrare ku tregohet një ngjarje. **Narracioni** është përdorimi i një komenti të shkruar ose të folur për të përcjellë një histori tek audienca me forma specifike të rrëfimit që lidhen me **kohën** dhe fokusin psikologjik të ngjarjes. Forma të tilla janë:

- **Retrospeksioni:** (nga latinishtja *retro* - prapa dhe *specere* - shikoj). Është ndërprerja e rrjedhës kronologjike të ngjarjeve për t'u kthyer në një pikë të kaluar. Kjo teknikë shërben për të ndriçuar shkaqet e një situate aktuale ose për të zbuluar të kaluarën e një personazhi.

- **Introspeksioni:** (nga latinishtja *intro* - brenda). Nuk ka të bëjë me kohën, por me "drejtimin" e shikimit të rrëfimtarit. Është vëzhgimi i vetvetes, ku rrëfimtari ose personazhi analizon gjendjen e tij shpirtërore, mendimet dhe ndjenjat më të thella (shpesh përdoret te "monologu i brendshëm").
- **Prospeksioni:** (nga latinishtja *pro* - përpara). Është e kundërta e retrospeksionit; rrëfimtari hedh vështrimin drejt të ardhmes, duke paralajmëruar ngjarje që ende nuk kanë ndodhur. Kjo krijon kureshtje ose tension (suspansë) te lexuesi.

Rrëfimi (narracioni) përcillet nga një "zëri" i krijuar nga autori dhe ky zë është **rrëfimtari** (narratori) që tregon ngjarjet në një vepër letrare. Ai shërben si ndërmjetës mes autorit dhe lexuesit, duke përcaktuar kështu këndvështrimin tonë për ngjarjen. Në letërsi, rrëfimtari klasifikohet sipas dy kritereve kryesore:

1. Sipas pozicionit (veta e rrëfimit)

   - **Rrëfimtari në vetën e parë** (unë): Është pjesë e ngjarjes, shpesh si personazh kryesor (protagonist) ose dëshmitar. Ky rrëfim është subjektiv dhe na lejon të shohim botën përmes syve të tij.

   - **Rrëfimtari në vetën e tretë** (ai/ajo): Qëndron jashtë veprimit dhe i referohet personazheve me emra ose përemra.

2. Sipas shkallës së njohjes

- **Rrëfimtari i gjithëditur:** Ai di gjithçka për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, si dhe njeh mendimet e fshehura të çdo personazhi.
- **Rrëfimtari i kufizuar:** Rrëfen vetëm atë që mund të shohë ose të dëgjojë nga perspektiva e një personazhi të caktuar.
- **Rrëfimtari objektiv:** Sillet si një vëzhgues i ftohtë (kamera), duke treguar vetëm veprimet e jashtme pa komentuar ndjenjat ose psikologjinë e personazheve.

Është e rëndësishme të mos ngatërrohet autori që ekziston jashtë librit dhe përdor imagjinatën e tij për të krijuar historinë, me rrëfimtarin (zërin imagjinar brenda librit) që ekziston vetëm brenda tekstit dhe shërben si ndërmjetës mes ngjarjes dhe lexuesit.

Element i rëndësishëm në vepër janë **personazhet,** që mud të jenë njerëz ose qenie që marrin pjesë në ngjarje dhe përjetojnë rrethana të ndryshme. Ata janë:

- **Protagonisti (heroi)** - është personazhi kryesor rreth të cilit rrotullohet konflikti dhe veprimi.
- **Antagonisti** – është forca ose personazhi që kundërshton protagonistin dhe krijon pengesa.

- **Personazhet dytësore** - ata ndihmojnë në zhvillimin e subjektit, por nuk janë në qendër të vëmendjes.
- **Personazhet episodikë** – ata shfaqen vetëm për një moment për të plotësuar një nevojë të caktuar të rrëfimit.

Të gjithë personazhët kanë edhe **karakterin** e tyre që përbëhet nga bota shpirtërore, nga pamja e jashtme dhe nga veprimet e tyre.

Diskutim

- Numëroni dhe përshkruani karakteristikat themelore të epikës!
- Njihni dhe dalloni tiparet e epikës nëpërmjet elementeve në raport me gjinitë e tjera dhe diskutoni për ato!

Llojet epike në vargje

Poezia epike ka marrë emrin nga fjala greke epos-fjalë, tregim dhe paraqet formën e gjatë të krijimit në vargje. Në përdorim janë edhe termat **ep, epope, poemë heroike** etj. Disa me fjalën **epos** i quajnë ciklet e këngëve epike, të cilët gjatë zhvillimi kanë mbetur në një shkallë më të ulët se sa **epi**. Fjala **epope** u vihet zakonisht epëve të mëdha për dallim nga epet e zakonshme. Në këtë rast epope do të emëroheshin *"Iliada"* dhe *"Odiseu"*, vepra të Homerit por edhe *"Komedia Hyjnore"* e Dante Aligierit. Zakonisht në këtë tip të epit zë vend një pamje e gjerë e jetës së kohës, e cila dëftohet përmes ngjarjeve të rëndësishme për jetën e fatin e atij populli në momente të caktuara, zakonisht në luftën prej së cilës do të mvaret zhvillimi i mëtejshëm. Epi synon ta kap jetën e shoqërisë në mënyrë totale, historike dhe shoqërore, andaj në ngjarjet e tij marrin pjesë njerëzit nga të gjitha shtresat e një popullit, mirëpo heronjtë e tij janë prijësit, mbretërit, gjysmëhyjënitë etj.

Llojet epike në vargje përfshijnë krijimet letrare ku rrëfimi i ngjarjeve dhe bëmave heroike realizohet përmes formës poetike. Këto vepra karakterizohen nga prania e një rrëfimtari, subjekti me linja të shumta veprimi dhe shpesh, tone heroike ose legjendare.

Megjithëse termet **ep, epope** dhe **poemë heroike** shpesh përdoren si sinonime për të treguar rrëfime të gjata heroike, ato kanë dallime specifike që lidhen me orgjinën, përmasën dhe strukturën e tyre:

- **Epi (eposi)**- është termi më i gjerë dhe shpesh i referohet zhanrit fillestar të krijuar nga populli. Zakonisht është produkt i krijimtarisë popullore (folklorike) që përcillet gojarisht. Ka karakter kolektiv dhe pasqyron besimet e një kombi në fazat e tij të hershme. Përbëhet nga një cikël këngësh ose legjendash që rrotullohen rreth një heroi ose ngjarjeje, por që nuk kanë domosdoshmërisht një unitet të rreptë strukturor, siç është p.sh. *"Cikli i Kreshnikëve"*.

FUQIJA E MUJIT

Lum e lum për t'Lumin Zot,
Nu'jém kânë e Zoti na ká dhânë!
Kurr ish' kânë Muja djalë i ri,
M'a kish çue baba n'rrogë tu nji zotni;
Çoban lopësh zotnija e ká bâ.
Për gjith ditë bjeshkët Muja tu'i kërkue;
Për gjith ditë ndër gurra tu'u freskue,
Për gjith ditë ndër mriza tuj pushue,
Rrugë as shtek pá njoftë nuk ká lânë
M'i çon lopët gjithherë ku s'i'n kânë.
'I natë lopët çobanit i paskan hupë.
E tu shpija nu' ká mujtë me dredhë,
Buzë nji shkambit m'u ndalë âsht ngushtue;
Âsht ulë djali aty për me fjetë,
Paj dy djepa aty ki'n qillue;
E kan marrë brimën e tuj kajtë,
M'ásht avitë Muja me i shikjue,
M'âsht avitë Muja me i pajtue.
Po i pajton tuj i përkundë,
E t'dy djepat i ká vû në gjumë.
Bardh si drita dý Zâna atëherë kan ardhë;
– Ty, qýsh të thonë – Mujon e kan pvetë –
Zo'! ç'të ká prû n'ket vend e shka t'ká tretë!
Kqyre Muja atëherë shka u ká thânë:
– Rrogtár lopësh un kam qillue,
Për gjith ditë kto bjeshkë i kam kërkue,
Mue rreziku sot ká ardhë me më ndeshë
M'kan hupë lopët, e askund s'kam mujtë me i gjetë:
Ktu m'xû nata e u ugja për me fjetë,
S'mbylla sy prej vajit, qi kam ndie,
Ishin kânë tuj kajtë këta dy fmíj,
Kurrkund çajre fmija nu'm'kan lânë
M'u kan dhimtë e jam hudhë me i pajtue.
I pajtova e sa grima n'gjumë i kam vdue.

Po Zo'! shka jeni me gjith ket dritë? –
– Zâna jemi, Mujo, tuj shetitë,
Tuj u sjellë na njerzvet me u ndimue,
Ti ç'farë ndere, Mujo, po na lypë?
Qi dy djepat na i ke vû në gjumë?
A don forcë, Mujo, me qindrue?
A don luftë, Mujo, me luftue?
A don gjâ, Mujo, a don máll?
A don dije, Mujo, a don gjuhë?
Lyp shka t'duesh Mujos te i kan thânë.
Kqyr Muji atëherë ç'ká qitë e ká thânë:
– Shpesh po m'ngucin çobanija,
Shum inád çobajt si më kan,
Paj me forcë me jau kalue un due.
Njana shoqes Zânat atëherë i kan thânë:
– Tamël gjiut Mujit për me i dhânë.
Tamël gjiut i kan dhânë me pí,
Me trí pika djalin m'a kan ngî,
E i ká falë Zoti kaq fuqí
Sá me e luejtë shkambin mâ t'madhin.
– Kape gurin! – Zânat i kan thânë,
Njimí okësh e mâ guri ish'kânë.
E ká kapë gurin njimí okësh
Badihava peshue me duer e ká:
Dér n'nye t'kâmës veç e nu'mujt mâ.
Njana shoqes Zânat atëherë i kanë thânë:
– Edhe do tamël Mujos me ia dhânë.
E ká marrë tamlin Muji e e ká pí,
E ká kapë gurin me e peshue,
Deri në gjû ai gurin e ká çue,
E ká ugjë prap n'tokë e ká pushue.
Kqyre Zâna sá mirë ká thânë:
– Edhe pak gjí Mujos me i a dhânë.
I ká dhânë prap gjí për me pí,
Sá don Zoti t'i ká dhanë fuqí,



E e ká marrë gurin me e peshue,
Deri në shogë gurin e ká çue.
E kan pá Zânat e kan kqyrë
Njana tjetrës prap te i ká thânë:
– Opet Mujit gjí lypet me i dhânë.
E ká marrë Muji gji me pí
O! se ç'po i ep edhe Zoti fuqí.
Kênka bâ si me kânë drangue.
Ká marrë gurin me e peshue,
N'cep të krahit Muji e ká vdue
Njimí okësh gurit i ká qindrue
Njêna shoqes Zâna çka i ká thânë:
– Tjetër gjí Mujit mos me i dhânë:
Pse tjetër gjí Mujit për me i dhânë
E batisë dyrnján anë-m' anë.
Atëherë Zânat Mujin po e zhgjertojnë
Se sá t'vogël qi po flasin:
Përmbí krye hâna tuj i shikjue,
Për mbas shkambit hija tu'u zgjatue,
Sá miqsisht me tê kan kuvendue.
Kqyre Zânat Mujit shka i kan thânë:
– Probatin na, Mujo, duem me të xânë:
Fol ti, Mujo, tash qysh po thue? –
– Tu t'jém ngusht, Zâna, me m'ndimue! –

E ká falë Zoti sabahin
Ferk e ferk Muji kânka çue,
I ká gjetë lopët e në shpí ká shkue,
N'fushë t'Jutbinës Muji kúr â rá
Bytym shokët e mbledhun i ká pá,
Se me Mujin aty i'n kênë msue
Me i a mujtë Mujit tuj ladrue.
Kqyre seri Muji shka ká bâ:
I a ká nisë me çobaj me ladrue.
Send mâ t'fortin me dorë e ká kapë
Pêsë konopë
përpjetë i ká dhânë.
As kurrkush me folë nuk po flet.
Se me thue kúr po i bjen
Dekun n'tokë gjinden po i qet.
Prej zotnís – tha – Muji âsht largue,
Prej Zotnís – tha – burri kúr âsht dá,
Ká dredhë n'shpí – tha – nânën për me e pá.
Tha – I a ká nisë Muji tuj punue
Tha – I a ká nisë Muji tuj luftue!
E n'sá lufta Muji si po bjen
Ai gjith herë me nderë si po del.

"Cikli i Kreshnikëve"

- **Epopeja** - konsiderohet si forma më e lartë dhe më e gjerë e epikës. Është vepër gjigante që përfshin një epokë të tërë historike, fatin e një populli ose të gjithë njerëzimit.
  Për dallim nga eposi që mund të jetë i copëtuar, epopeja ka një strukturë të mirëfilltë narrative dhe një subjekt qendror, Mund të jetë popullore (si *"Iliada"* e Homerit) ose e shkruar nga një autor i vetëm si *"Lahuta e Malcís"* e Fishtës.

LAHUTA E MALCISË (fragment)



Hej, moj Zânë, ti kjosh e bardhë!
Tridhetë herë, mana, rreth diellit
Hausit t' qiellës toka ká ardhë,
E aq herë lulet njethë janë Prillit,
Se ti, purë m' Lahutë t' Malcis,
N' hullí menden mbajtë m'a ké,
Qi të mûjshe vetë nipís
S' kohve t' vona enè per t' lé,
Me u kumtue me 'i kangë kreshnike,
Si erdh t' u regjë mendja e Shqyptarit,
Prap per t' gzuem lirín jetike,
Trashigim lânë atij prej t' Parit:
E sa u bâ gjaku e medeti,
Sa u tuer rrêna edhè tradhtija,
Dér qi duel Shqypnija m' veti,
Si premtue kisht' Perendija.
Por, qe, tash na u kapem m' cak:
Gjatë Parnasit mjaft m' ké rrekun
Mriz e m' mriz, a lak më lak:
Kangës ktu spiku tash do hjekun.
Veç se po, moj bjeshkatare,
Krah m' krah bashkë na tue këndue,
Ndertue kemi 'i pomendare,
Rrfé as mot mos m' e dermue.
N' at London, larg n' at dervend
Të shtatë Krajlat bâjn kuvend,
Bâjn kuvend me shoqishojn:
Per Shqypní po bisedojn:
Ashtû ndêjun rend mbas rendit
Me at Inglizin n' krye të vendit.
Prá, per Zotin, moj Shqypní,
Oren çuet, tham, ti m' a ké!
Nji pllamë vend, nji grusht njerzí,



Bukë pa bukë, e qe se prap
Té shtat Krajlat çue ké peshë;
T' cillt po ngasin turr e vrap
N' at London m' shoshojn me u ndeshë,
Per me folë, me bisedue,
Nji zojë m' vedi tý me t' qitë,
Shkjaut e Turkut me t' lirue:
Prap Kunora m' báll me t' ndritë,
Porsi t' ndriti dikur motit.
Me gjithkta, por larg nuk shkon
E me i vrá ká rrfeja e Zotit
T' shtatëtit, mledhë si janë n' London;
Persè rrumull pesqind vjet
Të randë Turkun me t' shtypë.
Me t' thá n' shpírt, dér qi simjet
M' shtjelma Shkjau atij s' ká hypë.
Jo, po, gjaku i bijve t' ue,
Moj lum nana, e njatà lot
Qi ti derdhe, janë tue vlue
E gjýgj lypin prej s' Tynzot.
Krajli i Inglizit, nji telbis:
Me çá qymen per mjedis:
Veç, me gjasë, pak si i pabesë
Ç' i a ká vû aj gishtin krés
Se edhè fjalët fort po i peshon,
Kah ká mârrë e ligjiron:
Si t' i a bâjm e tek t' i a bâjm;
Se na pykë, trima, kem' rá
Me Shqypní, sa mâ nuk ká!
Porsa krisi n' at Balkan
Pushkë, e top, edhè havan,
E i a nisen me u shemtuem
Turk e Shkjá idhtë tue luftuem,
Tue pá Turkun se per ballë
T' Shkjaut, qi luften kishte kallë,
Zot Shqypnís s' po mund t' i dalë,
E ká bâ pleqní n' Stambollë
Né Shqypnín me na e lshue n' dorë,
Qi, pa mbajtë na krah as pajë,
Ktû t' a dájm fatin e sajë;
A tue njoftë si Shtet të lirë
E krejt m' vedi: a se mâ mirë,
Ndoshta, Shkjaut na tue i a dá,
Si bashtinen — vllá per vllá,
Si me thânë, në kater pjesë,
Per mos t' lânë mâ asnji ngatrresë.

Gjergj Fishta

- **Poema heroike** - është formë më e shkurtër dhe më "moderne" brenda gjinisë epike sepse përqendrohet në një ngjarje të vetme heroike ose në një moment kulmi të jetës së heroit, pa pasur pretendimin të përfshijë gjithë historinë e një kombi. Ka më shumë elemente emocionale (lirike) sesa epopeja tradicionale. Vepra *"Istori e Skënderbeut"* e Naim Frashërit shpesh klasifikohet si **poemë heroike** për shkak të strukturës së saj të shkruar dhe frymës romantike.

ISTORIA E SKËNDERBEUT (fragment)

Këndo, ëngjëll, urtësinë
Edhe gjithë mirësitë,
Skënderben' e trimërinë,
Q'i dha Shqipërisë dritë.
Të lumtë goja, këndona,
Me gjuhë t'ëmblë si mjaltë,
Skënderben' e madh tregona,
Trimnë burrë, Zotn' e naltë.
Punëtë që ka punuar
Kordhëtari i vërtetë,
Kombinë duke nderuar
Dhe Shqipërinë përjetë.
Nga gjiri i Perëndisë
Pa m'i sill nër mënd të mija,
T'i ap dritë Shqipërisë
Nga shpirt'i ndritshëm i tija.
Ëngjëll i bukur, pa zbritmë,
Dhe me dritët të uruar
Shko përpara mej'e ndritmë,
Të shoh gjithë ç'kanë shkuar.
Që kur ngrehu gjithësinë
Zot'i madh e i vërtetë,
Ka bërë dhe Shqipërinë
E shqipëtarët në jetë.
Shqipëria kurdoherë
Ka qënë shum' e lëvduar,
Ka pasur burra të ndjerë,
Trima t'urt' e të dëgjuar.
Pati mbretër' e të parë
Fort të mëntshim e të mirë,
Burra, trima, shqipëtarë,
Që kan' emrë të pavdirë.
Ishte vënt' i Perëndisë
Që së pari Shqipëria,
Mëmëdheth'i urtësisë,
Që del soje mirësija.
Aleksandr'i Math e burrë,
I cili s'pat shok në jetë,
Nukë ka pasurë kurrë
Dhe kurrë do të mos ketë
Piro trimi e të tjerë
Burra shumë të lëvduar,
Që kanë qënë një herë,
Edhe sot s'janë harruar,
Qenë gjithë shqipëtarë,
Ishin djemt' e Shipërisë,
Nuk' ishin greq e bullgarë,
Po nga vënd'i Perëndisë.
Pirroja mundi romanët
Armikët' e njerëzisë,
Aleksandr'i Math persanët,
Egërsirat e Azisë.
Kë të zësh ngoje më parë
Nga burratë e vërtetë,
Q'ishin gjithë shqipëtarë,
E s'u erdhi shok në jetë!
Gjithë botën' e pushtuan,
Afrik', Europ', Azi zunë,
Lëftuan e mbretëruan,
Nën' urdhërë gjith' i vunë.
Edhe kur erdhë romanët,
S'u shkel fare Shqipërija,
As nga shqeht' e venetianët,
S'e zu kurrë dobëtija.
Shqipëtari në kurt s'hyri,
S'e shpërnderoj Shqipërinë,
Kurrë nukë ju tremb syri
E nuk' e humbi fuqinë.
Rrinte me kordhë në dorë,
Shkrefëtinte si dragua
Nëpër male me dëborë,
E kurrë s'u qetësua.
Armikët u dobëtuan,
Shqipërija ngriti krye,
Errësirat u mërguan,
Drit' e Zotit u rrëfye.Nga të gjitha mbretëritë,
Së Krujësë i dha Zoti
Më shumë fuqi e dritë,
Q'ishte mbret Gjon Kastrioti.
Mbretëronte urtësija,
Paqja, kamja, nderi, shpresa,
Drejtësi e dashurija,
Miqësija, besa-besa.
Tek po gjëndej Shqipërija
Në këto të mira kaqe,
Që mbretëron mirësija
Dhe ish në prehj'e në paqe,
Kur nj' e madhe egërsirë,
Duke dalë prej Asije,
U përhap si errësirë,
Dh'e mbuloi botën si hije.
Ish një komb i mallëkuar,
Në gjuhët kish dhelpërinë,
Syn' e kish të egërsuar,
Në zemërt kish djallëzinë
Ngado vij e kudo shkonte,
Zin' e gjëmënë po shpinte,
Vriste, priste, varfëronte,
Atje ku shkelte bar s'mbinte;
Më nj'anë kishte fuqinë,
Gënjeshtrënë m'anët tjetrë,
Për të mbytur njerëzinë,
Bënej her'ujk, herë dhelprë
Përse s'dolli trimërija
T'i prit gjurmën' egërsirës,
Po vate mbroth ligësija,
I zu udhënë së mirës
Ra më detrt qytetërija,
U ngrit si re errësira,
U përhap mi dhet padija,

Naim Frashëri

Diskutim

- Shpjegoni llojet e veprave epike sipas ligjërimit dhe përshkruani tiparet e tyre!

Llojet epike në prozë

Epikën përpos në vargje e hasim zakonisht në prozë ku jeta pasqyrohet nëpërmjet rrëfimit për ngjarje dhe njerëz që marrin pjesë në to, me sjellje dhe emocione të tyre në rrethana të ndryshme. Llojet kryesore epike në prozë, të cilat rrëfejnë ngjarje dhe pasqyrojnë jetën përmes veprimeve, janë: **tregimi, skica, novela, romani** si dhe **legjenda** e **përralla**. Këto forma letrare shquhen për rrëfimin në vetën e parë ose të tretë, duke shtjelluar tema nga jeta morale, shoqërore ose historike.

- **Tregimi** - është vepër e vogël letrare në prozë, në të cilën përshkruhet zakonisht një ngjarje me rëndësi nga jeta e një heroi apo personazhi, pa dhënë në mënyrë të hollësishme se ç'ka ndodhur më përpara a më pas. Tregimi sipas gjatësis mund të jetë i gjatë ose i shkurtër, që zakonisht përqendrohet në një ngjarje të vetme, një numër të kufizuar personazhesh dhe një periudhë të shkurtër kohore. Ai është realist dhe tregon dicka të vërtetë që ka ndodhur apo që edhe mund ti ndodhe dikujt tjetër.

NJË SHAKA E VOGËL

Mesditë e kthjellët dimri... Ngrica e ashpër, kërcet dhe Nadjenkës së mbështetur pas krahut tim, ia vesh një pah i argjendtë bryme kaçurrelat në tëmtha dhe pushin e buzës së sipërme. Qëndrojmë mbi një majëmal të lartë. Prej këmbëve tona e deri rrëzë fushës zgjatet pjerrina e lëmuar, në të cilën dielli shihet si në pasqyrë.



Ndanë nesh, sajat e vogla janë të veshura me një shajak të kuq e të ndezur.

– Lëshohemi poshtë, Nadjezhda Petrovna! – i lutem unë. – Vetëm një herë! Ju lutem, do t'ia dalim shëndoshë e pa gjëmb në këmbë.

Por Nadjenka ka frikë. Gjithë hapësira, nga galloshet e saj të vogla e deri në fund të malit të ngrirë, i duket e tmerrshme, një humnerë e thellë e pamatë. Asaj i ngrin zemra dhe i ndalet fryma kur sheh poshtë, sapo i propozoj të ulemi në sajë. Se, çfarë do të ngjasë nëse ndodh të fluturojë në greminë! Do të vdesë, të luajë mënç.

– Ju përgjërohem! – i them. – Mos kini frikë! Kuptojeni pra, është dobësi frika!

Më në fund Nadjenka pranon, dhe unë e dalloj në fytyrë, që ajo i lëshon pe rrezikut për jetën. E ndihmoj të ulet në sajë; të zbehtë, drithëruese, e mbërthej me duar dhe lëshohemi bashkë fluturim në humnerë.
Saja fluturon kokërr plumbi. Ajri i çarë rreh në fytyrë, ulëret, fishkëllen ndër veshë, ulëret, pickon hidhur nga tërbimi, kërkon të shkulë kokën nga supet. Nga frushullimi i erës s'kemi fuqi të marrim frymë. Duket sikur vetë djalli na ka mbërthyer me panxhat e tij dhe gjithë piskamë po na tërheq në ferr. Objektet që na rrethojnë shkrihen gjithë e më fort në një fashë të gjatë vraparake... hë-hë dhe një grimëçast, dhe duket se do të vdesim!
– Unë ju dashuroj, Nadja! – i them me gjysmë zëri.
Saja nis të rrëshqasë gjithë qetë e më qetë, ulërima e erës dhe zhuzhima e patinave të sajës tash nuk janë aq të tmerrshme, frymëmarrja nis të çlirohet, dhe në më në fund kemi mbërritur poshtë. Ajo është e zbehtë, mezi merr frymë... I ndihmoj të ngrihet.
– Herë tjetër s'do ta bëj më kurrë, – thotë ajo, duke më parë me sytë e gjerë, të mbushur me tmerr. – Për asgjë në botë! Për pak sa s'vdiqa!
Pas një grimëkohe ajo vjen në vete dhe më sheh në sy në mënyrë pyetëse: unë ia thashë ato katër fjalë, apo e gënjyen veshët në shkulmin e erës? Ndërkaq qëndroj përbri me të, pi një cigare dhe kundroj me vëmendje dorashkën.
Ajo mbështetet në krahun tim dhe shëtisim për një kohë të gjatë rrëzë malit. Enigma, si duket, nuk e lë të qetë. A qenë thënë vallë ato fjalë apo jo? Po apo jo? Po apo jo? Kjo është një çështje sedre, nderi, jete, lumturie, një çështje shumë e rëndësishme, më e rëndësishmja në botë.
Prajshëm, trishtueshëm, me një vështrim depërtues Nadjenka më vështron në fytyrë, përgjigjet kuturu, pret në do të flasë unë apo jo. O, se çfarë loje në këtë fytyrëz të ëmbë, çfarë loje! E shoh, ajo po grindet me veten, ka nevojë të thotë diçka, të pyesë për diçka, por nuk i gjen dot fjalët, i vjen rëndë, tmerr, gëzimimi e trazon...
– A e di çfarë? – thotë ajo, pa më parë fare.
– Çfarë? – e pyes.
– Hajde dhe një herë... rrëshqasim.
I ngjitemi malit nëpër shkallare. Sërish e vë në sajë të zbehtën, drithëruesen Nadjenkë, sërish fluturojmë në greminën e tmerrshme, sërish ulërin era dhe zhuzhijnë patinat, dhe sërish në pikun e skëterrshëm të fluturimit të sajës i them me gjysmë zëri.
– Unë ju dashuroj, Nadjenka!
Kur saja ndalon, Nadjenka e mat me sy shpatin, nëpër të cilin sapo rrëshqitëm, mandej gjatë ajo më këqyrën në fytyrë, përqendrohet në zërin tim, shpërfillës e të papasion, dhe gjithçka, gjithçka, madje manshoni dhe kapuçi i saj, gjithë figurëza e saj shprehin një ndërdyshje të madhe. Në fytyrën e saj është shkruar:
"Ç'është kjo punë kështu? Kush i shqiptoi ato fjalë? Ai, apo më kanë bërë veshët mua?"
Kjo mosditje e shqetëson, ia sos durimin. Vajza e gjorë nuk përgjigjet, rri e ngrysur, e gatshme t'ia shpërthejë të qarit
– A s'bën të shkojmë në shtëpi? – e pyes.
– Po mua... mua më pëlqen kjo rrëshqitje, – thotë ajo, duke u skuqur. – A s'e provojmë edhe një herë tjetër?

Asaj i “pëlqen” kjo rrëshqitje, po ndërkaq, teksa ulet në sajë, ajo, ashtu si dhe herët e tjera, është e zbehtë, mezi merr frymë nga frika, dridhet.
Ne lëshohemi për të tretën herë, dhe shoh se si ma kundron fytyrën, si vigjëlon buzët e mia. Por unë në buzë vë shaminë, kollitem dhe, kur mbërrijmë mesin e shpatinës së malit, ia dal të pëshpëris:
– Unë ju dashuroj, Nadja!
Dhe enigma mbetet enigmë! Nadjenka hesht, mendon për diçka... Unë e përcjell në shtëpi, ajo përpiqet të ecë pa zhurmë, ngadalëson hapat dhe vetëm pret, në do t’ia them vallë ato fjalë. E shoh se si vuan shpirti i saj, se si përmbahet me zor, të mos thotë:
– Nuk ka mundësi që ato fjalë t’i ketë thënë era! Dhe nuk dua, që t’i ketë thënë era!
Mëngjesin e ditës tjetër marr një pusullë: “Nëse do të shkoni sot të rrëshqisni me sajë, merrmëni dhe mua. N.” Që prej kësaj ditë unë me Nadjenkën shkojmë të rrëshqasim me sajë dhe, duke fluturuar poshtë, çdo herë i pëshpëris me gjysëm zëri të njëjtat fjalë:
– Unë ju dashuroj, Nadja!
Shumë shpejt Nadjenka do të mësohet me këtë frazë, si me verën apo morfinën. Ajo nuk mund të jetojë pa to. Njëmend, fluturimi në shpatin e malit është i tmerrshëm, si më parë, por tmerri dhe rreziku tashmë u japin një magji të veçantë fjalëve për dashurinë, fjalëve, të cilat si më parë përbëjnë enigmën dhe mundojnë shpirtin. Të dyshuarit janë dy, si më parë: unë dhe era... Se cili prej të dyve ia shpreh dashurinë, ajo nuk e di, por si duket, për të s’ka rëndësi; nga cilado enë të pish, e rëndësishme është të jesh i pirë. Njëherë, një mesditë, shkova i vetëm të rrëshqas me sajë; i përzier me turmën, shoh se si në majë po ngjitej Nadjanka, se si më kërkonte me sy... Mandej pashë me sa droje i ngjiste shkallët... E tmerrshme të vish vetëm. O, sa e tmerrshme! Ajo është e zbehtë, si dëbora, dridhet, mu sikur po shkon ta ekzekutojnë, por ecën, ecën, pa i hedhur sytë kund, vendosmërisht. Ajo, dukej haptazi, kishte vendosur, më së mbrami, të provojë: a do të ndihen vallë ato fjalë të ëmbla e të mrekullueshme, kur unë nuk do të jem me të? E shoh se si ajo, e zbehtë, me gojën e hapur nga tmerri, ulet në sajë, mbyll sytë dhe, duke i dhënë lamtumirën e përjetshme tokës, niset... “Zhzhzh...” – zhuzhijnë patinat. Po a do t’i dëgjojë a s’do t’i dëgjojë ato fjalë Nadjenka, unë nuk e di... Unë shoh se si ngrihet ajo nga saja, e raskapitur, e dobët. Dhe duket nga fytyra, as ajo vetë nuk e di, në ka dëgjuar gjë apo jo. Tmerri, ndërkohë që rrëshqiste poshtë ia hoqi mundësinë për të dëgjuar, për të dalluar tingujt, për të kuptuar...
Por ja që hyri muaji pranveror i marsit... Dielli bëhet më ledhatar.
Mali ynë i akullt bëhet i errët, e humb shkëlqimin e tij dhe më së mbrami shkrin. Ne nuk rrëshqasim më. Nadjenka e gjorë s’ka më ku t’i dëgjojë ato fjalë, por s’ka as se kush t’ia thotë, për shkak se era nuk dëgjohet më, ndërsa unë gatitem për në Petërburg, gjatë, e ndoshta përgjithmonë.
Se si njëherë, dy ditë para largimit, po rrija një buzëmuzgu në kopsht, ndërsa nga oborri ku banon Nadjenka, kopështi ndahej me një gardh të lartë, të farkuar me gozhdë... Është ende ftohtë, bora ende nuk ka shkrirë, pemët janë të vdekura, por tashmë pranvera

kundërmon dhe, duke sajuar vendet e fjetjes, këlthasin zhurmshëm mëllenjat. I afrohem gardhit dhe shoh për një kohë të gjatë përmes të çarave të tij. Shoh se si Nadjenka del në tremé dhe ngre në qiell vështrimin e saj të brengosur e të pikëlluar... Era pranverore fryn drejt në fytyrën e saj të zbehtë, të trishtuar... Kjo erë i kujton një tjetër erë, e cila na ulërinte atëherë në mal, kur ajo dëgjonte ato katër fjalë, dhe fytyra e saj bëhet e pikëllimtë, e pikëllimtë, nëpër faqe i shket një kokrrith loti... Dhe vajza e gjorë shtrin të dyja duart, mu sikur t'i kërkojë kësaj ere t'ia sjellë rishmi ato fjalë. Dhe unë, duke pritur gjersa të fyjër një shkulm ere, thërras me gjysmë zëri:

– Unë ju dashuroj, Nadja!

O Zoti im, ç'bëhet kështu me Nadjenkën! Ajo bërtet e habitur, buzëqesh me krejt fytyrën dhe ia shtrin krahët erës, e gëzuar e kaq e bukur.

Ndërsa unë shkoj të shtrihem në gjumë...

Kjo ka ngjarë qëmoti. Tani Nadjenka është martuar; e dhanë apo e zgjodhi vetë – pak rëndësi ka; u martua me një sekretar tutele për aristokratët, dhe tani ka tre fëmijë. Por kohën se si shkonim dikur bashkë për të rrëshqitur me sajë dhe se si era i sillte në veshë fjalët "Unë të dashuroj, Nadja!", nuk janë harruar; për të tani ky është kujtimi më i lumtur, më prekës e më i bukur në jetë...

Ndërsa unë edhe tani kur jam bërë më i moshuar, prapë s'e kuptoj, përse ia thoja ato fjalë, përse tallesha...

Anton P. Çehovi

- **Skica letrare** - klasifikohet si lloj më i shkurtër i prozës tregimtare, e cila qëndron midis tregimit dhe shënimit publicistik. Ajo përqendrohet në një episod të vetëm, një tipar personazhi ose një peizazh, duke pasur një vëllim shumë të kufizuar (shpesh vetëm një faqe ose pak rreshta). Ndryshe nga tregimi apo novela, skica nuk ka një zhvillim të gjatë të ngjarjeve apo konflikt të përshkallëzuar; ajo kap vetëm një "shkrepje" të momentit. Funksioni i saj kryesor është përshkrues dhe evokues, duke synuar të krijojë një përshtypje të fortë te lexuesi përmes detajeve kuptimplota. Në letërsinë shqipe, mjeshtrat e kësaj gjinie si Migjeni apo Faik Konica e kanë përdorur skicën për të dhënë goditje të shpejta kritike ose estetike mbi realitetin shoqëror.

MALLI I ATDHEUT

Kur vete njeriu, i lirë e i vetëm, larg atdheut - viset e reja, ndryshimi i zakoneve, ëmbelsia e udhëtimit e një mijë gjëra që vihen re ndër popuj të huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën e të bejnë jo të harosh shqipërinë, po të mos të vejë tek ajo aq dendur mendja. Më tutje, si ngopen sytë së pari ndryshime, gazi shuhet pak nga pak. S'di ç'të mungon, s'di se ç'të duhet. Një hije trishtimi ta mbulon fytyrën; e, pikë së pari herë-herë, mbastaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtimi i prindërve, i miqve e shokëve, kujtimi i dheut ku u lindëm e u rritëm, ku qajtem foshnja e ku lozëm djelm, kujtimi i atyre maleve larg të cilëve nuk rron dot mirë një shqiptar, kujtimi i kombit, që, me gjithë ca të liga që ka, është kombi ynë, e më tepër kujtimi e dëshira e etja e gjuhës sonë ta shtrëngojnë e ta dërrmojne me të vërtetë zemrën. Ah, malli i Shqipërisë, malli i atdheut të dashur, i shenjtë mall e dashuri e shenjtë, kush është ai shqiptar që s'e ka pasur në dhe të huaj! Duhet të jeshë jashtë Shqiperisë, e të jesh larg, për të kuptuar se ç'forcë e ç'bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri! Ajo më e zbrazura letër, ajo fjala më e vogël, na sjell, kur vjen nga Shqipëria, një gaz të parrëfyeshem, se na sjell si një copë të atdheut...

Faik Konica

- **Novela** – njihet si gjini e mesme e prozës tregimtare, duke u pozicionuar saktësisht midis tregimit (më i shkurtër) dhe romanit (më i gjatë). Për dallim nga tregimi që është një "shkrepje" ose një fragment jete, novela ka një zhvillim psikologjik më të thellë të personazhit brenda asaj ngjarjeje të vetme. Novela zakonisht ndërtohet rreth një konflikti apo ngjarjeje të vetme dramatike që shkon drejt një pike kthemi dhe ka një numër të kufizuar personazhesh të cilët nuk përshkruhen në të gjithë kompleksitetin e jetës së tyre (si në roman), por vëzhgohen në raport me situatën specifike ku ndodhen.

STUDENTI NË SHTËPI

Në një ndër qytetet e Evropes së Mesme Nushi po lexon letrën që posa ia kish prumë letërshpërdasi. Edhe në dore të shpërdasit e njofti letrën se ishte nga shtëpia. Po, zarf i bardhë në forme katrore, shtëpia e ulët, me një oborr të vogël me lule shumë. Mandej i ati iu paraftyronte Nushit, mbasi ai e ka shkruem letrën tue hymë n'at shtëpi, në muzg të mbramjes, dhe tue prue natën me vete. Se mbas tij dera u mbyllte, dhe atëthere të hymet e të dalmet ishin jashtëzakonisht të rralla, dhe vetëm kur lajmonte kush ndoj lindje, ndoj vdekje ose vinte ndoj mik i papritun, çka ngjante shum rallë, u prishte kjo ligie patriarkale. Ligjë, edhe çfarë ligje! Kush e shkelte at ligjë, gjith at natë do ta conte në një ndjenjë si me pasë shkelë dicka të ftohte, të rrëshqitshme si gjarpni. E syt e t'et që të përshkojnë me ftoftsi përftojshin tamam një aso ndjenje te Nushi. Si me pasë shkelë gjarpnin. Edhe kjo ishte një arsye për Nushin dhe nuk iu mbushte mendja me u kthye n'atdhe, në shtëpi aq shpejt. Ka ma se tri vjet që ka ardhë n'universitet për studime, e tash një vjet e sa asht tue vendosë jo po shkoj në shtëpi për këto Këshndella, jo për këto Pashkë, por vendimi rrite pa u ba veprim. Çka do të baj atje? - thoshte së fundi Nushi.

Por letra që mori tashti, i jepte afatin e fundit. "Motra jote do të të martohet, edhe një muej, prandej ti, si vllau i saj, duhesh me ardhë medoemos." Ishte urdhni i t'et. Nushit në fillim i erdh disi mirë, u gëzue, por kur u mendue pak, u ftof, ishte në natyrë të tij që githcka m'e marrë me mend e jo me zemër.

* * *

"A mundet me qenë ky oborri që e lash para tri vjetësh", mendonte Nushi. "Kaq i vogël, më bahet se nuk ishte," — dhe shikonte reth e përqark, me pa mos asht ndërtue gja që me ia zanë vendin oborrit. Por jo asgja të re. Po ato pemë: hardhia, fiku, kumbulla; po ato lule. Qe atje drandofillia e pak ma tej lulemustaku. E kur hyni mbrenda në shtëpi, dhomat iu banë shumë të vogla. Mobiliet ndër to si mos me i pasë prekë dora e njeriut. Gjithçka në vendin e përparshëm, si me qenë të destinueme dhe me u kalbë po n'ato vende. Por githçka, githçka disi e zvoglueme. Mezi Nushi gjet shkakun e këtij mashtrimi optik. Shaku ishte te shtëpiat e mdhaja dhe sheshet e hapta të qytetit ku kishte qenë. Po, gjithçka për Nushin ishte zvogluem, vetëm vllaznit e motrat ishin rritë, ishin ma të mdhaj sesa i paraftyronte ai vetë kur i kujtonte

përjashta. Tek e ama i ra në sy se i kishte ramë një dhamb, e i ati kishte fituem do rrudha në ball dhe thija në mustake.— A t'u mbush mendja me ardhë, - i tha i ati kur e pa. Nushi u mallëngjye pak me të pamun t'anë dhe donte këte dhe ta deftojë, por i ati vetëm i shtrini dorën, të cilën Nushi e shtrëngoi pa ditë me u përgjegjë në pyetje. Kur u rrok me motra, këto si me u mendue a ta puthin apo jo. Vetëm puthja e s'amës ishte e kjarte dhe oshtini nëpër shtëpi.
— Mamë, - tue kuvendue një mbramje me Nushin thirri Agia, motra e fejueme, dhe shpëtoi tek e ama në dhomë të zjarrmit. Mamë! Nushi thotë se edhe vajzat sa unë, edhe të martueme bile, shkojnë në shkolle. Ha-ha-ha! u perplas qeshja e vajzës në ftyrë të s'amës. - Mos u qesh ashtu moj bije, se po të ndijnë kojshit... asht marre. Vajza nuk përgjegji, por, e zanun me tregimet e vilaut, mendonte ato vende të çuditshme, ku vajzat nuk lidhen për shtëpi, ku dalin me djelm me shetitë pa fare turpit, ku kërcejnë... ah! kërcejnë aq bukur.
— Nush! - bërtet vajza nga dhoma e zjarrmit, - a po më mëson me kërcye? Një shoqe e eme ma plasi zemrën, tue m'u lavdue se din me kërcy... (Ah, kur të më mësoje mue Nushi, tash ia kallzoj qejfin - mendonte me vetë tue fshi një çini). Vllau muer motrën dhe filloi t'i kallzojë do regulla, por ashtu në grykë të shogi- shoqit dhe tue kërcye, i gjeti i ati.
— S'ke marre! Nesër do të martohesh!.. Edhe ti, - tue iu sjell Nushit, - s'je i vogël. Shyqyr që paske ardhë sonte herët! - tha i ati i vranët.
Motra iku në dhomë të zjarrmit e Nushi tha se u mërzit.
— Po, në shtëpinë tande me u merzitë? Jo, kjo mue s'më ka ndodhë kurr. Prandaj mezi dhe që erdhe një herë.
Nushi nuk dinte ç'ka me thanë. Nuk dinte me folë me t'anë. Kur ishte fëmi, e kuptonte shumë ma mirë. Por kaloi ajo kohë, kur n'imaginatë të tij baba ishte dicka ma tepër se babë, ishte një ideal, ideal i andrrimeve fëminore. E sot, e din Nushi, se baba i tij asht një prej qindra - në mos dhe mija - etnish të qytetit tonë, njeni prej atyne etenve që nga fmia i vet duhen me bamë një njeri anakronik, pikturën e vet, trashigimtarin e dej të një të kalueme te gjymte.
— Të kane pamë tue shëtitë me do djelm që nuk janë të fesë sonë...
— Po ata jane shokët e mi...
— Hë... shoket e tu... S'paske muejtë me gjetë shokë ma të mirë. Po, apo ke pak, more, shoke të fesë sonë?
— Po, kur u gjeta në mes të tyne unë nuk munda t'u iki, more babë. Mirë pra, sot e tej do të shëtis me ata që më thue, - vendosi Nushi t'i leshojë pe babës tue ia bamë qejfin.
— Hë, ashtu une due. Ndëgjo ti babën, dhe nuk do pendohesh. Ti duhesh me pasë një shoqni prej së ciles do mësojsh ndoj gja. Po prej asaj shoqnie, të cilën pate sot, çka mundesh me mësue? Ata, t'asaj feje, sado shkollë me ba, prapseprapë njerëz nuk bahen. Ndëgjo ti babën...

E Nushi ndëgjon. Don me qenë djal i mirë. Si mos me ndëgjue babën i cili e lindi, e rriti dhe e bani kaq! Pale mos ndëgjo. Megjithëse kundra ndërgjegjes së vet, Nushi ndëgjon. Nga fjalët e t'et i shtrembnohet fytyra, por me ndëgjue - ndëgjon. Ndëgjojnë edhe vllaznit e motrat, të cilët kanë



ndejun përreth edhe të gjithë janë bamë vesh. Pale mos ndëgjo. Ndëgjon dhe nana në dhomë të zjarrmit fjalët e burrit të vet dhe me një frigë çuditet për ditunin e madhe të bashkëshortit. Tanë një familje, e mbyllun mbrenda mureve të shtëpis dhe mbrenda një ambienti patriarkal, përgatitet për jetën qytetare të nesërme. "Mos të më korisin, - mendon kryetari i familjes, tue i shikue me rend të gjith pjestarët. Mos të më korisin, prandaj shtrëngo frenat, shtrëngo sa të mundësh, e nse nuk mund të marrin frymë - të pëlcasin. Sa vështirë asht me rritë fëmi në koh të sotme! Sa vështirë ashe me i ruejte varzat! Eh, Kohët e kalueme! — Por a e dini ju, more fëmi, se une njaq sa ju isha, kur fillova me fitue bukën... Edhe qe, ka dasht zoti, edhe ju me pasë mjaft, sa me ju plasë planci...

Nushi ndëgjon. Te gjithë ndëgjojnë. Pale e mos ndëgjo! Nushi ndëgjon dhe mendon. Ndoshta jeta e ka bamë këtë njeri kaq të rrepte.

Një buzëmbramje Nushin na e kish zane nostalgjia për viset e largta, për qytetin e studimeve të tij. Ai e don ket votër, ma mirë me thanë këto gjind reth votrës: prindët, motrat e vllaznit, por diçka si ma e fortë e lidh edhe për ato vise. Ato vise ku jeta impulsive të lejon ta shijosh dhe si i ri dhe si plak, si filozof ose si njeri i thjeshtë. Nushi vëren kontrastin e tmerrshëm në mes të vendit të vet dhe t'atyne viseve. Dhe si i ri që asht, ndjenjat e tij mnjanojnë për mrekullinat e largëta, e në mendime gjyrmon shkaqet pse vendi i tij asht aq mbrapa. Dhe njato shkage, me gith zjarrmin e rinis, i urren. Urren të kaluemen që asht aq e afërme, si baba i tij. Baba asht i afërm, si babë, por i largët si perfaqësues i shoqnis, si person. E gjith mosmarrveshja, të gjitha moskuptimet vijnë ngaqë të gjith kemi nëpër shtepia, nëpër votra, ka një ose ma tepër të këtille të dashtun dhe t'urrejtun përnjëherësh. Çashtja me ta qëndron si çashtja e një operacioni: ose ta presish kambën dhe të rrosh, ose mos ta presish kambën dhe të vdesish. Kush ka pasë fat me iu smund ashtu kamba, njat të dalun ka. Nushi e din që edhe baba i tij s'ka faj se asht i tillë; rethanat dhe shoqnia e krijuen. Prandaj dhe ka mbetun dashunia birnore në Nushin, pse din t'arsyetojë. Por vllaznit e tij, motrat, a thue do ta dojnë babën? Kujtohet se kur ishte fëmi, kundrejt babës ma parë ndiente frigë se dashuni. E tash motrat dridhen para babës, e vllaznit nuk e kand aspak në qejf shoqnin e babës; kur ven baba, ata zhduken.

— Çka kishe bamë, ti Nush, në këtë koh me qen përjashta? - ia preu mendimet Agia, tue hymë në dhomë, plot gjallni.

— Tash asht koha e shëtis, do të kishe shetitë me ndoj shok ose...

— Ose me ndoj shoqe, ha-ha-ha - ia priti motra tue u qeshë.

— Po, pse jo... Njësoj, si me shok si me shoqe. Këtu te na përmbyset bota me ba m'u pa një vajze me një djale. Atje as i bie në sy kujt. Gjithkush shikon punën e vet.

Dhe vllau shfrente nostalgjinë e viseve të largëta tue i tregue motrës bukurinat e atjeshme dhe mnyrën e jetesës. I dëftonte ndoj ngjarje me randsi që ka ngjajtë në shoqni, ndoj skandal të vogël. E Agia ndëgjonte dhe kuptonte shumë mirë. Ndërhynte me pyetje, ftyra ndrronte simbas tregimit të vllaut e klithmat e çudis i dilnin nga fyti, pa i kuptue ajo vetë. Pse Nushi flitte me gjith dëshirë që ta kuptojë motra. Po, ta kuptojë motra, e nuk dinte ai se fjalët e tij dalkadalë

përftojshin të motra një anderr, e cila mbasi nuk mund të jetohet me të vërtetë, krijon një kënaqësi që i mundon shpirtat e ri. E kur motra shante: “Eh, kot kemi le”, e cila fshamë dëgjohet përherë ma shpesh në vendin tonë, Nushi pushonte me fjalë dhe mendonte se si motra e tij asht fejue dhe shpejt do martohet për një burracak.Nushi për motrën ma të madhe, e cila me vjet iu avitte, ndiente një dashuni të pasun me kujtime fminore. Gjithmon bashke. Ndër mbramje të dimnit, kur u duhej me ra me fjetë, tue mberdhitë nga çarçafi i ftoftë i dyshekut, iu avitshin shoqi-shoqit. Përputheshin trup për trup dhe ndëgjojshin të rrektunat e zemrave të shoqi-shogit. E kur në përshpritjen e ndoj prrallës së gjatë trupnat e tyne u nxejshin mjaft, atëherë ndjejshin pranin e një gjas së tretë, të huej, deri atëhere të panjoftun për trupnat e tyne, por që tash, në nxehtësin e dyshekut, ngjallej, rritej dhe i perkundte në gjumë t’ambël. Kur vinte e ama e i shifte ashtu të rrokun e në gjumë, kënaqej, por edhe një zili e vogël, mezi e vrejtun, ia turbullonte kenaqsin për një çast. Q’atëhere Nushi e njef mirë të motrën e vet. Edhe tash motra e tij asht po ajo Age që ishte dikur. E gjallë, gazmore, jo romantike sa shoqet e saj, as andrruese. Për romantikë s’kish nge, nuk e linte puna të cilen e bante krahas me nanën, tue la, fshi dhe ndreqë orë e çast gjysmë duzinet fëmi, që u kish falë zoti nanës e babës, si thohet te na. Ku kish nge Agia të merret me romantikë dhe me andrue. E dinte Nushi këtë, si dinte dhe se motra e tij asht dhe mjaft e bukur. Por nuk e dinte - e kishte dëshirë me e ditë - si i vjen motres kjo martesë, martesa me një burracak. Nushi kish folë dy-tri herë me dhandrin e ri. I kish mbetë në kujtesë nga njato pjekje vetëm buzëqeshja banale e një fëtyrës së frytë e të zbetë, belbëzim i një bisedës ma banale nëpër dhambë të prishun dhe majmunizma e një snobit. Qe dhandri, miku i tij. Asht i shtëpis së mirë dhe tregtar i zoti, ka than baba. Dhe njato fjalë kanë qenë të mjafta para të shoqes; nenesre puna ka qenë e kryeme. E Agia? Agia asht vajze e mirë, e urtë, ndëgjon prindët, njajo gja nënkuptohet. Kur e pa të fejuemin, pak ne dhomë a ma tepër nëpër birat e dyerve, u zbe pak, por njaj të zbem ishte ndoshta një emocionim e asgja tjetër. “Pak i shkurt - i tha një teze - por ka pare mjaft. E lumja ti!” Ages i ngjante shumë e dyshimte njajo lumni, dhe q’atherë rrinte disi si e tretun. Vetëm me t’ardhmen e Nushit u gjallnue dhe qeshja e saj nisi të ndëgjohet nëpër shtëpi. E Nushi nuk e dinte si po i vjen Ages kjo martesë. Një natë i ati përmendi martesën, e moter e vlla u shikuen më një çast. Agia u çue, shkoi në dhomë të zjarrmit, e Nushi, ndërsa i ati fliste, rrinte pa bëzajtë dhe mendonte për motrën, e cila e shikoi me një shikim aq të mpitë, pa shprehje, saqë Nushi e kuptoi. Kupton Nushi shum prej një shikimi, se kjo mnyrë të marrunit vesht përdoret shume nëpër familje tona, ku shpeshherë nuk ke të drejtë me folë.

Në nesre Nushi u kthye jo mbas zakonit për të marrë një libër. “Në shtëpi nuk qenka kush” — mendoi. Kur në dhomë e gjet Agen, e cila u mundonte ta mfshehi ftyren, Nushi iu avit.

— Ç’ka ke, Age? Pse i ke syt e kuqun?

— Prej tymit.

Nushi dyshoi dhe shkoi në dhomë të zjarrmit, por, aty as nuk kishte zjarrm.

— Pse ke qa, Age?

— Nuk kam qa - thotë motra tue u mundue me buzëqeshe.

— Po, po, ke qa.

— Jo besa! - dhe u largue kinse me punë.

Nushi u mundue ashtu prej së largu, tue qeshë, të diktojë ndoj gja, por si shkoi për dore. Tue dale prej shtëpie, u kujtue pse qan Agia; i ra në mend dhe shikimi i saj i mbramshëm. Desht të kethehet, por e dinte se Agia nga turpi nuk do t'i tregojë gja, as nuk do t'i pohojë.
Turpi, e sidomos turpi i vajzave të fejueme, asht një hallkë ma tepër në zinxhirin që shtrëngon jetën. E si mos me pasë turp vajza e fejueme, kurse e din se te burri shkon vetem të daje dyshekun me të. Gja tjetër ku të dije ajo kur nuk e njef, një fjalë s'e ka folë me mashkullin që do të marri. Turp. E si mos t'i vijë turp. Thonë se varzat pa nder janë pa turp. Prandaj duhet turpi, turpi që s'të len me ngritë zanin në mbrojtjen e vetvetes prej atyne që të dëshrojnë shumë lumtuni. "Nuk e due!" Jo, deri tash nuk asht ndëgjue në farefisin tonë ajo fjalë nga një vajze e fejueme. Se secili burrë, çfarëdo qofte, s'paku mashkull asht. E me ba mos me qene mashkull?
Nushi vendosi t'ia tregojë babës mospëlqimin e vet për martesën e Ages. Torturonte veten: jo tash po i tham, jo mbasandej, jo tash nuk asht koha. Derisa një mbramje i ati u tregue mjaft i butë dhe i dhanun për bisedë. Nushi ia tha disi mospëlqimin e vet për martesën e Ages.
— Por për ke mendon ti me e dhanë? More, ku e kane at fat dhe motrat tueja tjera. Ai i shtëpis së mire po, i pasun po, djal puntor sa s'ka, s'e ka shoqin në pazar.
— Po, more babë, por sot varzat këqyrin djalin ma parë se të gjitha.
— Po kush e pyet ate? Çka din ajo?
— Ajo nuk asht e kënaqun.
— Eh, së parit njashtu i bahet, por mbasandej ka për t'i hymë në qejf.
"Qe e tan puna që munda unë të baj për Agen" - mendonte Nushi - e në zemër ndiente si helmim ngase nuk mund t'i ndihmonte motres. Bjerri besimin në vete. "Qe një rasë ku duhet me tregue fuqin e ndërgjegjes, të mendimit dhe të dashnis për me shpëtue dicka nga zakonet fatale. Por, kush të len! Ajri me mija zura, ku të len të jetosh një jetë të shndoshtë. Me kot u betove në vetvete për kontributin e vet në shoqni, për gjestet ideale! Qe një provë ku psove dështimin".
Nga të tilla mendime u grinte në dyshek Nushi gjith at natë deri n'agim, kur e zu gjumi. Agia nuk e pyette ma të vllanë për mrekullit e viseve të largëta. E interesonte burracaku i saj. E interesonte dhe tue mendue githnjë mbi të, ai dilte n'imagjinatë gjithnjë ma i keq. "Si një tatalosh" - i ka mrri Ages në vesh nga biseda e dy shoqeve. Një kundërshtim të parrfyeshëm ndien atëbote Agia. Dhe njaj kundërshtim shfrehej tashti në sjelljen e saj kundra vllazënve, motrave dhe s'amës kanjiherë. Si me pritë rasën, dhe ajo ishte gati me u kuq nga zemrimi, me i ra filxhani ose me thye dicka, sì ndoj çini, gotë ose gjë tjetër që kishte në dorë. Kur e ama i bërtitte për gjanë e thyeme, ajo u përgjigite ashpër me një: nuk deshta as un ta thej; mandej shkonte, u mshehte në ndoj skutiliq dhe qante.
As Nushi nuk tregonte ma mrekullitë e viseve të largëta. Në shtëpi qëndronte vetëm kohën e domosdoshme. I ati e qortonte gjithnjë pse vinte vonë në mbramje, por ai s'u përgjegjte dhe njashtu merrte fund leksioni. Kur aty-këtu shifte përgatitjet që baheshin për darsëm, atij iu kujtonte një film që kish pa dikur. Quhej "Ekstazë". Ishte film i një martese të papërshtatshme.

* * *

— Mos të koritena - ka thanë i ati. - Duhet gjithçka boll për darsëm. Të giitha, të gjitha duhet me



përgatitë. Rueju mos të harrojsh gja! - i ka thanë burri të shoqes. Dhe darsma ka dale shum e mirë. Ka plase delli i qejfit në te. Venë e raki, si aty ma. Darsmat janë të ralla, prandaj qejf, qejf me ba. Për shndet të nuses që na ka dalë aq e bukur! Për shndet të zotit të shtpis! Edhe shum të tjera kësi përshendetjesh, tue përplase gotat e tue i derdhe në fyt, nga i cili mandej dilte një kangë si kanga nga qerrja e palyeme. Megjithse këta po i lyejnë fytat shum mirë. Gratë, n'an të vet, tash këndojn kangen e japrakut, tash flasin të githa përnjëherësh, tue ndëgjue secila vetëm fjalët e veta, tash qeshen si-ki-ki, ka-ka-ka. Nepër qoshe fëmite, secili tue hangër ka dicka, shikojnë dhe çuditen për nanat e veta, se si kanë pamë kurr në gjendje aq të zjarrtë.

— Pse martohet Agia? - pyet një shok vllain e vogël shtatëvjeçar t'Ages.

— Baba ka thanë - pergjigjet ky.

— Sa i marre je... Uf... E di, more, se ka thane baba, por pse martooohet?

— Po edhe nana e eme asht martue, edhe nana jote.

— Po, more, po! Uf... Por pse martoooohet?

— Për me fjetë me burrin - ia pret një shok i tretë, pak ma i rritshëm, nja nand vjeç.

— Po si... Ku e din ti? - thot i vllau i Agës.

— Po, fort! Edhe nana e eme flen me babën tem - ia priti shoku i kureshtshëm.

— Mos folni fjalë te këqia, se po ju padis në shkollë, - iu kërcue nandëvjeçari dhe shkoi me gjuejtë ndoj gja për me ambëlsue gojën.

E Nushi, për gith kohën e darsmës ndiente një të velun. Me vjellë diçka... M'at shishmashin e darsmës nuk dinte të rregullohej. Jo këtu lypej të ndihmonte në ndoj punë, jo atje me rregullue miqët. Me disa prej kushrinave të cilat nuk i kishte pamë fare, iu donte të ndalej, të përshëndetej, të bisedojë, t'u deftojë nobarem si e ka çuem përjashta. Kushrinat ma të moçme e shikojshin me kureshte të madhe tue urue marshalla, marshalla, e kushrinat e reja tue bisedue me të, i zbardhshin dhambët dhe e admirojshin prej majës së kepucve deri të kaçurreli i flokve. E Nushit i vinte të vjellë. Matej shum herë me u përzi m'at shishmash të dasmës, të pije me miq, të kendojë valle me gra; por i dukej vetja qesharake. Nuk i shkonte për dore as me u përgjege urimeve që ia bajshin gratë, kur rasësisht vinte n'odë të nuses. E Agia qëndronte drejt, si qiri dhe e zbetë. "Ha, ma ti, mos u marro aq", i thojshin gratë tue ia ndreqë velin. E Nushi me gjith zemër deshironte të kryhej kjo ceremoni. Të shkoje Agia atje ku e caktoi fati dhe ma tepër ku dëshroi i ati. Ndoshta ka me i hymë në qejf, si tha i ati, mendonte Nushi.

— Jooo, kam pa e s'kam pa nuse tue qa kur martohet, por si kjo sot... s'kam pa - thoshte një grue mbasi erdhën krushqit dhe e morën Agen.

— Epo e shkreta ka të drejtë, la prindët, vllazënt, motrat.

— Moj, unë ndëgjova se Agia s'e ka dashtë djalin - pëshpriti një grue e tretë, tue u mnjanue ka shoqet.

— Jo, he qe! Po kë me dashtë ajo ma të mire? Djali, thone, se asht i pasun mjaft, mandej edhe prej shtpis se mire...

— Po... po...

— Ndoshta ta ka thane filania që u mundue mjaft me ia dhanë djalit vajzën e saj...

— Jo, besa! Edhe unë kam ndie se Agia s'e ka dashtë djalin, - hyni në bisedë një e katërt që s'mund të duronte të mos marri pjesë në këto pështpëritje enigmatike e që gjithnjë shikonte kah dera.
Çudi! Ma shum qau kur u nda me vllanë. I shkreti Nush! Edhe atij i shpëtuen lotet.
— Besa! Me tamam shifet se e kanë martue me përdhuni...
— Uuu! Punë e madhe! Po cila prej nesh asht martue pa përdhuni? Ku i kemi njoftë na burrat tonë? Na kanë martue për atë i cili na ka lypë ma parë. Edhe magjypi të na kishte lypë, magjypit na kishin dhanë. Njai asht fati! - tha tue u nxe një grue me ftyrë burri.
— Me dhimbet Agia e shkretë. Asht vajze e mirë - tha ma e reja.
— Po na paskemi qenë të këqija, a? - tha dhe i lëshoi synin e rreptë ndër ftyrat e shoqeve grueja me ftyrë burri.
Dy ditë mbas darsmës, Nushi shkoi në shtepi t'Ages, me u falë me të, se do të nisej përjashta. Kur i tha motrës po nisem, kesaj i filluen lotët me i rrjedhë dhe nuk i pushuen derisa u ndanë, ndoshta as mbasandej. E te dera e oborrit motra e perqafoi të vllanë aq me fuqi dhe i dha një të puthun aq të nxeht e të kjartë, saqe Nushi kurr s'e harroi.
Nderi i shoqnis asht i pacënueshëm. I mjeri ai i cili provon ta cenoje. Së paku, kështu ngjan për faqe. Mos të gërdhishtet, mos të prishet lustra e shoqnis së qytetit tonë. Të shkëlqejë lustra e marrëdhanieve tona të përditshme me shoqi-shoqin, të shkëlqejë si këpuca e lustrueme në baltë. E pse një grue, tue fjetë me burrin e vet plak ose idiot, vuen dhe mendon ndoj tjetër, s'ka gja. E pse një grue, pranë burrit të pamasskulli, merr mshehtas një tjetër që ta përkëdheli, prap s'ka gja. Njësoj. S'ka randsi. Jeta bashkëshortore njësoj asht e hyjnueshme. Këtë e ka vërtetue instituti fetar. Vetem dicka: skandali nuk durohet. Bani çmos që të mos shkaktoni skandal. Se skandali shkakton vdekjen e nderit, si për shembull grada 42 e temperaturës vdekjen e njeriut. Shoqnia lëngon, lëngon me temperatura të ndryshme, por këqyrni mos t'arrini gradën e fundit, po desht të jetoni me nder, me moral të pacënueshem. Në pazarin e qytetit tonë, kur duen të lëvdojne ndoj të ri, i apin atribute të ndryshme, si dhe ngjet gjithkund; ndër ato atribute ma tipike janë: bir... dhe zog dreqit. Ai shegert pazari, i cili ka fatin ta përkëdhelin gashtu, domethanë se asht dicka. Jo se do të bahet milionar, por se asht i zoti t'i kryejë punët e shegertllëkut ma së miri dhe me pëlqim të plotë të zotnis. Një prej kësi shegertave ishte dhe Luli, shegerti i të shoqit t'Ages. Zog dreqit i madh asht! Mos t'ishte ai, kurr zotnia i tij nuk kish arrijtë me e përhapë tregtin kaq sa e ka sot. Kështu mendojshin esnafët e pazarit. Ndër mendime shkojshin edhe ma larg: secili mendonte ta tërheqi Lulin për vete, por u shkonte mundi kot. Luli, edhe se i ri, njëzet vjeç, nuk lote nga zotnia i tij, prej të cilit as nuk kishte gja t'ankohej.
Kur Luli e pa të shoqen, zojën e zotnis së tij së parit, si nuse, u çudit për bukurin e saj dhe sidomos u çudit për shëmtimin e burrit të saj e të zotnis së tij. Deri në darsëm, ai e shikonte zotnin vetëm si zotnin e tij, të zotin e dyqanit, i cili ia pagonte rrogën regullisht dhe mirë. Luli disi nuk e mendonte, nuk mund t'ia paraftyronte vetes se zotnia i tij mundet me qenë dhe burr' i një grueje, sidomos burr' i një grueje si Agia. Në ndërgjegie të Lulit ishte formue një giykim për zotnin: i zoti të rrijë mbas banakut dhe të shikojë se si ai vete, shegert i tij, u



peshon, merr paret, ia bien atij zotnis, i cili i ve në banak, tue buzëqeshe me gojë pa dhanë në ndoj isharet të tij, të shegertit. Prej zotnis Luli nuk ndiente ndoj frigë, ose ndiente aq frigë, saqë e ndien një shok prej shoku tjeter me vjet ma i madh. Por tashti, me martesë të zotnis, i cili muer një grue aq të bukur, në thellsin e shpiti Luli njeu një pakënaqsi, por krejt të pandërgjegjshme. Kjo pakënasi me kohë, aty-këtu, u shfaqte në një mnijë, e cila ishte ma tepër
një smirë. Luli nuk dinte t'analizojë gjendien shpirtnore të vetën, se ishte një shegert pazarit, por instinki i thjeshtë njerzuer ndjente dhe shfaqej. Ai tatalosh, çfar vajzet me marrë - i tha Lulit një shok intim, shegert pazarit. Lulit iu theksuen këto fjalë në mendje. Shoku i tha, tue qeshe dhe tue e shtye me krah, edhe disa gjana tjera, të cilat prap Luli i mbajti në mend, iu ngjitën për truni.

* * *

Mbas tri vjetve tjera Nushi u kthye në shtëpi si mjek i kryem. Optimizmi, i cili e pushtoi me të marrmen e laurës si mediciner i kryem, githnjë vazhdonte edhe kur erdhi në shtëpi. Bota reth tij, miqët, kushërinët, të njoftunit iu silleshin rrotull si hyjt reth diellit; ai ishte një epicentër. Së paku, kështu iu dukte atij vetë. Por, njashtu ishte në të vërtet. Nushi e shifte edhe vetë, se njajo gja ishte ma se e vërtete. E pse? pyetej Nushi në vetvete. Po tash njëherë s'kish nge t'i api përgjegje asaj pyetje. Jo urimet, jo vizitat, jo darkat e drekat, jo shoqnia e re, natyrisht e zgjedhun, nuk e lejshin t'i pergjigjet pyetjes: pse asht ai epicentër.
Edhe në shtëpi Nushi, si mjek i kryem, u ndiente disi ndryshe. Edhe vllaznit e motrat, në praninë e tij, qëndrojshin ndryshe. Fjala mjek lëshon një ere barnash, të cilët ta shtijnë frigën e smundjes, prandej motrat dhe vllaznit e shikojshin dhe e dojshin Nushin ma shum me një dashni admiruese se vllaznore. E i ati kish ndrrue tonin e bisedës; e kish ulë për nja dy nota. Përpara fliste në sol e tash në re. I ra në sy Nushit se sjellja e babës përpara tij përgjithësisht kish ndryshue. Kur vinte në mbramje vonë në shtëpi, baba nuk i thoshte gja; perkundra, ia niste bisedës tue e pyetë me kë asht pa ditën dhe me kë qe deri tashti. E të githa pyetjet nuk kishin as idhnim, as ndoj tallje ironike, por i thoshte me një za si të dezinteresuem. Fillonte mandej biseda për punë, të cilen Nushi dita me dite pritte ta fillojë.
— Asht edhe koha me pasë edhe une ndihmën tande, se ka fillue me më lanë puna. Deri tash shkova disi, por mbas tashit keq, besa. Por shyqyr që kreve ti at shkollë. Motrat po të rriten, duhet me mendue edhe për to.
Nushi e thith cigaren, shikon si shkon tymi i saj dhe nëpër tym shikon t'anë, i cili flet ambël, sidomos kur flet për punën e tij që do ta fillojë si mjek. E kur i sillet ndokuj pjestarit tjetër të familjes, natyrisht toni i bisedës ndrron, fillon të bahet nga pak i vrazhdë.
Nushi, natyrisht si mjek, ishte dhe nga pak psikolog. Vërente me kujdes të madh sjelljen e babës kundrejt tij dhe kundrejt të tjerve të shtepis. E një mendim i ri, si stuhi, ia pushtonte trutë dhe ia perplaste andej. Ai ma vonë tundte kryet, si me dashtë me e largue at mendim. Ishte mendimi se edhe i ashtuquejtuni ideali familjar asht i mpshtetun n'interes. Nushi mendoi pikerisht si kishte lexuem diku, në një libër. Dhe njashtu asht. Baba i tij ka ndrrue sjelljen kundrejt tij, pse Nushi ka me fillue shpejt me fitue të holla. Dikush ka me thanë: po, asht e natyrshme, që i ati të prese ndihmen e të birit, se duhet mbajtë familja, të cilen ai vete, i ati, nuk mund ta mbajë. Po, por

Nushi arsyetonte në vetvete pak ma ekstremisht, pak ma n'e majtas, - si kishte për t'u thanë në gjuhe të soçme. Pse i ati i tij deri para tri vjetve ishte para tij, Nushit, djal i pjekun, një despot e tash do me u bamë jo bash një engjëll, por një mik, shok i dorës se parë? Para tri vjetve ti s'ke pasë të drejtë me çue zanin, se s'ishe gja fare, mbasi nuk mujshe me fitue të holla; por sot, mbasi rroga e jote do të jete e majme, unë të salutoj, ta heq kapelen, fesin e zi (se njate barte baba).
Kështu në trajtë dialogu, arsyetonte Nushi, megjithse nuk e kishte në qejf at arsyetim. Nuk kishte qejf t'anojë kaq shum n'an të doktrinave të reja materialiste dhe t'u api kaq të drejtë: si, për shembull, me thanë se nuk ekziston familje ideale dhe as dashuninat, të cilat i quejmë në ma të sinqerta, jane vetëm korrespondim i përshtatshëm i interesave materiale ose fizike. Nushi tundte kryet, donte ta largojë këtë mendim, ide që përmbys shqimit të githa ato gjana që na i quejmë të shenjta se i mbështjellim me velin e misterit. Dhe si njeriu, që, tue u mbytë kapet për një krande për të shpëtuem, ashtu dhe Nushi donte të kapet për një mister. Por falimenti dogmatiko-shpirtnuer i tij qëndronte bash aty, se ai shifte se misteri - si dhe nje krandë të mbytunin - nuk mund ta shpëtojë; asht vetëm një mashtrim, natyrisht i pranuem si pranojmë edhe shum mashtrime tjera, se na kande, na pëlqejnë, megithëse e dimë mirfilli se nuk janë të verteta.
Për tri vjet jetë në martesë, pau Nushi se Agia kish ndryshue mjaft. Fëmi deri tash nuk kishte pasë, por tash ishte nga mesi i trupt si e majun dhe iu dukte si t'ishte shtatzanë. I kuqi në ftyrë t'Ages nuk u dukte i qëndrueshëm, e syt që dikur aq drejt në sy te shikojshin, tash nguleshin diku n'anë, pranë teje, dhe vetëm si përshqit kanjëherë të shikojshin për të ba me ditë se flet me ty ose asht tue ndëgjue bisedën e jote. Nushin e çuditi ajo gja, tue ditë se motrat e martueme zakonisht janë ma të çeluna dhe ma të singerta kundrejt vllaznve. Dhe kur doli nga shtëpia e saj, nuk doli disi i kënaqun dhe i dukej se nuk asht pamë me motrën Age. "Ndoshta topitet" - tha Nushi në vetvete. Në mbramje t'asaj dite, Nushi tha në shtëpi se kish qenë të Agia dhe se kish ndryshue mjaft. Mbas ketyne fjalve të Nushit, i ati shikoi të shoqen dhe tha:
— Ai gomar, burr i saj, a pret të shkoj t'i them unë që ta heqi at'shërbtuer?!..
— Po nuk mundet me shikue punën pa të. Ti e din edhe vetë se sa i shkathët asht Luli, - iu përgjigj e shoqja me za të letë e me bisht synit shikoi të birin, Nushin.
— Nobarem, mos ta dërgojë diten në shtpi prej pazarit, kur asht Agia vetëm.
— Kur atij, burrit të saj, s'i vjen keq, çka po ke ti?
— Ti, si shifet, s'i ke mend në kry! A s'po ndëgjon se cka flet bota, a? - tha baba tue çue zanin dhe shikoi Nushin.
Nushi nuk bani za fare, por i ndëgjoi këto fjalë gati pa marrë frymë. Gjaku pak iu turbullue e i rodhi në ftyre. Por shpejt u fashit dhe nisi të bluejë me mend ato fjalë që i kembyen prindët në mes tyne.
E në shpi t'Ages sundon harmonia e plotë. Kushdo që thotë se aty ka shamat, grindje ose dicka tjetër - dajak si thonë - rren, kushdo që ta thotë rren. Aty mbretnon harmonia e plotë. Qe për shembull: burri vjen nga pazari, prej pune, në mbramje, e Agia ban çmos që ai ta giejë shtëpin sa

ma komode, për tu shplodhë nga puna e ditës; mandej e pyesin shoqi-shoqin si e kaluen ditën a u mërziten, çka ka të re. Agia të gjitha këto komplimente familjare i bante disi ftoftë, por singerisht. E burri, në përkëdheljet e ndjenjave, shkonte edhe ma larg; iu avitte Ages, kapte për faqe me dy gishta, me ere të dhjamit dhe ashtu si kapen fëmitë e vegjël, ia ledhatonte flokët, ose qafën, e shikonte me sy admirues reth mesit dhe, i kënaqun me lumnin familjare, ndezte cigaren, çonte gotën e rakis dhe ia niste bisedës së përditshme. Agia u sillte poshtë e nalt nëpër dhomën e zjarrmit tue bame punë, ndëgjonte fjalët e burrit dhe u përgjigjte aty ku duhej.

— At'i prue Luli të gjitha qe ke pase nevojë? - pyet burri tue çue gotën e rakis.

— Po, - i pergjegjet Agia shkurt, - por ke harrue me i dhanë byberin, - vazhdon tue u kuqë lehtë në ftyre dhe sjell kryet n'anë tjeter.

— A të ka prue këte e këtë e atë... - e kur i thote Agia se po, ai vazhdon: "Jo, Luli s'ka hile, askund deri tash nuk munda ta za për kaq" - dhe dëfton me gisht. Dhe në banak të dyqanit, ma shum i besoj atij se vetvetes, se asht dhe i shkathtë, dreqi. Sa vetë mundohen me e largue prej meje, për ta marrë për vete, tue qitë gjithfarë fjalësh...

Ages ndër këto fjale iu kuqen tamthat, zemra i trokiti shpejt dhe si me t'egër i tha:

— Po ti pse e dërgon Lulin ditën? Ato sende që duhen mundesh me i prue ti vetë në mbramje...

— Po për drekë mishin, ku me e marrë?.. Mandej pse mos me ardhë, xhanëm, Luli? Bota me të vertete flet, por unë e dij pse flet... Edhe Agia mendon me vete pse mos me ardhë në shtëpi ditën, ku asht ajo vetëm... atëherë bash duhet të vije, i thotë një ndjesijë, diku thellë e mfshehun, nga e cila Ages, zojës së ndershme të filanit e të filanit, i vjen ndoht. Por ndjesia e mfshehun ia pushton trupin e ri dhe ajo i thotë burrit:

— Mos harro me ma cue nesër byberin edhe... - mendohet të gjeje edhe diçka tjeter.

— Po, tash ta çoj edhe mish të mirë, më tha kasapi se do të prejnë nesër. Te tjerat i ke?

— Po...

* * *

Mbasi Nushi trokiti dy-tri herë në derë t'oborrit dhe pa se s'po i del kush, ai u nis vetë mbrenda në shtëpi, tue u çuditë pse s'po del Agia. Kur ndër shkallë ndeshi Lulin, i cili, disi i hutuem për së tepri, fliste diçka si me kërkue të fala për vonesë që s'i dulën përpara. Nushi u çudit së pari, tue mendue se ka ngjajtë gja, por njat çast i lindi befas një dyshim. Disi si i ngurruem, por instinktivisht shkoi nalt me hapa te shpejta. Agen e gjet me shpinë të sjellun derës, me një dorë ndë flokë e me tjetrën tue perzie makinalisht diçka në një enë. Kur u suell, pa Nushin dhe u buzëqesh, nsa në ftyre ishte e zbeme.

— Çka ke, Age? - e pyeti Nushi tue ia marrë dorën.

— Asgja, Nush. Pse? - pyeti si e hutueme.

— Je diçka si e zbetë.

— Ah, po, me dhemb kryet. Jo, parë me dhimbte, tash nuk më dhemb, - u ngatrronte Agia në gjuhë e në ftyrë ndrronte ngjyrë nën shikimin depërtues të vllaut. Shuplaka e friges nisi t'ia shterngojë zemen, gjujt iu këputen dhe qe tue ranë, mos t'ishte dora e Nushit për ta mbajtun.



— Ti Age, tash nuk duhesh me punue shum - tha Nushi tue sjell kryet nga dritorja dhe tue u mundue me e zbutë zanin. Motra u mundonte tinzisht me i pa ftyrën vllaut, me lexue në ftyrë të tij, por ai, sjellë nga dritorja, shikonte në rrugë e ajo ia shifte vetëm veshin dhe pjesën e nofullës, të cilën Nushi e kish shtërngue fort.
— Ashtu, Age, - tue u sjellë befas, — mos puno shum; sa ma pak punë, se asht ma mirë për ty, nuk të vjen kjo ligshti trupi që pate parë dhe mandej për barrën nuk asht mirë me punue shum.
Agia e shikoi të vllan drejt në sy dhe kuptoi se ai nuk mendonte asgja tjetër veç asaj q'i tha, nsa Nushi u gëzue kur pa se i kish shkue për dore me e genjye motrën, se ai nuk dyshon asgja ndër marrdhaniet e saj me Lulin. Mbasandej; Nushi filloi të flasi mbi gjanat e përditshme, tue pyet motrën për këtë dhe atë me gaz dhe tue u tregue në qejf, dhe e motra e pyette për baben, nanën, vllaznit e motrat, giithnjë tue u qeshë.
Nushi doli nga e motra me një buzëqeshje. Edhe, për çudi, ishte në qejf. Edhe ai vete u çuditte për këtë gëzim dhe qetsi që ndiente. Tashti pra, para një ore, duhej të ngjante diçka. Po, - mendonte Nushi në vetvete. Po, si atje, ndër malet tona primitive. Duhej të gersiste pushka. T'u bindte i madh e i vogël! T'u lante nderi. Të vdiste dikush e shoqnia të kënaqej. Jo se asht shpirtkeqe, por pse në qytetin tonë asht mërzi e madhe, e me la nderin me pushkë asht një sensacion i madh, i cili nuk të len të mbyllish syt për do net. Por vret merzinë. Mandej nderi, or vlla, nderi, nderi nuk asht ujë, mundet me qenë shampanjë, por ujë jo. Gjithnjë buzeqeshte Nushi dhe herë-herë i kujtohej me frigë se para një ore mundte me të vertete të bajë një gjest donkishotesk. Por shpejt qetsohej dhe buzqeshte tue paraftyrue veten me fes mbi njenin sy, me mustakë të mdhaj, me kobure në dorë, tue qëndrue mbi motrën dhe dashnorin e saj, të dy të vrame mbas shijimit të mollës se ndalueme. M'at akt burror qëndron fisnikeria e racës sonë - thonë moralistat tanë. - M'at akt shtazor qëndron primitiviteti dhe injoranca e vendit tonë - përgjegjet Nushi vet me veti. Une jam pa moral, koncepti i em menduer - mos me than ideologjik - nuk pajtohet me moralin, të cilin mue kjo shoqni ma imponon. Por unë e marr moralin e saj për sy e faqe, nsa mbrapa ia loz lojën kur të due. Keshtu si unë ia lozin lojën shoqnis me qinda veta në vendin tonë. Prandaj, shoqni, po deshe të mos lozin në kurriz tand, ndrro format. Higi bragashat.

Migjeni

- **Romani** – Romani është një lloj tregimi i gjatë narrativ në prozë që shtjellon ngjarje, personazhe dhe tema komplekse. Ai është forma më e përhapur e letërsisë së shkruar, që karakterizohet nga përshkrimi i hollësishëm i jetës, psikologjisë dhe marrëdhënieve njerëzore, shpesh duke reflektuar realitetin ose krijuar botë imagjinare.
  Karakteristika kryesore e romanit është ajo se është shkruar në prozë, jo në vargje, dhe tregon një histori shumë më të gjatë se tregime e novela. Karakterizohet nga një shtrirje e konsiderueshme, që lejon zhvillimin e thelluar të personazheve dhe intrigës. Përfshin ngjarje të shumta, konflikte, kthesa dhe shpesh disa linja rrëfimi. Përbëhet nga elemente si personazhet, mjedisi (vendi dhe koha), dialogu dhe përshkrimi.

Përmbledhje e shkurtër rreth romanit "I PADUKSHËM" nga Eloy Moreno

Romani "I padukshëm" (Invisible) i Eloy Moreno-s është një rrëfim tronditës që ndërthur realizmin me elemente të fantazisë psikologjike për të trajtuar fenomenin e bullizmit.

Ngjarja nis me një djalë i cili ndodhet në një shtrat spitali me lëndime të rënda. Përmes kapitujve të shkurtër dhe fragmenteve të kujtimeve, lexuesi zbulon se djali beson se zotëron një superfuqi: aftësinë për t'u bërë i padukshëm.



Kjo "superfuqi" është në fakt një metaforë për izolimin dhe traumën. Djali bind veten se njerëzit nuk e ndihmojnë apo nuk reagojnë ndaj dhunës që ai pëson sepse ai është "i padukshëm", dhe jo sepse ata zgjedhin të mbyllin sytë.
Libri nuk ndjek vetëm viktimën. Ai jep zë edhe personazheve të tjerë: një bashkëmoshatar i cili ushtron dhunë për të fshehur pasiguritë e tij; shokët e klasës që shohin gjithçka, por heshtin nga frika se mos bëhen viktimat e radhës. Pastaj mësuesit dhe prindërit që shpesh nuk arrijnë të shohin shenjat e qarta të abuzimit, me përjashtim të një mësueseje (e identifikuar shpesh si "mësuesja me tatuazhin e dragoit") që përpiqet të kuptojë të vërtetën.
Ndërsa bullizmi përshkallëzohet dhe bëhet i përditshëm, bota e fantazisë së djalit (e ushqyer nga librat komikë) përplaset tragjikisht me realitetin, duke çuar në aksidentin që e dërgon atë në spital. Në libër, djali shpesh reflekton mbi natyrën e fuqisë së tij, veçanërisht në fragmentin në vijim, ku thotë:

"Problemi është se asnjëherë nuk kam arritur ta kontrolloj mirë atë fuqi: Ndonjëherë, kur kisha më shumë dëshirë të isha i padukshëm, ishte atëherë kur më shihnin më shumë njerëz; dhe paradoksalisht, kur dëshiroja që të gjithë të më shihnin, trupi im vendoste të zhdukej."

Libri godet fort faktin se bullizmi ushqehet nga heshtja e atyre që shikojnë. Vetmia e adoleshencës është ndjenja e të qenit i tepërt ose i pa vërejtur nga bota e të rriturve.

Personazhi i agresorit (bullizuesi) është **MM.** Veprimet e tij ndaj djalit nisin me ngacmime të vogla, por shkallëzohen në një dhunë sistematike fizike dhe psikologjike që e shkatërron djalin emocionalisht. MM e shtynte në korridore, i vendoste këmbën për ta rrëzuar dhe ushtronte forcë mbi të, duke i shkaktuar shpesh lëndime që djali përpiqej t'i fshihte. Ai e tallte djalin para të tjerëve, duke vënë në dukje çdo dobësi të tij dhe duke nxitur shokët e klasës të qeshnin me të. Përdorte frikën për t'u siguruar që askush të mos i dilte në mbrojtje djalit. Ai krijonte një mjedis ku djali ndihej krejtësisht i vetmuar, sikur të mos ekzistonte për askënd. Meqenëse djali nuk reagonte dhe nuk e denonconte, MM e intensifikonte abuzimin, duke e parë heshtjen e tij si shenjë dobësie.

Reagimi i shokëve të klasës është një nga pjesët më të dhimbshme të librit, sepse ata zgjodhën të bëheshin "të padukshëm" me dëshirën e tyre. Kur MM-ja godiste djalin, shumica e shokëve ulnin kokën, shikonin nga dritarja ose bënin sikur ishin shumë të zënë me librat e tyre. Ata nuk donin të shihnin, sepse të shihje do të thoshte të mbaje përgjegjësi. Ata kishin tmerr nga MM-ja. E dinin se po të ndërhynin apo po të tregonin te mësuesit, ata do të bëheshin shënjestra e radhës. Kjo frikë i ktheu në bashkëpunëtorë të heshtur. Disa prej tyre madje qeshnin me talljet e MM-së, jo se u vinte mirë, por për t'u ndier pjesë e "grupit të të fortëve" dhe për të shmangur sulmin ndaj vetes. Ata krijuan një mur heshtjeje rreth djalit. Për personazhin kryesor (djalin), kjo ishte më e rëndë se goditjet e MM-së: ndjenja që, edhe pse je në mes të 20 njerëzve, askush nuk bën asgjë për të të ndihmuar. Megjithatë, ka dy përjashtime të rëndësishme: **Zaro** dhe **Kiri**. Ata vuajnë brendapërbrenda për atë që po ndodh, por edhe ata e kanë shumë të vështirë të thyejnë "ligjin e heshtjes" që ka imponuar MM-ja në shkollë. Zaro (shoku me vragë në vetull) dhe Kiri (vajza me byzylykë), janë dy shtyllat emocionale të djalit, por edhe ata përfaqësojnë betejën e brendshme mes frikës dhe besnikërisë. Zaro është shoku i ngushtë i djalit, por ai mbart një barrë të rëndë fajit. Ai ka një vragë në vetull, që është një shenjë fizike e një guximi të kaluar, por kur nis bullizmi i egër i MM-së, Zaro paralizohet. Për një kohë të gjatë, ai shikon djalin duke u rrahur dhe nuk ndërhyn. Kjo heshtje krijon një krisje të thellë në miqësinë e tyre. Djali ndihet i tradhtuar sepse "padukshmëria" e Zaros dhemb më shumë se grushtet e MM-së, por në fund, është pikërisht Zaro ai që gjen forcën për të treguar të vërtetën. Ai e kupton se të heshtësh të bën po aq fajtor sa agresori. Kiri është një tjetër personazh shumë i veçantë që lidhet me djalin përmes dhimbjes së përbashkët. Ajo mban shumë byzylykë në kyçin e dorës për të fshehur diçka (shenjat e vetëlëndimit). Ashtu si djali që dëshiron të bëhet i padukshëm, edhe Kiri përdor "zhurmën" e byzylykëve dhe aksesorëve për të fshehur heshtjen e saj të brendshme. Ajo është e vetmja që kupton vërtet se çfarë po kalon djali, sepse edhe ajo po lufton me demonët e saj. Ata të dy janë "të huaj" në një botë që nuk i kupton.
Nëpërmjet këtyre peronazheve Moreno tregon se edhe njerëzit e mirë (si Zaro dhe Kiri) mund të gabojnë duke heshtur, por kurrë nuk është vonë për t'u bërë "të dukshëm" dhe për të ndihmuar.

Në fund djali përfundon në spital si pasojë e një aksidenti të rëndë, i cili vjen si kulmi i dhunës psikologjike dhe fizike që ai përjeton në shkollë. Për t'i mbijetuar bullizmit të vazhdueshëm nga **MM**, djali krijon një botë imagjinare ku beson se ka superfuqi. Ai mendon se mund të bëhet i

padukshëm për t'i shpëtuar dhimbjes. Ky besim e shtyn atë të marrë vendime të rrezikshme, duke menduar se superfuqia e tij do ta mbrojë nga ligjet e fizikës. Në përpjekje për t'u zhdukur nga një situatë e padurueshme, ai pëson një aksident që i shkakton lëndime të rënda trupore dhe çrregullim të stresit post-traumatik. Indiferenca e mësuesve dhe shokëve të klasës e bën atë të ndihet aq i vetmuar, saqë humbet lidhjen me realitetin, gjë që çon drejtpërdrejt në tragjedinë që e dërgon në shtratin e spitalit.

Mësuesja (e njohur si mësuesja me tatuazhin e dragoit), një tjetër personazh në roman është figura më kyçe për djalin, sepse ajo është e vetmja e rritur që vërtet **e** "sheh" atë kur të gjithë të tjerët e injorojnë. Roli i saj është si i një detektivi i heshtur sepse ndryshe nga mësuesit e tjerë që i shohin shenjat e dhunës si "lojëra fëmijësh", ajo fillon të lidhë pikat. Ajo vëren ndryshimin në sjelljen e djalit, heshtjen e tij dhe izolimin progresiv. Ajo përfaqëson atë pjesë të shoqërisë që nuk pranon të bëhet "e padukshme" para epërsisë së dhunës. Tatuazhi i saj i dragoit nuk është thjesht estetik; ai simbolizon forcën dhe mbrojtjen, duke u bërë një lloj "spirance" besimi për djalin. Ajo përpiqet të hyjë në botën e tij të mbyllur pa e detyruar. Ajo kupton se djali nuk ka nevojë për pyetje direkte që e bëjnë të ndihet fajtor, por për dikë që t'i tregojë se **ai ka rëndësi**. Roli i mësueses është kritik në zbulimin e të vërtetës pas aksidentit. Ajo nuk dorëzohet para burokracisë shkollore apo indiferencës së kolegëve, duke u bërë zëri i djalit kur ai vetë nuk mundet ose nuk guxon të flasë. Në thelb, Eloy Moreno e përdor këtë personazh për të dhënë mesazhin se mjafton një njeri i vetëm që guxon të shohë, për të ndryshuar fatin e një viktime.

Përfundimi i historisë së MM-së në romanin e është më shumë një reflektim moral sesa një dënim i thjeshtë ligjor, pasi autori fokusohet te pasojat që lë dhuna te të gjithë. Falë dëshmisë së Zaros dhe këmbënguljes së mësueses me tatuazhin e dragoit, "muri i heshtjes" në shkollë shembet. MM nuk mund të fshihet më pas indiferencës së të tjerëve. Ai përballet me pasojat, përjashtohet nga shkolla dhe ndaj tij nisin procedurat disiplinore dhe ligjore. Megjithatë, libri tregon se dënimi më i madh për të është humbja e pushtetit. Ai që dikur sundonte përmes frikës, përfundon i vetmuar dhe i urryer, duke u kthyer vetë në një lloj "të padukshme" por në kuptimin negativ – dikush që njerëzit nuk duan ta shohin më. Autori na lejon të shohim se MM nuk lindi "i keq". Ai kishte vragat e veta (si humbja e gjysmës së gishtit dhe mungesa e dashurisë në familje). Ky detaj nuk e justifikon dhunën e tij, por plotëson mesazhin e librit: dhuna prodhon dhunë. Ndërsa MM përballet me drejtësinë, djali fillon procesin e shërimit. Ai kupton se nuk ka më nevojë të jetë i padukshëm për të mbijetuar, sepse tani ka njerëz që e shohin dhe e duan. Në thelb, MM merr dënimin e merituar shoqëror, por libri mbyllet me shijen e hidhur se e gjithë kjo mund të ishte shmangur nëse dikush do të kishte folur më parë.
Në fakt, i gjithë romani përcjell këtë mbyllje si një thirrje për ndërgjegjësim.

- **Legjenda** (gojëdhëna) - është një rrëfim popullor në prozë ose në vargje që bazohet në një ngjarje historike apo figurë reale, por që gjatë kohës është pasuruar me elemente fantastike dhe trillime. Legjendat përmbajnë ngjarje të pazakonta që shpesh i tejkalojnë rregullat e zakonshme të botës reale. Këto ngjarje mund të jenë magjike, mitologjike, apo të lidhura me përjetësinë. Ato përmbajnë personazhe të veçanta të cilët janë shpesh të idealizuara dhe kanë aftësi të veçanta ose karakterishtika të jashtëzakonshme. Legjendat zakonisht ndodhin në vende të caktuara, të cilat mund të jenë të njohura ose imagjinare.

  Janë pjesë e folklorit të përcjellura brez pas brezi përmes tregimit gojor dhe për shkak të kësaj, ndonjëherë ka versione të ndryshme të një legjende, pasi mund të ndyshojnë gjatë transmetimit. Ndryshe nga përrallat që janë krejtësisht trillim, legjenda ka gjithmonë një pikënisje reale, si një personazh historik, një vend gjeografik apo një ngjarje të shënuar, por ngjarja reale "legjendarizohet" duke i shtuar veti mbinjerëzore personazheve ose duke përfshirë krijesa mitologjike (si zanat, dragonjtë apo orët). Dallimi i legjendës nga llojet e tregimeve tjera është se legjenda nuk ka një kohë të caktuar të zhvillimit të ngjarjes.

  Legjendat kanë pasur ndikim të thellë në letërsi. Ata kanë frymëzuar shkrimtarët dhe poetët për të krijuar vepra të bazuar në tregime legjendare. Shumë pjesë të letërsisë botërore po edhe asaj shqiptare, kanë përdorur motive dhe elemente nga legjendat për të ndërtuar histori, personazhe dhe ngjarje.

BESA E KONSTADINIT

Një vajzë, motra më e vogël e dymbëdhjetë vëllezërve ishte aq e bukur e me aq shumë virtyte, sa nuk e kishte shoqen, ndaj asnjë nga djemtë nuk guxonte ta kërkonte për nuse.
Një ditë prej ditësh, prezantohet dhe kërkon dorën e saj një luftëtar i huaj, i pashëm e i fortë, që vinte nga një tokë e largët.
Nëna me njëmbëdhjetë vëllezërit ishin kundër martesës së tyre, por Kostandini, vëllai i dymbëdhjetë, duke parë dëshirën e motrës i kërkoi nënës që ta pranonte. Nëna e shqetësuar tha: “si t’ia bëj unë ta kem afër vajzen time të vetme në ditë gëzimi e si t’ia bëj unë ta kem afër atë në ditë hidhërimi?” Kështu, Kostandini i premtoi e i dha besën që sa herë që ajo do të donte ta shikonte, ai do t’ja sillte bijën e saj.
Pas dhjetë ditë festimesh, Doruntina, kështu quhej vajza, u nis drej vendit të huaj.

Vitet shkonin, dhe lufta mori me vete njëri pas tjetrit të dymbëdhjetë vëllezërit e saj.
Nëna e mjerë qante me ngashërim derisa një natë ndezi nga një qiri mbi varret e të njëmbëdhjetë djemve. Por, kur shkoi tek Kostandini ndezi dy të tillë e me dhimbje i thirri djalit të saj të vdekur: “Ku është besa jote o bir, tani kush do të ma sjellë mua Doruntinën?!”
Sapo u errësua, Kostandini u çua nga varri i tij. Pllaka e bardhë ju bë kal i zi. Ai fluturoi e fluturoi me erën, teksa kapërcente vende që nuk i kishte parë kurrë.
Në fund të rrugëtimit, arriti në fshatin ku jetonte motra e tij e dashur.
Ajo ishte në një festë, e veshur e gjitha me kadife, duke vallëzuar me gratë e fshatit. U çudit kur e pa të vëllain dhe shkoi ta përqafonte fort. Ai i kërkoi të hipte në kal me të, që ta çonte tek nëna, e veshur ashtu siç ishte.
Gjatë udhëtimit zogjtë ju shkonin rrotull dhe pëshpërisnin: “kalërojnë i vdekuri me të gjallin”. Doruntina i bënte shumë pyetje vëllait se përse rrobat e tij ishin plot me myk, përse flokët e tij ishin me pluhur, e përse ishte aq i zbehtë... Por ai i përgjigjej që ishte udhëtimi që e kishte sjellë në një gjendje të tillë.
Kur ju afruan kishës së fshatit, Kostandini i kërkoi Doruntinës të vazhdonte në këmbë rrugën drejt shtëpisë, pasi ai donte të ndalonte një çast për t’u lutur, në këtë mënyrë gjeti një justifikim për t’u kthyer përsëri në varrin e tij.

Legjendë shqiptare

- **Përralla** - është një lloj i vjetër i tregimit popullore ku ngjarjet dhe personazhet janë tërësisht të trilluara, dhe ku elementi fantastik e i mbinatyrshëm luan rolin kryesor. Ndryshe nga legjendat, të cilat kanë një bazë historike (vende apo njerëz realë), përrallat janë krijime artistike dhe simbolike që nuk pretendojnë të jenë të vërteta.
  Karakteristika kryesore që e dallon përrallën është struktura e saj universal që shumica e përrallave fillojnë me formula si *"Na ishte njëherë..."* dhe përfundojnë me fitoren e së mirës. Ngjarjet në përrallë ndodhin në një kohë të pacaktuar dhe në vende imagjinare (p.sh. "në shtatë male"). Ato japin mësime mbi etikën, të mirën dhe të keqen, duke përdorur alegorinë dhe simbolikën dhe se si personazhi pozitiv, përmes sakrificave dhe ndershmërisë, arrin gjithmonë lumturinë.

VAJZA E ZGJUAR E PLAKUT

Na ishte një herë një mbret i cili thirri një djalë të ri dhe i tha:
- Na këtë lirë që të blesh një dash, prej leshit të dashit dua mbulesë leshi, po dashin të ma sjellësh të paqethur dhe lirën të ma japësh po lirë.
Djali doli në të gjitha anët për të pyetur se si mund të përmbushte kërkesën e mbretit. Rrugës takoi një plak të vjetër.
- O plak, - I tha djali qemë një, u bemë dy. Do të mbajmë shoku – shokun.
-Ç`thotë ky, - mendoi plaku, - unë mezi mbaj veten time, jo të mbaj edhe këtë. Vazhduan rrugën të dy dhe qëndruan te ca varre.
E pyeti djali plakun:
- Në këto varre a ka shumë të vdekur që jetojnë apo të gjithë kanë vdekur? Çuditet plaku me këto fjalë dhe mendon se djali është i çmendur. Mbasi ecën dhe një copë rrugë, kaluan afër një are të mbjellë me grurë. Ky djali, sa e pa grurin i tha plakut:
- Qenka shumë i mirë ky gruri, po nuk e di në e ka ngrënë i zoti apo do ta hajë. Plaku nuk u përgjigj fare. Si u përshendet me djalin, u kthye në shtëpi.
Plaku kishte një vajzë shumë të zgjuar.
-Erdhe baba? E pyeti vajza.
-Erdha po më mërziti shumë një djalë që takova rrugës.
-Pse ç`të tha?- Sa u përshendetëm, më tha: "Hë, sa mirë që u takuam, se do të mbajmë shoku-shokun". – Ti baba, i tha vajza, - se ke marrë vesh se ç`të ka thënë ", sa mirë që u takuam bashkë, se do të kalojmë rrugën pa mërzitje". – Kur shkuam te varrezat,- vazhdoi plaku, më tha:"Në këto varre a ka shumë të vdekur që jetojnë, apo të gjithë kanë vdekur?"
-Baba, po tì se paske marrë vesh. Ai të ka thënë:"A ka në këto varre njerëz që kanë qenë të përmendur për zgjuarësi ose burrëri e që kujtohen edhe sot, apo të gjithë kanë vdekur dhe nuk përmenden më?"- Kur u afruam pranë një are me grurë, më tha:
"Qenka shumë i mirë ky gruri, por nuk e di në e ka ngrënë i zoti apo do ta hajë?"
-Baba , ai të ka thënë se ai që e kishte atë grurë a e ka të tijin apo e ka borxh për ta dhënë.

Po ç`u bë ai djali? Shko çoji diçka për të ngrënë. Vajza bëri bukë, zjeu dhe gjashtë kokrra vezë dhe plaku u nis. Duke shkuar rrugës mendon plaku me veten e tij: "Çì do ky një bukë të tërë dhe gjashtë vezë? Po i ha gjysmën". E pret bukën përgjysmë, ha dhe tri vezë dhe shkon e takon me djalin dhe i jep gjysmën e bukës dhe tri vezët. I mori djali bukën dhe vezët dhe, kur filloi të hajë, i tha plakut:-"Thuaj vajzës sate se hënëza është përgjysmë dhe në qiell duken vetëm tre yje. U kthye plaku në shtëpi dhe i tregoi vajzës çì tha djali.- Po baba, ia paske quar ushqimet të përgjysmuara? I tha vajza.- Po,- i tha plaku, ia qova gjysmën e bukës me tri vezë përsipër. – Ky djali qenka shumë i mençur tha vajza.- Po do të ketë ndonjë hall të madh. Shko merre e sille këtu. Shkoi plaku e mori djalin dhe e solli në shtëpi. Vajza sa e pa, i tha:- Ti do të kesh ndonjë hall të madh,po ma trego mua, se ndoshta mund të të ndihmoj. – Po i tha djali. Dhe i tregoi të gjitha sa i kish kërkuar mbreti.

-Mirë, tha vajza. Me lirën që ke shko bleje një dash të paqethur dhe sille këtu.

Shkoi në Pazar, bleu një dash të madh të paqethur dhe e solli. E mori vajza dashin, e qethi në kurriz dhe ia la leshin të paprekur në pjesën e barkut. E punoi leshin, bëri dy mbulesa të bukura dhe njërën ia dha djalit ta shiste në Pazar për një lirë. Shkoi djali në Pazar, e shiti mbulesën një lirë dhe u kthye te vajza. Pastaj mori dashin e paqethur, mbulesën, lirën dhe ia shpuri mbretit.

Mbreti u kënaq dhe djali u martua me vajzën e mençur.

Përrallë popullore shqiptare

Diskutim

- Paraqitni llojet e veprave epike sipas vëllimit/madhësisë dhe kompleksitetit, përshkruani karakteristikat e tyre dhe diskutoni për ato!

Llojet epiko-lirike

Në gjininë epike dallohen dhe llojet **epiko-lirike** të cilat janë vepra letrare që ndërthurin rrëfimin e ngjarjeve (**epikën**) me shprehjen e ndjenjave dhe botës së brendshme të autorit (**lirikën**). Këto vepra kanë zakonisht një subjekt (ngjarje), ku autori përveçse rrëfen ngjarjet, shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij. Të tilla mund të jenë: **balada, poema lirike, fabula**, por edhe **romani në vargje.**

- **Balada** - është një lloj i veçantë i poezisë epiko-lirike që tregon një ngjarje dramatike, shpesh me përfundim tragjik. Ajo qëndron në mes të ngjarjes (epikës) dhe ndjenjës (lirikës), duke u karakterizuar nga një atmosferë melankolike dhe përdorimi i elementeve fantastike ose legjendave. Balada zakonisht ka subjekt dramatik që përqendrohet në një konflikt të fortë njerëzor, si dashuria e pamundur, besa e thyer ose flijimi. Ka një ritëm të theksuar dhe shpesh shoqërohet edhe me vegla muzikore. Pothuajse gjithmonë përfundon me vdekjen e protagonistëve ose me një dhimbje të thellë dhe përdor refrene ose përsëritje vargjesh për të rritur tensionin emocional.



ANNABEL LI

Ka shumë e shumë vjet
Në një vënt afër në det,
Ish një vajzë që muntni ta njihni tani
Nën emërin Annabel Li;
Dhe kjo vajzë më donte edhe tjatër s'kërkonte
Veç ta deshnja sikundër më desh.

Isha e vogël dhe ish e vogël në vjet
N'atë vënt afër në det;
Po duheshim më tepër se me dashuri
Unë dhe Annabel Li;
Me një dashuri që dhe Engjëjtë lart në lavdi
Që të dyve na kishin zili.

Andaj, tani e shumë vjet,
Tek ky vënt afër në det,
F'ryri veriu nga ret' e ma ngriu
Të bukurën Annabel Li;
Edhe motrat e saj ëngjëllesha
Ma rrëmbyen, ma mbyllën në varr se e desha,
Dhe kështu më la shëndet
Nga ky vënt afër në det.

Engjëjtë që skishin sa ne dashuri
Që të dyve na mbanin mëri.

Po përandaj, siç e dini vërtet,
Tek ky vënt afër në det
Fryri veriu një nat' e ma ngriu
E ma vrau tim Annabel Li.

Dashuria që kishim ish m'e fortë se çdo dashuri,
S'e ka patur as plak as i ri,
As i marr', as i urtë njeri
Dhe as Engjëjt e qiellit në erë,
As demonët përposh në skëterrë;
Shpirtin tim s'munt ta shqitin nga shpirti
I së bukurës Annabel Li.

Se tek hëna që ndrit, syri im ëndërrit
Për të bukurën Annabel Li;
Dhe çdo yll që shkëlqen syt' e ëmbël rrëfen
Të së bukurës Annabel Li;
Nat' e ditë e shoh, edhe zemrën ma ngroh,
Shoq' e dashura ime, e mjera jetime,
Përmi varrin ku deti buçet,
I rri pranë mi varrin në det.

Edgar Allan Poe

- **Poema lirike**- është vepër poetike relativisht e gjatë që fokusohet kryesisht në shprehjen e botës së brendshme të autorit, ndjenjave, mendimeve dhe përjetimeve personale. Për dallim nga poema epike që tregon bëma heroike, ajo lirike "këndon" shpirtin.
- Karakteristikat kryesore të poemës lirike përfshijnë. Ajo nuk synon të rrëfejë edhe një ngjarje historike apo objektive, por pasqyron emocionet e autorit si dashurinë, mallin, dhimbjen apo adhurimin për natyrën. Poema lirike përdor një gjuhë të pasur me rima, ritëm dhe figura stilistike (si metafora dhe epitete) për të krijuar muzikalitet dhe estetik. Edhe pse është më e gjatë se një poezi e thjeshtë, ajo ruan strukturën në vargje dhe strofa, shpesh e ndarë në pjesë që zhvillojnë një gjendje shpirtërore.

POEMA E MJERIMIT

Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,
kafshatë që të mbetë në fyt edhe të zë trishtimi
kur shef ftyra të zbeta edhe sy t'jeshilta
që t'shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita
edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin
të tan jetën e vet derisa të vdesin.

E mbi ta n'ajri, si në qesendi,
therin qiellën kryqat e minaret e ngurta,
profetënt dhe shejtënt në fushqeta të shumngjyrta
shkëlqejnë. e mjerimi mirfilli ndien tradhti.
Mjerimi ka vulën e vet t'shëmtueme,
asht e neveritshme, e keqe, e turpshme,
balli që e ka, syt që e shprehin,
buzët që më kot mundohen ta mshefin -
janë fëmitë e padijes e flitë e përbuzjes,
t'mbetunat e flliqta rreth e përqark tryezës
mbi t'cilën hangri darkën një qen e pamshirshëm
me bark shekulluer, gjithmon i pangishëm.

Mjerimi s'ka fat. por ka vetëm zhele,
zhele fund e majë, flamujt e një shprese
t'shkyem dhe të coptuem me t'dalun bese.

Mjerimi tërbohet n'dashuni epshore.
nëpër skaje t'errta, bashkë me qej, mij, mica,
mbi pecat e mykta, t'qelbta, t'ndyta, t'lagta
lakuriqen mishnat, si zhangë; t'verdhë e pisa,
kapërthehen ndjenjat me fuqi shtazore,
kafshojnë, përpijnë, thithen, puthen buzët e ndragta
edhe shuhet uja, dhe fashitet etja n'epshin
kapërthyes, kur mbytet vetvetja.

Dhe aty zajnë fillin t'marrët, shërbtorët dhe lypsat
që nesër do linden me na i mbushë rrugat.

Mjerimi në dritzën e synit t'kërthinit
dridhet posi flaka e mekun e qirit
nën tavan t'tymuem dhe plot merimanga,
ku hije njerzish dridhen ndër mure plot danga,
ku foshnja e smume qan si shpirt' i keq
tu' ndukë gjitë e shterruna t'zezës amë,
e kjo prap shtazanë, mallkon zot e dreq,
mallkon frytn e vet, mallkon barrn e randë.
Foshnj' e saj nuk qesh, por vetëm lëngon,
e ama s'e don, por vetëm mallkon.
vall sa i trishtueshëm asht djepi i skamit
ku foshnjën përkundin lot edhe të fshamit!

Mjerimi rrit fëmin në hijen e shtëpive
të nalta, ku nuk mrrin zani i lypsis,
ku nuk mund t'u prishet qetsia zotnive
kur bashkë me zoja flejnë në shtretënt e lumnis.

Mjerimi pjek fëmin para se të burrnohet,
don ta msojë t'i iki grushtit q'i kërcnohet,
atij grusht që n'gjumë e shtërngon për fytit
kur fillojnë kllapitë e etheve prej unit
dhe fetyrën e fëmis e mblon hij' e vdekjes,
një stoli e kobshme në vend të buzqeshjes.
Nji fryt kur s'piqet dihet se ku shkon
qashtu edhe fëmia n'bark t'dheut mbaron.

Mjerimi punon, punon dit e natë
tu' i vlue djersa në gjoks edhe në ballë,
tue u zhigatun deri n'gjujë, n'baltë
e prap zorrët nga uja i bahen palë-palë.
Shpërblim qesharak! për qindenjë afsh
në ditë - vetëm: lekë tre-katër dhe "marsh!".

Mjerimi kaiher' i ka faqet e lustrueme,
buzët e pezmatueme, mollzat e ngjyrueme,
trupin përmendore e një tregtis s'ndytë,
që asht i gjikuem të bijë në shtrat vet i dytë,
dhe për at shërbim ka për të marrë do franga
ndër çarçafë, ndër fëtyra dhe në ndërgjegje danga.
Mjerimi gjithashtu len dhe n'trashigim
-jo veç nëpër banka dhe në gja të patundshme,
por eshtnat e shtrembta e n'gjoks ndoj dhimbë,
mund që t'len kujtim ditën e dikurshme
kur pullaz' i shpis u shemb edhe ra
nga kalbsin' e kohës, nga pesha e qiellit,
kur mbi gjithçka u ndi një i tmerrshmi za
plot mallkim dhe lutje si nga fund i ferrit,
ish zan' i njeriut që vdiste nën tra.
Kështu nën kambët'randë t'zotit t'egërsuem -
thotë prifti - vdes ai që çon jetë të dhunuem.

Dhe me këto kujtime, ksi lloj fatkeqësinash
mbushet got' e helmit në trashigim brezninash.
Mjerimi ka motër ngushulluese gotën.

Në pijetore të qelbta, pranë tryezës plot zdrale
të neveritshme, shpirti me etje derdh gotën
n'fyt për me harrue nandhetenand' halle.
E gota e turbull, gota satanike
tu' e ledhatue e pickon si gjarpni-
dhe kur bie njeriu, si gruni nga drapni,
nën tryezë qan-qeshet në formë tragjikomike.
Tê gjitha hallet skami n'gotë i mbyt
kur njiqind i derdh një nga një në fyt.
Mjerimi ndez dëshirat si hyjet errsina
dhe bajnë tym si hejt q'i ban shkrum shkreptima.

Mjerimi s'ka gëzim, por ka vetëm dhimba,
dhimba paduruese qe t'bajnë t'çmendesh,
që t'ap in litarin të shkojsh fill' e t'varesh
ose bahe fli e mjerë e paragrafesh.

Mjerimi s'don mshirë. por don vetëm të drejt!
Mshirë? Bijë bastardhe e etënve dinakë,
t'cilt n'mnyrë pompoze posi farisejt
i bijnë lodërtinës me ndjejt dhelparak
tu' ia lëshue lypsiti një grosh të holl' n'shplakë.

Mjerimi asht një njollë e pashlyeme
n'ballë të njerzimit që kalon nëpër shekuj.
Dhe këtë njollë kurr nuk asht e mundshme
ta shlyejnë paçavrat që zunë myk ndër tempuj.

Millosh Gjergj Nikolla - Migjeni

- **Fabula** - është një zhanër letrar i shkurtër, zakonisht në prozë dhe më rrallë në vargje. Ka qëllim didaktik ose edukues. Fabula përdor tregime simbolike për të dhënë një mësim moral në fund të saj duke kombinuar rrëfimin gazmor e shpotitës, me elementet lirike Personazhet më së shpeshti janë kafshë, por mund të jenë edhe bimë apo objekte të cilave u veshen cilësi njerëzore (personifikimi).
  Çdo fabul përfundon me një mësim të qartë moral, i cili nxjerr në pah një ves apo virtyt njerëzor. Ajo përfshihet nga alegoria sepse ngjarjet dhe personazhet fshehin një kuptim më të thellë që lidhet me shoqërinë dhe sjelljen njerëzore. Është shumë e shkurtër dhe e përqendruar në një konflikt të vetëm që zgjidhet shpejt.

FAMILJA E MILINGONAVE

Një familje milingonash e përbërë nga nëna, babai dhe dy vajzat e tyre të vogla, jetonte e lumtur në shtëpinë e tyre.
Dimri po afrohej shpejt, kështu që e gjithë familja doli në kërkim të ushqimit, përndryshe ata do të vdisnin.
Duke ecur nëpër livadh, ata hasën në një milingonë tjetër, por kjo nuk ishte e së njëjtës specie, pasi ishte e kuqe dhe i mungonin dy këmbë.
E shqetësuar, milingona e kuqe u kërkoi ndihmë për ta marrë në shtëpi, pasi ajo mund të vdiste e varrosur në dëborë.
Milingona nënë tha prerazi jo, pasi ai nuk i përkiste specieve të tij dhe nëse pjesa tjetër e milingonave të zeza do ta zbulonin ata mund ta hidhnin atë jashtë livadhit.
Kështu që familja vazhdoi rrugën e tyre, por njëra nga vajzat nuk mundi të duronte dhe u kthye për të ndihmuar milingonën e kuqe, edhe pse ajo e dinte se ata mund ta dëbonin atë përgjithmonë nga livadhi.
Sapo të dy mbërritën në shtëpinë e milingonave të kuqe, ata u befasuan nga solidariteti i milingonës së zezë, u dhanë atyre të gjithë ushqimin që kishin.
Falë këtij shpërblimi, familja e milingonave të zeza mundi të mbijetojë tërë dimrin falë familjes së milingonave të kuqe.

Popullore

- **Romani në vargje** - është një zhanër hibrid letrar që ndërthur strukturën narrative dhe kompleksitetin e një romani me formën estetike dhe ritmin e poezisë. Karakteristië kryesore e tij është rrëfimi i gjatë. Për dallim nga poezitë e shkurtra lirike, ai ka një ngjarje të mirëfilltë, personazhe të zhvilluar dhe një subjekt që shtrihet në kohë. I gjithë romani shkruhet në vargje (shpesh me rimë dhe metrikë të caktuar), gjë që i jep tekstit një muzikalitet dhe densitet emocional më të lartë se proza. Romani në vargje lejon autorin të futet më thellë në gjendjen shpirtërore të personazheve përmes metaforave dhe figuracionit poetik.

Përmbledhje e shkurtër rreth veprës "SHTEGËTIMET E ÇAJLD HAROLDIT" nga Xhorxh G. Bajroni

Është vepër epike-lirike, një roman në vargje e konsideruar si vepër emblematike e romantizmit. Ndjek udhëtimet e Çajld Haroldit, një fisniku të ri të dobësuar nga një jetë dekadente e të zhgënjyer, i etur për ndryshime i cili vendos të largohet nga Anglia. Niset në një udhëtim nëpër Evropë, duke kaluar nëpër vende të ndryshme si Spanjë, Portugali, Itali, Greqi dhe Shqipëri, duke mediuar mbi lirinë, kulturën antike dhe natyrën e egër. Vepra në tërësinë e saj është një udhëtim romantik ku tema universale është liria e popujve, kontrasti mes lavdisë së kaluar dhe mjerimit aktual, si dhe fuqia shëruese e natyrës. Bie në sy admirimi për natyrën e mrekullueshme të vendeve që viziton Çajldi, duke e pasqyruar atë në përshkrimet epike të peisazheve. Kjo vepër shërben si një lloj ditari i udhëtimeve reale të vetë Bajronit nëpër Mesdhe ku ai shpreh pesimizmin dhe indiferencën ndaj botës, duke kritikuar moralin dhe etikën e shoqërisë së tij. Çajld Haroldi paraqitet si një personazh i vetmuar dhe pesimist, por me një shpirt të madh dhe kërkues, që nuk gjen kuptim dhe qëndrim në botën që e rrethon.
Vepra është e ndarë në **katër pjesë (këngë)** të shkruara në periudha të ndryshme midis viteve 1809 dhe 1818:

- **Kënga I:** Haroldi udhëton në **Portugali** dhe **Spanjë**, ku dëshmon tmerret e luftës kundër Napoleonit dhe vlerëson guximin e popullit spanjoll.
- **Kënga II:** Heroi romantik, viziton **Greqinë** dhe **Shqipërinë** duke qëndruar si bujtës në sarajet e Ali Pashës ku pritet me ndere të mëdha. Bajroni përshkruan me admirim Shqipërinë dhe mikpritjen e Ali Pashë Tepelenës. Ai i portretizon shqiptarët si luftëtarë trima dhe besnikë, ndërsa për Greqinë shpreh dhimbje për humbjen e lavdisë së dikurshme nën zgjedhën osmane.
- **Kënga III:** Heroi viziton fushëbetejën e Vaterlosë në **Belgjikë** dhe shtegton përgjatë lumit Rin në **Gjermani** e **Zvicër**, duke reflektuar mbi natyrën dhe vetminë.
- **Kënga IV:** Zhvendoset në **Itali** (Venedik, Romë), ku autori mediton mbi rënien e perandorive dhe përjetësinë e artit.

“SHTEGËTIMET E ÇAJLD HAROLDIT” – Kënga II (fragmente)

O Shqipëri, ku lindi Iskanderi –
Këngë e rinis’, fanar i t’urtëvet! –
Dhe Iskanderi tjetër, që i dërrmoi
Përherë armiqt me Kordhn’ e tij kreshnike:
Shqipëri, lejomë të kthej syt’ e mi
Mbi ty, o nënë e rreptë burrash t’egër!
Kryqi po zbret, po ngrihen minaretë,
E zbehta hënëz ndrin nëpër lugina
Mbi pyje me selvi n’agor të çdo qyteti.
E zbehta hënëz ndrin nëpër lugina
Mbi pyje me selvi n’agor të çdo qyteti
.....
Agimi lind; me të po çohen brigjet
e Shqipëris’ së rreptë, shkëmb i Sulit,
Dhe larg të Pindit çuka mjegull-veshur,
Të lara përrenjsh të bardhë si dëbora
Me ngjyra mashkullore e kuqërreme.
Dhe ndërsa retë nisin të shpërndahen,
Spikasin tbanat e malësorëve;
Këtu bredh ujku, shqipja sqepin mpreh,
Zogj, bisha, njerëz t’egër zën’ e duken,
Stuhitë rrotull tundin motin që mbaron.

Haroldi tash e ndjeu veten vetëm;
I la shëndenë botës së krishterë;
Po nisej për në trevë të panjohur
– Shumëkush e mburr, pakkush guxon ta shohë; – Pat armatosur parzmën kundër fatit;
Rrezik s’kërkonte, por as nuk i shmangej:
Vërtet qe e egër skena, por e re;
Kjo udhën plot mundim ia bëri t’ëmbël,
Të mos e ndjente dimrin e t’i dukej verë.

Nga Mat i zymtë shqipëtar Haroldi
Kaloi gjer në kërthizë t’Ilirisë
Nër pllajë e male fort të madhërishëm
E vise q’historia s’i kujton:
N’Atik;n e p;rmendur rrall sheh
Lugina kaq të bukura; s’ka Tempja
Stoli q’aty se gjen; Parnasi i dashur,
Me gjithse vend klasik i shejtëruar,
S’krahasohet dot me vise që fsheh ky bregdet.

Kaloi dhe Pindin, gjolin e Janinës,
E la kryeqytetn’ e Vilajetit,
Dhe mori rrugën për të ngjatjetuar
Prijsin e Shqipëris, urdhr’ i të cilit
Është ligj pa ligj, sepse me dorën gjak
Sundon një popull kryengritës trim;
Aty-këtu ndonjë fis guximtar
E kundërshton, e që nga kullë e shkëmbit
I akrohet e s’i bindet kujt, në mos floririt.

Xhorxh G. Bajroni

Diskutim

- Paraqetni dhe shpjegoni tiparet e veprave epiko-lirike duke i dalluar elementet epike dhe ato lirike!
- Krijoni vepra të thjeshta epike për një temë të caktuar!

Dramatika

Dramatika (ose gjinia dramatike) është një nga tri gjinitë kryesore të letërsisë, bashkë me lirikën dhe epikën, e krijuar posaçërisht për t'u shfaqur në skenë përmes interpretimit të aktorëve. Rrjedh nga fjala greke *drâma,* që do të thotë *"veprim", "bëmë"* ose *"ngjarje".*
Karakteristikat themelore të dramës e dallojnë atë nga poezia (lirika) dhe romani (epika) për shkak të natyrës së saj skenike. Karakteristika e parë dhe e veçantë mbi të cilën ndërtohet çdo vepër dramatike është:

- **Paraqitja skenike** ose **vënia në skenë** - është procesi i shndërrimit të tekstit të shkruar në një shfaqje të gjallë që shihet dhe dëgjohet nga publiku. Nëse teksti është "shpirti" i dramës, paraqitja skenike është "trupi" i saj. Elementet kryesore që e përbëjnë paraqitjen skenike janë:
- **Skenografia** - është mjedisi fizik ku zhvillohet ngjarja. Përfshin dekoret (muret, mobiliet, sfondin) që krijojnë iluzionin e vendit (p.sh. një dhomë mbretërore, një rrugë e errët apo një pyll).
- **Kostumografia** - janë veshjet e aktorëve që tregojnë epokën, statusin shoqëror dhe karakterin e personazhit. Një mbret me rroba të grisura jep një mesazh krejt tjetër nga një mbret me rroba kadifeje.
- **Ndriçimi** – është eknikë që përdoret për të krijuar atmosferë. Drita e fortë dhe e bardhë sugjeron gëzim ose të vërtetën, ndërsa hijet dhe drita e kuqe sugjerojnë mister, rrezik ose tension.

Karakteristikat e tjera që dallojnë dramën nga epika dhe lirika janë edhe:

- **Veprimi:** Drama nuk është thjesht rrëfim, por veprim që ndodh "tani". Çdo gjë që mësojmë për ngjarjen vjen përmes veprimit që personazhet bëjnë ose thonë në moment.
- **Konflikti:** Është momenti kryesori i dramës. Pa një përplasje mes dy forcave, drama nuk ekziston. (p.sh. njeriu kundër fatit, dëshira kundër detyrës, ose dy personazhe me qëllime të kundërta),
- **Prologu**:Është pjesa hyrëse e një vepre dramatike (ose letrare) që vjen para se të fillojë akti i parë për t'i treguar publikut se ku dhe kur po ndodh ngjarja, duke kursyer kohë për dialogun që pason. Shpesh jep shenja për temën kryesore ose fundin e veprës.
- **Dialogu:** Është biseda e drejtpërdrejtë midis dy ose më shumë personazheve dhe mjeti kryesor i komunikimit përmes të cilit ne njohim personazhet. Përmes dialogut zbulohet karakteri i personazheve, zhvillohet ngjarja dhe jepet informacioni i nevojshëm për publikun.
- **Monologu:** Kur një personazh flet vetëm në skenë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij më të thella, duke i bërë ato të njohura për publikun.

- **Epilogu:** Është pjesa përmbyllëse e një vepre dramatike që vjen pas përfundimit të ngjarjes kryesore (pas aktit të fundit). Nëse prologu na fut në botën e dramës, epilogu na nxjerr prej saj duke shërbyer si fjalë e fundit. Autori shpesh e përdor epilogun për të përmbledhur mesazhin kryesor që publiku duhet të marrë me vete ose tregon se çfarë ndodh me personazhet që mbijetuan ose si ndryshoi bota e tyre pas ndonjë konfliktit të treguar në dramë.
- **Udhëzimet skenike**: Janë shënimet e autorit, që zakonisht vendosen në klapa, për të udhëzuar aktorët se si të lëvizin, si të flasin (me zë të lartë, me trishtim) dhe si duhet të duket skena (ndriçimi, orenditë).
- **Skena:** Në dramë ka dy kuptime kryesore: **1. Si njësi dramatike** (pjesë e tekstit), ajo është pjesa më e vogël e ndarjes së një vepre dramatike, pra është nënndarje e aktit që shënon një segment të veprimit që zakonisht ndryshon kur një personazh i ri hyn ose del nga skena dhe kur ndryshon vendi ose koha e ngjarjes brenda të njëjtit akt. **2. Si hapësirë fizike** (teatri) ku në kuptimin praktik, skena është platformë e ngritur, pra është vendi në teatër ku aktorët, këngëtarët ose valltarët interpretojnë para publikut.
- **Akti:** Është pjesa kryesore në të cilën ndahet një vepër dramatike . Ai përfaqëson një njësi të rëndësishme të veprimit që zakonisht ndodh në një kohë ose vend të caktuar.
  Një akt përbëhet nga disa skena. Ndërsa skenat ndryshojnë sa herë që një personazh hyn ose del, akti shënon një ndryshim më të madh në rrjedhën e ngjarjes. Tradicionalisht, aktet ndahen nga njëri-tjetri me uljen e siparit (perdes) ose me fikjen e dritave në skenë, gjë që u jep mundësi aktorëve të ndërrojnë kostumet dhe punonjësve të skenës të ndryshojnë dekorin. Çdo akt shërben për të çuar përpara tensionin dramatik. Akti i parë zakonisht prezanton konfliktin, i dyti, i treti etj., e ndërlikon atë, dhe akti i fundit sjell zgjidhjen e ngjarjes.

Diskutim

- Tregoni dhe përshkruani karakteristikat themelore të dramës!
- Njihni dhe interpretoni elemente të strukturës së dramës nëpërmjet analizës specifike të një vepre dramatike!
- Shpjegoni se si një vepër dramatike shndërrohet për shfaqjen skenike!

Historia e dramës dhe e teatrit

Arti dramatik është ndër krijimet më të lashta, pasi nismën e saj e gjejmë qysh te këngët korale. Në shoqëritë e hershme njerëzore, poezitë kanë pasur lidhje të ngushtë me teatrin sepse janë interpretuar në formë lojërash skenike për shfaqjen e ndjenjave dhe në nderim të hyjnive si recitime himnesh e lutjesh dhe në këtë mënyrë janë vënë themelet e artit dramatik.

Historia e dramës dhe e teatrit është një rrugëtim mijëvjeçar që ka evoluar nga ritet fetare, në një formë më komplekse arti që pasqyron shoqërinë. Ata linden në Greqinë e lashtë (shekulli VI p.e.s.) si pjesë e festimeve për nder të Dionisit, perëndisë së verës dhe pjellorisë

Për të kuptuar evoluimin e dramës, është mirë t'i shohim veçoritë e tyre të krahasuara sipas tri periudhave më përcaktuese: **Antikitetit**, **Rilindjes** dhe **Periudhës Moderne**.

- **Periudha e Antikitetit (Greqia e Lashtë)** - Temat kryesore në dramën antike ishin: mitologjia, fati dhe hyjnitë ku heroi kryesorë gjithmonë ishte një fisnik, mbret ose gjysmëperëndi. Konflikti ishte njeriu kundër fatit, që s'ndryshohet dot. Element thelbësor në antikitet ishte kori që komentone dhe mbronte moralin, ndërsa struktura e saj respektonte rreptësisht "tri njësitë": kohën, vendin dhe veprimin. Gjuha skenike ishte poezi e lartë dhe madhështore.
- **Periudha e Rilindjes** - Temat kryesore në dramën e rilindjes ishin: historia, pushteti, dashuria njerëzore dhe heroi kryesorë ishte fisnik ose personazh me peshë të madhe morale. Konflikti kishte në qendër njeriun kundër vetvetes ose kundër rrethanave politike. Në Periudhën e Rilindjes elementi i korit zhduket pothuajse plotësisht si grup, por edhe struktura e dramës nuk respekton njësitë, sepse ngjarja lëviz në vende e në vite të ndryshme, ndërsa gjuha skenike mbetet poezi e pasur, por me përzierje të stilit popullor e tragjik.
- **Periudha e Moderne (shekulli XIX)** - Temat në dramën moderne ndryshojnë plotësisht, ku më shumë hasim psikologjinë e individit, problemet sociale por edhe absurditetin. Personazhi kryesor tanimë është njeriu i thjeshtë, shpesh një anti-hero. Konflikti në dramën moderne e shndërron njeriun kundër shoqërisë ose kotësisë së ekzistencës, ndërsa elementi i korit nuk ekziston fare, por zëvendësohet me monologë të brendshëm. Edhe struktura e dramës moderne bëhet shumë elastike dhe shpesh thyen çdo rregull kronologjik. Për dallim nga drama antike dhe ajo e rilindjes, gjuha skenike në dramën modern është prozaike, e përditshme, shpesh e

Roli i teatrit në zhvillimin e dramës

Në fillimet e saj, drama ishte pjesë e ritualeve fetare. Teatri, si institucion, e shkëputi atë nga altari dhe e solli në skenë. Kjo bëri që drama të mos i shërbente më vetëm perëndive, por komunikimit me publikun dhe kjo lindi dialogun dhe konfliktin njerëzor.
Drama quhet e tillë sepse do të thotë "veprim", prandaj teatri e detyroi shkrimtarin të mos mjaftohej me përshkrime (si në roman), por ta tregonte ngjarjen përmes përplasjes së drejtpërdrejtë.

Nevoja për të mbajtur publikun të vëmendshëm në sallë solli strukturën me akte, kulminacion dhe zgjidhje. Gjatë historisë, teatri ka qenë vendi i vetëm ku njerëzit mblidheshin masivisht.
Në **Antikitet**, teatri e detyroi dramën të merrej me etikën dhe ligjin, për të edukuar qytetarët, ndërsa në **Mesjetë dhe Rilindje**, ai e ktheu dramën në një mjet që pasqyronte pushtetin dhe moralin për të argëtuar mbretërit por edhe popullin, por teatri i kohës **Moderne**, e ka shtyrë dramën drejt provokimit, duke e detyruar atë të trajtojë tema tabu që shoqëria shpesh i fsheh. Edhe nevoja e aktorit për të "jetuar" rolin në skenë e detyroi dramën të zhvillonte thellësinë psikologjike, prandaj edhe shkrimtarët filluan të shkruanin personazhe më kompleksë (si Hamleti), sepse teatri kërkonte diçka më shumë se një skicë; kërkonte një shpirt që mund të interpretohej.

Llojet e dramatike

Llojet e veprave dramatike ndahen në tri kategori kryesore, duke u bazuar te ndjenja që përcjellin dhe përfundimi i ngjarjes, **tragjedia, komedia** dhe **drama**:

- **Tragjedia** - është lloji më i lashtë dhe më i fuqishëm i dramës, që trajton konflikte të rënda dhe heronj që përballen me një forcë më të madhe se veten (fatin, ligjin ose moralin). Tragjedia synon të zgjojë te publiku ndjenja të forta si mëshira dhe frika. Ajo nuk është thjesht një histori e trishtë, por një përplasje madhështore mes njeriut dhe forcave që ai nuk i kontrollon dot. Përfundimi gjithmonë është tronditës ose tragjik, zakonisht me vdekjen e protagonistit.

Përmbledhje e shkurtër rreth tragjedisë “HAMLETI” nga Uilliam Shekspiri

Historia zhvillohet në Danimarkë. Princi Hamlet kthehet në shtëpi pas vdekjes së babait të tij (Mbretit), vetëm për të gjetur nënën e tij, **Gertrudën**, të martuar me xhaxhain e tij, **Klaudin**, i cili ka marrë fronin. Princi Hamlet është i dërrmuar nga kjo martesë, që në kohën e Shekspirit konsiderohej incest dhe që ndodhi shumë shpejt pas vdekjes së babait të tij.

Rojeve të kështjellës u shfaqet një Fantazmë që ka pamjen e mbretit të vdekur. Kur Hamleti e takon, Fantazma i rrëfen se është helmuar në gjumë nga Klaudi dhe kërkon prej djalit të tij hakmarrje.

I pasigurt nëse Fantazma është vërtet babai i tij apo një djall që kërkon ta mashtrojë, Hamleti vendos të shtiret si i çmendur. Kjo i jep liri të vëzhgojë Klaudin pa rënë në sy. Megjithatë, kjo sjellje shkatërron marrëdhënien e tij me **Ofelinë**, vajzën që dashuron. Ajo është personazhi më i pastër në kështjellën e Elsinorit, ku gjithçka është plot gënjeshtra. Ofelia shërben si një kontrast i fortë me **Gertrudën** (nënën e Hamletit) dhe me vetë **Hamletin**. Ndërsa të tjerët luftojnë për pushtet ose hakmarrje, Ofelia thjesht bindet dhe vuan. Sjellja e tillë e Hamletit, gjithashtu, rrit edhe dyshimet e mbretit, i cili vë **Rozenkrancin** dhe **Gildensternin,** dy miqtë e Hamletit, që ta përgjojnë.

Për të vërtetuar fajin e Klaudit, Hamleti angazhon një trupë aktorësh për të luajtur një dramë që imiton vrasjen e babait të tij. Gjatë shfaqjes, Klaudi reagon me tmerr dhe largohet nga salla. Ky është momenti i konfirmimit për Hamletin, por ai përsëri heziton ta vrasë Klaudin kur e gjen duke u lutur, nga frika se shpirti i tij do të shkonte në parajsë.
Në një debat të ashpër me nënën e tij, Hamleti vret gabimisht **Polonin** (këshilltarin e mbretit dhe babanë e Ofelisë), duke menduar se pas perdes ishte Klaudi. Ky krim i jep Klaudit pretekstin për ta dërguar Hamletin në Angli me një letër sekrete ku kërkohej ekzekutimi i tij. Hamleti shpëton falë piratëve dhe kthehet në Danimarkë.

Gjatë mungesës së Hamletit, Ofelia çmendet nga dhimbja dhe mbytet në lumë. Vëllai i saj, **Laerti**, kthehet i tërbuar për hakmarrje. Në këtë rast Klaudi organizon një duel midis tyre, duke helmuar majën e shpatës së Laertit dhe një kupë me verë. **Gertruda** pi verën e helmuar gabimisht dhe vdes. Laerti e plagos Hamletin, por gjatë përleshjes ndërrojnë shpatat dhe Hamleti plagos Laertin. Para se të vdesë, Laerti rrëfen komplotin e mbretit.

Në çastet e fundit, Hamleti vret Klaudin dhe detyron atë të pijë helmin. Vepra mbyllet me vdekjen e Hamletit në krahët e mikut të tij, **Horatit**, ndërsa princi norvegjez **Fortinbrasi** merr kontrollin e mbretërisë së shkatërruar.

“HAMLETI” (fragment)

SKENA V

(Një anë tjetër e platformës)
(Hyjnë FANTAZMA dhe HAMLETI)

HAMLETI

Ku po më shpie? Fol! S’të vinj më tutje

FANTAZMA

Dëgjo-më!

HAMLETI

Urdhëro!

FANTAZMA

Pothua ardhi ora
Të kthehem prapë dhe të hynj në flagët
Prej squfri ku mundohem.

HAMLETI

Plak i mjerë!

FANTAZMA

Mos m’a qaj hallin, po dëgjo, vër re
Ato që vinj të të zbulonj

HAMLETI

Fol, jam gati të të dëgjonj.

FANTAZMA

Dhe m’a merr gjakun, passi të dëgjosh.

HAMLETI

Si?

FANTAZMA

Jam fantazma e tyt-ati.
Dënuar të bares ca kohë natën
Dhe mbyllur ditën në një burk prej zjarri
Gjer sa të digjen e të shuhen krimat
Që bëra më të gjallë. Po të çfaqnja dot
Sekretet e tmerruara të ferrit,
Të thosha gjëra, që m’e lehta fjalë
T’a ngjethte shpirtin e t’a ngrinte gjakun,
Si zj, shkëndija të lëshonin sytë,
Flokët e shtruara të çthureshin,
Dhe qimet lart të ngriheshin nga tmerri
Si drizat e një eshi t’egërsuar,
Po çfaqj’ e amëshimit nukë bën
Për veshët e të gjallëve. Dëgjo, dëgjo!
Tyt-atë n’e patsh dashur ndonjë herë, -

HAMLETI

O Zot!

FANTAZMA

Një vrasje e pabesë sa më s’bëhet,
Pa shpirt, pa turp, pa yëmër sa s’ka më!

HAMLETI

M’a thuaj sa më parë që me krahë
Të shpejtmë dashurie dhe mejtimi
Të fluturoj të t’a marr gjakun.

FANTAZMA

Të shoh që ke dëshirë!
Do t’ishe më I fjetur se mëllaga
Që rritet anës lumit Leth’ e ngjallme,
Po të mos tundeshe. Tani dëgjo!
U-hap se gjoja më kafshoi një gjarpër
Në kopsht tek finja; Danemark’ e tërë
Nga ky raport i rremë u-gënjye
Mi vdekjen time; po mëso, o Hamlet,
Se gjarpëri që t’a kafshoj tyt-atë
Tani I mban kurorën

HAMLETI

Oh, shpirti profetik sikur m’a thoshte Im ungj !

FANTAZMA

Po, ajo shtazë incestare
Dhe adultare, me magjin’ e mëndjes
Dhe me disa dhurata të pabesa –
Sa na gënjen magjija dhe dhurata! –
Fitoj për dashuri të turpishme
Dhe Mbretëreshën time që më dukej
Aq’ e virtytshme! Oh, sa poshtë ra!
Nga unë, q’e kam dashur fjesht me zëmër,
Siç iu-betova ditën e kurorës,
Më ran ë prehër të një faqe-ziu
Katil që, nga dhuratat natyrale,
Përpara meje është liparak,
Po, kur virtyti s’tundet kurr’ – as kur
E nget harvalëria formë-qjell –
Përkundër, vesi, lidhur me një ëngjëll,
Po velet, në një shtrat të perëndishme
Dhe u vërvitet kermave.

Po dale! Se ndjej erën e mëngjezit;
Le t'a shkurtonj pra fjalën. Tek po flinja
Në kopsht, pas drake, pas zakonit tim,
Yt-ungj më vjen në gjum më një shishe,
Plot me një lënk hebone të mallkuar,
Dhe helmin-lepër m'a kullon në vesh.
Efekt' i tij ësht aq' i keq për gjakun
Sa shpejt si hidrargjiri po vrapon
Nër dejt' e arterit' e trupit
Dhe me'një force të befast' e ngin
Si kos' i thartë qumështin – e mpiks
Gjakun' e shëndosh; kjo më ngjau, pra;
Dhe befas cipa nisi e më çfokshej
Dhe me një guaj të shëmtuar zvjedhëze,
I tërë trupi m'u mbula.
Kështu në gjumë më rrembeu vllaj
Jetë, kuror' e mbretëreshë bashkë;
Më vrau mun' e në lulëzim mëkati
Pa myrë, pa pendim e pa kungatë;
Më çoj në gjyq pa lar' asnjë hesap
Me fajel e të zezat përmi kokë!
O tmerr! O tmerr! O tmerr i patreguar
Në qoftë se keg jak, mos e duro!
Mos e ler shtratin mbretëror Danez
Të bëhet grazhd incesti të mallkuar.
Po, sido që t'a ndjekësh këtë punë,
Mos e nxi shpirtin e mos e bëj asgjë
Kundër sat' ëme; lerj'a Perendisë
Dhe gjëmbave përbrënda krahërorit
T'a çpojn' e t'a kafshojnë. Lamtumire!
Shkëndijëzat më thon' – afroj mëngjezi,
Se drit' e tyre e dobët po u zbehetË
Pra, mirëmbetsh e mirëmbetsh! Kujto-më.

(Del).

HAMLETI

O qjell! O Dhe! E ç'të shtonj tjatër vallë?
O ferr? Oh, turp! Qëndo, moj zemër,
Dhe ju, o mushkulla, mos m'u-zbërtheni
Po mbajmëni në këmbë. The, të të kujtonj!
Po, moj Fantazmë! Po, sa kam memorje
Në kokën e trullosur. T'a kujtonj!
Po, po, se nga tabella e memorjes
E shova çdo kujtim të dashur tjatër,
Çdo libër e çdo form' e çdo përshtypje
Të djalëris e t'obeservatës sime
Edhe kumanda jote do të rronj' e vetëm
Në librën dhe vllimin e trupit tim
Pa lëndë më të poshtër! Po, për Zotin!
O grua faqe-zezë!
O vrasës buzë-qeshur, vrasës i mallkuar!
Vërtet, duhet t'a shkruanj në tefter
Që vrasës je dhe prapë buzë qeshur;
Kështu të paktën qënke në Dani.

(Shkruan).

Im unq, këtu të kam! Tani për kryefjalë
"Pra, mirëmbetsh e mirëmbetsh! Kujto-më!"

HORATI dhe MARCELI

(që përbranda). Imzot! Imzot!

MARCELI

Princ Hamlet!

HORATI

Zoti na e ruajtë!

HAMLETI

Ashtu qoftë!

HORATI

Hallo, hallo, Imzot!

HAMLETI

Hallo, hillo, hillo, fajkua, eja!

(Hyjnë HORATI dhe MARCELI).

MARCELI

Si vajti puna, Imzot?

HORATI

Ç'të re na ke, Imzot?

HAMLETI

Oh, të çuditshmë.

HORATI

Imzot, na thuaj.

HAMLETI

Jo, se kam frikë mos tregoni.

HORATI

Për Zotin, kurr' – Imzot.

MARCELI

As un' – Imzot.

HAMLETI

A mund t'ia priste mëndja kujt? Si thoni
Po vall' a do t'a mbani fshehur?

HORATI dhe MARCELI

Për perëndinë, po Imzot.

Uilliam Shekspiri

- **Komedia** - është lloj i gjinisë dramatike që përdor humorin si mjet për të trajtuar dukuri të jetës, duke synuar jo vetëm argëtimin, por edhe edukimin përmes talljes së veseve. Komedia funksionon përmes të qeshurës që lind nga ngatërresat e papritura, keqkuptimet ose rrethanat. Buron nga vetë natyra e personazhit, i cili është i pushtuar nga një ves i tepruar si koprracia, mendjemadhësia, xhelozia dhe hipokrizia. Komedia shërben si një pasqyrë ku shoqëria sheh të metat e veta. Duke qeshur me një politikan të korruptuar ose një prind tiran, publiku në fakt po dënon atë sjellje në jetën reale.
  Ndryshe nga tragjedia që ka një rrugëtim drejt rrënimit, komedia gjithmonë ka përfundim të lumtur.

Përmbledhje e shkurtër rreth komedisë “PAS VDEKJES” nga A. Z. Çajupi

Është një nga komeditë më të mprehta të **Çajupit**, e shkruar në formën e një farse satirike që godet pseudo-intelektualët dhe "patriotët" e rremë të kohës së Rilindjes.

Demaskimi i demagogjisë së xhonturqve dhe i bejlerëve që u bënë vegël e tyre, është vënë në qendër të kësaj vepre. Edhe ngjarjet zhvillohen në zyrat e gazetës "Liria" të këtij klubi, por kuptohet se përmbajtja e komedisë është shumë më e gjerë dhe më e thellë. Ajo zbulohet përmes një situate komike, të gjetur me mjeshtëri prej shkrimtarit. Doktor Adhamudhi vjen në zyrat e "Lirisë" t'i tregojë Skëndo beut abetaren e tij shqipe. Atje doktori sheh rastësisht një nekrologji për deputetin Haxhi Aliu, që ende s'ka vdekur dhe i lind dëshira të dijë edhe ai se ç'do të shkruhet për të pas vdekjes. Këtë dëshirë e shfrytëzon me zgjuarsi shërbëtori i klubit **Zeneli,** i cili fut në vrullin e shakasë së tij dhe të tjerë, mësonjësen **Lulushe** dhe gazetarin **Vurko,** që i vjen rrotull asaj. Por dy janë personazhet më të goditura të veprës: **dr. Adhamudhi** dhe **Zeneli**. **Dr. Adhamudhi**, një personazh që pretendon se është shkencëtar, gjuhëtar dhe atdhetar i madh, por që në fakt është një injorant i fryrë me vetëbesim. Ai ka shpikur një alfabet absurd me 52 shkronja dhe beson se shqipja vjen nga gjuhë të çuditshme. Ai vjen te redaktori i gazetës për të botuar shkrimet e tij "shkencore". **Zeneli,** një djalë i ri, i zgjuar dhe ironik e kupton menjëherë boshllëkun e Adhamudhit. Ai vendos ta tallë atë duke e lëvduar me ironi, për të nxjerrë në pah budallallëkun e tij.

Adhamudhi kërkon lavdi "pas vdekjes". Ai është i fiksuar që emri i tij të mbetet në histori si shpëtimtari i kombit. Ai propozon disa ide absurde. Skena e komikes është dialogu mes Zenelit dhe Adhamudhit ku është edhe kulmi i veprës. Zeneli e "fryen" Adhamudhin duke e quajtur "kolos", ndërsa ky i fundit beson çdo fjalë dhe shton mburrjet e tij deri në absurditet.

Përmes kësaj komedie, Çajupi godet disa fenomene si: **pseudo-patriotizmin**, njerëzit që merren me çështjen kombëtare vetëm për ego personal dhe jo për progres të vërtetë; **diletantizmin**, ata që flasin për shkencë dhe gjuhësi pa pasur asnjë njohuri, duke dëmtuar kulturën dhe **etjen për lavdi**, dëshirën e njerëzve të vegjël për t'u dukur gjigantë në sytë e historisë.
Çajupi përdor ironinë therrëse në këtë komedi, për të treguar se "sharlatanët" si Adhamudhi janë më të rrezikshëm se armiqtë e jashtëm, sepse e korruptojnë kombin nga brenda.



“PAS VDEKJES” (fragment)

ZENELI, ADHAMUDHI

(Hyjnë bashkë nd’odë të klubit, ku gjenden do karreklla, një tryezë në mes, ngarkuar me gazeta, me dorëdoreshkrime. Me të djathtë, një dollap; me të mëngjër, një telefon në mur.)

ADHAMUDHI: (Me zemerim.):

Cudë! S’ë mund të marr vesh! Yt zot, kryetar’ i klubit, me dha fjalë ëe piqemi këtu me 8 pasdreke, dhe ti më thua që s’ka dhe ardhe! I the, bre, se kush jam unë? A i tregove që jam unë, doktor Adhamudht që po rri e pres?...

ZENELI: (Duke qeshur nën buzë):

Doktor efendi, nuk’ i thashë gjësendi beut, se s’është këtu sot!

ADHAMUDHI:

Dreqi të marrtë!...

ZENELI:

Qysh! Mos e thuaj prapë këtë fjalë se...

ADHAMUDHI: Ma paske gjuhnë si bilbil!

ZENELI: (Me vete.):

Qenka i cmendur!

ADHAMUDHI-ZENELI-VURKUA

VURKUA: (Duke hyrë me rrëmbim):

Zenel, a erdhi Skendo beu?

ZENELI:

Jo, zoti Vurko, po s’besoj të menojë. Prit pakëz, në mos ke punë.

VURKUA: (Duke ndenjur.)

Do ta pres të vijë.

ADHAMUDHI: (Madhështor)

Do të rri dhe pakëz, sido që kam punë shumë!

VURKUA: (Në vesh të Zenelit)

Kush është ky?

ZENELI: (Duke folur fort)

Si! S’e njojtke, a? Zotënia është doktor A-dha-mu-dhi nga Frashëri, nga katund’ i Naim beut dhe...

ADHAMUDHI: (I pret fjalën)

Naimi ishte nga katundi im! Msou të flaç!...

ZENELI: (Duke qeshur nën buzë)

Me ndje, zotëni, po... (Duke ulur kryet) më ndje, doktor Adhamudhi!

VURKUA: (Duke qeshur)

Lot a qesh, o Zenel? Cfarë emër ky, më qafsh?

ADHAMUDHI: (I vrenjtur)

Duket s’të pëlqen!

VURKUA: (Me qetësi)

Jo, zotëni, fort i bukur, për besë!

Adham-ati yt’ i pari dhe Uti – emer i dyt’ i Udhisit, si thotë Omeri...



ZENELI: (I habitur)
Ja se ç'domethënë të jesh i ditur! Un' i gjori këtë emer e pandeje shqip... Dhe duke ditur se doktori është' i krishtenë, po mendoneshe se ç'ditë luset shënt Adhamudhi që të vejë ta urojë dhe t'i thoshe: për shumë mot gëzuar!
ADHAMUDHI: (E rëndë)
Sido që duket ky emër, (këqyr Vurkon) un' e kam nderuar!
ZENELI: (Vështron Vurkon):
Vërtet, vërtet! Zotënia është shëronjës i ndëgjuar
ADHAMUDHI:
Dhe shkronjëtor, vjershëtor!
VURKUA: (Duke unjur)
T'u ngjatë jeta, doktor Adhamudhi! Besa gëzonem që njojta sot zotërine tnde! Nder i math, perë zonë! Une jam Vurkua, korrepondenti i gazetes «Rrufeja».
ADHAMUDHI:
A! Qenkej gazetar!
VURKUA:
Ndaj të lutem të më thuash ç'mendonen njerzt' e mëdhenj për Shqipërinë që të shkruajmë në gazetën tonë.
ADHAMUDHI:
Domethënë, ti kërkon sot nga unë «interview»?
VURKUA:
Po, Zotëni, që ta botoj te "Rrufeja".
ADHAMUDHI:
Mos thuaj «Rrufeja» po thuaj "Rrufea"! Rrufe, rrufea; liri, liria dhe jo lirija! Do t'i them dhe Skëndo beut! Kjo gjuhë që përdorni ju sot s'është shqip! Pun' e gjuhës ka rënë në duart të liga dhe kurrë s'ka për të vatur mbarë!... Abetari që përdorni ju sot s'është për të qenë!...
VURKUA: (I mbirë)
Qysh! Po e ka vendosur Kongres' i Manastirit...
ADHAMUDHI: (Me rrëmbim)
Kongres' i Manastirit. ç'është Kongres' i Anastirit? Kush vate? A vajta unë?
VURKUA: (Duke qeshur)
Pse s'vajte, or zot?
ADHAMUDHI:
A! a! Përpara më thoshe: doktor efendi, tani qenkam vetëm zot, se fola të vërtetën! Thash' ato që janë! Dhe guxon të më kërkosh «interview»! Jo, jo, s'kam zakon unë, të jap "interview", jo, për gazetat tuaja.
VURKUA:
S'pandeje kurrë..., s'të dijë për armik të gazetave!
ADHAMUDHI:
Ja ku e msove tani dhe thuaje në gjithë botë me anë të «Rrufesë», në ka njërz të këndojnë të tillë fletë!... Këto janë fjalët e fundit!

A. Z. Çajupi

- **Drama (në kuptimin e ngushtë)** - është lloj gjinisë dramatike që ndërthur elemente serioze me ato të jetës së përditshme. Për ta kuptuar dramën në kuptimin e ngushtë, duhet të shihet si pasqyrën e jetës reale. **Drama bashkëkohore** i referohet veprave teatrore të shkruara nga fundi i shekullit XX deri në ditët tona. Ajo karakterizohet nga një liri e madhe krijuese dhe zakonisht trajtojnë tema që burojnë nga jeta e përditshme dhe tensionet shoqërore. Ajo fokusohet te problemet serioze të njeriut të thjeshtë. Ndryshe nga tragjedia që përfundon gjithmonë me katastrofë, drama mund të ketë një zgjidhje shpresëdhënëse, ose thjesht një fund ku personazhi mëson diçka, edhe pse mbetet i lënduar. Personazhet nuk janë as plotësisht të mirë, as plotësisht të këqij. Ata kanë dobësi, bëjnë gabime dhe shpesh gjenden në udhëkryqe morale.

Përmbledhje e shkurtër rreth dramës "SHTËPI KUKULLE" nga Henrik Ibsen

Tema e kësaj drame është emancipimi i gruas dhe hipokrizia e shoqërisë.
Nora, personazhi kryesor, duket se ka një jetë perfekte me burrin e saj, **Torvaldin**. Por, ajo mban një sekret: ka falsifikuar një firmë për të marrë një hua që t'i shpëtonte jetën të shoqit kur ai ishte i sëmurë. Kur sekreti rrezikon të dalë në dritë, Nora kupton se burri i saj nuk e dashuron vërtet si njeri, por e trajton si një "kukull" apo dekor i bukur në shtëpi. Drama trajton një të vërtet të dhimbshme, sepse përplasja nuk është mes të mirës dhe të keqes, por mes detyrës ndaj shoqërisë dhe detyrës ndaj vetvetes. Kulmi i konfliktit dramatik është kur Nora thyen rregullat e kohës (shekulli XIX) ku gruaja ekzistonte vetëm si "pronë" e burrit. Ajo është personazhi që pëson transformimin më të madh. Në fillim sillet si një fëmijë e llastuar. Hante karamele fshehurazi, kërcente dhe këndonte vetëm për të kënaqur burrin e saj. Ajo besonte se dashuria do të thotë sakrificë e verbër kur ffalsifikoi firmën për të shpëtuar Torvaldin. Por zhgënjimi i saj i madh vjen kur kupton se Torvaldi nuk shqetësohet për sakrificën e saj, por për reputacionin e tij. Kjo e bën atë të kuptojë se ajo kurrë nuk ka pasur një personalitet të vetin.
Torvald Helmer nuk është një kriminel klasik. Ai është një produkt i kohës së vet që beson se është detyra e tij ta mbrojë dhe ta drejtojë gruan si të ishte një fëmijë. Ai e dashuron Norën si një objekt estetik, jo si një partnere. Pika e tij më e dobët është frika nga ajo që thonë të tjerët. Kur Nora e lë, ai nuk shkatërrohet nga dhimbja e humbjes së dashurisë, por nga frika e skandalit.
Krogstad është një tjetër personazh në dramë. Është njeriu që shantazhon Norën. Ai është një njeri i dëshpëruar që po përpiqet të pastrojë emrin e tij për hir të fëmijëve. Kjo e bën dramën më reale: njerëzit bëjnë gjëra të këqija jo se janë të ligë, por sepse janë të shtyrë nga rrethanat sociale. Ndërsa **Zonja Linde** (Kristina) është shoqja e Norës që ka jetuar një jetë të vështirë dhe ka punuar gjithë kohën. Ajo tregon se liria që kërkon Nora nuk është "fushë me lule". Kristina është e lirë dhe e pavarur, por është e vetmuar dhe e lodhur. Asnjë prej këtyre peronazheve nuk është hero apo tradhtar i pastër. Ata janë të gjithë njerëz që luftojnë me rregullat e pashkruara të shoqërisë.
Pasi debaton me Torvaldin dhe kupton se ai nuk e ka dashur kurrë si njeri, por si një pronë, Nora braktis burrin dhe fëmijët për të gjetur veten e saj. Torvaldi, i tmerruar, i thotë se ajo nuk mund ta bëjë këtë, se është e çmendur dhe se po braktis "detyrat e saj të shenjta".
Nora i përgjigjet: *"Kam një detyrë tjetër, po aq të shenjtë... detyrën ndaj vetvetes."*

“SHTËPI KUKULLE" (fragment)

NORA: (pas një heshtjeje) Po ulem. Kemi shumë për të thënë.
TORVALDI: Nora, çfarë është kjo? Kjo fytyrë e ngurtë...
NORA: Ulu. Do të dojë kohë. Kam shumë gjëra për të t’i shpjeguar.
TORVALDI: (ulet përballë saj) Ti më tremb, Nora. Nuk të kuptoj.
NORA: Pikërisht. Ti nuk më kupton. Dhe as unë nuk të kam kuptuar ty – deri sonte... Kemi tetë vjet që jemi martuar. A nuk të bie në sy që kjo është hera e parë që ne të dy, burrë e grua, po ulemi të bisedojmë seriozisht?
TORVALDI: Po çfarë do të thotë "seriozisht"?
NORA: ...Kur isha në shtëpi me babanë, ai më tregonte mendimet e tij dhe unë i ndiqja. Nëse kisha mendime të mia, i fshihja, sepse ai nuk do t'i pëlqente. Ai më quante "kukulla e tij e vogël". Pastaj erdha në shtëpinë tënde...
TORVALDI: Çfarë shprehjeje përdor për martesën tonë!
NORA: (e patundur) Po, është e vërtetë. Kalova nga duart e babait në duart e tua. Ti rregullove çdo gjë sipas shijes sate dhe unë jetoja duke bërë truke për ty, Torvald. Shtëpia jonë s'ka qenë gjë tjetër veçse një dhomë lojrash. Këtu unë kam qenë gruaja-kukull, ashtu siç isha vajza-kukull te babai.
TORVALDI: Ka diçka të vërtetë në ato që thua, ndonëse janë të ekzagjeruara. Por tani e tutje çdo gjë do të ndryshojë. Koha e lojës mbaroi, tani fillon koha e edukimit.
NORA: Edukimi i kujt? I imi apo i fëmijëve?
TORVALDI: Edhe i yti, edhe i fëmijëve, Nora ime e dashur.
NORA: Ah, Torvald, ti nuk je njeriu që mund të më edukojë mua që të jem gruaja e duhur për ty.
TORVALDI: Dhe këtë e thua ti?
NORA: Po unë... po unë vetë, a jam e aftë t'i edukoj fëmijët?
TORVALDI: Nora!
NORA: A nuk e the vetë pak më parë se nuk guxoje t'm'i besoje fëmijët mua?
TORVALDI: E thashë në një moment zemërimi! Pse i kushton rëndësi?
NORA: Sepse kishe të drejtë. Unë nuk jam e aftë për këtë detyrë. Ka një detyrë tjetër që duhet ta kryej më parë. Duhet të edukoj veten time. Dhe ti nuk je njeriu që mund të më ndihmojë në këtë gjë. Këtë duhet ta bëj e vetme. Prandaj po të lë.
TORVALDI: (kërcen përpjetë) Çfarë po thua?
NORA: Duhet të jem e vetme nëse dua të kuptoj veten dhe botën rreth meje. Nuk mund të rri më me ty.
TORVALDI: Je e çmendur! Nuk të lejoj! Të ndaloj!
NORA: Është e kotë të më ndalosh tani. Do të marr me vete vetëm gjërat e mia. Nga ti nuk dua asgjë, as tani, as kurrë.
TORVALDI: Çfarë çmendurie! Do të braktisësh shtëpinë, burrin, fëmijët? Po çfarë do të thotë bota?
NORA: Nuk mund t'i kushtoj rëndësi kësaj. Unë di vetëm që kjo është e nevojshme për mua.
TORVALDI: Oh, kjo është revoltuese! Ti shkel kështu detyrat e tua më të shenjta!
NORA: Çfarë quhen sipas teje detyrat e mia më të shenjta?
TORVALDI: A duhet t'ta them? Detyrat ndaj burrit dhe fëmijëve të tu!
NORA: Unë kam detyra të tjera, po aq të shenjta.
TORVALDI: Jo, nuk ke! Cilat qenkan këto?
NORA: Detyrat ndaj vetvetes.
TORVALDI: Ti je para së gjithash grua dhe nënë.
NORA: Nuk e besoj më këtë. Besoj se para së gjithash unë jam një qenie njerëzore, ashtu siç je edhe ti... ose të paktën duhet të përpiqem të bëhem e tillë.

Henrik Ibsen

- **Antidrama (drama e absurdit)** - është një lloj vepre teatrore që u krijua për të sfiduar dhe "shkatërruar" rregullat klasike të dramës që njiheshin prej shekujsh. E lindur në klimën e pas luftës, kjo dramë i ka rrënjët në filozofinë e ekzistencializmit, si: absurditeti i ekzistencës, paqëndrueshmëria e vlerave, mungesa e komunikimit, dykuptimësia e ndjenjave, shndërrimi i gjuhës në formula të privuara nga domethënia, tjetërsimi etj. Në antidramë është evidente **mungesa** e subjektit (ngjarjes): Në një dramë klasike ka një fillim, një zhvillim dhe një zgjidhje. Në antidramë nuk ndodh asgjë. Personazhet thjesht presin ose përsërisin të njëjtat veprime pa mbërritur askund. Ata nuk janë heronj me biografi të qartë. Shpesh janë qenie të humbura, pa vullnet, që ngjajnë me kukulla ose hije. Ata nuk e ndryshojnë dot fatin e tyre. Dialogu në antidramë është "shurdh". Personazhet flasin, por nuk dëgjohen. Fjalët e tyre janë shpesh pa lidhje logjike, përsëritëse ose boshe, duke treguar se njerëzit e kanë të pamundur të kuptohen me vërtetësi dhe nuk ka një rrjedhë kronologjike (dje, sot, nesër). Koha në antidramë duket sikur ka ndaluar ose sillet në rreth. E nesërmja është identike me të sotmen. Antidrama përdoret për të treguar se bota është e pakuptimtë, e paarsyeshme dhe se njeriu është i vetmuar në një univers që nuk i përgjigjet thirrjeve të tij.

Përmbledhje e shkurtër rreth dramës “PAHINTIKË NË ËNDËRR” nga Xhabir Ahmeti

Është dramë që kombinon elemente të botës së brendshme (ëndrrës) me situata konkrete të jetës. Kjo dramë, shpesh e referuar si një virtualitet i një ëndrre të pahitur ose të pluhërosur, është një vepër që eksploron kufijtë mes realitetit dhe gjendjeve shpirtërore të personazheve. Subjekti sillet rreth idesë së një "ëndrre të pahitur", një gjendje ku gjithçka është e mbuluar nga një pluhur simbolik (pahintika). Personazhet jetojnë në një mjedis që duket i mykur dhe i bllokuar në kohë, ku kufiri mes asaj që po ndodh vërtet dhe asaj që është imagjinare mbetet i paqartë. Personazhet si **Trëndelina** dhe **Barkishi** janë të burgosur të rrethanave të tyre psikologjike që reflektojnë mbi vetminë, pamundësinë e komunikimit dhe absurditetin e ekzistencës njerëzore. Ata mishërojnë bërthamën e konfliktit dhe tematikës së veprës. Nuk janë thjesht njerëz, por simbole të një gjendjeje shpirtërore të rënduar.

Trëndelina përfaqëson figurën femërore që vuan në heshtje dhe që është e mbërthyer në një mjedis mbytës. Emri i saj (një lule) krijon një kontrast të fortë me mjedisin e "pahitur" (të pluhërosur) ku ajo ndodhet. Ajo bart trishtimin e një ëndrre të parealizuar që lëviz në skenë si një hije, duke reflektuar pamundësinë e shpëtimit nga realiteti i mykur që e rrethon. Ndërsa **Barkishi** është figura që përballet me rëndesën e kohës dhe të kujtesës. Ai shpesh shfaqet si personazhi që artikulon absurdin e situatës ku ndodhen dhe është i lidhur ngushtë me konceptin e "virtualitetit" të ëndrrës, duke u përpjekur të gjejë kuptim në një botë që duket sikur ka ndaluar.

Gjyshi është një tjetër personazh që përfaqëson lidhjen me të kaluarën dhe kujtesën i cili shërben si një figurë që dëshmon kalimin e kohës dhe pluhurin që ka mbuluar familjen dhe shtëpinë, kurse **Nëna** paraqitet si një figurë që bart peshën e traditës dhe të vuajtjes së heshtur. Ajo është pjesë e asaj përditshmërie të përsëritur që nuk ofron dalje. Ata që e bëjnë dramën më të ndjeshme janë **Zërat ose Hijet** që nuk janë njerëz fizikë, por mendime që "vijnë nga muret", duke përforcuar ndjenjën e virtualitetit të ëndrrës.

Drama përfundon ashtu siç fillon — në një gjendje letargjie. Personazhet nuk arrijnë të shpëtojnë nga pluhuri. Ata mbeten të ngufatur në virtualitetin e tyre, duke sugjeruar se çlirimi nga kjo ëndërr e hirtë është i pamundur. Të gjithë pranojnë se janë pjesë e një bote që po thërrmohet. Fundi përforcon idenë se njeriu shpesh bëhet rob i kujtimeve dhe i një realiteti që nuk ndryshon dot.

“PAHINTIKË NË ËNDËRR” (fragment)

BARKISHI: (Duke parë përreth me plogështi) Gjithçka është mbuluar. Edhe drita ka marrë ngjyrën e pluhurit. A e ndjen, Trëndelinë?
TRËNDELINA: Është pahintika e rëndë... Ka rënë mbi ne si një vello që nuk hiqet. Unë nuk e di më nëse jemi zgjuar apo nëse kjo është vetëm një pritje e gjatë në prag të një ëndrre tjetër.
ZËRI (si pëshpërimë nga errësira): *Prisni... gjithmonë prisni... pluhuri nuk fshihet, ai bëhet lëkurë.*
BARKISHI: Kush foli? Apo ishte thjesht koha që po thërrmohet mbi muret e kësaj shtëpie?
TRËNDELINA: Janë zërat e asaj që kemi harruar. Ata flasin kur ne heshtim. Barkish, a po na mbulon edhe neve kjo hije?
BARKISHI: (Prek supin e tij sikur kërkon të heqë diçka të padukshme) Çdo lëvizje peshon. Sikur ajri të ishte bërë plumb. Trëndelinë, a po na harrojnë edhe ne, ashtu siç kemi harruar ne botën jashtë?
TRËNDELINA: Botën jashtë? (Qesh me një zë të vakët) Ajo botë ka kohë që është bërë pjesë e kësaj pahintike. Ne nuk jemi më njerëz që presin, ne jemi vetë pritja. Shiko duart e mia... nuk janë më të bardha, janë ngjyra e hirit.
ZËRI (më i fortë, si një kor i largët): *Pluhuri nuk njeh emra... pluhuri njeh vetëm heshtje. Edhe emri yt, Trëndelinë, do të bëhet pluhur.*
BARKISHI: (I tmerruar por i pafuqishëm) Heshtni! Kush jeni ju që na vjedhni edhe emrat? Trëndelinë, më mbaj dorën... të paktën ta dimë që jemi ende këtu, në këtë prag të thyer.
TRËNDELINA: (Nuk e zgjat dorën, shikon drejt errësirës) Jemi këtu, Barkish... por jemi vetëm hije që bisedojnë në gjumin e dikujt tjetër. Edhe kjo dorë që kërkon, është vetëm një vegim i mbuluar nga koha.
BARKISHI: (Zëri i dridhet, ndërsa dora i mbetet pezull në ajër) Si mund të jemi hije në gjumin e dikujt tjetër? Kjo dhimbje që ndjej në kraharor... kjo peshë që më pengon frymëmarrjen... nuk mund të jetë ëndërr! Trëndelinë, më shiko!
TRËNDELINA: (Kthehet ngadalë, por sytë e saj duken sikur shohin tej tij) Të shoh, Barkish, por shoh edhe pluhurin që po të mbulon flokët, rrobat, fjalët. Ti po flet, por zëri yt vjen si nga një pus i tharë. Ne nuk jemi më këtu. Jemi vetëm kujtime që dikush ka harruar t'i fshijë.
ZËRI (tashmë si një oshtimë që vjen nga të gjitha anët): *Asgjë nuk mbetet... vetëm pahintika. Edhe drita që shihni është thjesht pluhur që ndriçon në errësirë.*
BARKISHI: (Bie në gjunjë, duke u përpjekur të gërvishtë dyshemenë) Do ta gjej një vrimë! Një plasaritje në këtë ëndërr! Duhet të ketë një dalje përtej këtij moli që po na gllabëron!
TRËNDELINA: (Ulet pranë tij, por pa e prekur) Mos u mundo. Dalja është vetëm një tjetër dhomë e pluhërosur. Ne jemi brenda vetes sonë, Barkish. Dhe brenda nesh... nuk ka mbetur asgjë tjetër, përveç kësaj pahintike që po na bën të pavdekshëm në harresë.

Xhabir Ahmeti

Fusha programore: *NJOHURI MEDIATIKE*

Fakte dhe opinione

Qasja tek informacionet është e lehtë, kurse sasia e tyre është aq e madhe, saqë shpesh mund të humbasim në to. Po bëhet edhe më e ndërlikuar kur informacionet shtrembërohen, manipulohen ose janë plotësisht të pasakta. Sasia e informacioneve ndonjëherë është aq e madhe saqë bëhet e vështirë të dish se çfarë të besosh dhe cilave burime t'u besohet. Prandaj kemi nevojë për aftësi për analizim, vlerësim, shpërndarje ose krijim të mesazheve për lloje të ndryshme të mediave. Duhet të mësojmë se si të shmangim manipulimet dhe si të marrim kontroll mbi zhvillimin tonë personal kognitiv dhe intelektual, prandaj është më se e nevojshme që fillimisht të njohim dhe të dallojmë faktet dhe opinionet. Çfarë do të thotë të shprehësh një **opinion** dhe çfarë do të thotë të shprehësh një fakt?

Opinioni - është besim ose pikëpamje. Mundet, por nuk është e thënë të bazohet në fakte dhe nuk mund të vërtetoni se vetë opinioni është i drejtë apo i gabuar. Për shembull, dikush thotë se *"Spanja është vendi më i mirë për pushime".* Ju mund të mos jeni dakord me atë, por nuk mundeni ta vërtetoni se kjo është gabim. Një opinion i dhënë mund të trajtojë çështje subjektive në të cilat nuk ka gjetje përfundimtare, ose mund të trajtojë fakte që synohen të kundërshtohen nga gabimi logjik se dikush ka të drejtë për opinionet e tyre. Opinioni ndikon në vendimmarrje dhe në mënyrën se si ne e shohim dhe e perceptojmë jetën tonë.

Përveç kësaj, me ndryshimin e vetë mjedisit mediatik, ndryshon edhe roli ynë në të. Ne nuk jemi më vetëm dëgjues, lexues dhe shikues passive, por jemi edhe krijues dhe shpërndarës të informacioneve. Thjesht duke klikuar "më pëlqen" ose duke ndarë një video, postim, lidhje/link, tekst, audio ose fotografi, ne përfshihemi drejtpërdrejt në procesin e përhapje së lajmit dhe shpërndarjes së informacioneve. Miqtë, familja dhe bashkëpunëtorët tanë e shohin këtë aktivitet dhe, duke na besuar, ndonjëherë gabimisht i konsiderojnë informacionet të besueshme dhe të sigurta, të cilat ne vetë ndoshta nuk i kemi kontrolluar plotësisht.

Faktet - nga ana tjetër, mund të verifikohen dhe të vërtetohen se janë të vërteta ose të pasakta. Gjatë kësaj, duhet të jemi në gjendje të vërtetojmë vërtetësinë ose pavërtetësinë e pohimit me prova. Për shembull, *"Macja është gjitar"* ose "*Maja më e lartë malore në Maqedoninë e Veriut është Korabi me 2753 metra"* janë fakte që shumë lehtë mund të vërtetohen. Fakti është një dëshmi, ngjarje a veprim që ka ndodhur në të vërtetë, që është në përputhje me realitetin objektiv dhe me prova mund të dëshmohet se është e vërtetë.

Duhet të kemi parasysh se deklaratat me fakte gjithashtu mund të jenë **të pasakta.** Për shembull, *"Maqedonia e Veriut ka 10,000,000 banorë"* është një keqinterpretim sepse pretendon diçka që ne mund ta kontrollojmë dhe ta zbulojmë se ky pohim është i rremë. Kjo është paraqitur si fakt, jo opinion, por gjithsesi është i pavërtetë.

Tani provoni të njihni dhe të dalloni faktet dhe opinionet!

	Pohime	Fakt ose opinion
1	Vodno është mal që ndodhet në jug të qytetit të Shkupit.	
2	Sharri është mali më i bukur.	
3	Lufta e Dytë Botërore ishte një konflikt i tmershëm ushtarak.	
4	Lufta e Dytë Botërore ndodhi midis viteve 1939-1945	
5	Muzika klasike përmirëson inteligjencën.	
6	"Meshari" është libri më i vjetër i botuar në gjuhën shqipe.	
7	Toka rrotullohet edhe rreth vetes cdo 24 orë.	
8	Kujdesi për natyrën është prioritet ynë.	
9	Paraqitja dinjitoze duhet të jetë shembull për rininë.	
10	Kushtetuta është akti më i lartë juridik i një shteti.	

Ndonjëherë faktet dhe opinionet mund të gjenden në të njëjtin tekst. Opinionet mund të përmbajnë edhe fakte, por faktet janë atje për të mbështetur qëndrimin e autorit. Nëse janë të shkruara mirë, postimet e opinionit janë një kontribut i rëndësishëm në diskursin publik, por ato jo gjithmonë i përmbahen standardeve gazetareske në të njëjtën masë si mbulimi i lajmeve.

Është e rëndësishme mediat të shënojnë qartë opinionet për të shmangur keqorientimin e publikut se përmbajtja duhet të kuptohet si fakt. Në çdo rast, është thelbësore që autorët të citojnë burimet e fakteve në mënyrë që, lexuesi / shikuesi / dëgjuesi, të mund t'i kontrollojnë ato.

Diskutim

- Shpjegoni dallimin ndërmjet fakteve dhe opinioneve që përdoren në media!
- Ndani faktet nga opinionet në tekste apo në raportime mediatike!
- Analizoni tekste gazetareske për të vërtetuar se si autori kombinon faktet dhe opinionet për të krijuar paragjykime!

Burime të informacionit

Shkëmbimi i shpejtë i informacionit luan një rol të rëndësishëm në formësimin e shoqërive. Në qendër të këtij shkëmbimi janë burimet e informacionit që veprojnë si kanale midis krijuesve të përmbajtjes dhe publikut. Këto burime jo vetëm që ofrojnë lajme dhe njohuri, por ndikojnë edhe në mënyrën se si bota i percepton çështje të ndryshme.

Burimet e informacionit shërbejnë si kanali kryesor përmes të cilit lajmet, idetë dhe opinionet shpërndahen te masat. Në epokën e dixhitalizimit dhe globalizimit, këto media kanë evoluar ndjeshëm. Nga gazetat tradicionale të shtypura te faqet dixhitale të lajmeve dhe platformat e mediave sociale, fushëveprimi i mediave të informacionit është zgjeruar, duke lejuar që informacioni të udhëtojë më shpejt dhe të arrijë audienca më të gjera.

Llojet e burimeve të informacionit mund të jenë:

- **Mediat zyrtare** (radio-televizionionet publike, agjencitë shtetërore të lajmeve, gazetat) - mbeten burime kryesore informacioni për komunikimin masiv. Edhe pse ato mund të mos jenë aq të përhapura sa dikur por, ato ende luajnë një rol vendimtar në formësimin e opinionit publik. Këto media tanimë janë edhe platforma digjitale që janë bërë një burim kryesor informacioni për shumë njerëz duke e bërë kështu më të lehtë për përdoruesit qasjen në lajmet më të fundit në kohë reale.

- **Blogjet dhe rrjetet sociale** - Këto platforma u lejojnë përdoruesve të krijojnë, ndajnë dhe komentojnë përmbajtje, duke çuar shpesh në përhapjen virale të lajmeve dhe informacionit. Mediat sociale kanë demokratizuar mënyrën se si gjenerohen lajmet, duke u lejuar individëve të veprojnë si burime informacioni, duke ndarë përvoja dhe mendime personale që mund të arrijnë miliona njerëz.

Pra, prania në rritje e mediave të informacionit në jetën tonë ka çuar gjithashtu në rritjen e keqinformimit dhe dezinformimit. Përhapja e lajmeve të rreme dhe pretendimeve të paverifikuara mund të shtrembërojë perceptimin publik dhe të krijojë konfuzion.

Si konsumatorë të informacionit, është thelbësore të jemi të kujdesshëm në lidhje me burimet që u besojmë dhe të sigurohemi që mediat në të cilat mbështetemi të ruajnë standarde të larta gazetareske. Gazetari duhe të përdor burimet e informimit që të dëshmojë se informacioni është i besueshëm dhe më pas të ofrojnë raportim të ekuilibruar.

Diskutim

- Tregoni karakteristikat e burimeve të ndryshme të informacionit (media zyrtare, blogje dhe media sociale) dhe shpjegon se si ato ndryshojnë nga njëra-tjetra!
- Analizoni shembuj nga media dhe burime të tjera për të përcaktuar nëse ato janë të vërteta dhe të besueshme.

Fusha programore: *NJOHURI MEDIATIKE*

Vërtetim i fakteve

Vërtetimi i fakteve (fact-checking) është një proces i rëndësishëm i gazetarisë profesionale që synon të verifikojë saktësinë e informacioneve, deklaratave publike dhe lajmeve për të luftuar dezinformimin.

Gazetarët dhe editorët e shërbimit publik janë të detyruar që tu përmbahen parimeve të vërtetësisë, paanshmërisë dhe gjithëpërfshirjes së informacioneve, baraspeshës politike, të cilat qytetarëve ju mundësojnë lirshëm t'i formojnë mendimet e tyre, të respektojnë privatësinë, dinjitetin, autoritetin dhe nderin e individit,

Por përmbajtjet e mediave sociale qarkullojnë pa verifikim dhe kontroll të qartë. Për më tepër, jo të gjithë përdoruesit e kanë zakon të kontrollojnë besueshmërinë e informacionit që marrin dhe të njejtin e ndajnë edhe me të tjerët dhe kjo krijon mundësinë e përhapjes së qëllimshme ose të paqëllimshme të informacionit të rremë dhe të dezinformatave.

Verifikimi i një lajmi të dyshimtë kërkon një qasje kritike dhe përdorimin e disa veglave digjitale të thjeshta. Ja hapat kryesorë që duhet ndjekur:

1. **Kontrollimi i burimit dhe i autorit:**

- **Kush e thotë?** – Verifikohet nëse uebfaqja është e njohur apo ka ndonjë emër të çuditshëm (p.sh. që përfundon me ".com.co" ose imiton media të mëdha).
- **Seksioni "Rreth nesh":** Faqet serioze kanë informacion të qartë mbi pronësinë dhe stafin.
- **Autori:** Kërkohet emri i autorit në Google. Nëse nuk ka autor ose ai nuk ka histori gazetareske, duhet dyshuar.

2. **Përdoret metoda e *"Leximit lateral":***

- Hapen dritare të reja (tabs) në shfletues dhe kërkohet nëse media të tjera të besueshme (si Reuters, AP, apo media kombëtare prestigjioze) po e raportojnë të njëjtën ngjarje.
- Nëse lajmi është "bombastik" por nuk gjendet askund tjetër, ka shumë gjasa të jetë i rremë.

3. **Verifikimi i fotografisë / videos:**
   - Reverse Image Search: Përdoret *Google Images* ose *TinEye* për të parë nëse një foto është e vjetër apo e nxjerrë nga konteksti.
   - Shpesh lajmet e rreme përdorin foto nga luftëra apo ngjarje të viteve më parë për të ilustruar diçka që pretendohet se po ndodh "tani".

4. **I kushtohet vëmendje detajeve teknike:**
- **Data e publikimit:** Shumë herë lajme të vjetra rishpërndahen sikur janë aktuale.
- **Gabimet gjuhësore:** Lajmet e rreme shpesh kanë gabime të shumta ortografike, përdorin shumë shkronja kapitale ose pikaçuditëse të tepërta (!!!).

5. **Përdoren vegla të specializuara**
- ***Google Fact Check Explorer:*** Një motor kërkimi ku mund të shkruani temën dhe të shihni nëse organizatat botërore të vërtetimi i fakteve (fact-checking) e kanë verifikuar atë.
- **Platformat Lokale:** Për lajme në gjuhën shqipe, kërkohet në arkivat e **vertetmates.mk, Faktoje.al, Hibrid.info** ose **Kallxo.com**

Këshillë: Para se të shpërndani (bëni "Share"), ndaloni dhe pyesni veten: "A po ndikon ky lajm te emocionet e mia?", sepse dezinformimi shpesh synon të provokojë zemërim ose frikë për t'u shpërndarë më shpejt.

Diskutim

- Demonstroni procesin e verifikimit të informacionit duke përdorur burimet online dhe veglat për verifikimin e vërtetësisë së fakteve!
- Përcaktoni besueshmërinë e ndonjë informacionit të dhënë duke aplikuar veglat adekuate!
- Zbatoni kriteret për kontrollimin e besueshmërisë së burimeve të informacionit në disa shembuj që merren nga lloje të ndryshme burimesh!

Fusha programore: *NJOHURI MEDIATIKE*

Paragjykimi dhe manipulimi

Paragjykimet dhe manipulimi në media përdoren si mjete strategjike për të kontrolluar narrativën publike, shpesh duke anashkaluar faktet logjike për të nxitur reagime emocionale. Ata nuk futen gjithmonë në mënyrë të hapur, por shpesh, janë të qepura hollë në tekst përmes teknikave psikologjike dhe gjuhësore.

Ja mënyrat kryesore se si ato infiltrohen në media:

1. **Paragjykimi i konfirmimit** - Mediat ofrojnë informacion që përputhet me besimet paraprake të audiencës, duke injoruar qëllimisht provat kundërshtuese.
2. **Përzgjedhja e Informacionit (Cherry-picking)** - Ky është manipulimi përmes **heshtjes**. Media raporton vetëm ato fakte që mbështesin një anë, duke fshehur qëllimisht kontekstin ose faktet që e kundërshtojnë atë. Për shembull: Raportohet për rritjen e pagave, por nuk përmendet që inflacioni është rritur dyfish më shumë.
3. **Përdorimi i "gjuhës së ngarkuar"** - Përdorin fjalë që nxisin emocion (zemërim, frikë, adhurim) në vend të fjalëve neutrale. Për shembull: Në vend që të thuhet *"Protestuesit u mblodhën"*, thuhet "*Një turmë e tërbuar rrethoi ndërtesën".* Kjo e orienton lexuesin të ndiejë frikë pa e analizuar shkakun e protestës.
4. **Kuadrimi (Framing)** - Kjo ka të bëjë me mënyrën se si "paketohet" një lajm. Media vendos se cili është "fajtori" që kur lexon titullin. Për shembull: Një lajm për koston e jetesës mund të kuadrohet si *"Dështim i qeverisë"* ose si *"Krizë globale"*, duke ndikuar direkt në atë se kë do të fajësojë publiku.
5. **Apeli ndaj autoritetit të rremë** - Përdorimi i shprehjeve si *"Burime të besueshme pohojnë..."* ose *"Ekspertët thonë..."* pa emëruar asnjërin prej tyre. Kjo krijon iluzionin e vërtetësisë pa pasur mundësi verifikimi.
6. **Renditja e Lajmeve** - Lajmi që media dëshiron të promovojë vendoset në krye të faqes ose si lajm i parë në kronikë, ndërsa lajmet që i prishin punë interesave të tyre "fshihen" në fund ose në rubrika më pak të vizituara.
7. **Manipulimi Vizual** - Përdorimi i fotove ku një person publik duket i zemëruar ose i shëmtuar për të krijuar antipati.
8. **Efekti i ankorimit (Bias-i i parë)** - Njerëzit priren t'i besojnë informacionit të parë që dëgjojnë. Mediat manipuluese nxitojnë të nxjerrin një version të parë të ngjarjes (edhe nëse është i rremë), sepse e dinë që përgënjeshtrimi i mëvonshëm nuk do të ketë të njëjtin efekt.

Për të kuptuar më mirë dallimin mes përmbajtjeve mediatike të manipuluara (njëanëshme) dhe atyre objektive (të paanshme), të le të marrim një lajm neutral: **Komuna vendos të ndalojë qarkullimin e makinave në qendër të qytetit gjatë fundjavës.**

Ja se si ndryshon raportimi:

1. **Përmbajtja e Njëanshme - e manipuluar dhe me paragjykime.**

Titulli: *"Kaos dhe bllokim: Komuna 'burgos' qytetarët dhe godet bizneset e qendrës!"*

- **Gjuha e përdorur** - fjalë emocionale dhe agresive ("kaos", "burgos", "godet").
- **Burimet e informacionit** - Interviston vetëm një pronar dyqani të zemëruar dhe një shofer që ka mbetur në trafik.
- **Objektiviteti:** Nuk përmend arsyen e vendimit (p.sh. ulja e ndotjes ose siguria e fëmijëve).
- **Saktësia:** Edhe pse fakti (ndalimi i makinave) është i vërtetë, përshtypja e krijuar është e deformuar, duke e paraqitur si një veprim dashakeq.

2. **Përmbajtja e Paanshme (Objektive)**

Titulli: *"Qendra e qytetit bëhet pedonale gjatë fundjavës; Bashkia synon uljen e ndotjes."*

- **Gjuha e përdorur** - Neutrale dhe përshkruese. Përdor folje faktike ("bëhet", "synon").
- **Burimet e informacionit:** Citon zyrtarin e komunës për planin, një ekspert mjedisi për përfitimet dhe transmeton shqetësimin e bizneseve për furnizimin.
- **Objektiviteti:** Paraqet të gjitha anët e medaljes: arsyen mjedisore dhe sfidat logjistike.
- **Saktësia:** Informacioni është i plotë, me të dhëna për oraret dhe rrugët alternative, duke i shërbyer publikut e jo vetëm një agjende.

Këshillë: Pyetja më e mirë që mund t'i bëni vetes kur lexoni një lajm është: "Pse po ma thonë këtë tani dhe çfarë po mungon në këtë përmbajtje?"

Diskutim

- Shpjegoni se si paragjykimet dhe manipulimet futen në përmbajtjen mediatike!
- Shpjegon se si manipulimi i përmbajtjes mediatike ndikon në ndërgjegjësimin dhe në mendimin kritik të audiencës!
- Krahasoni përmbajtjen e njëanshme dhe të paanshme për të përcaktuar dallimet në objektivitet dhe saktësi!
- Analizoni ndonjë përmbajtje të dhënë mediatike (përfshirë titujt e mediave) për të përcaktuar nëse dhe në çfarë mase ato janë të njëanshme apo manipuluese.

Dezinformata dhe lajme të rreme

Dezinformimi dhe lajmet e rreme (fake news) përbëjnë një sfidë globale që synon manipulimin e opinionit publik, veçanërisht përmes rrjeteve sociale dhe mediave digjitale. Ato shpesh përdoren si mjete për të ndikuar në procese politike, zgjedhore dhe për të përhapur teori konspirative ose propagandë në kohë krizash.

Lajmet dhe informacionet jo të besueshme mund të vijnë në disa forma, duke përfshirë:

Dezinformimin (informata të rreme) –që janë krijuar qëllimisht për të mashtruar publikun në lidhje me një person, grup social, organizatë ose shtet të caktuar. Qëllimi është të ndikohet mbi publikun, të krijohet panik, besim i rremë, të dëmtohet reputacioni i dikujt ose të rritet lexueshmëria e një postimi të veçantë.

Misinformin (keqinformimi) - janë informata të gabuara ose informacione që kanë ndodhur si rezultat i një gabimi të paqëllimshëm ose nga injoranca. Media, pas publikimit të këtij informacioni, duhet të njoftojë se është bërë një gabim ose të korrigjojë informacionin.

Malinformimin (informata keqdashëse) - janë informacione që mund të jenë edhe të vërteta, por nuk kanë qëllim informues. Ato synojnë të dëmtojnë dikë, veçanërisht një figurë publike ose një person - ushtrues i ndonjë funksioni. Ky është kryesisht informacion në lidhje me jetën e tij/saj personale, pamjen, intimitetin, shëndetin apo situatën e të afërmve të tij/saj.
që mund të na ndihmojë të mos biem viktimë e mashtrimit të dikujt ose e keqbërjes së dikujt.

Ato janë krijuar për të tërhequr vëmendjen tonë, shpesh me qëllimin për të na detyruar të përgjigjemi emocionalisht. Ky informacion shpesh ndryshon sipas qëllimit të tij, d.m.th, nëse krijuesi po përpiqet të mashtrojë, manipulojë ose të shkaktojë dëme në përmbajtjen e krijuar.

Secili prej nesh është element i rëndësishëm në këtë sistem, sepse jemi mësuar të shpërndajmë përmbajtje nëpërmjet mediave sociale ose t'i transmetojmë atë gojarisht. Aftësia për ta njohur informacionin që mund të jetë i rremë ose manipulues në një farë mënyre është aftësia kryesore e edukimit mediatik që mund të na ndihmojë të mos biem viktimë e mashtrimit të dikujt ose e keqbërjes së dikujt.

Sa herë që pranojmë dhe shpërhapim në mënyrë pasive informacionin pa e kontrolluar dhe pa e verifikuar atë, ne shtojmë zhurmë dhe konfuzion në peizazhin tashmë kompleks mediatik.

Prandaj, ne kemi përgjegjësi të verifikojmë sigurinë e informacionit që ndajmë në rrjetet që përdorim, si dhe vetë krijuesit e përmbajtjes.

Këshillë: Mos harroni të mendoni para se të shpërndani - ju jeni linja më e rëndësishme e mbrojtjes kundër dezinformatave!

Diskutim

- Shpjegoni se si shpërndahen informacionet e rreme nëpër media!
- Shpjegoni dhe diskutoni se si informacioni i rremë ndikon në opinionin publik dhe në vendimmarrje!
- Vlerësoni rëndësinë dhe saktësinë e informacionit duke përdorur burime të verifikuara dhe vegla të ndryshme për verifikim!
- Identifikoni teknikat e përdorura për të krijuar lajme të rreme, të tilla si raportimi selektiv, përdorimi i gjysmë të vërtetave ose nxjerrja e informacionit jashtë kontekstit!